



Rritja e Ndjekësve Pasionantë për Jezusin

Fuqia e
Prindërimit të Qëllimshëm

**Phil dhe
Diane Comer**

Titulli në origjinal:
Raising Passionate Jesus Followers
Phil and Diane Comer

Përkthyen:
Mirela ZEFI
Elisa ZEFI

Redaktoi:
Zefjan NIKOLLA

Botues:
“ERIK” Botime

Arti Grafik & Dizajni:
Denada GEGA
Flori KASAJ

ISBN: 978-9928-275-67-7

Botimi i parë: viti 2021

Tirazhi: 1000 kopje

© **LIBRARI SOKOL ZEFI**

Nuk lejohet kopjimi, riprodhimi, ripublikimi, shpërndarja pa miratimin me shkrim nga Librari Sokol Zefi, i cili zotëron të drejtën ekskluzive të këtij botimi.

“ERIK” Botime
Rr. Kont Urani, Nr. 25, Tiranë - Albania.
Tel.: +355 4 2220645;
Cel.: +355 69 40 66 442;
E-mail: erikbotime@mail.com
Website: www.erikbotime.com

Vlerësime për: Rritja e Ndjekësve Pasionantë për Jezusin

Derisa u bëra prind, nuk e kisha idenë sa përvojë e vështirë, e ndërlikuar, shpërblyese, argëtuese, e lodhshme, intensive dhe ngazëllyese është të shpalosësh një fëmijë në potencialin e tij/saj të plotë. E kam ditur gjithmonë që kisha prindër të mirë, por kur lindi fëmija ynë i parë, u binda vërtet: prindërit e mi ishin nga më të mirët. Shpejt e kuptova se po të mund të isha sa gjysma e babait tim, do të ishte një sukses i jashtëzakonshëm, por nuk do të ishte një punë e lehtë! Pak ditë pas lindjes së Xhudit, ngela duke telefonuar rregullisht mamën ose babin dhe duke u bërë pyetje pa fund. Tani, ndërsa hyjmë në vitet e adoleshencës, kam më shumë pyetje se ç'mund të kem patur ndonjëherë më parë. Prindërit e mi nuk i kanë të gjitha përgjigjet, por ata kanë shumë urtësi për të përçuar tek një brez që po lëkundet nga shpërbërja e familjes në kulturën perëndimore dhe nga dështimet emocionale, relative e shpirtërore që pasojnë. Familja jonë ka ato pikat e saj të dobëta, ashtu si dhe shumë familje të tjera, por deri më sot e tërë familja jonë po ndjek Jezusin dhe për prindërit e mi, ky ka qenë gjithmonë qëllimi numër një. Nëse edhe ju keni këtë qëllim, nuk mund të mendoj për një udhëzues më të mirë në këtë rrugëtim sesa këtë libër. Lexojeni!

John Mark Comer

Sigurisht që nuk ishin të përsosur, por ata ishin të mrekullueshëm. Mësimet që ata japin për prindërimin mund të mos duken revolucionare, por mund të them këtë: shumica e suksesit personal dhe relativ që kam parë në jetën time është për shkak të përpjekjeve të palodhura të prindërve të mi për të më mësuar si të dua mirë, t'u shërbej të tjerëve dhe të njoh Perëndinë më shumë çdo ditë.

Rebekah (Comer) Opperman

Unë dhe bashkëshorti im nuk duam asgjë më tepër sesa t'i rritim të katër fëmijët tanë duke dashur dhe duke i shërbyer Jezusit me çdo pjesë të jetës së tyre. Shumë herë ndihemi pa shpresë të mjaftueshme - fëmijët nuk vijnë me një manual udhëzues! Megjithatë prindërit e mi janë të gatshëm për të pranuar se janë larg përsosmërisë, urtësia që kanë grumbulluar ndër vite duke kërkuar Jezusin dhe duke lejuar mënyrat e Tij t'i japin formë prindërimit të tyre është ar i kulluar. Ne u telefonojmë atyre herë pas here për t'u kërkuar këshilla dhe mendime. Tani jam e entuziazmuar që gjithë këtë urtësi dhe kuptim e kemi të disponueshëm për këdo që po shpreson, ashtu si edhe ne, të rritë brezin e ardhshëm të ndjekësve të pasionuar të Jezusit.

Elizabeth (Comer) Mosser

Bashkëshortja ime dhe unë po hyjmë në vitin e tretë të martesës dhe në një të ardhme të afërt mund të bëhemi me fëmijë. Për këtë arsye, kemi filluar të flasim se si duam t'i rritim fëmijët tanë. Të jem i sinqertë, mendimi është i frikshëm! Ne duam të rritim fëmijë që maturohen duke e ditur se janë të dashur dhe që të dinë të duan mirë. Më së shumti, shpresojmë që të ndjekin Jezusin. Rritja e Ndjekësve Pasionantë për Jezusin na mëson një mënyrë prindërimi dhe rritje të fëmijëve që bën pikërisht këtë. Në këtë libër, babi dhe mami kanë ndarë jo vetëm ide të mira, por metoda praktike që funksionojnë në të vërtetë. Ky nuk është një udhëzues si të jesh prind i përsosur - kjo është e pamundur - por nëse edhe ju keni të njëjtën dëshirë si ne për të prindëruar mirë, atëherë ju inkurajoj ta lexoni këtë libër.

Matthew Comer

"I kam njohur Phil-in dhe Diane-n që nga takimi i tyre i parë. Ecja e tyre me Zotin ka qenë e patëmetë. Martesa e tyre është e fortë dhe e qëndrueshme. Fëmijët e tyre ecin me Zotin dhe i shërbejnë Atij me gjithë zemër. Parimet e dhëna në këtë libër bazohen në Shkrim dhe zbatimet e tyre janë të qarta dhe të dobishme. Lutem që të ndihmojë shumë familje që duan të rrisin fëmijë të perëndishëm dhe dëshirojnë të mësojnë si ta bëjnë këtë nga një çift i perëndishëm, i kujdesshëm, i dashur dhe i mençur."

Luis Palau

Ungjilltar dhe autor

Prindërimi i mençur kërkon që sytë e zemrave tona të ndriçohen nga mentorë të perëndishëm, me përvojë, reflektues, të cilët ndërthurin perceptimet biblike dhe zbatimin me urtësi. Phil dhe Diane Comer na e kanë dhënë këtë në librin Rritja e Ndjekësve Pasionantë për Jezusin. Suksesi i tyre me vetë fëmijët e tyre, plus udhëheqja e tyre pastorale ndaj mijëra të tjerëve, janë themeli i këtij materiali të çmuar.

Gerry Breshears, PhD, Profesor Teologjie, Western Seminary
Portland, Oregon

Phil dhe Diane Comer kanë vërtetuar që janë një burim i paçmueshëm për kishën. Është gjë e rrallë të gesh njerëz që e kanë ruajtur integritetin e tyre përgjatë një jete me shërbesë të frytshme dhe kanë rritur fëmijë që janë ndjekës të Jezusit. Fatmirësisht, duke ofruar urtësinë e tyre përmes materialeve dhe konferencave Prindërimi i Qëllimshëm, çifti Comer po sjellin një zë shumë të nevojshëm në kishë!

Chuck Bomar, pastor i kishës Colossae në Portland, Oregon dhe autor i Better Off without Jesus dhe Losing Your Religion

“Ata paskan folur shqip!” E kam dëgjuar shpesh këtë kompliment lidhur me seminarin Prindërimi i Qëllimshëm, dhuruar vendit tonë nga Phil dhe Diane Comer. Arsyeja nuk ishte që ata kishin kuptuar sfidat e brendshme të familjes shqiptare. Jo! Për më tepër, ata as nuk kishin jetuar në Shqipëri dhe u nevojitej përkthyes. Jo vetëm kaq, por Fili dhe Diana ndajnë plot histori se si kanë dështuar vetë si prindër, dhe mezi janë ngritur sërish në këmbë. Pra, si ia dolën të ushqenin kaq bukur zemrat tona me parime kaq praktike për të rritur fëmijët tanë në mënyrë që të bëhen ndjekës pasionantë të Jezusit? Arsyeja ishte e thjeshtë. Çdo pikë bazohej në një buqetë vargësh nga Bibla. Kaq! Thënë troç, Bibla nuk është shkruar në Amerikë. Shkrimi Jetëdhënës gjen zbatim kudo dhe për çdo bir e bijë të Prindit më të mirë në univers, Atit tonë qiellor. Ndaj po e rekomandoj këtë trajnim për prindërit që nga Vermoshi e deri në Tajlandë. Këto të vërteta do të bekojnë brezin e ardhshëm shqiptar. Merrini, shumojini, dhe nëpër betejat e sërta të jetës, bëhuni gati që një ditë të shijoni mrekullinë e dashurisë qiellore në nipërit dhe mbesat tuaja.

Von Golder

Pastor dhe Misionar në Shqipëri

Të rritim ndjekës pasionantë është një proces shumë i ndërlikuar dhe kërkon së pari prindër të perëndishëm. Duke njohur nga afër familjen e Phil & Diane Comer mund të dëshmoj se ata jo vetëm predikojnë çfarë besojnë, por ata e jetojnë atë që besojnë.

Pa marrë parasysh moshën e fëmijëve tuaj, ky është një nga librat më praktikë dhe plot me këshilla biblike që kam lexuar ndonjëherë mbi prindërimin.

Roland Sula dhe DeAnne Sula

Pastor i Kishës “Nxënësit e Jezusit”

Diane dhe Phil na mësojnë përmes parimeve shumë të thjeshta dhe mënyrave praktike se ndërtimi i kombit fillon në tavolinat tona të ngrënies, në këndet e lojërave dhe në dhomat e fëmijëve tanë përmes një ushtrimi tepër të thjeshtë: duke i mësuar fëmijët tanë të duan Perëndinë dhe të duan të afërmin e tyre. Ne besojmë se sekretin e tyre për një trashëgimi kaq të suksesshme prindërimi është të qenit të vërtetë dhe të dashur kundrejt çdo rrethane.

Edi Gogu, Drejtoreshë Ekzekutive, Profamilja, dhe Toni Gogu,

Zëvendësministër i Drejtësisë, Republika e Shqipërisë

“Rritja e Ndjekësve Pasionantë për Jezusin” është dëshira dhe qëllimi i çdo prindi të krishterë. Por njëkohësisht, është edhe një nga sfidat më të mëdha. Autorët e këtij libri të mrekullueshëm përcjellin tek ne jo vetëm këshilla teorike, por ata ndajnë copëza nga jeta e tyre, përjetime reale, sfida, përballje me problematika që karakterizojnë çdo moshë, dhe mbi të gjitha një model të shëndetshëm e të suksesshëm prindërimi. Jam i sigurt se do të gjeni veten përmes faqeve që do të shfletoni, dhe do të merrni këshilla të mençura për dilemat që mund të keni për sa i përket kësaj teme. Mirënjohje për shërbesën tuaj Phil dhe Diane Comer.

Sokol Zefi

Pastor i kishës “Burimi i Jetës”, Tiranë

Prindërimi në Shqipëri është gërmadhë.

Që kur isha gjashtë javësh, si çdo foshnjë e lindur në Shqipëri gjatë komunizmit, më çuan në çerdhe - një çerdhe e organizuar sipas rregullave komuniste, dhe më pas pa shkëputje fare, shkova në kopsht, ku edhe fjala e parë që mësuam nuk ishte “nënë” por “nëna Parti”, dhe më pas arsimimi ynë në duart e punonjësve të partisë komuniste do të vazhdonte përmes shkollës së mesme e kështu me radhë në çdo fushë tjetër të jetës ku do të hynim, asnjëherë jashtë syrit gjithnjë vigjilent të qeverisë.

Prindërit tanë ishin në punë, që të dy prindërit! I gjithë brezi im u rritëm të arsimuar totalisht nga punonjësit e qeverisë dhe u ushqyem me historitë dhe ideologjinë e tyre. Ndaj, mendoj se ishte e qëllimshme nga ana e komunistëve të mos lejonin prindërit t’i rrisnin fëmijët e tyre - ishte më e lehtë për ta që në atë mënyrë të na distanconin nga çdo ndikim njerëzor. Kështu, ky është brezi im sot - brezi i prindërve të sotëm - ne mund të jemi bërë besimtarë tani, por nuk kemi përvojë të vërtetë nga prindërit tanë se si t’i rrisim fëmijët. Prindërit tanë, gjyshërit e fëmijëve tanë, nuk dinë ndonjë mënyrë tjetër përveç dërgimit të fëmijëve për t’u arsimuar në kopshte dhe shkolla, pasi kështu kanë bërë për vete. Atëherë mirë se vini në “pikënisjen” më të mirë të prindërimin! Prindërimi si fëmijë i Atit qiellor, për të rritur fëmijë në prehrin e Birit të vetëmlindur të Perëndisë që është i vetmi udhëheqës botëror që tha: “I lini fëmijët e vegjël të vijnë tek Unë, sepse e tyrja është mbretëria e Perëndisë”.

Faleminderit Diane dhe Phil Comer për gjithë këshillat që ju sillni në këtë libër për prindërit shqiptarë.

Ylli Doçi

Kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë

Libri “Rritja e Ndjekësve Pasionantë për Jezusin” nga Phil dhe Diane Comer përmbledh mësimin biblik për fuqinë e prindërimit të qëllimshëm. Parimet që parashtron ky libër janë të bazuara në Fjalën e Perëndisë, të mbështetura nga autorë të njohur në fushën e prindërimit, të vërtetuara dhe të ilustruara nga përvoja e familjes Comer. Sa mirë që ky libër vjen në shqip në një kohë kur sfida për rritjen e ndjekësve pasionantë për Jezusin sa vjen e bëhet më reale! Urojmë të lexohet nga të gjithë ata që predikojnë dhe mësojnë Biblën dhe ata që janë bekuar apo presin të bekohen me privilegjin e rritjes së fëmijëve.

Faleminderit Phil dhe Diane Comer për këtë libër të vyer për çdo familje!

Zefjan Nikolla,

Pastor i kishës “Emanuel”, Tiranë

Do të donim të mund t’ju tregonim bllokun e shënimeve nga ajo konferencë i cili u mbush plotësisht. Zakonisht, nuk mbajmë kaq shumë shënime, por në atë konferencë donim të shkruanim gjithçka - nuk donim të humbisnim asnjë nga frazat që folësit po ndanin me ne. Jemi shumë të lumtur që tashmë mund ta kemi edhe në shqip librin “Rritja e Ndjekësve Pasionantë për Jezusin”, pasi na mungojnë libra në shqip që trajtojnë këtë temë.

Genti dhe Djana Shani

Koordinatorë të Jetë Familjare Shqipëri.

Me përvullimin e tyre të sinqertë, integritetin e dashurinë për Perëndinë dhe të tjerët, Phil dhe Diane Comer kanë ndikuar mijëra familje në shtete të ndryshme rreth e qark botës. Lutja jonë është që përmes këtij libri të Prindërimit të Qëllimshëm, edhe më shumë prindër dhe rrjete mbështetëse të familjes dhe miqve do të përqafojnë vizionin për të rritur fëmijë që do të duan Jezusin përmbi gjithçka tjetër.

Pleqtë e Westside: A Jesus Church

Si prindër, dëshira jonë është t’i shohim katër fëmijët tanë të rriten në maturi, si ndjekës të Jezusit, të jenë të disiplinuar dhe të përgatitur në mënyrë adekuate për jetën.

Në këtë liber Phil & Diane flasin nga përvoja personale, duke dhënë këshilla praktike dhe biblike për prindërit (madje edhe për ata që shpresojnë të bëhen prindër një ditë) se si ta bëjnë këtë në mënyrën e duhur!

Sean & Vita Mason

Të dashur miq dhe familje shqiptare,

Në vizitën tonë të parë në Shqipëri, unë zura një mike të mirë - një motër të vërtetë. Ishim ulur e po flisnim së bashku - unë duke u përpjekur të qëndroja zgjuar si pasojë e fluturimit të gjatë dhe ndryshimit të orës, dhe shoqja ime e re duke u përpjekur të vinte djalin e saj të vogël në gjumë mbrapa një skene të ngritur në sheshin Nënë Tereza. Ndërsa Luis Palau po ftonte mijëra t'i jepnin jetën e tyre Jezusit, ne i hapëm zemrat njëra-tjetrës në lidhje me dëshirën tonë të ndërsjellë për të rritur fëmijë që do ta ndiqnin Jezusin me gjithë zemër, si dhe frikërat se vetë thyerjet tona mund të bëheshin pengesë për këtë. Sot e kësaj dite akoma nuk e kuptoj si u lidhëm aq shpejt dhe ngushtësisht në atë udhëtim të parë në Shqipëri. Por ndërsa fluturimet tona për t'u kthyer në këtë vend u bënë të shpeshta, u lidhëm edhe më shumë, e ndërsa edhe mikeshat ime na ka vizituar këtu në SHBA, çdo ndryshim kulturor është venitur duke u zhvilluar një marrëdhënie e vërtetë motërore.

Ndërsa Edi po ndante me mua zemrën e saj, doli në pah diçka: Shqiptarët kanë shumë pak libra të krishterë në gjuhën e tyre. Dhe ndërsa ajo kishte lexuar shumë libra për prindërimin në anglisht, e kishte ëndërr që një ditë të lexonte një të tillë në shqip. Atë ditë, me grupin e lavdërimit të Luis Palaut në sfond që gati po e mbyste bisedën tonë dhe dritat që ndizeshin e fikeshin në skenë, një shpresë lindi në zemrën time:

A do të ishim në gjendje t'u jepnim nënave dhe baballarëve shqiptarë një libër shprese dhe ndihme për rritjen e brezit të ardhshëm të ndjekësve të Jezusit në gjuhën e tyre?

Mund ta merrni me mend tani gëzimin tim ndërsa prezantojmë këtë përkthim të librit tonë, Rritja e Ndjekësve Pasionantë për Jezusin në gjuhën shqipe!

Dhe tani lutem për secilin prej jush që do të lexojë fjalët tona. Pavarësisht nëse jetoni në Alpet madhështore shqiptare në veri, përgjatë vijës bregdetare mahnitëse në jug, apo në fushat midis tyre, ky libër ju sjellte mençurinë që ju nevojitet për të rritur një brez shqiptarësh që do të ndjekin Jezusin me pasion.

Derisa të takohemi ballë për ballë,

Diane dhe Phil Comer

****Dedikuar...***

John Mark dhe Tammy

Rebekah dhe Steve

Elizabeth dhe Brook

Matthew dhe Simona

Si dhe fëmijëve tuaj. . . dhe fëmijëve të fëmijëve tuaj

*Perëndia i urtësisë ju dhëntë gjithçka që ju nevojitet për të rritur
brezin e ardhshëm të ndjekësve pasionantë për Jezusin.*

Ne ia dedikojmë këtë version në shqip të *Rritja e Ndjekësve Pasionantë Për Jezusin*, Toni dhe Edi Gogut, miqve tanë të parë dhe të përhershëm në Shqipëri.

Si dhe ndjekësit pasionant për Jezusin dhe misionarit pionier ndaj popullit shqiptar, Von Golder.

****Falenderime***

Dëshirojmë gjithashtu të falënderojmë...

Landi dhe Dee Sula të cilët organizuan konferencën tonë të parë për pastorët dhe udhëheqësit shqiptarë, misionarin dhe pastorin Sean Mason, pastorin e Foursquare Sokol Zefi, përkthyeset Mirela dhe Elisa Zefi, Zefjan Nikolla për redaktimin e materialit si dhe të gjithë ata që e bënë realitet këtë përkthim.

Përmbajtja

<i>Parathënie nga Emerson Eggerichs</i>	15
<i>Shënim për prindërit</i>	19

Pjesa 1: Hartimi i Planit

Kapitulli 1: Historia Jonë	25
Kapitulli 2: Çmimi	30
Kapitulli 3: Historia Juaj	35
Kapitulli 4: Urdhërimi i Madh	39
Kapitulli 5: Llamba dhe Drita	47
Kapitulli 6: Qëllimet kundrejt Vlerave	56

Pjesa 2: Hedhja e Themelit - Nga Lindja deri në Moshën 5-vjeçare

Kapitulli 7: Zemra e Bindur	65
Kapitulli 8: Mjete për Disiplinim	70
Kapitulli 9: Zemra me Vetëkontroll	99

Pjesa 3: Ndërtimi i Strukturës - Moshat 6 – 12 vjeç

Kapitulli 10: Ndërtojini Ata	111
Kapitulli 11: Kutia	124
Kapitulli 12: Formimi i Karakterit	132
Kapitulli 13: Ndërtimi i Marrëdhënieve	150
Kapitulli 14: Përgatitja Shpirtërore	158

Pjesa 4: Instalimi i Sistemeve Funktionale - Moshat 13–17 vjeç

Kapitulli 15: Katër Gjëra Që Do T'ju Nevojiten	179
Kapitulli 16: Tre Sekretet e Disiplinës	193
Kapitulli 17: Tri Gjëra Që Do T'i Nevojiten Adoleshentit Tuaj	209

Pjesa 5: Përmbyllja e Punës - Moshat 18–22 vjeç

Kapitulli 18: Kutia Tani	231
Kapitulli 19: Lista	235
Kapitulli 20: Vendosja e çatisë	255

Pjesa 6: Hapja e Derës

<i>Kapitulli 21: Bekimi, Kutia dhe Çelësi.</i>	263
<i>Shtesa A: Riparimi</i>	275
<i>Shtesa B: Drejtimi i Fëmijës tek Jezusi</i>	284
<i>Shtesa C: Sugjerime për Lexim</i>	289
<i>Shënime</i>	291
<i>Mirënjohje / Falënderime</i>	302

Parathënie

John Mark Comer është një mësues Bible i jashtëzakonshëm, pastor, drejtues dhe baba i krishterë. Kështu që, kur dëgjova se ai u kishte kërkuar prindërve të tij të jepnin mësim për prindërimin në kishë, kjo ma tërhoqi vëmendjen shumë. Por, m'u ngjeth mishi kur mësova se ai ishte ulur në rreshtin e parë, së bashku me bashkëshorten e tij Tammy, për të mbajtur shënime nga ato që mami dhe babi i tij do të shpjegojnë rreth prindërimit!

Ti thua: “Çfarë?”, “Çfarë the? Ai u ul te këmbët e tyre me laps dhe fletore? Mos po tallesh me mua?”

Nuk ishte shaka. Kur e dëgjova këtë, e dija që po dëgjoja diçka të veçantë, për të mos thënë mahnitëse.

Cili fëmijë i rritur, që ka fëmijë të vetët, jo vetëm që u kërkon prindërve të tij të mësojnë rreth prindërimit, por edhe ai vetë regjistrohet në klasë dhe rezervon vendet nga fillimi?

John Mark Comer e bëri!

Ai e dinte se prindërit e tij kishin bërë diçka të drejtë, diçka të qëllimshme. Ai e dinte se ata e kuptonin çfarë duhej bërë për të udhëhequr dhe motivuar një fëmijë të ketë pasion për Jezu Krishtin.

Tashmë, si baba i ri, ai dëshironte të bënte të njëjtën gjë për pasardhësit e tij. Ai e kishte dëgjuar melodinë, e thënë kështu, përmes prindërimit të prindërve të tij dhe tashmë kishte një dëshirë të madhe për të mësuar fjalët e kësaj melodie prindërimi. Ai ishte i gatshëm të mësonte: çfarë, pse dhe si. Ai ishte i vetëdijshëm se ata kishin ndërtuar diçka tek ai dhe zemra e tij dëshironte të përdorte të njëjtin projekt dhe të njëjtat mënyra.

Mendoj se do të binit dakord që nëse fëmijët tuaj të rritur që tani kanë fëmijë edhe vetë, do t'ju kërkonin t'i mësonit rreth prindërimit, do të ishte një provë që keni vepruar drejt! Mendojeni në këtë mënyrë: tullacët nuk do të shisnin vaj për rigjenerimin e flokëve!

Phil dhe Diane Comer vepruan në mënyrën e duhur! Ata janë prova e vërtetë. I kemi parë nga afër. Ata kanë rritur katër fëmijë të cilët i kanë dedikuar tërësisht jetët e tyre për Krishtin dhe janë martuar me bashkëshortë/e me të njëjtat bindje. Ndaj, kur Phil dhe Diane flasin rreth prindërimit, unë dëgjoj.

Meqë ra fjala, John Mark nuk do të thoshte kurrë se mamaja dhe babai i tij e prindëruan atë në mënyrë perfekte, por ai deklaroi se parimet që ata kanë përdorur kanë qenë biblike, praktike dhe efektive. Shikoni bllokun e tij të shënimeve.

Ah, dhe a ju tregova se John Mark e bindi bashkësinë që të merrnin pjesë në konferencën e prindërve të tij? A e përmenda që drejtuesit e kishës i bindën mamën dhe babin e tij se ata duhet t'ua jepnin këtë mesazh turmave dhe se ata do t'i ndihmonin ta realizonin këtë gjë?

Të gjithë ata që i njohin Phil dhe Diane besojnë në atë që ata janë dhe në çfarë ata përkrahin. Në të vërtetë, njerëzit duan të mbajnë shënime në atë që ata prezantojnë.

A ka nevojë ta them që ata nuk ndihen rehat kur dëgjojnë të tjerët të thonë gjëra të tilla? Sigurisht, ja përse unë doja ta shkruaja këtë hyrje. Dikush duhet ta thotë!

Për ta përmbyllur: mesazhi i këtij libri bazohet në të vërtetat biblike dhe eksperiencat jetësore të dy prindërve, të cilët i kanë zbatuar këto të vërteta besnikërisht te fëmijët e tyre. Nuk ka asnjë premtim në Bibël që fëmijët do të ndjekin Krishtin me një dashuri të thellë e plot pasion për Të, për shkak se prindërit e tyre respektojnë parimet e përcaktuara në këtë libër. Sidoqoftë, lind pyetja: pse të mos e bëjnë ata?

Kur një baba dhe një mama e duan Krishtin përlësisht dhe krijojnë mjedisin më të dashur që një fëmijë mund të njohë, përse të mos zgjidhte fëmija besimin dhe vlerat e prindërve? Fëmijët kërkojnë vërtetësi. Ata janë në gjendje të dallojnë kush është i vërtetë. Ky libër do t'ju frymëzojë që ju të jeni ky person dhe prind. Më pas, ndoshta një ditë, fëmijët tuaj - si të rritur e me fëmijë të tyre - do të vijnë e t'ju pyesin: "Mami, babi, më tregoni si keni vepruar kur më rritët mua. Dua të ndjek modelin tuaj".

Sa për Phil dhe Diane, cilët janë ata? Phil është një udhëheqës i urtë dhe i perëndishëm. Ai ka drejtuar shërbesa adhurimi rreth e qark botës për Luis Palau, dhe ka themeluar Westside: A Jesus Church -- Kishën e Jezusit, në Portland, Oregon, e cila është pjesë e një lëvizjeje të madhe kishash. Mijëra persona erdhën javë pas javë që të dëgjonin pasionin e tij për Biblën. Të njohësh Phil është ta duash atë. Të gjithë e duan. Më besoni. Phil është modeli i kritereve të një pastori sipas 1 Timoteut 3:2-5, që mbikëqyr kishën lokale:

“Peshkopi duhet të jetë i patëmetë, burrë i një gruaje të vetme, të jetë i përmbajtur, i arsyeshëm, i sjellshëm, mikpritës, mësues i zoti, të mos jetë i dhënë pas verës ose pijeve dehëse, të mos jetë i dhunshëm, të mos jetë lakmues i fitimeve të turpshme, por i butë, jo grindavec, të mos dojë paranë; njeri që e qeveris mirë shtëpinë e vet dhe i ka fëmijët të bindur me çdo lloj mirësjelljeje (por në qoftë se dikush nuk di të qeverisë familjen e vet, si do të kujdeset për kishën e Perëndisë?)”.

Bazuar në këtë pasazh, Phil e ka qeverisur mirë shtëpinë e tij, gjë që shpjegon se përse është kujdesur për kishën e Perëndisë dhe përse ai dhe Diane kanë shkruar këtë libër. Shumë pak veta kanë jetuar ashtu si Phil. Çdo person që e njeh personalisht do t'u thoshte “Amen” komenteve të mia.

Sa për Diane, Perëndia e krijoi atë me një bollëk talentesh, një nga të cilët është të shkruarit. Por gjëja më mbresëlënëse është karakteri i saj. Bashkëshortja ime Sarah dhe unë kemi qenë të prekur thellësisht nga zemra e Diane dhe dashuria e saj për Krishtin. E dini, Diane ka vuajtur, siç shkruan në librin e saj *Ai Flet në Heshtje*:

“Kur isha 26 vjeçe, u diagnostikova me një humbje progresive dëgjimi - po bëhesha e shurdhër. Doktorët më dhanë shumë pak shpresë për kurim, ndërsa më këshillonin që të përshtatesha me aparatet e dëgjimit duke më paralajmëruar se me këtë ritëm humbjeje, brenda pak

vitesh do të isha krejt e shurdhër. Kisha tre fëmijë të vegjël, një burrë të perëndishëm, dhe një teologji të paformuar mirë që nuk mund ta pranonte konceptin se Zoti do të lejonte që ta humbisja dëgjimin. Besimi im filloi të shpërbëhej po aq shpejt sa edhe dëgjimi im”.

Ky libër do të zbulojë çfarë bëri ajo si përgjigje. Megjithatë, mund t’ju them diçka. Kur Diane qëndron në heshtje, ajo dëgjon nga Perëndia. Si pak njerëz, ajo dëgjon zërin e padëgjueshëm të Jezusit. Ky libër është pjesë e urtësisë që Ai i ka dhënë asaj gjatë momenteve të qëndrimit në heshtje. Faleminderit Diane, që na tregon se çfarë Ai të ka folur ty në qetësinë tënde.

A jeni gati ta ndërtoni shtëpinë tuaj si një shtëpi ndjekësish të pasionuar për Jezusin? Ky libër parashton planin, themelin, strukturën dhe pjesën që mbetet. Atë që kanë bërë Phil dhe Diane, mund ta bëni edhe ju.

Në rregull, le të fillojmë. Le të mësojmë se çfarë John Mark mësoi në këmbët e prindërve të tij.

Një Shënim për Prindërit

Fëmijët janë thesari juaj më i madh. Edhe kur debatojnë ose zihen, edhe kur rrëmuat e tyre i bëjnë lëmsh planet tuaja dhe vështirësitë e tyre ju stresojnë. Po, edhe atëherë.

Në ato momentet e para të mbushura me pasiguri pas agonisë së lindjes, e mban foshnjën tënde pranë dhe të merret fryma. E vërteta ushtron presion mbi shpatullat e tua sikur të ishte pesha e gjithë botës. *Është një njeri, një qenie njerëzore.*

Jo një embrion, jo një fetus - një qenie e gjallë, e vërtetë, me personalitet, me qëllim, me potencial!

Ky është momenti kur dyshimet e tejshpojnë mahnitjen tënde dhe të bëjnë të biesh në gjunjë. Çdo frikë, çdo dështim, çdo gjë e pamatur, e pamend që ke bërë ndonjëherë venitet përmes plasaritjeve të tua të dobëta si një përmbytje e çastit. Gjithë frikërat e tua të pathëna bashkohen me lëndimet që keni mbartur nga gabimet që prindërit tuaj kanë bërë. Si një lumë i fryrë që nuk përmbahet, kjo e vërtetë ju çon me shpejtësi në mënyrë të pakontrollueshme në përfundimin që ju shtang:

Ky është fëmija juaj.

Ju mbani në duar potencialin për ta lënduar, për ta dëmtuar, për ta larguar nga Perëndia. Një frikë që agon bërtet në veshin tuaj:

Mos e prish këtë!

Çfarë duhet të bëjmë? Si duhet të veprojmë? Po sikur të bëjmë ndonjë gabim dhe ky fëmijë që e duam kaq fort papritur rritet dhe vendos të mos e ndjekë Jezusin?

Ky libër përmban përgjigjet që kemi kërkuar kur shtrëngonim duart në lutje, kur agjëronim, kur kërkonim urtësi herë pas here. Morëm ditaret që Diane kishte mbushur, të renditur në dosjet e fryra të Phil. Më pas studiuam dhe shtuam më tepër: të gjitha gjërat që uronim t'i kishim ditur. Më shumë se tri dekada duke pyetur e duke gërmuar, duke studiuar e mësuar; të vërtetat që kemi mbledhur e grumbulluar, të mësuara e të zbatuara. Ky libër i ngjan shumë një grafiku mëkimi hap pas hapi të shpirtit të fëmijës dhe është i realizueshëm.

Duke shfrytëzuar dekadat e studimeve intensive të Shkrimit, përafërsisht dyzet vite duke drejtuar/pastoruar njerëzit, si dhe një raft librash që rënkon nga pesha e urtësisë së brezave të tërë, kemi përpiluar ato që kemi mësuar në mënyrë që ju të keni atë që ne na nevojitej dëshpërimisht kur rritnim fëmijët tanë: një udhëzues për përgatitjen shpirtërore të fëmijës tuaj.

Ato që nuk do të gjeni në këtë libër janë garancitë. As nuk do të largoheni me ndjesinë se prindërit e përsosur rritin fëmijë të përsosur. Por gjithashtu ne premtojmë që s'do t'ju japim disa parulla të gatshme që ju lënë të paditur dhe të keqpajisur.

Në fakt, ne ju ftojme në historinë tonë jo të përsosur, të rrëmujshme e të thyer, në mënyrë që të gjeni copëza të Shpenguesit dhe hirin e mrekullueshëm të cilin Ai me kënaqësi e sjell në familjen tonë jo ideale.

Jezusi me të cilin ne donim që fëmijët tanë të binin në dashuri ishte Ai që, kur u sfidua lidhur me kohën që Ai kalonte me mëkatarët famëkeq, deklaroi në mënyrë të prerë se zemra e Tij ishte për ata që e dinë gjendjen e tyre të dëshpëruar dhe e njohin nevojën që kanë për Të.¹ Kemi mbajtur shënim dhimbjet e mëdha të shkaktuara nga gabimet që kemi bërë dhe gjërat që uronim t'i kishim bërë ndryshe. Shpresa jonë është që ju të mësoni prej gabimeve tona, po aq sa edhe nga këto të vërteta që do të ndajmë.

Si dy persona që filluan me shumë pak për të ofruar, tani ne po korrim shpërblimet e të rriturit të katër fëmijëve që e kanë përkushtuar jetën e tyre plotësisht në Zotin dhe janë martuar me bashkëshortë/e që jetojnë për të nderuar Jezusin.

Tashmë puna jonë ka ndryshuar: ne po bëjmë gjithçka që mundemi për të ndihmuar fëmijët tanë të rritin brezin e ardhshëm të ndjekësve të Jezusit.

Së pari dhe kryesisht ky libër është shkruar për ta —John Mark dhe Tammy, Matt dhe Simona, Rebekah dhe Steve, Elizabeth dhe Brook— dhe për brezat e ndjekësve të Jezusit që do të vijnë.

Në këtë libër, ne ecim me ju përmes çdo faze të jetës së fëmijës tuaj, duke filluar nga lindja. Ne ofrojmë shembuj praktik e të arritshëm për ju, “kështu ka ndodhur në shtëpinë tonë”, në mënyrë që t'i përshtatni me rrethanat tuaja specifike.


Në të njëjtën kohë, ne hedhim bazat teologjike për rritjen e fëmijës tuaj për të dashur dhe për të shkuar pas Perëndisë, duke ju dhënë një kuptim më të thellë për mënyrën se si Perëndia kujdeset për ne si një Atë. Ne zbërthejmë pasazhe kyçe të Shkrimit, të kontrolluara e të rikontrolluara nga studiues në fushën e teologjisë dhe të gjuhëve origjinale.

Si përfundim, ne ju ndihmojmë të krijoni planin tuaj që në mënyrë të qëllimshme t'i sillni fëmijët tuaj në një lidhje të ngushtë dhe personale me Krishtin që do të zgjasë e do të rritet gjatë gjithë pjesës tjetër të jetës së tyre.

Në këtë përfundim përfshijmë:

1. Si të dizenioni tek fëmija juaj një zemër që dëshiron vërtet të bindet.
2. Një çelës befasues mbi të cilin jemi mbështetur për të udhëzuar veçanërisht fëmijët me karakter të fortë.
3. Se si burrat dhe gratë këshillohen nga Shkrimi që të punojnë së bashku si llamba dhe drita e shtëpisë.
4. Ndihmë për prindërit që po e bëjnë këtë gjë vetëm.
5. Ndryshimi midis ndëshkimit dhe disiplinës.
6. Një sërë metodash disiplinuese me bazë biblike që janë testuar me kohën, së bashku me këshilla se si dhe kur të përdoret secila.
7. Kutia – një model jashtëzakonisht efektiv për të ndërtuar një strukturë të sigurt përreth fëmijës tuaj, në të cilën ai ose ajo do të rritet dhe do të lulëzojë.
8. Riparimi – Po sikur ta kem bërë gjithçka gabim? Po tani?

Ky është libri që kemi kërkuar më kot gjithë ato vite më parë. Pse-të dhe Si-të që do t'ju japin shpresën dhe ndihmën për të cilat keni nevojë në mënyrë të dëshpërueshme. Është një material që mund t'i riktheheni sërish e sërish ndërsa fëmija juaj rritet nga foshnjëria, përmes viteve të para të fëmijërisë, në vitet e shumë përfolura të adoleshencës dhe deri në ditën kur do t'i dorëzoni çelësin që ai/ajo të ndërtojë shtëpinë e vet shpirtërore. *Rritja e Ndjekësve Pasionantë për Jezusin* është një udhëzues për të krijuar tek fëmija juaj një zemër që rreh për Perëndinë.



Pjesa 1



Hartimi i Planit

Të rritësh një fëmijë është si të ndërtosh një shtëpi.

~ FJALË E URTË SHQIPTARE

Kapitulli 1

Historia Jonë

Nuk kam gëzim më të madh nga ky: të dëgjoj se
bijtë e mi po ecin në të vërtetën.

3 Gjonit 4

Asnjëri prej nesh nuk u rrit në një shtëpi që kishte Krishtin në qendër. Kishim familje të mira, të shëndetshme, me të dy prindërit, por asnjëri prej prindërve tanë nuk mendonin që të bëheshin ndjekës të Jezusit ndërsa po na rritnin ne.

Natyrisht, familjet tona shkonin herë pas here në kishë dhe sigurisht që e plotësonim përkatësinë tonë fetare me *Protestant*. Në të dyja shtëpitë tona kishte një Bibël në raftin e librave; Phil madje edhe e kishte rrëfyer Jezusin, ndërsa prindërit e mi një verë më regjistruan në një program biblik në një kishë Baptiste.

Por, të ndiqnim Jezusin? Asnjëra nga familjet tona as nuk ia kishte idenë se çfarë do të thoshte kjo gjë.

Phil ishte në universitet dhe luante në një grup rroku kur një shok i tij ndau ungjillin me të. Teksa ai gradualisht ia dha zemrën Jezusit, jeta e tij u transformua në mënyrë radikale e të përhershme.

Diane, e cila sapo ishte rikthyer nga të jetuarit përtej oqeanit, ishte një gjimnaziste plot pasiguri që po përpiqej të përshtatej me gjithçka, kur rastisi në një grup bashkëmoshatarësh që shkonin në kishë të cilët e përqaftuan pikërisht aty ku ajo ishte. Përjetimi i dashurisë së sinqertë të këtyre adoleshentëve e solli atë tek Jezusi. Ajo e donte Jezusin, sepse donte *ata*.

Në kohën që u martuam, Phil ishte pjesë e grupit drejtues si pastor adhurimi i një kisha të madhe ku u takuam. Të dy ishim rritur deri në pikën ku ishim të vendosur ta bënim Jezusin qendrën e jetëve dhe të shtëpisë tonë. Dhe për kënaqësinë tonë të madhe, të dyja palët e

prindërve tanë ishin në rrugën e duhur drejt kultivimit të një besimi të sinqetë brenda tyre.

Si brez i parë i ndjekësve të Jezusit, e kemi ndjerë shumë mungesën e modeleve në përpjekjet që bënim për t'i sjellë fëmijët tanë në një marrëdhënie autentike dhe jetësore me Perëndinë, kështu që shikonim përreth në familjet e drejtuesve të kishës tonë për të parë se çfarë mund të mësonim. Jemi tronditur kur shihnim disa nga fëmijët e tyre që ishte e qartë se ishin indiferentë ndaj Perëndisë, madje-madje dukej haptas se ishin rebelë.

Si mund të ndodhë kjo?

Si është e mundur që fëmijë të rritur në këto familje të mira të krishtera, nga prindër të perëndishëm të mos e duan Jezusin? Pse do të zgjidhnin ata me dashje t'i kthenin shpinën Atij që kishte ndryshuar kaq rrënjësisht jetën tonë?

Vëzhguam adoleshentët e kishës tonë që shkonin në shkolla publike dhe vumë re se shumë prej tyre nuk kishin ndonjë dallim në sjellje nga shokët e tyre jo besimtarë. Ndërsa Phil po jepte mësim në një kamp për një shkollë të mesme të krishterë, u trembëm nga qëndrimet apatike dhe mospërfillëse që përshkonin atë grup.

E vërteta filloi të ndriçojë tek ne, se *prindërit e krishterë nuk prodhojnë automatikisht fëmijë të krishterë!*

Sinqerisht, kjo stimuloi një frikë absolute tek ne.

Disa vite më pas, kur po prisnim fëmijën tonë të parë, e pamë se ishim të paaftë për shkak të historikut tonë të përbashkët me mungesë besimi, mungesës së modeleve për t'u ndjekur dhe më e keqja, nuk ia kishim idenë se si të rritnim fëmijë që do të bëheshin ndjekës plot pasion të Jezusit.

Nuk ia kishim idenë se çfarë po bënim; dhe ishim të vetëdijshëm për këtë!

Kështu që filluam të pyesnim. Vështruam përreth disa familjeve, adoleshentët ose të rinjtë e të cilëve dukej se po ecnin me Perëndinë, familje, fëmijët e të cilëve i admironim. Shpresonim që fëmijët tanë do të bëheshin si fëmijët e tyre dhe i ftonim ata në shtëpinë tonë, në mënyrë që t'i bombardonim me pyetje - shumë e shumë pyetje! I mbanim shënim ato që mësonim, duke mbushur dosje me urtësinë e tyre.

Zbuluam që shumë shpesh, kur fëmijët ndiqnin totalisht Jezusin, këtë bënin edhe prindërit e tyre po ashtu, dhe ata kishin vendosur qëllimisht të bënin gjithçka që duhej për t'i ushqyer dhe trajnuar, për t'i mësuar e dashur fëmijët e tyre në Perëndinë. Besimi i fortë i atyre fëmijëve nuk ishte rastësor!

VIZIONI

Disa muaj pasi lindi djali ynë, John Mark, u transferuam në Portland, Oregon, kështu që Phil mund të shkonte në seminar. Morëm me qira një shtëpi të vjetër, me lagështirë afër kampusit të Universitetit Multnomah, të shtrënguar nga të ardhurat që kishim, pa miq dhe pa familje aty pranë. E megjithatë, tani kur kthejmë kokën pas në ato vite, e kujtojmë si një nga periudhat më të mira të jetës sonë.

Një ditë me shi hymë në një librari të krishterë dhe shkuam drejt shkallëve të bodrumit ku ruheshin librat e përdorur. Diane tërhoqi nga rafti një libër që do të ndryshonte krejtësisht trajktoren e jetës sonë, duke na shtyrë drejt një kërkimi për të mbledhur së bashku copëzat e një plani të qëllimshëm për rritjen e fëmijëve që do të bëhen dishepuj pasionantë e të zgjuar të Jezu Krishtit.

Gjithsesi, libri kishte një titull fatkeq: *Martesa me një burrë të vështirë!*¹

Në të vërtetë nuk ishte një libër për burrat e vështirë, por përkundrazi një biografi e Jonathan Edwards, teologut të parë të famshëm të Amerikës. Ai përshkoi New England më 1734 dhe predikimet e tij të zjarra mbillnin atë që historianët e quajnë Rizgjimi i Madh. Autori shkruante për Edwards përmes lenteve të familjes së tij: gruas së tij Sara, dhe njëmbëdhjetë fëmijëve të tyre. E intriguar gjithnjë e më shumë, Diane vazhdonte ta ndërpriste Phil-in ndërsa ai studionte për t'i treguar për këtë familje të mrekullueshme.

Nga familja Edwards brez pas brezi kanë dalë udhëheqës të perëndishëm, me arritje të larta e me ndikim në botë: mjekë, avokatë, gjyqtarë, gjigandë të industrisë amerikane. Ka patur presidentë universiteti, guvernatorë, senatorë dhe ambasadorë, madje edhe një Zëvendëspresident të Shteteve të Bashkuara, si dhe mbi treqind pastorë, misionarë dhe profesorë teologjie.

Ndërsa lexonim, në zemrat tona filloi të krijohej një shpresë. Me besim të ndrojtur, guxuaam të themi, një vizion.

A mund të bënte Perëndia diçka të tillë në familjen tonë? A mund ta merrte Ai atë që i kishim përkushtuar Atij dhe ta bënte një trashëgimi të qëndrueshme? A mund të na përdorte Ai për të ndryshuar rrjedhën e historisë, për të ndikuar kishën?

Ajo që filloi si një shpresë e egër, u rrit në bindjen se, po, Perëndia mund dhe do të përdorte atë që i kishim ofruar Atij për të bërë një ndryshim.

Për më tepër, besuam se Ai po kërkonte nga ne që të ushqenim, të trajnonim dhe të mësonim: të dishepullizonim fëmijët tanë në mënyrë që ata të rriteshin duke ndikuar për mbretërinë e Tij në mënyra që ne kurrë nuk do të ishim në gjendje t'i bënim vetë.

Pikërisht, në atë kohë dhe në atë vend, ne u përkushtuam që të derdhnim çdo dituri, mësim, energji dhe përpjekje tek secili prej fëmijëve që Zoti do të na jepte. Ne do t'i bënim ata thirrjen e jetës tonë, duke i vendosur përpara shërbesës apo karrierës, përpara rehatisë personale, përpara planeve tona - përpara çdo gjëje.

Me besim të guximshëm, i kërkuaam Perëndisë që të na përdorte duke na bërë matriarken dhe patriarkun e brezave të Comers që do të rendnin pas Jezusit. Ne u lutëm që Ai të derdhte urtësinë e Tij mbi ne, në mënyrë që ne nga ana tjetër, të drejtonim fëmijët tanë për ta ndjekur Atë me gjithë zemër, duke i nxitur dhe duke i pajisur ata për të udhëhequr fëmijët e tyre, që edhe ata të bënin të njëjtën gjë një ditë.

Ishte një vizion ngazëllyes për dy besimtarë fringo të rinj. Përtej hijes së dyshimit e dinim se kjo ishte pikërisht ajo që Ai na kishte thirrur për të bërë.

Ky vizion i brezave të ndjekësve pasionantë të Jezusit ka gjurmuar ëndrrat tona dhe ka motivuar ditët tona. Ka udhëhequr çdo vendim që kemi marrë: çdo lëvizje, çdo sakrificë, pushimet tona, mënyrën se si kemi shpenzuar paratë tona, ku kemi shkuar në kishë, ku kemi punuar dhe si kemi jetuar.

A duhet ta shohim atë emision sarkastik? Çfarë librash duhet t'u lexojmë fëmijëve tanë? A është Babagjyshi i Vitit të Ri një ide e mirë ose a mund ta zbehtë miti historinë e vërtetë? A është kjo kishë vërtet

me Krishtin në gjithçka apo mesazhi mund të bëjë që fëmijët tanë të humbasin thelbin e çështjes?

Nga shkollat e deri te karriera në kishë ne kemi zgjedhur të bëjmë tonën; gjithçka i nënshtrohej shqyrtimit të pyetjes: *A do t'i ndihmojë kjo që të afrohen më pranë Shpenguesit apo ka gjasa që t'i largojë? A do t'i bëjë kjo gjë dishepuj ata apo do të krijojë rebelë pa pikë interesi?*

Në faqet që vijonë ju do të lexoni historitë tona. Na lejoni të themi pa mëdyshje se nuk jemi prindër idealë! Do të lexoni jo vetëm për gjërat që ne jemi të lumtur që i kemi bërë, por edhe për gabimet tona, gjërat që kemi bërë e do të dëshironim të mos i kishim bërë dhe pse. Kemi ndarë gjithashtu gjërat që do të donim t'i kishim kuptuar ndërsa po rritnim fëmijët tanë, sepse besojmë se gabimet nuk shkojnë kot kur mund të mësojmë prej tyre. Do të lexoni për mënyrën se si përpunonim të vërtetat dhe thesaret që zbulonim në Shkrim për familjen tonë si dhe praktikat që kaplonin në mënyrë të efektshme zemrat e fëmijëve tanë në rrugën e tyre për të njohur Jezusin.

Nëse kjo është ajo që dëshironi për veten dhe për fëmijët tuaj — lexoni më tej.

Kapitulli 2

Çmimi

Kapitulli i dytë i Gjyqtarëve rrëfen një histori të frikshme:

“Populli i shërbeu ZOTIT gjatë gjithë jetës së Jozueut dhe gjatë gjithë jetës së pleqve që jetuan pas Jozueut dhe që kishin parë të gjitha veprat e mëdha që ZOTI kishte bërë për Izraelin. Pastaj Jozueu, bir i Nunit, shërbëtori i ZOTIT, vdiq ... Kur tërë ai brez u bashkua me etërit e vet, mbas atij doli një brez i ri që nuk e njihte ZOTIN, as veprat që kishte bërë për Izraelin” (Gjyq. 2:7-8,19).

Tani, le të shikojmë se çfarë ndodhi më pas:

“Bijtë e Izraelit bënë atë që ishte e keqe në sytë e ZOTIT dhe u vunë në shërbim të Baalit; ata braktisën ZOTIN, Perëndinë e etërve të tyre; i cili i kishte nxjerrë nga Egjipti dhe adhuruan perëndi të tjera ndërmjet perëndive të popujve që i rrethonin, ranë përmbys para tyre dhe kështu nxitën zemërimin e ZOTIT” (Gjyq. 2:11-12).

Pikërisht kjo ishte ajo që ne *nuk* donim të shikonim t’u ndodhte fëmijëve tanë – dhe ajo që ju nuk doni të shikoni t’u ndodhë fëmijëve tuaj!

Pasi e çliroi në mënyrë dramatike popullin e Tij nga shtypja e Egjiptit, u kujdes sërish për ta përmes shkretëtirës së tmerrshme të rebelimit të tyre, ndërkohë që gjatë gjithë kohës ishte duke i ushqyer besnikërisht, duke i udhëhequr dhe duke u dhënë udhëheqës të mirë, të qëndrueshëm dhe heroikë, si Moisiu dhe Jozueu në një histori ku

Perëndia me besnikëri përmbushi çdo premtim mbrojtjeje të pamerituar, *ndërsa një brez i tërë zgjodhi të ndiqte perëndi të tjera.*

A mund t'a ndjeni zemrën e thyer të Perëndisë në këto fjalë? Në mënyrë ironike, përgjatë gjithë viteve që kemi ecur përkrah familjeve të tjera në kishën e Perëndisë, e kemi parë këtë model të përsëritet herë pas here si një ritransmetim që nuk ndalon.

Brezi i parë përjeton Perëndinë. Pendesa e thellë i hap rrugën një historie krejtësisht të re e mahnitëse të një jete të shpenguar – rezultat i një takimi autentik me Jezu Krishtin, Shpëtimtarin. Kjo çon në vendimin radikal për t'u larguar nga mënyra e vjetër e të jetuarit që i la ata në zbrazëtirë dhe në dhimbje. Në Letrën e tij të Dytë drejtuar Korintasve, Pali e quajti këtë ardhja *e një krijese të re*¹, ndërsa e vjetra ka shkuar.

Këta jemi ne: të krishterët e brezit të parë. Ne të dy kemi histori madhështore të një Perëndie aq të madh sa të na ndryshojë deri në palcë. Por nëse nuk jemi të kujdesshëm, nëse nuk jemi *të qëllimshëm* në të bërit dishepuj të vetë fëmijëve tanë, ata rrezikojnë të humbasin përvojën shpirtndryshuese me një Perëndi që shpengon. Atyre do t'ju mungojë adhurimi pasionant që pason një përvojë të tillë.

Nëse kjo ndodh, atëherë ...

Brezi i dytë e njeh Perëndinë, por nuk e përjeton Atë. Nëse ne nuk e jetojmë këtë model dhe nuk përçojmë tek fëmijët tanë një përjetim transformues kaq rrënjësor, nëse nuk arrijmë t'u tregojmë atyre se si duket, ndihet, ngjan dhe sillet një ndjekës pasionant i Jezusit, ata mund të rriten thjesht duke ditur *rreth* Perëndisë. Ata mund të dinë se çfarë pret Ai dhe se si duhet të jetojnë. Mund të jenë njerëz të mirë, me vlera morale të forta dhe një stil jetese të admirueshëm. Ata madje edhe mund të shkojnë në kishë, siç u është mësuar. Por ata mund të mos bëhen kurrë ndjekës tërësisht pasionantë e të nënshtruar të Jezusit.

Ky brez i dytë nga ana tjetër ka prirjen t'i rritë fëmijët e tyre me shumë më tepër tolerancë dhe vullnet të mirë, por pa shumë bindje ose drejtim.

Nëse kjo ndodh, atëherë ...

Brezi i tretë nuk e njeh Perëndinë dhe as nuk e përjeton Atë. Flaka venitet dhe shuhet dalëngadalë pa u vënë re. Gjithë ai

pasion radikal i brezit të parë me besimin pulsues dhe transformimin e mrekullueshëm, *ikën*.

Kjo duhet të trembë e të gjunjëzohë secilin prej nesh!

Ungjilltari Luis Palau thotë: “Perëndia nuk ka nipër e mbesa, vetëm fëmijë.” Secili prej bijve ose bijave tona duhet t’u marrin vetë vendimin e tyre për të ndjekur Jezusin.

Që besimi i vërtetë të lulëzojë, çdo brez duhet të bëhet brezi i parë.

Në rast se ende nuk jeni motivuar sa duhet për të mësuar se si të jeni të qëllimshëm në rritjen e një brezi ndjekësish pasionantë të Jezusit, vini re këtë statistikë, që tregon se si historia e Gjyqtarëve përsëritet në botën tonë të shekullit të 21-të:

Një studim i vitit 2009 arriti në përfundimin se 90% e të rinjve aktivë në programet e kishave për shkollat e mesme, e braktisnin kishën gjatë viteve të universitetit dhe vetëm 34% e tyre mund të rikthehej ndonjëherë.²

E trishtë, apo jo? Nëse nuk arrini të fokusoheni në mënyrë të qëllimshme në rritjen e një ndjekësi pasionant të Jezusit, ai djalë ose vajzë e vogël që ju sot e mbani në prehërin tuaj mund të jetë një nga 90 përqindëshi. Por, prapë ka shpresë.

Një studim i 2010-ës tregoi për *disa familje të qëndrueshme* ku besimi kishte mbetur i fortë deri në moshë madhore. Ky studim tregoi se prindërit e studentëve të universitetit që nuk e kishin braktisur kishën, e theksonin “fenë” dy herë më shumë sesa ata, fëmijët e të cilëve ishin larguar nga kisha. Ndërsa studentët që kishin qëndruar në kishë përgjatë viteve të universitetit thanë se gjëja e parë që bënë kur kishin dyshime ose pyetje ishte të flisnin me prindërit e tyre dhe të lexonin Biblat.³

A E KUPTOJMË ÇFARË RREZIKOHET?

Perëndia na deshi gjithsecilin prej nesh me aq pasion, sa që Ai zgjodhi të bënte gjënë më të vështirë që një atë mund të bëjë ndonjëherë: Sakrifikoi Birin e Tij.

Ati e çoi të Birin drejt një dhimbjeje torturuese *me qëllim*. Jo për të na bërë të mirë. As që të na bënte të lumtur, ashtu siç duket se mendojnë një pjesë e madhe e brezit tonë. Ai e bëri këtë si pjesë të planit të Tij, për të kthyer botën njëherë e përgjithmonë tek Vetja e Tij.

Përpara se të vazhdojmë më tej me atë që Shkrimi na mëson rreth rritjes së fëmijëve, besimi i të cilëve do të bëhet besimi i tyre personal, jemi të detyruar të ndalojmë e të pyesim: *A je ti një ndjekës pasionant i Jezusit?*

A është Jezusi në qendër të vendimmarrjeve, prirjeve apo marrëdhënieve tuaja? A jeni duke mësuar, duke u rritur e duke u dashuruar edhe më shumë me Jezusin? A mund të thoni me sinqeritet se Ai është Mjeshtri juaj? A do ta konsideroni veten tuaj pjesë të asaj që A. W. Tozer e ka cilësuar “bashkësia e zemrave të zjarra”?⁴

Apo jeni si brezi i dytë që regjistrohet në librin e Gjyqtarëve; ju dini shumë rreth Perëndisë, madje edhe shkoni në kishë shumicën e rasteve, por nuk e njihni Atë në një mënyrë intime jetëndryshuese. A duket besimi juaj më shumë si një busull morale apo si një ndjekje pasionante e një Perëndie të gjallë?

Në studimin e zgjeruar të George Barna për familjet që rritin fëmijë të cilët ai i quan “Kampionë Shpirtërorë Revolucionarë,”⁵ thotë:

“Shumë nga prindërit në hulumtimin tonë nuk kishin një edukim që t’i përgatiste ata të ishin kampionë shpirtërorë . . . Sidoqoftë, pas shqyrtimit të mundësive bazuar në përvojat e jetës së tyre, kishin dalë në përfundimin se dhurata më e madhe që mund t’i jepnin pasardhësve të tyre do të ishte një edukim i shëndetshëm bazuar në parimet biblike. Ky mentalitet ishte një reflektim i fushatës së tyre personale për të integruar besimin e tyre në Krishtin në çdo dimension të jetëve të tyre.”⁶

Fëmijët tuaj kanë një aftësi të çuditshme për të parë drejt e në zemrën tuaj. Ata e kuptojnë ndryshimin mes një babai, interesi i të cilit për Perëndinë është i përciptë dhe të atij babai, shpirti i të cilit digjet për atë që vetëm Ai mund t’ia japë. Ata mund ta dallojnë kur prindërit e tyre janë në një “fushatë personale për të integruar besimin në Krishtin në çdo dimension të jetës së tyre.”⁷ A mund ta kuptoni pse ishim aq të frikësuar gjithë ato vite më parë? Sapo kishim filluar të integronim besimin tonë të sapogjetur në ato vende të thyera në jetën tonë që binin ndesh me atë që po mësonim për Perëndinë. E dinim shumë qartë që kishim një rrugë shumë, shumë të gjatë për të bërë.

Në të njëjtën kohë, fëmijët, prindërit e të cilëve e ndjekin Jezusin në mënyrë jo të përkryer, por me pasion, kanë një pamje të qartë për atë që Shpëtimtari kishte ndër mend kur tha: “Përpara së gjithash kërkoni Mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e Tij dhe të gjitha të tjerat do t’ju shtohen”⁸ (Mt 6:33).

Ne të gjithë dëshirojmë që fëmijët tanë të dëgjojnë Jezusin t’u thotë atyre atë që dëshirojmë të dëgjojmë edhe për veten tonë: “Të lumtë shërbëtor i mirë dhe besnik . . . hyr në gëzimin e zotit tënd” (Mt 25:23).

Ne e donim këtë lloj gëzimi për fëmijët tanë; këtë gjë dëshironi edhe ju. Si prindër ndjekës të Jezusit, ne dëshirojmë fort të dimë se fëmijët tanë do ta kalojnë pjesën e mbetur të përjetësisë me ne në praninë e Perëndisë.

Ne dëshirojmë që fëmijët tanë jo vetëm të *deklarojnë* që besojnë, por në të vërtetë të *zotërojnë* një besim real.

Ne duam t’i shohim ata të bëhen ndjekës pasionantë të Jezusit.

Kapitulli 3

Historia Juaj

Si një prind që ia ke dhënë jetën Jezusit, prioriteti juaj parësor është që fëmijët tuaj jo vetëm duhet të *dinë rreth* Perëndisë, por edhe ta *përjetojnë* Atë. Gëzimi juaj më i madh do të jetë t'i shihni ata të ecin me Zotin dhe frika juaj më e madhe do të jetë që ata mund të largohen nga Perëndia, pa e njohur Atë dhe pa dashur t'ia dinë për këtë gjë.

Njësoj si ju, edhe ne ishim të përhumbur nga frika që mund të dështonim. Por në të njëjtën kohë, na motivonte ideja se çfarë ndikimi të pamasë mund të kenë dy prindër - ose edhe vetëm njëri, nëse kanë vullnetin që të investojnë vitet e tyre më të mira në jetën e fëmijëve të tyre.

Le të bëjmë ca llogari: Phil dhe unë kishim katër fëmijë. Le të themi që ju keni tre fëmijë dhe më pas diku rrugës ju qëllimisht sillni një fëmijë të katërt në mesin tuaj, një fëmijë që ka nevojë për vëmendjen tuaj dhe integrohet mes jush.

Nëse secili prej këtyre të katërve, me këshillat, trajnimin dhe inkurajimin tuaj, do të bëjnë të njëjtën gjë – ta derdhnin veten tek katër fëmijë, duke bërë dishepuj të cilët bëjnë dishepuj, kjo do të thotë gjashtëmbëdhjetë burra dhe gra.

Vazhdoni në këtë formë për dymbëdhjetë breza. Një brez matet me njëzet e pesë vite¹, pra kemi një periudhë rreth 300 vjeçare.

Në dymbëdhjetë breza do të jenë plot 16,777,216 dishepuj pasionantë, ndjekës të Jezusit që vazhdojnë të bëjnë dishepuj.

Kjo është më shumë sesa numri total i popullsisë së qyteteve të Portland dhe Nju Jorkut, Los Angeles, Atlantas, Bostonit, San Francisco, Seattle dhe San Diego *së bashku!*

Dhe fillon vetëm me një person.

Po sikur ju të vendosnit ta filloni këtë gjë me familjen tuaj? Po sikur të përkushtonit më të mirën e gjithçkaje që keni dhe ta bëni këtë synimin e vetëm?

Kjo është një rrugë e gjatë, aventura e një jete të tërë që korr shpërblimet më të pasura. A kemi guxim të themi se kjo është detyra jonë - plani A i Perëndisë për ungjillizimin? Çdo nënë dhe baba që dishepullizon fëmijën e vet reflekton mënyrën parësore dhe origjinale të Perëndisë për të kthyer botën sërish tek vetja e Tij. Kjo është mënyra se si Ai i urdhëroi izraelitët ta jetonin besimin e tyre.

Por ata nuk e bënë. Diku rrugës, ata ranë në një qëndrim apatik ndaj trajnimit dhe mësimi të fëmijëve të tyre. Presupozuan se gjithçka ishte në rregull në botën e tyre të mbrojtur, që nuk kishte armiq që përgjonin rreth e rrotull, duke u përpjekur t'i joshnin fëmijët e tyre për t'i larguar nga Perëndia. Ata ndaluan së treguari histori për Zotin. Hoqën dorë nga qëndrimi i pakompromentuar që Jozueu modeloi në mënyrë të guximshme.

Pak nga pak, dështuan.

Dhe përse na është dhënë kjo histori në Shkrim? Apostulli Pal shkroi: “Këto gjëra u ndodhën atyre si shembuj dhe u shkruan si paralajmërim për ne...” (1 Kor. 10:11).

Kalojini shpejt disa mijëvjeçarë, deri në shekullin e 21-të – në ditët tona. Modeli vazhdon.

DIANE:

Jo shumë kohë më parë një mikja ime e mirë zbrazi zemrën e saj tek unë.

“Asnjëri prej fëmijëve të mi nuk po ecin vërtet me Perëndinë”, tha ajo. “Ata janë të mirë. Kemi një marrëdhënie të mirë. Por ata thjesht nuk janë të interesuar të ndjekin Jezusin”.

Dëgjova mjerimin e një nëne shumë të mirë që jehonte në fjalët e saj. Ajo dhe bashkëshorti i saj ishin prindër të mirë - lloji i prindërve që shkonin në çdo ndeshje, trajnonin, kujdeseshin dhe bënin çdo përpjekje që t'u siguronin fëmijëve të tyre një atmosferë të ngrohtë familjare. Ata bënë gjithashtu sakrifica të konsiderueshme që t'i

futnin fëmijët në një shkollë të krishterë për njëfarë kohe. Pa asnjë dyshim, të dy prindërit ishin të përfshirë dhe të pranishëm në jetën e tre fëmijëve të tyre.

Pyetja që i linte ata pa gjumë ishte: “Ne ishim prindër të mirë. I kemi çuar fëmijët në kishë. Çfarë ka shkuar gabim?”

Ti çoni fëmijët në kishë është shumë mirë - bëjeni! Por nuk mjafton me kaq.

Bashkëpunimi me Perëndinë në formimin e karakterit të tyre, duke i mësuar, trajnuar dhe këshilluar për të dashur Jezusin - duhet të bëhen prioriteti juaj kryesor.

Duhet të bëheni *të qëllimshëm* për këtë.

E vërteta është që ne jemi të qëllimshëm për shumë gjëra: karrierën që zgjedhim, universitetin ku shkojmë, apo personin me të cilin martohemi. Raftet tonë të librave janë të mbushur me librat më të shitur rreth të jetuarit të një jete *të qëllimshme* dhe të fokusuar. Megjithatë, kur vjen puna tek rritja e fëmijëve që do ta duan Perëndinë me gjithë zemër dhe do të ecin me Të për pjesën e mbetur të jetëve të tyre, shumë prindër - *shumica e prindërve* - nuk kanë një plan konkret. Sigurisht që as ne nuk kishim! Kishte disa gjëra që nuk donim t'i bënim në asnjë mënyrë për shkak të gabimeve që kishim parë prindërit tanë të bënin, por shumica, madje edhe prindërit e krishterë të përkushtuar nuk kanë një plan të vërtetë, një plan të mirëmenduar që ata janë të vendosur t'a zbatojnë.

Dikush ka thënë: “Çdo person përfundon diku, por vetëm disa arrijnë atje qëllimisht!” Të paktët që arrijnë atje me qëllim janë ata që e dinë se ku duan të shkojnë, pastaj i vihen punës duke bërë atë që duhet bërë në mënyrë që të arrijnë atje.

Që të mos ngajë sikur kemi një metodë ose formulë që do t'i kyçë fëmijët tuaj të rriten duke ecur me Perëndinë, le të themi këtë: Ju mund të bëni gjithçka në rregull (të paktën teorikisht), dhe fëmijët tuaj përsëri do të bëjnë *zgjedhjen e tyre* për të ndjekur Jezusin. Ashtu siç Ruth Bell Graham me keqardhje tha: “Edhe Perëndia ka telashe me bijtë e Tij!”²

Edhe me synimet më të mira, nuk ka garanci. Sidoqoftë, *ka* udhëzime. Shprehja e vjetër “Mund ta çosh një kalë tek uji, por nuk mund ta bësh atë të pijë”, mund të jetë e vërtetë. Por, është shumë e vërtetë gjithashtu që një prind i dashur mund të bëjë shumë për të stimuluar etje për Perëndinë tek fëmijët e tij.

Ne besojmë që nëse jeni të qëllimshëm në trajnimin shpirtëror të fëmijëve tuaj, nëse e dini për ku jeni drejtuar dhe çfarë duhet të bëni për të arritur atje dhe, (kjo është e rëndësishme!) nëse nuk hiqni dorë shumë shpejt, atëherë me kalimin e kohës, kur ata të jenë adoleshentë, do të jeni bërë miq të mirë. Do të keni stabilizuar bindje dhe fituar respektin e tyre, dhe fëmijët tuaj do të rriten në forcë dhe urtësi, duke ndjekur Perëndinë me gjithë zemër.

Gëzimi juaj, ashtu si ai i apostullit Gjon, do të jetë i madh.

Duke patur këtë qëllim, le të fillojmë të formulojmë planin.

Kapitulli 4

Urdhërimi i Madh

Në mënyrë që të krijojmë një plan praktik për çështjen e rritjes së fëmijëve që e duan dhe ecin me Jezusin, le të përdorim analogjinë e ndërtimit të një shtëpie. Bibla e përdor këtë metaforë në Psalmin 127:1.

“Në qoftë se Zoti nuk e ndërton shtëpinë, më kot lodhen ndërtuesit”

(Psa. 127:1)

Ose, siç thuhet në një përkthim tjetër:

“... puna e ndërtuesve është e kotë” (Psa. 127:1)

I njëjti psalm vazhdon duke thënë: “Fëmijët janë një dhuratë e Zotit . . . ashtu si shigjetat në dorën e një trimi, ashtu janë bijtë e rinisë. Lum njeriu që e ka kukurën e tij plot!” (Psa. 127:3-5).

Jezusi i do fëmijët tuaj. Ai ka një dëshirë të zjarrtë t’i tërheqë ata pranë, t’i shpengojë dhe t’i bëjë të vetët.

Tek Kolosianët 1:27 Pali thotë: “Ky është sekreti: Krishti rron në ju. Kjo ju jep juve sigurinë e pjesëmarrjes në lavdinë e Tij”. Ju e doni këtë siguri edhe për fëmijët tuaj! Kjo do të thotë se njerëzit më të rëndësishëm që ju duhet të drejtoni tek Jezusi janë vetë fëmijët tuaj.

Perëndia po ju fton që të bashkoheni me Të në këtë detyrë që është më e shenjta nga të gjitha. Ati - Ai që e krijoi fëmijën tuaj, dëshiron t’ju përdorë si një instrument që ta drejtoni fëmijën tuaj drejt gëzimit të të qenit një ndjekës i devotshëm i Jezusit - që është një tempull i Perëndisë së gjallë,¹ një banesë ku Jezusi do të jetojë dhe do të ndihet rehat.

“Çdo fëmijë duhet të gjejë mënyrën e tij / të saj drejt besimit”, tha Wayne Rice, “por Perëndia ju ka caktuar ju që të shërbeni si instrumenta të hirit, nëpërmjet të cilëve Ai i tërheq bijtë e tij tek Vetja”.²

NDËRTIMI I NJË SHTËPIE

Shumë vite më parë kur u shpërngulëm në Paqësorin Veriperëndimor, patëm kënaqësinë e ndërtimit të një shtëpie. Tani jetojmë në një shtëpi të vogël në pyll, të cilën po e rimodelojmë nga çatia deri në dysheme.

Disa këshillues të urtë, na paralajmëruan me zgjuarsi ndaj ndërmarrjes së një projekti të tillë, duke evidentuar se konfliktet e mundshme në marrjen e shumë vendimeve mund të sillnin strese të papërshtatshme në marrëdhënien tonë. Por sinqerisht, ne e shiuam shumë!

Përpara se të fillojë ndërtimi i një ndërtese, përpara gërmimit të tokës, hedhjes së themeleve ose shembjes së një muri, ju duhet të hartoni plan-projektin.

Sa dhoma gjumi dëshironi? Çfarë përmasash janë më të përshtatshme? Plani i dyshemesë duhet të jetë i finalizuar, analiza e kostove duhet të jetë llogaritur me shumë kujdes dhe duhet të jetë përcaktuar buxheti. Gjithashtu, kur ndërton një shtëpi, duhet përfunduar brenda një afati kohor të përcaktuar.

Në të njëjtën mënyrë, kur synimi juaj është të rritni fëmijët tuaj në burra dhe gra të perëndishëm, ju keni një kohë të caktuar për ta kryer këtë punë. Ka një afat përfundimi. Biblikisht, do të ishte rreth njëzet vjet, që është përafërsisht koha që i duhet një fëmije për t’u bërë një i rritur plotësisht i përgjegjshëm për veten.

Megjithëse nuk ka ndonjë seri udhëzimesh hap pas hapi që të tregojë si të rritësh fëmijë të perëndishëm, Bibla është e mbushur me urtësi për prindërit. Nga fillimi deri në fund.

Në veçanti, duhen ndjekur dy pasazhe që paraqesin planin e Perëndisë për këtë çështje: Ligji i Përtërirë 6 dhe Efesianët 6. Këto Shkrime skicojnë modelin e Perëndisë për ndërtimin e një shtëpie shpirtërore. Fillimisht ne do të shpalosim planin e Perëndisë për familjet tek Ligji i Përtërirë dhe në pjesën tjetër, do të shikojmë nga afër Efesianët.

Pse? Sepse vendi ku duhet filluar është aty ku Perëndia fillon. Ndërkohë që mund të kemi një masë suksesi nëpërmjet hartimit të një plani për të ndikuar fëmijët tanë që të bëhen studentë të shkathët, atletë të aftë, ose njerëz të mirë, e vetmja mënyrë për të rritur ndjekës pasionantë të përkushtuar të Jezusit është duke hulumtuar Shkrimet për të zbuluar se si ta bëjmë këtë, dhe pastaj t'i kërkojmë Frymës të na japë urtësi për të aplikuar Shkrimin në situatat tona.

Le të kthehemi pas tek fillimi i historisë së shpengimit të Perëndisë, tek një pjesë e Shkrimit që studiuesit e quajnë Urdhërimi (Shema) i madh. Këto fjalë janë shkruar në kohën kur Perëndia po i jepte urdhëra të drejtpërdrejta popullit të Tij.

“Dëgjo Izrael, ZOTI, Perëndia ynë është një ZOT i vetëm.
Duaje ZOTIN, Perëndinë tënd, me gjithë zemër, me gjithë
shpirt dhe me tërë forcën tënde” (Ligji i Përtërirë 6:4-5).

Ky ishte urdhërimi gjithëpërfshirës i Perëndisë për bijtë e Izraelit: zhytu në thellësitë e Perëndisë me çdo qelizë të qenies tënde. Jo deri në gjysmë, jo praniam pasiv. Perëndia po kërkonte për ndjekës tërësisht të përkushtuar. Qëllimi i Tij ishte t'i tregonte botës se çfarë do të ndodhte nëse një komb i tërë do të zgjidhte të adhuronte Perëndinë e vetëm të vërtetë dhe të jetonin jetën ashtu siç Ai e kishte projektuar.

Por përpara se këta ish-skllëvër të lodhur, të mund të rimerrnin frymë, Ai iu kthye prindërve dhe bëri një tjetër deklaratë gjithëpërfshirëse:

“Dhe këto fjalë që sot po të urdhëroj do të mbeten në zemrën tënde: do t'ua ngulitësh bijve të tu, do të flasësh për to kur rri ulur në shtëpinë tënde, kur ecën rrugës, kur ke rënë në shtrat e kur të çohesh. Do t'i lidhësh si një shenjë në dorë, do të jenë si shirita midis syve, dhe do t'i shkruash mbi pllakat e shtëpisë sate dhe mbi portat e tua” (Li. i Për. 6:6-9).

Zoti i jep Dhjetë Urdhërimet popullit të Tij, më pas kthehet drejt prindërve dhe u thotë: “Tani *ju* mësojuani këto urdhërimet fëmijëve tuaj!”

Zoti nuk po u flet drejtuesve të të rinjve këtu, as udhëheqësve shpirtërorë në kishë. Ai nuk po paraqet një plan mësimor për takimin e të dielës ose ndonjë udhëzim shkollë të krishterë.

Perëndia vendos përgjegjësinë për zhvillimin shpirtëror të fëmijëve në supet e nënave dhe baballarëve të tyre dhe Ai u thotë që këto mësimet t'ua japin atyre përmes momenteve të vërteta të jetës. Kjo mund të jetë një arsye e mirë se pse një studiues vuri në dukje se prindërit e fëmijëve që zgjedhin të ndjekin Jezusin “i identifikojnë qëllimisht fëmijët e tyre si fokusin e tyre kryesor tokësor përgjatë viteve të prindërimit”.³

Dikush njëherë ka thënë: “Problemi me prindërimin është se është shumë i përditshëm!” Është e vërtetë! Të rritësh fëmijë që duan Perëndinë me pasion është diçka e përditshme. Ky trajnim me Perëndinë në qendër ndodh kur ju i përshëndetni fëmijët tuaj me sy të përgjumur dhe me zemrën plot çdo mëngjes, kur i vini në gjumë në darkë dhe në çdo moment tjetër të ditës.

Mark dhe Jan Foreman⁴ kanë shkruar: “Brenda këtij pasazhi është skalitur një strategji fitimtare për t’u shpjeguar Perëndinë fëmijëve tanë: Është trajnim në punë e sipër. Ne përdorim metodën trego-dhe-thuaj të momenteve të përditshme për të transmetuar jetën shpirtërore”.⁵

Jo shumë kohë më parë fëmijët e pastorit të kishës tonë na treguan një histori se si ai kishte hasur një familje që bënte pikërisht këtë gjë. Çifti kishin një vajzë pesëvjeçare. Ata po vizitonin kishën tonë një të dielë, me shpresën që do të gjenin një kishë familje që do të ishte mirë për ta. Ndërsa qëndronin ulur gjatë adhurimit dhe më pas gjatë predikimit, duke ndjerë praninë e Frymës, edhe mami edhe babai u ndjenë si në shtëpi. Teksa shkuan për të marrë të bijën nga takimi i fëmijëve, ata po shpresonin që edhe vogëlushes së tyre të shtrenjtë t’i kishte pëlqyer po aq sa dhe atyre.

Vrulli i saj i shtangu që të dy. “Nuk dua të shkoj më kurrë në atë kishë!” - tha ajo me duart e mbledhura grusht në bel.

“Çfarë? Për ç’arsye po e thua këtë?” Prindërit panë njëri tjetrin, krejtësisht të hutuar. Shërbesa e fëmijëve dukej shumë entuziaste dhe tërheqëse.

Të habitur, ata vijuan ta merrnin në pyetje vajzën e tyre butësisht. Më në fund, vajza e vogël papritmas shpërtheu: “Për shkak të asaj që ata i bënë Jezusit!”

Gradualisht babai i vajzës filloi të kuptonte që ajo po fliste për kryqëzimin. Atë mëngjes ajo kishte dëgjuar në nivelin e saj pesëvjeçar, historinë e vdekjes së Jezusit. Ajo e përjetoi kaq shumë padrejtësinë e gjithë kësaj ngjarje, sa që nuk donte të kishte të bënte më fare me asgjë që lidhej me veprime të tilla!

Këta dy prindër të urtë e kaluan javën e ardhshme duke i folur vajzës në nivelin e saj, duke i shpjeguar asaj për kryqin, duke folur me të për zgjedhjen e Jezusit për ta dhënë Vetën të kryqëzohej në nivelin më të lartë të dashurisë. Me kalimin e kohës, ndërsa vajza e vogël vrapoi drejt klasës së takimit të fëmijëve në javën që pasoi, e bëri këtë me qejf të madh.

“Unë kam vendosur të ndjek Jezusin”, deklaroi ajo, “sepse Jezusi më do mua kaq shumëëëë!”

Pikërisht kjo është ajo që Ligji i Përtërirë 6 përshkruan: Një besim i përçarur dhe i transmetuar nga përditshmëria e jetës.

Por si? Ku duhet të fillojë prindi me këtë mënyrë të mësuarit me impakt kaq të lartë, por edhe të frikshme njëkohësisht? Na lejoni t’ju japim tri të vërteta themelore që do t’ju duhen për të filluar.

TRE PËRBËRËS THELBËSORË

Dashuria pasionante për Perëndinë është diçka që duhet të ndodhë fillimisht në vetë jetën tuaj.

Sigurisht! Zoti nuk po parashtron thjesht një kod moral sjelljeje që të shohë nëse ti kalon apo dështon. Ai dëshiron të ketë një marrëdhënie dashurie me secilin prej nesh. Ai dëshiron të na flasë, të na udhëzojë dhe të na këshillojë. Qëllimi i Tij është që gjithmonë të na kthejë pas tek zemra e Tij. Dhe Ai na merr pikërisht aty ku jemi – nuk ka kushte paraprake perfeksioni! Ai i merr parasysht hapat tonë të pafuqishëm drejt Tij dhe i mbush shpirtërat tanë me pasion shpirtëror.

Më pas ajo siguri pasionante, e mbështetur tek Perëndia modelohet në shtëpinë tuaj, pikërisht aty ku vijon jeta e përditshme.

Fëmijët tuaj zënë vend në rresht të parë, duke vëzhguar çfarë ndodh kur mami ose babi e duan Zotin me çdo qelizë të qenies së tyre.

Ata ju shohin të dështoni, ju shohin të falni, vëzhgojnë çlirimin që vjen nga rrëfimi. Pastaj shohin tensionin mbi supet tuaja të relaksohet dhe kuptojnë kush është ai që ju jep juve paqe.

William Booth (themelues i Ushtrisë së Shpëtimit) tha këtë në vitin 1902:

“Mos prisni që fëmijët tuaj të jenë aq naivë sa të mos shohin poshtë mantelit të një krishterimi të rremë, veçanërisht nëse e shohin këtë gjë në vetë shtëpinë e tyre. Dhe mos mendoni që pasi të zbulojnë fallsitetin e tij, të mos e përçmojnë atë. Mos u befasoni nëse, kur të shohin këtë lloj hipokrizie, të nxjerrin justifikime për të neglizhuar, e ndoshta për të mos besuar fare në Krishtin”⁶

Fjalë të forta. Por Booth nuk po flet këtu për perfeksion. Ai po nxjerr në pah supozime. Kur një prind thotë se është duke ndjekur Jezusin, se e do Zotin, se është një drejtues në kishë, por dështon ta jetojë në shtëpi atë që thotë se beson - ky është “fallsiteti” që fëmijët fillojnë të përçmojnë.

Dallas Willard shkroi: “Jezusi nuk na thërret të bëjmë atë që bëri Ai, por të jemi siç ishte Ai, plot dashuri. Më pas, bëra e atyre që Ai bënte dhe thoshte bëhen shprehje e natyrshme e asaj që ne jemi në Të”⁷

Po! Dhe fëmijët tuaj e shikojnë këtë shprehje të natyrshme. Teksa ju jetoni duke kultivuar dashuri - dashurinë e Perëndisë që rrezaton në fytyrën, fjalët dhe qëndrimet tuaja - fëmijët tuaj do të duan të njëjtën dashuri për veten e tyre. Kur një prind jep dhe merr hir në familje, është më e fuqishme sesa kisha apo shkolla më e mirë në botë!

Por prapë nuk mjafton. Që fëmija juaj të ndjekë Jezusin në moshë madhore, duhet të praktikoni një aspekt të lënë shpesh pas dore të rritjes së fëmijëve që ndjekin Jezusin . . .

Besimi që është i gjallë dhe i vërtetë duhet t’u mësohet në mënyrë të qëllimshme fëmijëve tuaj.

Charles Spurgeon, një predikues i viteve 1800, ngulmonte në ngarkimin e prindërve me çështjen e trajnimit shpirtëror:

“. . . Shërbyesit dhe mësuesit e shërbesave të fëmijëve në kishë nuk supozohet kurrë të jenë zëvendësues të nënave dhe baballarëve . . . Çfarë orësh dhe mbrëmjesh të këndshme kanë kaluar fëmijët në gjunjët e prindërve të tyre teksa dëgjonin ‘histori të bukura të kohëve të vjetra!’”⁸

Të mësuarit me qëllim të fëmijëve tanë në përditshmërinë e jetëve tona, në “mbrëmjet e këndshme”, po ashtu si dhe në mes të rrethanave stresuese, është mënyra për të hapur zemrat e tyre ndaj Jezusit.

Të treja këto të vërteta janë të nevojshme për të krijuar një shtëpi në të cilën fëmijët do të lulëzojnë në dashurinë për Perëndinë; vërtetësia e besimit tuaj, manifestimi i këtij besimi në përditshmëri tek fëmijët dhe të mësuarit e qëllimshëm të fëmijëve për gjithçka që keni kuptuar mbi karakterin dhe rrugët e Perëndisë.

Nëse ndiheni të trembur, merrni zemër! Kur Perëndia na urdhëron të bëjmë diçka, Ai derdh Frymën e Tij mbi ne, duke na pajisur e aftësuar përtej asaj që jemi. Ai na jep gjithçka që na nevojitet për të përmbushur thirrjen tonë.

Nënkuptimi pra, është që kalimi i besimit tuaj tek brezi i ardhshëm - *tek fëmijët tuaj* - mund të realizohet! Perëndia është i gatshëm dhe dëshiron të na përdorë, madje edhe në nevojën tonë të dëshpëruar për transformim. Ne duam që ju të shihni se është e mundur të rritni fëmijë që e duan Perëndinë me gjithë zemrën, me gjithë shpirtin dhe me gjithë forcën e tyre.

Ju mund t’ia dilni! Perëndia na e ka treguar si ta bëjmë këtë në Fjalën e Tij. Ai premton të jetë me ne, duke na dhënë urtësi dhe mendjemprehtësi teksa ecim me Të.

PËRMBI GJITHÇKA TJETËR

Kthehemi qindra vite pas në kohë, kur Jezusi u pyet: “Cili është urdhërimi më i rëndësishëm në të gjithë Shkrimin?” Ai citoi Shemën e madhe, duke thënë: “Ky është urdhërimi i parë dhe më i madhi” (Mat. 22:38).

Dhe më pas Ai shtoi një citim nga Levitiku 19:18

“Dhe i dyti [urdhërim] i ngjashëm me këtë është: ‘Duaje të afërmin tënd porsì vetveten’. Në këto dy urdhërime përmblihet i tërë ligji dhe profetët” (Mat. 22:38-40).

E bukura e këtyre fjalëve qëndron në thjeshtësinë e tyre. Në vend të 1001 të vërtetave shpirtërore që u duhen mësuar fëmijëve tuaj, këto të dyja janë më thelbësore dhe në to varet çdo e vërtetë tjetër, janë më jetike se sa të mësuarit si të lajnë dhëmbët ose si të bëjnë detyrat, madje edhe më të rëndësishme sesa edukimi i tyre për përgjegjësi ose për standarde të larta morale.

Kur gjithçka është thënë e bërë, Jezusi thotë: *Çfarë vlen më shumë është të duash Perëndinë me pasion dhe të duash njerëzit me qëllim.*

Çfarë çlirimi! Nuk kërkohen diploma seminaresh. Nuk kërkohet ndonjë super përshpirtshmëri.

Nuk ka rëndësi historia juaj, nuk ka rëndësi se ku jeni në rrugëtimin tuaj; këto janë dy gjërat thelbësore që jeni thirrur t'i përcillni tek fëmijët tuaj të cilët i doni më shumë se vetë jetën.

Kapitulli 5

Llamba dhe Drita

Kini kujdes! Rrugëtimi që po filloni nuk është i thjeshtë. Siç ka thënë faktori Ed Asner: “Rritja e fëmijëve është pjesërisht gëzim dhe pjesërisht luftë guerile!”

Edukimi i fëmijëve që *e duan Perëndinë me pasion dhe duan njerëzit me qëllim* do t’ju marrë çdo grimcë krijimtarie, energjie dhe varësie totale tek Zoti. Do t’ju duhet të punoni së bashku për t’ia arritur kësaj. Mamatë dhe baballarët do të duhet të përdorin rolet e tyre unike dhe të ndërthurin forcat që Perëndia u ka dhënë në një mënyrë që do të sjellë kurajo dhe nderim për njëri-tjetrin dhe për fëmijët e tyre.

Teksa kthejmë kokën pas në kohën kur po ndërtonim shtëpinë së bashku, kuptojmë se arsyeja kryesore përse e shijuam aq shumë ishte sepse tashmë ne i njihnim pikat e forta dhe dobësitë e njëri-tjetrit në marrëdhënien tonë. Ne dinim çfarë të prisnim nga njëri-tjetri, çfarë të shmangnim dhe si të nxirrnim në pah më të mirën e njëri-tjetrit.

Me fjalë të tjera, i dinim rolet tona.

Phil mbikëqyri financat: buxhetin, huatë, kontratat dhe telefonatat. Ai është shumë i mirë me këtë pjesë; detajet dhe mbikëqyrja i japin energji. Duke iu përmbajtur atij buxheti (më së shumti!), Diane u mor me dizenjimin: ngjyrat e bojës, zbukurimet, tavanet dhe dyshemetë. Asaj i pëlqen shumë përfytyrimi i konceptit dhe mobilimi i shtëpisë.

Pastaj, kemi bërë biseda pafund së bashku, lart e poshtë. Negocionim dhe binim dakord, duke vlerësuar kontributet e njëri-tjetrit. E dëgjonim njëri-tjetrin.

Dëshirojmë t’ju tregojmë se si kemi punuar së bashku në të njëjtën mënyrë për të rritur fëmijë që duan Perëndinë. Duam të ndajmë me ju të vërtetat që zbuluam në Shkrime, dhe po ashtu edhe gjërat që vumë në praktikë në shtëpinë tonë.

Në fillimet tona, hasëm vështirësi me një pasazh tek Fjalët e Urta që mbështetet në modelin e ndërthurjes së forcave dhe urtësisë së të dy prindërve për edukimin dhe udhëzimin e fëmijëve të tyre. Na tingëllonte disi çuditshëm dhe mistershëm, por sërish riktheheshim aty për të provuar të gjenim kuptimin e asaj që Zoti po thoshte. Fillon me një deklaratë:

“Biri im, ruaje urdhërimin e atit tënd dhe mos i harro mësimet e nënës sate” (Fj. e Urta 6:20).

Fjala hebraisht e përkthyer këtu “urdhërim” është *mitsvah*. Është një fjalë që përdoret për të theksuar udhëzimet e mësuesit për nxënësit ose të prindit për fëmijën e tij. Është përdorur gjithashtu për t’u referuar urdhërimeve të Perëndisë. Në pesë librat e parë të Biblës, që shpesh i referohemi si Pentatuk, kjo fjalë është përdorur vetëm për urdhërimet e Perëndisë, përfshirë Dhjetë Urdhërimet.

Mitsvah i një babai ka qëllim të theksojë ato që psalmisti i quante “urdhërimet e Perëndisë”:

“Ligji i Zotit është i përsosur, ai e përtërin shpirtin; dëshmia e Zotit është e vërtetë dhe e bën të ditur njeriun e thjeshtë. Urdhërimet e Zotit janë të drejta dhe e gëzojnë zemrën; urdhërimet e Zotit janë të pastra dhe ndriçojnë sytë” (Psa. 19:7-8).

Ai vazhdon duke thënë: “Edhe shërbëtori yt mëson prej tyre; ka një shpërblim të madh duke i mbajtur ato” (Psa. 19:11).

Zoti i ka shfaqur qartë urdhërimet e Tij. Ato janë të arritshme për këdo që dëshiron t’i njohë. Askush nuk ka pse të shpenzojë jetën në kërkim të tyre, sepse ato janë shumë pranë nesh - dhe as nuk ju nevojiten diploma seminaresh që t’i gjeni ato.

Detyra e babait, përkrah gruas së tij, është t’u mësojë fëmijëve urdhërimet e Perëndisë. Babi, ti je bërë për shumë më tepër sesa një tifoz aty në anë që i thua “Të lumtël!” gruas tënde. Ati po të fton të atërosh në të njëjtën mënyrë si Ai, duke ju mësuar fëmijëve tuaj rrugët e Tij.

Fjala e përkthyer “mësimet” e nënës tënde është fjala hebraisht *torah*, ose ligji. Vjen nga folja *yarah*, që do të thotë “të mësosh dhe të udhëzosh”.

Ashtu siç priftërinjtë duhet t’i mësonin Torahun Izraelit, në të njëjtën mënyrë mamatë duhet t’u mësojnë fëmijëve të tyre ligjet e Perëndisë, rrugët e Perëndisë dhe urtësinë themelore që të aftësohen për jetën.¹

Kjo do të thotë që edhe baballarët, edhe mamatë do të bënin mirë të njihnin Shkrimin! Thuhet për Ezdran se ai “e përkushtoi veten në studimin dhe zbatimin e ligjit të Perëndisë dhe në mësimin e dekretëve dhe ligjeve të Tij në Izrael” (Ezd. 7:10). Ai ishte një burrë që njihej për aftësinë e tij në shpjegimin e Shkrimeve.² Çdo ndjekës i Jezusit dhe çdo prind është i ftuar të bëjë të njëjtën gjë.

Fjalët e Urta 6 vargu 23 vazhdon: “Sepse ky urdhërim është një llambë, ky mësim është një *dritë* dhe ndreqjet e mësimet janë rruga e jetës”.

Për çfarë është e gjithë kjo?

Fjala e përkthyer “llambë” është *niyr*. Hebrenjtë i kishin të dëgjua këto fjalë dhe e kuptuan menjëherë këtë metaforë nga jeta e tyre e përditshme. Llamba ishte një pjesë e vogël qeramike në formë tasi që përmbante vaj dhe një fitil. Llambat përdoreshin për të ndriçuar tabernakullin - vendin kur njerëzit vinin për t’u takuar me Perëndinë. Shandanët vendoseshin në vende strategjike në mënyrë që të ndriçonin atë vend të shenjtë.

Shtëpia juaj duhet të jetë një vend i shenjtë!

Prania e babait është ideuar të jetë si llamba në tabernakull, duke shkëlqyer dritën dhe dashurinë e Jezusit në çdo cep të shtëpisë.

Drita ose ‘*owr*’, është një koncept tejet i rëndësishëm që gjendet përmes Shkrimit, si një simbol i jetës, lumturisë dhe gëzimit. Tek Gjoni 8:12 Jezusi tha: “Unë jam drita e botës. Kush më ndjek nuk do të ecë më kurrë në errësirë, por do të ketë dritën e jetës”.

Drita gjithashtu është përdorur në mënyrë metaforike në Shkrim për të dhënë pamjen se si Fjala e Zotit na ndriçon ne, duke na aftësuar të ecim me besim në shtegun e Tij. Në Psalmin 119:105 lexojmë: “Fjala Jote është një llambë në këmbën time dhe një dritë në shtegun tim”.

Pasazhi tek Fjalët e Urta 6 tregon që, mësimet e nënës ofrojnë dritë: jetë, lumturi, gëzim, dhe njohuri. “Kur do të ecësh, do të të udhëheqin; kur të pushosh, do të të ruajnë; kur të zgjohesh, ata do të të flasin ty” (Fj. e Urta 6:22).

Në një kuptim shumë real, prindërit janë ideuar të punojnë *së bashku* si partnerë në edukimin e fëmijëve të tyre. Ne jemi thirrur nga Perëndia që t'i mësojmë fëmijët tanë, duke u dhënë njohuri e udhëzime dhe duke integruar të vërtetat e Perëndisë në jetën e përditshme. Babai duhet të qëndrojë i drejtë dhe i fortë si llamba, ndërsa mësimet e qarta të nënës nga Shkrimi sjellin dritë.

Ky përdorim i poezisë metaforike jo vetëm që është i bukur, por është edhe i mbushur me urtësi praktike. Ju mund ta përpunoni këtë parim disi ndryshe nga ne, por në interes të praktikitetit, duam t'ju japim një copëz nga mënyra se si ne e kemi zbatuar këtë pasazh nga Fjalët e Urta.

Në të njëjtën kohë, ju këshillojmë që ta mendoni këtë me një vlerësim të qartë të asaj që ju jeni dhe si mund të punoni më mirë së bashku. Ka shumë mënyra për ta konceptuar këtë pasazh – nuk ka një plan të saktë t'hapësh për t'u ndjekur. Dhe kjo, pa dyshim, është e qëllimshme! Për shkak se Perëndia e ka bërë secilin prej nesh të veçantë, asnjë familje nuk e përpunon metaforën e llambës dhe dritës në të njëjtën mënyrë.

Thënë kështu, ja si është përdorur ky koncept në shtëpinë tonë:

SË PARI, BABAI PARASHTRON VIZIONIN

Bibla e përshkruan qartësisht bashkëshortin si ai që duhet të udhëheqë bashkëshorten e tij. Jo që të dominojë mbi të ose t'i japë urdhra, por të ndër marrë iniciativa për të kuptuar atë që Perëndia do për familjen e tij. Iniciativa e bashkëshortit duhet të kombinohet me një qëndrim të përulur shërbyes ndaj bashkëshortes dhe fëmijëve të tij. *Si mund t'i shërbej më së miri familjes dhe Zotit tim duke u bërë nismëtar i një mënyre jetese të orientuar nga Jezusi?*

Në rastin tonë, shkarja në imoralitet e Phil gjatë viteve të tij si baterist në një grup rroku e bëri atë të dëshironte diçka më të mirë për

fëmijët. Ai vendosi një ton standardesh të perëndishme pa kompromise. Kjo gjë na bëri ta ruanim shtëpinë tonë si një vendstrehim nga imoraliteti që gjendet në botë. Ne donim të krijojmë një vend të shenjtë, që do të thoshte bllokimin e filmave, programeve televizive dhe muzikës që nuk e nderonin Perëndinë.

Nënkuptonte gjithashtu praktikimin e udhëzimeve që ndodhen tek Efesianët 4 për të folur me vërtetësi dhe hir me njëri-tjetrin. Pa të bërtitura, pa sarkazëm therës, pa mburrje, me shumë përulësi të shprehur qartësisht si dhe kërkimin e faljes kur duhej bërë.

Djali ynë John Mark e ka përpunuar konceptin ndryshe. Ai dhe gruaja e tij ndajnë të njëjtën barrë, të hapin shtëpinë e tyre për njerëzit që kanë dëshpërimisht nevojë të shohin dashurinë e Zotit në veprim. Kjo i ka drejtuar ata të krijojnë marrëdhënie me personat që jetojnë përreth tyre. Si baba në shtëpinë e tij, John Mark ka stabilizuar një vizion përbashkësie dhe misioni dhe kjo tregon mënyrën si ata jetojnë së bashku.

Një tjetër familje që ne njohim ka vendosur një vizion shërbimi në bazat e saj. Dy djemtë e tyre u rritën duke mësuar t'u shërbenin të tjerëve si një familje, duke u shërbyer njerëzve në kishë, por edhe njerëzve të distancuar nga kisha. Në këtë rast ishte barra e mamit që t'u shërbente njerëzve të lënduar në mungesë të prindërve.

Më shumë se gjithçka tjetër, Phil parashtroi një vizion për t'i dhënë nder Perëndisë në shtëpinë tonë. Ne dëshironim një familje që do të donte Perëndinë me pasion dhe do të donte njerëzit me qëllim.

SË DYTI, MAMI E PËRÇON VIZIONIN

Ishte kryesisht Diane ajo që e bëri të funksiononte vizionin e familjes. Ajo ishte me fëmijët gjatë gjithë ditës dhe çdo natë. Ishte ajo që përballëj me shpërthimet emocionale tek dyqani i ushqimeve. Ishte më së shumti ajo që duhet të përballonte konfliktet ose mungesën e respektit. Ishte Diane ajo që duhet të vendoste në çast nëse një shpërthim emocional ishte një qëndrim i keq që duhej korrigjuar, apo thjesht një ditë e keqe që duhej anashkaluar.

Phil ishte i zënë duke siguruar për ne, duke punuar me orë të gjata, në mënyrë që Diane të mund të qëndronte në shtëpi ato vitet e

para. Kur Phil kthehej në shtëpi në mbrëmje dhe në ditët e pushimit, ai mendohej t'i përmbahej me rigorozitet synimit, duke kaluar kohë të qëllimshme me fëmijët.

Kjo gjë kërkonte shumë e shumë biseda gjerë e gjatë, duke ripërcaktuar atë që ne donim të shihnim të ndodhte në jetët individuale të fëmijëve tanë. Ne ishim në mision *së bashku* për fëmijët tanë edhe pse Diane ishte më së shumti shefja e disiplinës në vitet e para. Edhe Phil i disiplinonte fëmijët kur ishin të vegjël, por më rrallë sesa Diane. Ishte kryesisht në dorë të Diane që të realizonte atë që kishim vendosur së bashku.

Ne bëmë sakrifica të mëdha në mënyrë që Diane ta fokusonte vëmendjen e saj tërësisht tek katër fëmijët tanë të vegjël. Pensioni ynë nuk është siç do të kishte qenë nëse Diane do të kishte shkuar në punë gjithë ato vite. Dhe prapë, ja ku jemi, duke iu afruar fundit të viteve tona të punës dhe aspak të penduar për mënyrën se si e shpenzuam atë periudhë të jetëve tona.

Prindër të tjerë bëjnë një punë mjeshtërore me xhonglime oraresh në mënyrë që fëmijët të marrin sa më shumë të jetë e mundur vëmendje dhe mësim prej tyre, ndërkohë që ata kryejnë thirrjet që kanë në vendin e tyre të punës. Shumë familje që ne njohim, të zhytura në hua për shkollën, me rritjet e kostove të sigurimeve shëndetësore dhe një ekonomi që shpeshherë kërkon edhe të ardhura (të tjera) dytësore, kanë gjetur mënyra krijuese për t'u dhënë fëmijëve të tyre të vegjël më të mirën edhe kur të dy prindërit punojnë.

Kini parasysh se ne nuk po nxisim një ideal prindërimi si tek shfaqja amerikane "*Leave It to Beaver*"³ si modelin biblik përfundimtar. Femrat kanë punuar gjithmonë. Për ne, vendimi për të lënë Diane të përqëndrohej kryesisht në mësimin dhe edukimin e fëmijëve tanë teksa ata po rriteshin ishte një vendim i hulumtuar që ne besonim se ishte më i miri për ne, por jo se është domosdoshmërisht i arritshëm për të gjithë.

SË TRETI, BABAI MERRET ME SKEMAT

Në vend që ta priste Phil-in, në fund të ditës së tij të gjatë në punë, me një varg ankesash për prapësitë e fëmijëve apo acarimet e saj, Diane raportonte më së shumti skemat.

“Matthew është grindur herë pas here sot, çfarë do të bëjmë?” ose “Bekah dhe e vogla Beth janë zënë e grindur gjithë ditën sot. A do të bëhen ndonjëherë shoqe ato të dyja?”

Çdonjëri prej fëmijëve tanë shfaqte tendenca, të asaj që Bibla në përkthimin King James i quan *mëkate të vazhdueshme* dhe në përkthimin NIV i quan “mëkate që na qarkojnë vazhdimisht” (Heb. 12:1). Këto janë anë të dobëta me të cilat duhet të përballemi herë pas here, në mënyrë që të ndihmojmë fëmijët tanë të jenë ata që Perëndia do që të jenë: jo të përsosur, por të lirë nga sjellje jo të shëndetshme që mund t'i ngatërrojnë gjatë jetës së tyre.

Phil sigurohej që Diane të mos rraskapitej e të hiqte dorë. Ne kishim dy djem me vullnet të fortë dhe dy vajza po aq të forta dhe të ndërlikuara nga ana emocionale. Tashmë ata janë të gjithë drejtues, por si fëmijë të vegjël shumë shpesh ishin sfidues. Nuk ka asnjë person që manipulohet lehtë apo flegmatik në familjen tonë!

Phil e mbante vizionin përpara nesh kur ndiheshim të lodhur ose të tunduar, në mënyrë që t'i injoronim sfidat.

SË FUNDMI, MAMI DHE BABI KËRKOJNË URTËSI SË BASHKU

Kur shfaqej diçka krejtësisht jashtë karakterit, Diane e sillte incidentin në vëmendjen e Phil dhe së bashku zbulonin se çfarë po ndodhte.

DIANE:

Në një rast mora një telefonatë nga një nënë e irrituar, e cila kërcënoi se do të raportonte tetëvjeçarin John Mark tek kushedi-se-kush, pasi ai kishte pranuar sfidën e birit të saj oh-aq-të-pafajshëm dhe e kishte sorollatur me makinë zonjën që mbinte kudo papritur përmes bulevardit Ocean në Santa Cruz, Kaliforni.

Unë, sigurisht u shtanga, ashtu siç do të bënte çdo nënë me respekt për veten! Nuk mund të vendosja me kë isha më e zemëruar - me mamin në anën tjetër të telefonit, djali i së cilës padyshim që kishte nxitur John Mark ta bënte këtë gjë, apo me tim bir, i cili e dinte që e kishte kapërcyer kufirin tejmas!

Phil më qetësoi, duke më kujtuar se kjo ishte jashtë karakterit të djalit tonë. Pastaj ai thjesht foli me të birin, duke e ditur si është për një mashkull të jetë i sfiduar dhe i tunduar. Ai i drejtoi pyetje të tipit: “Çfarë po ndodh bir?” pa presionin e turpit ose të fajit.

Në fund, ai më siguroi se John Mark nuk ishte fëmijë me premisa kriminale, por një fëmijë i mirë që ende kishte nevojë për shumë mbikëqyrje.

Phil ma kujtonte shpesh qëllimin tonë: jo të rritnim fëmijë perfekt në mënyrë që mami të krenohet, por të trajnojmë drejtues të brezit të ardhshëm që do të guxojnë të heqin mykun, Danielë dhe Nehemia që do të jenë të gatshëm të çajnë rrymën dhe të ndjekin Jezusin pa frikë.

Ai më thoshte: “Mos disiplinohu burrin brenda tij”, duke më kujtuar herë pas here synimin që po ndiqnim.

Shpesh është babai ai që shikon pamjen e madhe, ndërsa mamaja është në llogore duke bërë “luftën guerrile” që duhet bërë në një ritëm të përditshëm. Megjithatë disa herë është mami ajo që e frymëzon bashkëshortin e saj duke përfytyruar se si Zoti po e fton familjen e tyre që të jetë.

Të dy prindërit janë ngarkuar me privilegjin për t’iu mësuar fëmijëve të tyre urdhërimet dhe udhëzimet e Perëndisë duke gërshtuar rrugët e Tij në çdo aspekt të jetës. Pse? Në mënyrë që këta fëmijë të dashur për ju të rriten duke kuptuar çfarë do të thotë të jetosh me urtësi.

Kur mbreti Solomon i shkroi të birit për urtësinë e ndjekjes së Perëndisë, ai e këshilloi: “Biri im, mos i harro mësimet e mia. Ruaji urdhërimet e mia në zemrën tënde. Nëse bën këtë, do të të shtohen ditë të gjata, vite jete dhe paqeje” (Fjalët e Urta 3:1-2).

Nëse perspektiva e gjithë këtyre mësimëve duket e pamundur në mes të jetëve tuaja të mbushura me stres, ju inkurajojmë që të merrni parasysh përfundimin, të llogaritni koston. Në fakt, Bibla është e mbushur me histori mbretërishe të cilët ishin udhëheqës të mëdhenj, por dështuan si etër.

Është e qartë se Perëndia e mat suksesin ndryshe nga bota. Ai e ka hedhur mantelin e udhëheqësisë shpirtërore vendosmërisht në supet e prindërve, duke na kujtuar vazhdimisht se urtësia e Tij është rruga për tek jeta që është vërtetë jetë.⁴

Kapitulli 6

Qëllimet kundrejt Vlerave

Asnjë nuk mundet,
pa hequr dorë nga bota në kuptimin më literal të fjalës,
të ndjekë metodën time; dhe ka pak, nëse ka,
që do të përkushtonin njëzet vitet më të mira të jetës
me shpresën për të shpëtuar shpirtërat e fëmijëve të tyre,
sepse ky ishte qëllimi im themelor,
kur mendojnë që mund të shpëtohen pa shumë mund.

SUSANNA WESLEY

Fjalët e Susanna Wesley na kanë ndikuar thellësisht. Ne po jetonim në Santa Cruz ku Phil ishte drejtues adhurimi në një kishë që po rritej në mënyrë vibrante, kur Diane - në kërkim të urtësisë për të rritur fëmijët tanë - lexoi biografinë e nënës së John dhe Charles Wesley.¹ Fëmijët tanë ishin gjashtë, katër dhe një vjeç, kur fjalët e saj injektuan një ndjesi të re urgjence tek ne - Një thirrje e përtërirë për të shqyrtuar çdo gjë në jetët tona, një thirrje për të hequr dorë nga çdo gjë që mund të ndërhynte në “shpëtimin e shpirtërave të fëmijëve tanë”, dhe një gatishmëri për të përkushtuar vitet më të mira të jetës sonë për rritjen e ndjekësve pasionantë të Jezusit.

Nëse jeni ende duke lexuar, padyshim që edhe ju keni vendosur të njëjtën gjë. Ju po kuptoni pafundësinë e kësaj thirrje dhe jeni të gatshëm të bëni gjithçka që nevojitet për t'u përballur me “mundin” që Susanna derdhi tek fëmijët e saj. Për t'ju ndihmuar të përmbushni këtë detyrë të madhe, duhet të jeni të aftë të kuptoni ndryshimin midis një qëllimi dhe një vlere.

Fjalori Webster e përcakton qëllimin si “fundi drejt të cilit drejtohet përpjekja . . . pika përfundimtare e një gare”.

Ne sugjerojmë që ndërsa fëmija juaj rritet, të fokusoheni në një qëllim të vetëm: të rritni bij dhe bija që janë ndjekës pasionantë të Jezusit.

Me “ndjekës pasionantë të Jezusit” nënkuptojmë fëmijë që rriten për të dashur dhe për të ecur vërtetësisht me Zotin, që e ndjekin dhe i shërbejnë Atij dhe që kuptojnë thirrjen e tyre për të sjellë të tjerë në mbretërinë e Tij.

Nuk po flasim për shembuj perfektë virtytesh, por për ndjekës të Jezusit që transformohen në dishepuj. Burra dhe gra, qëllimi i jetës së të cilëve është ta njohin ngushtësisht Perëndinë dhe ta kënaqin Atë vazhdimisht. Ky është qëllimi! Sepse kur Jezusi është i pari, gjithçka tjetër shkon në vendin e vet. Edhe kur vijnë sfidat, tundimet dhe vështirësitë, fëmijët tuaj nuk do të ecin kurrë në errësirë.

Jezusi tha: “Unë jam drita e botës. Kush më ndjek nuk do të ecë kurrë në errësirë, por do të ketë dritën e jetës” (Gjoni 8:12).

Kjo marrëdhënie jetëndriçuese me Jezusin është qëllimi ynë përfundimtar për jetët e fëmijëve tanë dhe për atë fund ju angazhoheni të bëni gjithçka që duhet bërë, në mënyrë që të arrini realizimin e qëllimit.

Vlera ndryshon nga qëllimi. Për qëllimet e këtij libri, vlera mund të përkufizohet si diçka që është shumë e rëndësishme për ju. Diçka që ju e vlerësoni dhe admironi; diçka që ju vërtet dëshironi që fëmijët ta kenë pjesë të jetës së tyre.

Në mënyrë që të arrini qëllimin, duhet vazhdimisht të shikoni nga afër vlerat tuaja. A ju ndihmojnë apo ju pengojnë ato në arritjen e qëllimeve tuaja?

Të gjithë kemi vlera që duam t’i përcjellim - cilësi, zakone dhe standarde që shpresojmë që fëmijët tanë t’i përvetësojnë teksa rriten për të krijuar modelet e tyre të të jetuarit.

Nuk po flasim vetëm për vlera morale këtu. Vlerat tona do të jenë kryesisht të mira, cilësi biblike të përziera me disa standarde kulturore dhe zakone të jetës që ne duam të shohim fëmijët tanë t’i bëjnë të vetat.

Disa vlera do të ndihmojnë dhe disa do të jenë asnjëherë, por rreziku është ky: që disa herë gjërat *e mira* mund t'u zënë rrugën gjërave më të mira.

Një vlerë që e kemi parë herë pas here janë sportet konkurruese të të rinjve - diçka e mirë! Sportet mësojnë punën në ekip, disiplinën, nënshtrimin ndaj autoritetit, përgatitjen për afatet kohore dhe të qëndruarit në formë.

Po sikur ta mbajnë fëmijën tuaj larg kishës të dielave? Po sikur të komunikoni pa dashje që adhurimi sistematik i Jezusit në bashkësi është fakultativ? Që kur rrethanat shtrëngohen, përkushtimi ndaj ekipit vjen i pari? Po sikur të përballeni me situatën kur djali ose vajza fitojnë atë bursën e universitetit (që statistikisht tregojnë të ketë pothuajse vetëm një përqind mundësi), por largohet nga kisha (i mbani mend statistikisht?) dhe nuk është i interesuar të ecë me Jezusin?

Po pastaj?

Në këto situata, *vlera* do ta kishte spostuar qëllimin tuaj.

VLERA TË NDRYSHME

Nuk ka familje që mund të kenë një listë vlerash identike. Prandaj, nuk ka as prindër që mund të kenë një listë vlerash identike.

DIANE:

Ndërsa po rrisja fëmijët, në krye të listës sime të vlerave ishin pastërtia, sistemimi dhe rregulli - një vend për gjithçka dhe gjithçka në vendin e vet, siç i thonë një fjale. Doja një shtëpi të mirëmbajtur që rrezatonte mikpritje. Kështu isha rritur unë dhe kështu doja që të veprimej edhe në shtëpinë time.

Pastërtia ngjan me perëndishmërinë - është në Bibël, apo jo? Epo, jo. Nuk është, por është në biblën time!

Por Phil nuk e vlerësonte dhe ende nuk e vlerëson një shtëpi të pastër si një nga pesë vlerat e tij të para. Ai nuk dëshiron të jetojë në një vend të rrëmujshëm e të pisët, por as nuk do të bënte sakrificat të mëdha që të sigurohej që shtëpia të ishte perfekte.

Nga ana tjetër, argëtimi renditet lart në listën e vlerave të Phil - argëtimi si familje, të parit e filmave argëtues, planifikimi i udhëtimeve dhe pushimeve argëtuese.

Ndërsa rritesha, në familjen time ne punonim edhe në Ditën e Punëtorëve. Ne punonim sepse të dy prindërit e mi i vinin rëndësi shumë të madhe (mund t'ju shkojë mendja) pastërtisë, sistemimit dhe rregullit.

Shumica e kujtimeve nga pushimet e mia rrotullohen rreth të punuarit së bashku në oborr, lyerjes së verandës ose ndonjë projekti tjetër ku nevojitej përfshirja e të gjithëve. Phil mendon se kjo gjë është e tmerrshme! Ai nuk mund ta kompromentojë vlerën e tij të argëtimit si familje me shpenzimin e kohës tonë të lirë duke punuar në projekte për mirëmbajtjen e shtëpisë. Ai do të zgjidhte më mirë të bënte një xhiro me makinë drejt detit ose të shkonte të shikonte një film.

A mund t'a shikoni rënien që kemi përpara?

Dy prindër të ndryshëm me dy palë vlera të ndryshme që ndonjëherë përplasen. Kjo është normale!

Siç thotë Emerson Eggerichs: “Nuk është gabim, thjesht ndryshe”.²

QËLLIMET KUNDREJT VLERAVE - USHTRIM

Ne dëshirojmë t'ju ndihmojmë të kuptoni ndryshimet që keni me njëri-tjetrin, kështu që kemi hartuar një listë vlerash në mënyrë që t'ju orientojë të identifikoni se çfarë ju “çmoni dhe admironi” – çfarë është shumë e rëndësishme për *ju*. Vlerat që ju jeni të prirur t'i kultivoni në jetën e fëmijëve tuaj. Vlera, të cilat shpresoni që fëmijët tuaj t'i adoptojnë dhe t'i përshtatin si të vetat.

Mbani mend që një vlerë nuk është thjesht diçka që e preferoni, por diçka për të cilën jeni të gatshëm të bëni *sakrifica të rëndësishme* në mënyrë që ta realizoni. Phil pëlqen një shtëpi të pastër - por a do të bënte ai sakrifica të rëndësishme për ta mbajtur në atë mënyrë? Jo domosdoshmërisht. Diane e shijon argëtimin - shpeshherë - por ajo

nuk rri zgjuar natën duke ëndërruar për aventurën argëtuese të radhës.

Djali ynë John Mark ka një vlerë të vetën të bukur. Ai dëshiron që djemtë e tij të rriten duke qenë shokë të ngushtë. Madje edhe tani, kur ata kanë ndonjë mosmarrëveshje, ai i pyet: “Pse ziheni? Ju të dy jeni shokë të ngushtë!” çfarë vlere nderuese ndaj Perëndisë për ta rrënjosur tek fëmijët tanë.

Përpara se të vazhdoni leximin, merrni pak kohë për të përcaktuar pesë vlerat tuaja parësore. Këtu është një listë që mund t’ju ndihmojë të filloni, por ndihuni të lirë që të shtoni të tjera. Sapo ju dhe bashkëshorti/ja të keni përfunduar, merrni disa minuta për të kuptuar vlerat që keni ndryshe.

Mbani mend se duhet të jeni të sjellshëm dhe të respektueshëm kundrejt njëri-tjetrit. Sensi i humorit ndihmon në raste të tilla. Ne jemi të bindur se identifikimi i këtyre ndryshimeve të rëndësishme (jo të gabuara!) do t’ju ndihmojë të mbani parasysh qëllimin tuaj tekta punoni së bashku në rritjen e fëmijëve, zemrat e të cilëve rrahin për Perëndinë.

Pasi të keni identifikuar pesë vlerat parësore, bëjini vetes këtë pyetje të rëndësishme:

A na ndihmojnë apo na pengojnë vlerat tona për të arritur qëllimin tonë të vetëm?

Cili është qëllimi juaj i vetëm? Të rritim fëmijë që e duan Perëndinë me pasion dhe i duan njerëzit me qëllim.

VLERA


Argëtimi	Mbrojtja
Organizimi	Aktiviteti fizik
Efikasiteti	Mirësjellja
Kreativiteti	Ndershmëria
Respekti	Edukimi
Dieta e shëndetshme	Toleranca
Etikë e fortë pune	Mirënjohja
Mprehtësia	Paqedashja
Suksesi	Bujaria
Pavarësia	Dhembshuria
Optimizmi	Miqësia
Shkathtësia	Respekti ndaj autoritetit

Kujdesi ndaj kafshëve	Dashuria
Aftësi të mira komunikuese	Miqësia mes vëllait-motrës
Dashuria për leximin	Përgjegjësia
Iniciativa	Aftësitë ose interesi artistik
Aftësia dhe vullneti për të zgjidhur konflikte	Të mësuarit
Interesi në teologji	Intelektualiteti
Guximi	Konkurrenca
Drejtimi	Aktivizimi politik
Sensi i humorit	Aftësi mbikëqyrëse
Stilimi	Pastërtia
Kursimi	Të menduarit analitik
Përshtatja me kulturat e tjera	Të menduarit strategjik
Dëshira për drejtësi	Imagjinata
Pastërtia seksuale	Ndjeshmëria
Vetëbesimi	Pozitivitetit
Siguria	Përshtatshmëria
Spontaniteti	Produktiviteti
Disiplina	Durimi
Përpikmëria	Prezenca
Mikpritja	Shqyrtimi
Meraku për të krijuar	Nostalgjia
Afrimiteti familjar	Harmonia
Aftësitë ose interesi muzikor	Të menduarit kritik
Të qenit aventurier	Besnikëria
	Entuziazmi

Rritja e Ndjekësve Pasionantë për Jezusin

QËLLIMI: Të bashkëpunojmë me Perëndinë në mënyrë të qëllimshme që të rritim bij dhe bija të cilët do të bëhen ndjekës pasionantë të Jezusit.

*Të duash Perëndinë me pasion dhe të duash njerëzit me qëllim.
Ligj i Përt. 6:4-9 Mat. 22:36-40*



Pjesa 2



Hedhja e Themelit

Nga lindja deri në Moshën 5-vjeçare

Prandaj, kushdo që i dëgjon dhe i zbaton fjalët e mia, i ngjan një njeriu të mençur, që e ka ndërtuar shtëpinë e tij mbi shkëmb. Ra shiu, erdhën përrenjtë, frynë erërat dhe u vërsulën kundër kësaj shtëpie; por ajo nuk u shemb, sepse i kishte themelet në shkëmb.

Mateu 7:24-25

Kapitulli 7

Zemra e Bindur

PHIL:

Po i jepja makinës në rrugën e zakonshme për në zyrë, rrëzë një kodre përmes një lagjeje me shtëpi të mëdha e të shtrenjta. Hodha një vështrim djathtas dhe ajo që pashë më bëri të shkelja frenat. Një shtëpi trekatëshe që kishte qenë aty një ditë më parë nuk ishte më! Ishte zhdukur!

Një natë më parë, një stuhi kishte sjellë me vete rrëshkitje katastrofike të dheut duke bërë që e tërë shtëpia të rrëshkiste pjesë-pjesë poshtë kodrës. Fatmirësisht familja nuk ishte aty, kështu që askush nuk ishte lënduar.

Shtëpia dukej shkëlqyeshëm një ditë më parë, me derën e parme që ndrinte dhe fasadën me tulla. Por kishte diçka të gabuar, shumë të gabuar: themeli i saj kishte defekte.

Kur vjen puna tek ndërtimi i mirë i një shtëpie, rëndësinë më të madhe e ka themeli. Nëse nuk e hidhni themelin siç duhet, e gjithë ndërtesa do të vuajë pasojat. E njëjta gjë vlen edhe për prindërimin. Kur vjen puna për të rritur fëmijë të perëndishëm, themeli që hidhni është kritik.

Në këtë pjesë do të merremi me fazën e edukimit të fëmijës nga lindja deri në pesë vjeç. Meqë ra fjala, këto janë faza, jo mosha. Çdo fëmijë zhvillohet me një ritëm të ndryshëm intelektual, emocional, fizik dhe shpirtëror. Për disa arsye, vajzat duket se janë vite dritë përpara djemve!

Këto janë udhëzime të përgjithshme se çfarë të prisni përsa i përket formimit shpirtëror të një fëmije përgjatë kësaj faze të jetës së tij. Në përfundim të kësaj faze, dy janë gjërat parësore që ju doni të shihni të zhvillohen tek fëmija juaj:

1. Zemra e bindur
2. Zemra me vetëkontroll

Ne nuk po sugjerojmë se deri në moshën pesëvjeçare, fëmija juaj do t'i bindet automatikisht dhe pa bujë çdo urdhri tuaj. As nuk po aludojmë se në përfundim të kësaj faze ju do të keni mbaruar së disjplinuari problematikat e vetëkontrollit. Përkundrazi, këto janë cilësi që ju dëshironi t'i shihni të dalin *në pah*.

Do të filloni të shihni fëmijën tuaj teksa bën hapa të qartë në fushën e bindjes dhe të vetëkontrollit. Fëmija të kuptojë nevojën për të kontrolluar qëndrimet dhe të pajiset për të zotëruar krizat.

Mbani mend, thamë se ka dy pasazhe ku prindërit mund të drejtohen kur vjen puna për rritjen e fëmijëve të tyre. Këtu është pasazhi i dytë.

Në letrën e Efesianëve, Zoti i flet drejtpërdrejt fëmijëve, duke u dhënë këto udhëzime:

“Fëmijë, bindjuni prindërve tuaj në Zotin, sepse kjo është e drejtë. ‘Ndero babanë tënd dhe nënën tënde’, ky është urdhërimi i parë me premtim, ‘që të jesh mirë dhe të jetosh gjatë mbi dhe’” (Efe. 6:1-3).

Neve na pëlqen kjo pjesë!

Në këtë pasazh të Shkrimit, Perëndia urdhëron fëmijët t'u binden prindërve të tyre. Por nëna dhe baballarë, është detyra juaj t'i mësoni ata të binden! Dhe duhet të fillojmë ta bëjmë këtë gjë herët, sa janë të modelueshëm, sepse përpara se t'i mësoni fëmijës rrugët e Perëndisë, ju duhet të bashkëveproni me Perëndinë për të krijuar tek ai/ ajo një zemër të mësueshme, përndryshe mësimi do të bjerë në veshë të shurdhër.

Ashtu siç Perëndia kujdeset për zemrën *tuaj*, po ashtu edhe ju duhet të kujdeseni për zemrën e birit ose bijës tuaj. Mbreti Solomon e kuptoi këtë koncept kur shkroi: “Biri im, mos harro mësimet e mia dhe *zemra* jote le të ruajë urdhërimet e mia” (Fja. e Urta 3:1).

Ka një ndjenjë urgjence në këto fjalë. Pse? Ai vazhdon duke thënë: “sepse do të të shtohen ditë të gjata, vite jete dhe paqeje” (Fja. e Urta 3:2).

Këto janë udhëzime të një ati që jeton për t’i treguar birit të tij rrugën për një jetë të gjatë e të kënaqshme! Tani, pikërisht *çfarë* ju i mësoni, kur ia mësoni dhe si ia mësoni, do të variojnë nga faza në fazë.

Në këtë fazë të parë themelore, synimi përfundimtar është të krijoni tek fëmija juaj një zemër të bindur. Jo një pajtim *perfekt*, *pa dashur t’ia dinë pse*, por një zemër që në të vërtetë e me sinqeritet dëshiron të bindet.

PSE ËSHTË KAQ E RËNDËSISHME BINDJA?

Arsyeja përse i mësojmë fëmijët tanë të na binden nuk është për shkak se ne jemi egomaniakë ose diktatorë, as sepse duam të mburremi me fëmijët tanë ekzemplarë sikur të ishin trofe.

Ne i mësojmë fëmijët tanë të na binden në mënyrë që të rriten me aftësinë e natyrshme, refleksive për të zgjedhur t’i binden Perëndisë në vend të impulsive të tyre personale.

Kur Perëndia foli për Davidin, i cili ishte një burrë larg të qenit i përsosur, Ai e quajti atë “një njeri sipas zemrës sime; ai do të plotësojë tërë dëshirat e mia” (Vep. 13:22).

Kur i mësojmë fëmijët tanë të na binden, ne u japim atyre një kapacitet shtesë për t’iu bindur Perëndisë. Çfarë dhurate e mrekullueshme! Fëmijët që kurrë nuk mësojnë t’u binden prindërve të tyre (pavarësisht nëse e ndjejnë apo jo) kanë disa periudha vërtet të vështira kur rriten.

Ata nuk dinë *si* t’i binden Perëndisë. Shumë luftojnë dhe dështojnë për pjesën e mbetur të jetës së tyre, të paaftë në mënyrë të dukshme për t’ia nënshtruar vullnetin e tyre Atij që e quajnë Zotin e tyre.

Andrew Murray, një predikues afrikano-jugor me influencë në vitet 1800, shkroi:

“ . . . një vullnet i pabindur është mallkim; por një vullnet që zotëron vetveten nëpërmjet bindjes është vullneti vërtet i fortë”¹

Me fjalë të tjera, ne i mësojmë fëmijët tanë që ta zotërojnë vullnetin e tyre në bindje, në mënyrë që të rriten për të qenë burra dhe gra me fuqi të vërtetë.

Trajnimi i fëmijëve tuaj në bindje do t’ju kushtojë: do t’ju marrë vëmendje, punë, vendosmëri dhe përkushtim.

Në këtë fazë të hershme të jetës së fëmijës tuaj, mund t’ju duhet të kufizoni disa mundësi dhe të ngadalësoni ritmin e jetës tuaj. Ndoshta do t’ju duhet të qëndroni shumë në shtëpi. Para se të bëheshit me fëmijë, mund të dilnit çdo natë, por tani keni oraret e gjumit dhe rutinat, një program për t’u mbajtur.

Për shumë fëmijë, të qenit larg shtëpisë gjatë këtij trajnimi intensiv që kërkohet në këtë fazë, mund të përbëjë një hap të madh pas. Kufijtë ndryshojnë kur shkoni në dyqan me ta, ose i merrni në një vend ku disiplina duhet të lehtësohet për pak. Në njëfarë mënyre fëmijët e dinë këtë dhe shumë prej tyre përfitojnë nga kjo liri!

Por merrni zemër! Kjo fazë nuk zgjat përgjithmonë. Mund të duket sikur zgjat përjetë, por na besoni, kjo periudhë trajnimi intensiv do të përfundojë më shpejt nga ç’ prisni. Nëse e bëni punën tuaj mirë, duke krijuar një zakon strategjik për trajnimin e fëmijës tuaj në bindje, dhe nëse ai përvetëson nevojën e domosdoshme që t’ju bindet me një urgjencë që tejkalon prirjet personale për kontroll - atëherë kjo fazë shumë shpejt do të jetë thjesht një kujtim i largët.

Ajo që ndodh në këto vite themelore mund të ndikojë në mënyrën se si do të shkojë çdo fazë tjetër e jetës së tij.

Bibla lë të nënkuptohet që prindërit kanë hapësira disiplinore të efektivitetit në këtë detyrë të rritjes së fëmijës. Fjalët e Urta 19:18 e citon në këtë mënyrë:

“Disiplinonini fëmijët tuaj për sa kohë ka shpresë.
Përndryshe do t’i shkatërroni jetët e tyre”.

Kjo periudhë e hershme në shtëpi është si një kamp stërvitor: ata do t'i rikthehen sërish trajnimit të tyre më vonë, kur ju të mos keni më kontroll mbi zgjedhjet e tyre. Kjo është një periudhë kohore në të cilën ka shpresë, një kohë kur trajnimi, disiplinimi, dashuria dhe përkujdesja për fëmijën tuaj rezultojnë në një zemër të etur për t'u afruar e për t'u bindur.

Mos harroni, ju jeni trajnerë, jo diktatorë. Një trajner me cilësi të larta është i rreptë dhe i informuar, me një mençuri që vjen nga të kuptuarit e synimit të tij. Pali e kuptoi këtë kur këshilloi Timoteun të “ushtronte veten në perëndishmëri; sepse ushtrimi i trupit nuk është shumë i dobishëm, por perëndishmëria . . . mbart premtimin e jetës së tanishme dhe *gjithashtu të jetës* që do të vijë” (1 Tim. 4:7-8).

Si prindër, ne i disjplinojmë fëmijët tanë në perëndishmëri, duke rrënjosur tek ata gradualisht aftësinë për të zgjedhur t'i binden Perëndisë. Duke bërë këtë, një ditë - kur zgjedhja për të ndjekur ose jo rrugën e Jezusit të jetë plotësisht në dorën e tyre - ata do të zotërojnë fuqinë e brendshme që t'i rikthehen trajnimit të dhënë prej jush, në vend që të bashkohen me bashkëmoshatarët e tyre ose vullnetin e tyre të shfrenuar.

Autori i Hebrenjve e ka shprehur në këtë mënyrë: “Ata që janë ushtruar në këtë mënyrë do të shijojnë frytë paqtimi e drejtësisë” (Heb. 12:11).

Kapitulli 8

Mjete për Disiplinim

Është shumë mirë të flasim për *konceptin* e bindjes, por e dimë çfarë po mendoni, sepse kjo gjë na ka irrituar edhe ne ndërsa rritnim fëmijët tanë:

Si ta bëj këtë? Si të krijoj tek fëmija im këtë zemër bindjeje?

Nuk i dinim të gjitha këto sa i kishim fëmijët të vegjël. E dinim se donim t'i mësonim fëmijët të na bindeshin - ishim të sigurt për këtë gjë. Nuk donim të rritnim tiranë të vegjël mospërfillës. Por nuk dinim çfarë mënyrash të përdornim; nuk dinim *si*.

Kështu që bëmë dy gjëra.

Fillimisht pamë rreth e rrotull për prindër që kishin fëmijë që i admironim dhe u bëmë disa pyetje. Shumë pyetje! I ftonim këto familje të na mësonin, të na jepnin njohuri që nuk i kishim, e më pas i nxirrnim për drekë ose kafe dhe *paguanim ne!* Sepse kishim lexuar tek Fjalët e Urta:

“Bli të vërtetën dhe mos e shit atë, fito dituri, njohuri dhe gjykim”.

(Fjalët e Urta 23:23)

Më pas autori vazhdon:

“Babai i të drejtit ka një gëzim të madh; kush ka lindur një bir të urtë gëzohet në të. Le të gëzohet ati yt dhe nëna jote; ngazëlloftë ajo që të ka lindur”. (Fjalët e Urta 23:24-25)

Një herë, Diane pyeti një nënë që jetonte aty pranë nëse mund të takohej me të që ajo t'i mësonte se si të rriste fëmijë të perëndishëm. Ne i admironim katër fëmijët adoleshentë të kësaj familjeje, të cilët ndiqnin Jezusin me një gëzim të dukshëm. Gruaja u përgjigj duke e ftuar Diane t'i bashkohej asaj gjatë vrapit të mëngjesit.

Ndërkohë që ato vraponin, Diane i bënte pyetje dhe Laurie shpaloste urtësinë e saj. Pas disa muajsh, Laurie i përmbloodhi vështirësitë me të parëindurin tonë duke thënë: “Problemi me atë djalë është kontrolli”.

Një dritë u ndez! Sigurisht, kjo ishte! Intuita e saj na udhëzoi në mënyrën se si e trajtuam disiplinën me djalin tonë të parë që nga ai çast e në vazhdim dhe hodhi dritë mbi tendencat tona për të kontrolluar njerëzit dhe rrethanat. Phil sidomos kuptoi betejën e tij me dëshirën për të mbikëqyrur dhe kontrolluar gjërat. Ai vuri re të njëjtin problem edhe tek djali i tij i vogël.

Dikush ka thënë: “Është e dhimbshme të shohësh defektet e tua të ecin në dy këmbë të vogla”.

Jeta e prindit është udhëzuesi i fëmijës. Fëmijët tuaj ju kopjojnë juve. Mendoni pak këtë për një çast: ata imitojnë tonin e zërit tuaj, shprehjet e fytyrës e mënyrën si ju komunikoni pakënaqësitë. Nëse unë nuk kam një zemër të bindur dhe qëndrimin zemërhapur e të panegociueshëm *unë-do-bëj-gjithçka-që-Zoti-thotë* ndaj Atit, si mund të pres unë që fëmija im të ketë një zemër të bindur ndaj meje?

Së dyti, ne vazhduam të hulumtonim Shkrimet dhe të luteshim për urtësi. Herë pas here, shtrëngonim duart dhe luteshim, duke i kërkuar Perëndisë që të përmbushte premtimin e Tij tek Jakobi 1:5:

“Por në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtësia, le të kërkojë nga Perëndia, që u jep të gjithëve pa kursim, pa qortuar dhe do t'ju jepet”.

Kemi përsëritur po ashtu lutjen e Solomonit që e gëzoi zemrën e Perëndisë kaq shumë sa që Ai i dha mbretit të ri jo vetëm urtësi të madhe, por dhe pasuri të mëdha gjithashtu:

“Shërbëtori yt është në mes të popullit që ti ke zgjedhur, një popull i madh, tepër i shumtë për t’u numëruar dhe llogaritur. Jepi pra, shërbëtorit tënd një zemër të zgjuar, në mënyrë që të administrojë drejtësinë për popullin tënd dhe të dallojë të mirën nga e keqja. Kush në fakt mund të administrojë drejtësinë për popullin tënd kaq të madh?’ Perëndisë i pëlqeu që Solomoni bëri këtë kërkesë” (1 Mbr. 3:8-10).¹

Ne zgjoheshim herët që të kishim kohë personale me Zotin, duke lexuar përmes Shkrimit me pritje të madhe për të marrë urtësinë që do të na ndihmonte të bënim atë që nuk mund ta kuptonim vetë.

Çfarë zbuluam ishte kjo: Mënyra më e mirë për të rritur fëmijë që vërtetë e duan dhe e ndjekin Perëndinë është të kopjojmë mënyrën se si Perëndia na disiplinon dhe na rrit *ne* si bijtë e Tij!

Në kërkimin tonë për urtësi nëpër Shkrime, zbuluam pesë mënyra, ose pesë *mjete* disipline që Perëndia përdor me ne. Këto nuk janë të vetmet mjete disipline që përdoren në Bibël, por janë pesë nga më të rëndësishmet, ato që ne vërejtëm se i përdornim herë pas here.

Këto janë pesë mjete që në fakt mund të ndryshojnë *zemrën* e fëmijës tuaj. Nuk janë taktika modifikuese të sjelljes, por metoda të dala nga Perëndia që, kur zbatohen në prindërim, sjellin zbutjen e shpirtit të fëmijës ndaj prindërve të tij.

Katër mjetet e para gjenden në letrën e Palit drejtuar djaloshit Timote. Pali e konsideronte veten si një atë për Timoteun, ndërsa e quan “biri im i vërtetë në besim” (1 Tim. 1:2). Teksa e udhëzonte Timoteun se si të udhëhiqte kishën që ai po pastoronte, Pali shkroi:

“Prediko fjalën; ngul këmbë me kohë e pa kohë, korrigjo, qorto dhe këshillo duke i mësuar të tjerët me shumë durim.” (2 Tim. 4:2).

Ndoshta po mendoni: *Por ky varg i është shkruar një pastori për kishën e tij, jo një babai ose mamaje për fëmijën e tyre.* Dhe keni të drejtë. Por tani, pas dyzet vitesh si pastor, Phil shpesh pyetet nga pastorë të rinj se si i ka udhëhequr dhe pastoruar kishat në të cilat ka shërbyer. Ai

u përgjigjet: “Në të njëjtën mënyrë siç kam drejtuar familjen time, sepse kisha është familje!” Një kishë e shëndetshme dhe e matur funksionon si një familje, me konfliktet dhe ndërlikimet me të cilat ballafaqohet familja.

Këto mjete nuk janë të listuara sipas ndonjë radhe rëndësie. As nuk duhen përdorur me ndonjë intensitet përshkallëzues. Përkundrazi, mund të përdoren të ndërthurura në varësi të situatave. Është njëlloj si me mjetet në një kuti veglash; kur ju nevojitet një çekiç, për atë kërkoni dhe, kur mjeti më i përshtatshëm është një kaçavidhë, pikërisht atë zgjidhni.

Do të ketë momente kur gjithçka që nevojitet është një korrigjim i qetë. Por në disa raste të tjera, një qortim i ashpër, por me dashuri do të jetë mjeti më i përshtatshëm i disiplinës. Në këto raste ju nuk përdorni zemërimin për të kontrolluar sjelljen e fëmijës tuaj, por thjesht shfrytëzoni një mjet të efektshëm për të zgjuar dhe tërhequr zemrën e fëmijës tuaj drejt bindjes.

MJETI #1: KORRIGJIMI

Fjala greke *elègchō*, e përkthyer si *korrigjim*, do të thotë të qortosh, të nxjerrësh në pah fajin, të ekspozosh, ose të bindësh. Mund të përkthehet edhe si “të heqësh vërejtje”. Kjo është e njëjta fjalë greqisht që gjendet tek Gjoni 16:8, ku Jezusi thotë se Ati i Tij do të dërgojë Frymën e Shenjtë, i Cili do të “bindë (*elègchō*) botën për mëkat, për drejtësi dhe gjykim”.

Ky është mjeti që ne ndjejmë shpesh të ëmblin Frymë e Shenjtë t’u përdorë në jetët tona për të ndërmarrë një korrigjim të nevojshëm të drejtimit. Kur ulemi në kishë duke dëgjuar një predikim, mund të ndodhë që diçka e thënë nga pastori të bëjë që zemrat tona të hidhen përpjetë nga ajo që kuptojnë. Ose mund të jemi duke medituar mbi Shkrimin dhe duket sikur papritur një dritë ndriçon një zonë të jetës tonë që është ende e vështirë. Ose kur jemi të ulur në kishë dhe ndjejmë zërin e butë të Frymës së Shenjtë duke thënë: “Fale atë që të lëndoi!” Kur ndodh diçka e tillë, përgjigja jonë mund të jetë e menjëhershme:

Oh! Po, Zot, të lutem më fal dhe bashkoje zemrën time me zemrën Tënde. Ndihmomë!

Dhe Ai e bën.

Katër gabime që prindërit i bëjnë shpesh

1. Neglizhenca ndaj sjelljes ose qëndrimit

Në vend që të jemi tërësisht të fokusuar tek fëmijët tanë, ne shpërqendrohemi duke humbur kështu mundësinë për të parandaluar disa sjellje që në moshë të hershme, përpara se të na dalë situata nga duart. Sa katastrofa mund të ishin shmangur nëse ne thjesht do të ishim më të vëmendshëm ndaj fëmijëve tanë?

2. Mendimi që kur të rriten do t'u kalojë

Ky është një mit i përhapur që nuk i lejon prindërit të shikojnë seriozitetin dhe peshën e madhe të sjelljes së fëmijës. Diçka që mund të duket e lezetshme kur ata janë dy ose tre vjeç, mund të bëhet ekstremisht e pakëndshme teksa rriten, vetëm nëse do të ndërhyjmë duke u mësuar butësisht një mënyrë më të mirë.

3. Nxjerrja e justifikimeve për qëndrimet apo veprimet e fëmijës tuaj

Ne sillemi sikur fëmija ynë mund t'ia hedhë lehtë vetëm sepse “është i lodhur” apo sepse “është shumë e turpshme”, por a është realiste kjo gjë? Ndonjëherë fëmijët tanë janë vërtetë të lodhur dhe të turpshëm, por ne duhet t'i ndihmojmë ata të njohin dobësitë e tyre. Duke u dhënë mjete që të përballen me to, në vend të justifikimeve, ne u mundësojmë fëmijëve të rriten e të ndryshojnë.

4. Ngritja e zërit në zemërim dhe presion

Ky është ndoshta gabimi më i përhapur që bëjnë prindërit e rinj për të kontrolluar fëmijën e tyre. Është vendi ku përplasen shumë prej nesh kur përballemi me pasojat e neglizhimit tonë, ndërkohë që duhet të kishim qenë të vëmendshëm dhe të përdornim korrigjimin përpara se sjellja e fëmijës të dalë jashtë kontrollit.

Çdo prind i bën këto gabime hera-herës. Sigurisht që edhe ne i kemi bërë! Por, të pranoni që këto taktika nuk janë pjesë e planit tuaj për rritjen e fëmijëve, zemrat e të cilëve priren drejt bindjes, ju lejon t'u kushtoni vëmendje dhe t'i rikalibroni përgjigjet tuaja.

Rregulli Dhjetëvjeçar

Po për ato raste kur thjesht nuk jeni të sigurt nëse ajo që po bën fëmija juaj meriton të disjplinohet? Kjo gjë mund t'ju drejtojë në konfuzion dhe paqëndrueshmëri dhe prandaj dolëm me atë që e quajmë Rregulli Dhjetëvjeçar. Thjesht pyet veten: *Si do të jetë kjo sjellje ose ky qëndrim pas dhjetë vitesh?*

Nëse fëmija juaj përplas derën në zemërim sot, a nuk do të prishë edhe një makinë tre mijë sterlinëshe kur të jetë shtatëmbëdhjetë vjeç?

Nëse vogëlushja juaj gjuan me shkelma kur nuk i pëlqen diçka ose largohet me vrap kur ju e thërrisni, pyetni veten: *Çfarë do të bëjë ajo pas dhjetë vitesh?*

Si do të jenë shpërthimet emocionale kur të jenë tetëmbëdhjetë vjeç? Ose njëzet e tetë? Ose tridhjetë e tetë? Kush do të jetë viktima e këtij zemërimi të pakontrolluar?

E vërteta është që fëmijët nuk rriten duke lënë pas ndonjë gjë, përveçse rrobat e tyre! Nëse ata nuk mësohen të kontrollojnë qëndrimet dhe veprimet e tyre tani, mund të ketë pasoja serioze në jetën e tyre më vonë.

Në veri-perëndim të Paqësorit ku ne jetojmë, shkurret e manaferrave rriten shumë. Kur u shpërngulëm këtu fillimisht, Diane e dashuronte idenë e manaferrave të pjekura, të lëngshme e të ëmbla gati për t'u këputur e futur drejt e në gojë - dhe kishte plot nga ato tek dera e mbrapme e shtëpisë tonë! Gjatë verës tonë të parë, ajo i preu deri në rrëzë ca manaferra që kishin marrë për kot, kur pa që ato po rriteshin në një vend të papërshtatshëm. Kjo ishte e gabuar! E njëjta situatë u shfaq edhe në anën tjetër të kopshtit. Shpejt mësuam se e vetmja mënyrë për të shmangur që shkurret e manaferrave të mos na zaptinin shtëpinë ishte të gërmonim thellë dhe të shkullnim rrënjët plotësisht.

E njëjta gjë ndodh edhe me qëndrimet dhe sjelljet e këqija të fëmijëve tuaj. Nëse nuk shkoni tek rrënja, ato do të vazhdojnë të rriten. Dhe do të bëhet edhe më e vështirë t'i ç'rrënjosi ato.

Tani, kjo nuk do të thotë se duhet t'i vërsuleni djalit apo vajzës tuaj sa herë që sjellja e tyre është më pak se idealja. Kush do të mund të jetonte me këtë lloj censure? Ne thjesht po mundohemi të theksojmë rëndësinë e të qenit vigjilent ndaj fëmijëve tuaj dhe të shikoni për modele

të mira ndaj të cilave mund të kenë nevojë të adresohen qetësisht përpara se ata t'i ngulin rrënjët fort, si ato ferrat bezdisëse të manaferrave.

Nëse *e doni* fëmijën tuaj, do të ketë momente kur do ta korrighoni atë. Perëndia flet për disiplinimin e atyre që Ai i quan të Vetët: “Ata që i *dua*, i qortoj (është përkthyer gjithashtu korrighoj) dhe disolinoj” (Zbulesa 3:19).

Kur ju e korrighoni butësisht fëmijën tuaj, ashtu siç Fryma bën me ne, ai jo vetëm do ta ndjejë dashurinë tuaj, por madje do t’ju dojë për faktin që e keni korrighuar dhe qortuar kur ishte e nevojshme. Ashtu siç thuhet tek Fjalët e Urta: “Qorto të urtin dhe ai do të të dojë” (Fj. e Urta 9:8).

Do të vini re shpesh që korrighimi i një sjelljeje herët, përpara se të dalë situata nga duart, mjafton për të frenuar rrjedhën e saj. Ndonjëherë gjithçka që i duhet fëmijës tuaj është t’i kujtoni atë që ju prisni prej tij. Një prind i mençur nuk pret derisa fëmija i tij të dalë jashtë kontrollit, por *vëzhgon nga afër* dhe *ndërhyn shpejt* me korrighim të lehtë.

Mos e humbisni këtë të vërtetë të rëndësishme! Të kapësh një sjellje që herët - të mos qeshësh me të duke menduar se është e lezetshme dhe e padëmshme, do t’ju shpëtojë nga përdorimi i një disipline më të rëndë e më pak efikase në të ardhmen.

Vini re urtësinë në Fjalët e Urta 29:17 që na këshillon:

“Korrigho birin tënd dhe ai do të të japë rehatinë dhe do t’i sigurojë kënaqësi shpirtit tënd”.

Përdoreni korrighimin kur është mjete i përshtatshëm për t’u përdorur. Më së shumti ky është hapi i parë i disiplinës tek fëmijët e vegjël fare.

Teksa fëmija juaj maturohet dhe shikon drejt jush për aprovim, disa herë korrighim do të thotë një ngritje miqësisht e vetullës që me delikatesë tërheq vëmendjen për sjelljen e tij, ose një pyetje e thjeshtë si: *A je i sigurt që do ta bësh këtë?* Ai e kupton fare mirë për çfarë e keni fjalën dhe mund të zgjedhë të ndalojë vetë përpara se të ketë nevojë për disiplinë të mëtejshme. Për një fëmijë të vogël që sapo ka filluar të zgjatet

për të kapur objekte që nuk doni t'i kapë, ju thjesht mund t'i kapni dorën butësisht përpara se të mund ta arrijë atë gjë dhe me një zë të dashur i thoni: “Jo, jo!” Ose nëse përpëlitet në mënyrë të pakontrollueshme në tavolinën ku po e ndërroni, vendosjani dorën tuaj të ngrohtë tek barku dhe i thoni: “Jo! Mos lëviz,” dhe më pas shpërqendrojeni me një lodër shumëngjyrëshe. Kështu ju e prezantoni atë me konceptin e kontrollit të sjelljeve përpara se të ketë një kuptim të plotë për bindjen.

Sigurisht, duhet të bëjmë kujdes që të mos kapemi me detaje të panevojshme për çdo reagim fëmijor! Jezusi i do fëmijët kaq shumë, sa që Ai i qortoi dishepujt kur nuk i lanë fëmijët të uleshin në prehrin e Tij. Kini kujdes që të mbani balancën e duhur, në mënyrë që fëmijët tuaj të mos tërhiqen pas duke ju parë si prindër të rreptë, e pamundur t'ju kënaqin, që i korrigjoni vazhdimisht për sjelljet e papërshtatshme.

Sidoqoftë, do të ketë raste, kur nevojitet një mjet pak më i fortë për të ndaluar sjellje ose qëndrime të padëshiruara. Në këto raste, konsideroni mjetin e dytë - i ngjashëm me korrigjimin, por pak më intensiv.

MJETI #2: QORTIMI

Fjala greke *epitimáo*, e përkthyer *qortim*, do të thotë “të paralajmërosh, të tregosh rreptësi ose t'i mëshosh fort”. Është ai shikimi në sytë e tu që thotë: “Bën mirë të ndalosh në këtë çast!”

Kur një korrigjim i butë nuk ka mjaftuar për të ndryshuar sjelljen e fëmijës tuaj, ky mund të jetë mjeti i nevojshëm për të bërë një korrigjim të kursit. Toni i zërit tuaj rritet gradualisht duke u bërë më intensiv, por pa të bërtitura ose pa komunikuar zemërim.

Shkruesi i Fjalëve të Urta na thotë këtë për birin ose bijën që nuk dëgjon:

“Dhe do të thuash: “Vallë si urreva mësimin dhe si e ka përçmuar qortimin zemra ime? Nuk dëgjova zërin e atyre që më mësonin dhe nuk ua vura veshin atyre që më udhëzonin. Shumë shpejt u gjenda në probleme serioze” (Fj. e Urta. 5:12-14)

Ne i qortojmë fëmijët tanë sepse i duam ata aq shumë sa t'i ndihmojmë të shmangin probleme serioze në të ardhmen. Por kini parasysh, zëri juaj duhet të jetë qartësisht më i lartë, në mënyrë që t'ia bëni të ditur fëmijës tuaj që jeni të vendosur të mos e injoroni atë sjellje. Kjo i jep një mundësi që ta konsiderojë nëse ia vlen të vazhdojë apo jo.

Fjalët e Urta 9:8-9 thotë: “Mos qorto tallësin sepse ai do të të urrejë; qorto të urtin dhe ai do të të dojë. Mësoje të urtin dhe ai do të bëhet edhe më i urtë. Mësoje të drejtin dhe ai do të rritë diturinë e tij”.

Askush nuk kënaqet kur i duhet të qortojë dikë. Megjithatë, kur merrni kohë për të qortuar dikë që ka vlerë për ju, *në dashuri* dhe *me hir*, në fakt jeni duke i dashur ata. Fjalët e Urta 27:5-6 na siguron se është: “Më mirë një qortim i hapur sesa një dashuri e fshehur. Besnike janë plagët e një miku”.

Vini re theksin mbi dashurinë. Ky nuk është një mjet për t'u përdorur kur jeni të stresuar apo kur ju është sosur durimi. Irritimi juaj do t'i prishë fjalët që do të thoni. Më mirë prisni deri sa të jeni më të qetë dhe më pas bëni një bisedë të prerë mbi faktin se sa e papërshtatshme ishte ajo sjellje apo ai qëndrim.

Kur ju e qortoni fëmijën tuaj me dashuri dhe ai përgjigjet me bindje, ndërhyrja juaj e parandalon atë që të futet edhe më shumë në telashe!

Gjithsesi, të qortosh nuk do të thotë t'i bërtasësh fëmijës nga ana tjetër e dhomës: “Hej! Ule poshtë atë menjëherë!” Nuk është as një ofendim i ashpër ose poshtëruës.

Një qortim i praktikuar biblikisht është një paralajmërim privat i rreptë që përdoret për të parandaluar fëmijën tuaj nga nevoja e disiplinës së mëtejshme. Rritni intensitetin, por pa bërtitur. Mos përdorni zemërimin për të ushtruar kontroll mbi fëmijën tuaj.

DIANE:

Ju duhet një shembull? Disa javë më parë, po ndihmoja vajzën që të sistemonte fëmijët në klasat e tyre përkatëse në shërbesën e së dielës, në mënyrë që ajo të mbante larg nga grumbulli i fëmijëve bebin që ishte sëmurë. Një nga nipërit e mi refuzoi të shkonte në klasën e tij. Fillimisht, i hodha krahun rreth shpatullave dhe i bëra disa pyetje për të zbuluar çfarë e shqetësonte rreth kësaj situatë. I rikujtova se prindërit e tij donin që ai të shkonte në klasë. Ky është një korrigjim.

Pasi ai sërish nuk donte të shkonte, i kapa dorën, e çova në një vend të qetë, u ula në të njëjtin nivel me të dhe ia bëra të ditur që nëse nuk do të futej brenda, nuk kisha zgjedhje tjetër përveçse t'u tregoja prindërve për refuzimin e tij. Isha miqësore, e ngrohtë dhe shumë e prerë. Pa turpërim, pa manipulim emocional, thjesht një shpjegim logjik, i shpejtë dhe me një notë urgjence.

Kështu ngjan qortimi: pak intensitet, pa zemërim apo ofendime turpëruese. Natyrisht, kjo ishte një situatë e thjeshtë. Ndërhyrja në zënkat mes vëllezërve e motrave ose ndalimi i një bebi nga rrëzimi i raftit të librave do të kërkonte një zë më të rreptë dhe ndërhyrje të menjëhershme.

Ai refuzoi sërish të shkonte në klasë. Tani, unë jam Amma e tij (nofka që më kanë vendosur nipërit e mi) kështu që unë nuk kam një autoritet të vërtetë, dhe as nuk e dua. Prandaj, e çova tek mamaja e tij dhe i shpjegova situatën.

Tani ju po pyesni veten se ç'bëri ajo, apo jo?

Ky është një nga momentet kur urtësia që shoh tek fëmijët e mi të rritur më befason ndonjëherë. Ajo pati instinktin frymor për të kuptuar që ky fëmijë, në këtë situatë specifike, nuk po sillje me mospërfillje. Një stuhi ngjarjesh po vërtiteshin në zemrën e tij, duke e bërë atë ngurrues që të merrte pjesë në një orë ose edhe më shumë në aktivitete grupi argëtuese e të zhurmshme. Ajo i dha mundësinë e zgjedhjes që të rrinte me të në kishë ose të shkonte në klasë. Kur arritën në shtëpi disa orë më vonë, ajo kaloi pak kohë me të birin duke e ndihmuar të kuptonte, përpunonte dhe artikulonte emocionet e tij të papërpunuara në një mënyrë të shëndetshme.

Një qortim me dashuri është thjesht një mundësi për fëmijën tuaj që të ndalojë e të mendojë për sjelljen ose qëndrimin e tij dhe ta korrigjojë atë vetë nëse mundet. Është një moment pezull kur mendja dhe zemra e tij mund të ndeshen me pasojat që me siguri do të pasojnë nëse do të vazhdojë në këtë rrugë të mosbindjes. Prandaj, një qortim i neglizhuar duhet pasuar nga veprime nga ana e prindit, jo thjesht nga një zë më i lartë.

Në fakt, një studim i publikuar që krahason prindërit “*me autoritet*” me prindërit “*autoritarë*” arrin në përfundimin se “një kombinim i arsyetimit me pasojat kategorike të pushtetit është më efektiv sesa vetëm njëra prej tyre”.² Me fjalë të tjera, shumica e fëmijëve duhet të kuptojnë se korrigjimi apo qortimi i prindërve të tyre do të pasohet me veprime.

Megjithatë, në rastin e nipit tonë, “një pasojë kategorike e pushtetit” do të kishte qenë e papërshtatshme, dhe kjo është arsyeja pse është kaq e rëndësishme që të prindërojmë në Krishtin. Duke i dëgjuar fëmijët tanë dhe duke qenë vigilentë ndaj shtytjeve të Frymës, ne do të dimë se kur duhet të bëjmë përjashtime nga avancimi i disiplinës.

Mbani mend, prindërimi nuk është një shkencë ekzakte! Ne disiplinojmë për shkak të marrëdhënies. Duke njohur dhe duke qenë syhapët ndaj zemrës së fëmijëve tanë, do të kemi instinktin që na nevojitet për t’i udhëzuar e për t’i mësuar mirë ata.

Mjeti i tretë që keni në dispozicion për të përdorur teksa modeloni një zemër të bindur tek fëmija juaj është mjeti i *inkurajimit*, i quajtur gjithashtu nxitje në disa përkthime të Shkrimit.

MJETI #3: INKURAJIMI

Fjala greke *paráklētos*, e përkthyer *inkurajoj*, vjen nga dy fjalë greke: *para*, që do të thotë *përkrah*, dhe *kaleo*, që do të thotë *të thërrasësh*. Të inkurajosh do të thotë të vish përkrah dikujt për t’i dhënë ndihmë, të mbështetësh, të ngushëllosh dhe të japësh kurajo.

Kjo është e njëjta fjalë që përdori Jezusi kur tha: “por Ngushëlluesi, Fryma e Shenjtë, që Ati do ta dërgojë në emrin tim, do t’ju mësojë çdo gjë dhe do t’ju kujtojë të gjitha këto që ju thashë” (Gjo. 14:26).

Prindër, më shumë se gjithçka tjetër, jeni thirrur që krah për krah të ndihmoni fëmijët tuaj - njëzet e katër orë në ditë! Ashtu siç Perëndia nuk na braktis ne kurrë, kështu duhet të jeni ju për fëmijët tuaj, duke i ndihmuar të bëhen ata njerëz që Perëndia dëshiron që të bëhen. Fëmijët tanë janë të gjithë të martuar dhe duke ecur me Jezusin, por ata sërish kanë nevojë që ne t'u shkojmë pranë dhe t'i ndihmojmë, sidomos kur kanë nevojë për dikë që të kujdeset për fëmijët!

Të inkurajoni fëmijën tuaj do të thotë edhe t'i thoni: “Të lumtë!” kur ai/ajo bën gjënë e duhur.

Ishte ish-zonja e parë Lady Bird Johnson që i kujtoi një brezi prindërisht se “Fëmijët janë të prirur të jetojnë sipas asaj që ju besoni për ta”. Nëse gjithçka që ata dëgjojnë prej jush është *korrigjuese*, shumë fëmijë gradualisht do të arrijnë në përfundimin se ka diçka që nuk shkon me ta; se janë të vështirë, ose të këqinj, ose shkaktojnë shumë telashe, madje-madje edhe se ungjilli nuk funksionon për ta.

Kjo është arsyeja pse për çdo qortim duhet të ketë dhjetë “të lumtë.”

DIANE:

Ky është një mjet që nuk e kam përdorur sa duhet në shtëpinë time. Ankesa e vetme që kam dëgjuar pak a shumë nga secili prej katër fëmijëve të mi është se kam qenë shumë e shpejtë për të korrigjuar dhe qortuar dhe shumë e ngadaltë për të nxitur dhe inkurajuar. Prisja shumë nga fëmijët e mi, që nuk është diçka e keqe në vetvete! Por mos harroni hapin tjetër, t'i inkurajoni dhe lavdëroni pasi kanë vepruar drejt.

Nxitja ose inkurajimi, është një nga mjetet më të fuqishme për të ndryshuar zemrën e fëmijës tuaj.

Mbaj mend kur djali im i madh ishte tre vjeç. Çdo dy muaj merrja një broshurë me postë mbi momentet kyçe të zhvillimit për fëmijët në moshën e tij. E studioja me kujdes çdo numër që vinte; të gjitha studimet e fundit shkencore rreth zhvillimit të trurit, çfarë tingujsh duhet të formonin ose çfarë duhet të arrinin të bënin në këtë moshë.

Një muaj, lexova këto fjalë: “Në këtë moshë fëmija juaj dëshiron t’ju kënaqë”.

Fillova të qaj! Biri im trevjeçar me vullnet të fortë nuk shfaqte as dëshirën më të vogël për të më kënaqur!

Por ja çfarë kam kuptuar: Ju mund ta influenconi në fakt fëmijën tuaj kokëfortë të ketë një zemër të bindur duke përdorur mjetin e inkurajimit. Funkzionon për mrekulli!

Në momentin që ju bindet sado pak, bëjeni të madhe këtë gjë! Brohoriteni! Le t’ju dëgjojë teksa i tregoni babit sesa i bindur ka qenë ai. Shikoni qoftë edhe një gjë të vogël nga ato që i janë thënë për të bërë dhe e ka bërë dhe lavdërojeni duke i thënë: “Të lumtë bir! E shoh që nuk po ia tërheq flokët motrës! Jam shumë krenare për ty!”

Që të bëhesha një prind inkurajues, mu desh të mësoja një gjuhë krejt të re - gjuhën e inkurajimit. Ishte Phil ai që më trajnoi dhe u bë shembulli im teksa shikoja mungesën e fjalëve inkurajuese në fjalorin tim. Duhet të zgjidhja që të shtyja përtej rezervave të mia të natyrshme dhe të hidhja tej prirjen time për perfeksionizëm në mënyrë që ta zotëroja këtë gjuhë. Me kalimin e kohës, me praktikë e përlësi, teksa Perëndia e ka rritur shpirtin tim që të dojë si Ai, e kam mësuar rrjedhshëm gjuhën e inkurajimit. Por, oh sa do të doja ta kisha mësuar këtë gjë më herët!

Grafiku i karakterit

Diçka që bëmë për të na ndihmuar të akumulonim inkurajim tek fëmijët tanë ishte krijimi i një grafiku karakteri. Diane e nisi këtë, pasi kishte filluar të ndihej si police gjithë ditën, duke korrigjuar dhe duke u bërë e bezdisur për të njëjtat gjëra, duke ndërhyrë për të shuar zënkat dhe duke ndjerë përgjithësisht një irritim në rritje në ndërveprimet e saj me fëmijët.

Tani, kjo mund t’ju duket e çuditshme dhe në fakt ishte pak. Por mos harroni, kjo ka ndodhur përpara ditëve të iPhone ose iPad. Për ju tani mund të funksionojë në një mënyrë më “moderne” - në fakt, shpresojmë që një ditë një gjeni kompjuterash do t’a lexojë këtë dhe do të krijojë një aplikacion për të!

Ne ngjitëm një fletë në pjesën ballore të frigoriferit. Lart fare shkruajtëm: “Grafiku i Karakterit”. Shkruajtëm në të gjërat që donim të shikonim të zhvilloheshin në jetën e fëmijëve tanë, cilësi të karakterit, si butësia, bujaria, përlulësia dhe shërbimi.

Më pas ngjitim një yll pranë emrit sa herë që shikonim se ata shfaqnin një nga këto cilësi të karakterit. Dhe duke qenë se fëmijët tanë ishin po aq konkurrues sa fëmijët tuaj, ne u thamë se i pari që do të merrte njëqind yje tek emri i tij do të mund të dilte për darkë me gjithë familjen *dhe* mund të zgjidhte restorantin. Për fatin tonë, Carl’s Jr. dukej se kishte kulinarinë më ambicioze nga fëmijët tanë në atë moshë!

Nxitja i afirmon gojarisht fëmijët tuaj për atë që janë, për zgjedhjet që bëjnë, për përgjigjet e tyre të perëndishme dhe për suksesin e tyre në situata të vështira.

Kohë më pas, kur fëmijët tanë ishin rritur tashmë për grafikët e karakterit dhe ngjitëset me yje, praktikimi i inkurajimit vepronte mrekullisht për t’i influencuar ata që të bindeshin me dëshirë. Pse? Sepse fëmijët tuaj do të bëhen ata që ju u thoni se i shihni të bëhen. A e keni kuptuar këtë? Ia vlen të lexohet sërish:

Fëmijët tuaj do të bëhen ata që ju u thoni se i shihni të bëhen.

Përdoreni këtë mjet bujarisht dhe do të mahniteni nga rezultatet, teksa fëmijët tuaj fillojnë t’ju binden me dëshirë për shkak të pranimit dhe miratimit që e dinë se do të marrin prej jush.

Pali e këshilloi Timoteun, “birin e tij të vërtetë në besim” (1 Tim. 1:2), të korrigojë, të qortojë dhe të inkurajojë ata për të cilët Zoti e kishte thirrur që të kujdesej. Por ai nuk e la me aq. Ai vazhdoi dhe i tha: “duke i mësuar të tjerët me shumë durim” (2 Tim. 4:2).

MJETI #4: UDHËZIMI / MËSIMI ME DURIM

Udhëzim do të thotë të mësosh të tjerët në mënyrë aktive, jo thjesht të tregosh pasivisht.

Pali ka përdorur fjalën *durim* (greqisht *didachē*) si një mënyrë për të shpjeguar qasjen më të mirë ndaj mjetit të udhëzimit. Ashtu si Perëndia na udhëzon ne me dashuri dhe durim – duke iu dashur të na mësojë të njëjtat gjëra sërish e sërish, kështu duhet të udhëzojmë edhe ne fëmijët tanë me durim dhe dashuri.

Ju nuk keni arritur në kryeveprën e përsosmërisë ku jeni brenda natës! Dhe nuk duhet ta presim këtë as nga fëmijët tanë. Pjekuria kërkon kohë që të zhvillohet - është një proces, jo një ngjarje.

Udhëzimi është kur ti merr një sjellje negative dhe me durim e mëson fëmijën tënd se si ai *mund* dhe *duhet* të sillej. Është edhe kur i themi fëmijës: “Jo në atë mënyrë; në këtë mënyrë”.

Të gjithë e kemi provuar bezdisjen kur fëmija të ndërpret gjatë një bisede që të të bëjë një kërkesë, që është urgjente për të. Nëse do të ndiqnim këshillën e Palit për të udhëzuar me durim, duhet t’u marrim fëmijën mënjane më pas dhe t’i themi diçka të tillë:

“Zemër, mos më ndërprit që të tërheqësh vëmendjen time; thjesht eja tek unë dhe nëse jam duke folur me dikë, vendose dorën anash meje. Unë do të ta kap dorën që të kuptosh që të kam vënë re dhe më pas ti duhet të presësh me durim derisa të të përgjigjem”.

A mund ta shihni bukurinë në këtë përgjigje të hirshme ndaj fëmijës? Në vend që t’i bëjmë të ndihen të turpëruar nga ndonjë qortim i pamenduar, ju ofrojmë një mënyrë më të mirë.

Shpeshherë, veçanërisht në publik, presim shumë maturi nga fëmijët tanë kur janë të vegjël deri në vitet e parashkollorit. Deri diku ne presim që ata instinktivisht të dinë si ta përmbajnë vetveten, a thua se deri në moshën katërvjeçare ata duhet ta dinë se çfarë është e përshtatshme dhe çfarë nuk është e përshtatshme.

Më pas tmerrohemi nga sjelljet e tyre të këqija kur gjatë gjithë kohës, gjithçka që u duhej ishte mësim me durim – i herëpashershëm.

Shën Theophani Oshënar, një peshkop rus i shekullit të shtatëmbëdhjetë shkroi: “Të bërit mirë duhet të mësohet ashtu si gjithçka tjetër . . . nuk është e vështirë t’i mësojmë ata të bëjnë gjëra të tilla. Mundësitë dalin në çdo moment. Individit thjesht duhet t’i përdorë ato”.³

Ky lloj udhëzimi i kujdesshëm është një formë e vërtetë *trajnimi*. Fjalori Webster e përkufizon trajnimin si: “të mësuarit e një aftësie ose sjelljeje të veçantë përmes praktikës dhe udhëzimit për një periudhë kohore”. *Të mësuarit* e fëmijëve tanë për të bërë mirë. Të mësuarit e bijve dhe bijave tona për të dashur mirë. Të mësuarit e fëmijëve tanë për të zgjidhur konfliktet në mënyrë të qetë dhe paqësore.

Një fjalë greke e përkthyer “stërvit/ mëso” në Dhiatën e Re është *gumnázō*. Nga këtu kemi marrë fjalën “palestër”. Palestra është një vend për t’u stërvitur. Është po ashtu vendi ku shkojmë për të ardhur në formë dhe për të qëndruar në formë. Në mënyrë metaforike kjo fjalë i referohet stërvitjes me qëllim përëndishmërie.

E mbani mend synimin tonë? Të rritim fëmijë të përëndishëm.

Autori i Hebrenjve e përdori *gumnázō* për të përshkruar maturinë shpirtërore të “atyre që, për shkak të praktikës, i kanë shqisat të stërvitura për të dalluar të mirën nga e keqja” (Heb. 5:14).

Fjalët e Urta 22:6 jep një këshillë të urtë për prindërit: “*Mësoji* fëmijës rrugën që duhet të ndjekë, dhe ai nuk do të largohet prej saj edhe kur të plaket”.

Ky nuk është një premtim; është parim. Kjo nuk do të thotë që nëse e çoni fëmijën në kishë, në kampe biblike verore, ose në shërbesa të veçanta për fëmijë sa është i vogël, do t’a dojë Jezusin e do të ecë gjithmonë me Të.

Çfarë do të thotë është kjo: Fëmijët që udhëzohen me durim ditë pas dite, javë pas jave, vit pas viti se si të duan Perëndinë dhe të ecin në rrugët e Tij, gjersa kjo të bëhet natyrë e dytë për ta, nuk ka gjasa të largohen nga ato mësimë as kur të rriten.

Kjo nuk e mohon vullnetin e lirë të dhënë nga Perëndia; është thjesht një vëzhgim i mençur i pasojave dhe shpërblimeve të mësimit/udhëzimit me durim.

Ky lloj të mësuarit merr kohë dhe vëmendje jashtëzakonisht të madhe - duhet të qëndroni në të!

E kemi parë shpeshherë nusen tonë Tammy, ta përdorë këtë mjet, udhëzimin me durim. Vlerat e Tammy rrjedhin nga trashëgimia e saj e ngrohtë italo-spanjolle-kubane, kultura që i japin shumë vlerë aftësive të njerëzve. Ajo i ka trajnuar fëmijët që të shprehin mirënjohje ndaj të tjerëve, por edhe të jenë të dashur, pavarësisht prirjeve të tyre të natyrshme.

Për vite me radhë, fëmijët vinin në shtëpinë tonë të enjteve në mbremje për një “natë takimi”. (Deri kur nipi ynë Jude ishte rreth pesë vjeç, ai mendonte se kjo “natë takimi” ishte nata e takimit të tij me ne!) Sapo fëmijët mbërrinin tek dera e shtëpisë, Tammy këmbëngulte që ata të na përshëndetnin me përqaftim e puthje, dhe duke na parë drejt

e në sy na pyesnin: “Si je Amma?” ose “Si je ti Pops (gjyshi)?” Nëse nuk e bënin, nëse vraponin direkt tek dollapi i lodrave, ajo i bënte të ktheheshin mbrapsht dhe me durim i kujtonte se sa e domosdoshme ishte një përshëndetje e ngrohtë dhe personale.

Më pas ajo i vëzhgonte me kujdes derisa të vepronin siç duhej dhe përgjatë rrugës i përcillte me fjalë inkurajuese. Trajnimi i saj ka qenë i vazhdueshëm! Dhe të tre fëmijëve ju është bërë e natyrshme të jenë mirënjohës dhe të dashur.

Tani që fëmijët janë rritur, sa herë na shohin, ata vijnë me vrap dhe na hidhen në krahë! Ne duhet të jemi të përgatitur për përshëndetjet e tyre entuziaste ose përndryshe do të biem përtokë nga përqaqimet e tyre të përzemërta. Çfarë bekimi është ky për ne! Dhe e gjitha kjo për shkak se Tammy i ka trajnuar ata se si t'i duan njerëzit në mënyrë të qëllimshme.

Ne i udhëzojmë me durim fëmijët tanë në mënyrat jetësore të mirësjelljes: si të thonë të lutem dhe faleminderit, si të trajtojnë njerëzit me respekt dhe dinjitet. U mësojmë atyre sjelljet e përshtatshme si, për shembull: të flasin me zë të ulët në vende të caktuara ose të mos shtyjnë njerëzit në radhë.

Madje, e përdorim udhëzimin me durim për të mësuar fëmijët tanë t'i përgjigjen Perëndisë me dashuri, adhurim dhe mirënjohje. Herë pas here, ne i ndihmojmë ata të dallojnë Perëndinë në krijim, t'a falënderojnë Atë për ushqimin e mirë, ditët e bukura dhe miqtë e mirë.

Në fazat pasuese të jetës të tyre, ju do të përdorni po këto katër mjete për t'i mësuar fëmijët tuaj të vrapojnë tek Fjala instinktivisht që të mund të ngushëllohen nga Fryma. Me durim do t'i udhëzoni ata në artin e dëgjimit të Perëndisë dhe si të mësojnë ta shohin Atë në mes të përditshmërisë, duke i mësuar që t'i përqendrojnë jetët e tyre tek Ai.

Biseda pa fund

Ju mund t'a keni vënë re deri tani se këto katër mjetet e para përfshijnë të folurin - jo pasoja drastike ose ndëshkime afatgjata, thjesht forma të ndryshme komunikimi. Në një kulturë që duket e prirur të poshtërojë këdo që e kalon cakun, të gjitha këto fjalë mund të duken të paefektshme, por studimet dëshmojnë ndryshe.

Në një studim kërkimor për johebrenjtë që rrezikuan jetën për të shpëtuar hebreujt gjatë Holokaustit, studiuesit zbuluan se ajo që i dallonte personat që ndihmuan nga ata që qëndruan duarkryq dhe nuk bënë asgjë, ndërkohë që fqinjët e tyre po persekutoheshin, ishte mënyra se si prindërit e tyre kishin disiplinuar sjelljet e këqija dhe lavdëruar sjelljet e mira. Prindërit e atyre që ndihmuan flisnin me ta, i mësonin dhe ua shpjegonin gjërat. “Siguria në arsyetim, shpjegimet, sugjerimi i mënyrave për të ndrequr dëmin e bërë, përpjekjet dhe këshillat që prindërit e këtyre ndihmuesve u kishin dhënë, i bënin ata të dallueshëm ... Arsyetimi komunikon një mesazh respekti ... kjo nënkupton që kishin fëmijë, por e dinin që nuk do të vepronin kurrë në mënyrë të papërshtatshme.”⁴

Udhëzimi me durim është gjithashtu mënyra se si Perëndia *na* afron, duke na forcuar dhe duke na ftuar në praninë e Tij, duke na mësuar me durim që të jetojmë me kurajo sipas shembullit të Tij, për lavdinë e Tij dhe për të mirën tonë.

Na e merr mendja se disa prej jush do të donin ta ngrinin dorën lart direkt si ata studentët e paduruar, duke insistuar: “Por unë i kam provuar të gjitha këto gjëra dhe vogëlushi im vazhdon të më kundërshtojë! Duket sikur asnjë masë korrigjimi, qortimi, inkurajimi, apo mësimi nuk depërton në zemrën e fëmijës tim!”

Po pastaj?

Cila do të ishte përgjigja juaj nëse, pas përdorimit të këtyre katër mjeteve biblike, fëmija juaj vazhdon të rezistojë pa përfillur t’ju bindet? Çfarë do të bëni kur katërvjeçari juaj, të cilin keni provuar ta bindni papushim që të mos vrapojë në rrugë, vazhdon të bëjë pikërisht atë gjë?

Pothuajse çdo fëmijë në një periudhë të caktuar nuk i bindet babit ose mamit të vet. Çdo prind e di që do të përballet me këto situata ku do t’i duket sikur po bën një vijë në rërë. Kur vogëlushja juaj e ëmbël ju sheh në sy dhe thotë: “Më dëno!” Ose vogëlushi juaj i dashur syblu ju thotë: “Nuk të dua! Ti je budallaqë!”

Për situata të tilla, Bibla flet për një mjet të pestë, i cili, kur përdoret me hir dhe zgjuarsi, mund të jetë përforcimi që ju duhet për të udhëhequr birin ose bijën tuaj drejt vetëkontrollit dhe bindjes. Ky mjet në Bibël quhet *thupra e disiplinës*.

MJETI #5: THUPRA E DISIPLINËS

“Thupra e disiplinës” është një term biblik për atë që ne shpesh e quajmë një përdorim i lehtë i thuprës në të ndenjura. *Fjalori Hebraisht i Strong* e përkufizon fjalën *shebet* si një “thupër, shkop, degë”, ndërsa fjala musar i referohet “disiplinës, ndëshkimit ose korrigjimit”.

Në Amerikë dhe vende të tjera të botës, janë ngritur polemika mbi atë që disa e quajnë “ndëshkim trupor”. Ideja e të qëlluarit të fëmijës në zemërim për ta detyruar të bindet është vërtet e frikshme. Fshikullimi që prindërit mund të bëjnë në një gjendje nervozizmi është aq shumë kundër zemrës së Perëndisë sa me të drejtë konsiderohet mizor. Dhuna nuk është mënyra e mbretërisë për të cilën Jezusi mësoi në mënyrë aq produktive, dhe po kështu nuk është as *dënimi* për dështimet tona.

Thupra e disiplinës biblike nuk është as ndëshkuese, as e dhunshme, por përkundrazi është një mjet i dashur që prindërit janë të ftuar ta përdorin në edukimin e fëmijëve të tyre për të sjellë bindje dhe vetëkontroll. Mospërputhjet midis një të rrahure dhe një thupre të lehtë e të kujdesshme janë po aq të mëdha sa ndryshimi midis një të bërtitje ndaj fëmijës në zemërim dhe dhënies së një qortimi të rreptë, por me dashuri. Njëra është mësim, ndërsa tjetra është thjesht shpërthim zemërimi i një të rrituri.

Shumë prindër të rinj të krishterë po zgjedhin sot t'i rritin fëmijët e tyre duke mos e përdorur këtë mjet. Çdo prind që është një ndjekës i Jezusit duhet të vendosë atë që beson se Bibla mëson rreth kësaj teme dhe si duhet ta zbatojnë këtë mjet nëse zgjedhin ta përdorin.

Për shkak të keqkuptimeve të shumta rreth thuprës së disiplinës, do të marrim pak kohë për të parë se çfarë mëson Fjala e Perëndisë lidhur me këtë temë.

Shikoni me kujdes këto vargje nga Fjalët e Urta:

“Thupra dhe qortimi japin urtësi, por fëmija për të cilin nuk kujdeset kurrkush e turpëron nënën e vet” (F. e Urta 29:15).

“Kush e kursen thuprën, e urren birin e tij, por ai që e do është i kujdesshëm që ta dispiplinojë atë” (F. e Urta 13:24).

“Marrëzia lidhet me zemrën e fëmijës, por thupra e disiplinës do t'a largojë prej saj” (F. e Urta 22:15).

“Mos ia kurse disiplinën fëmijës; edhe sikur ta rrahësh me thupër, nuk do të vdesë; do ta ndëshkosh me thupër, por do të shpëtosh shpirtin e tij nga Sheoli”⁵ (F. e Urta 23:13-14).

Shkruesi i Fjalëve të Urta duket se thekson efektivitetin e përdorimit të këtij mjeti *me dashuri*. Duke e përdorur *siç duhet* këtë mjet discipline, prindërit mund të shpëtojnë fëmijët e tyre nga marrëzia që mund të rezultojë në vdekje metaforike, ose në vdekje faktike.

Tani le të shtjellojmë Hebrenjve 12:5-11 në mënyrë që të dëgjojmë zemrën e Perëndisë për këtë çështje. Mbani mend: shikojeni këtë pasazh në kontekstin në të cilin është shkruar. Kapitulli paraardhës (Heb. 11) përmban një listë të burrave dhe grave më guximtarë dhe besnikë të historisë. Ky pasazh i jashtëzakonshëm shpesh quhet kapitulli i besimit; pikërisht ai lloj besimi pas të cilit ne shpresojmë që do të kapen fëmijët tanë. Pasi lexojmë historitë e tyre, atëherë Perëndia fillon një bisedë me ne për historitë tona dhe për kujdesin e *Tij* atëror për *ne*:

“Biri im, mos e përçmo ndreqjen e Zotit dhe mos e humb zemrën, kur Ai të qorton; sepse Zoti ndreq atë që do, dhe fshikullon çdo bir që Ai pranon.⁶ Në qoftë se ju duroni ndreqjen, Perëndia sillet me ju si me bij, sepse cili është ai bir të cilin s'e ndreq i ati? Por, po të jeni pa ndreqje, në të cilën të gjithë u bënë pjesëtarë, atëherë jeni kopila dhe jo bij. Pastaj kishim edhe etërit tanë sipas mishit dhe i respektonim ata; a nuk do t'i nënshtrohemi edhe më tepër Atit të frymërave dhe të jetojmë? Sepse ata na disiplinuan për pak kohë, ashtu siç u dukej më mirë, kurse Ai *na disiplinon* për të mirën tonë, që të bëhemi pjesëtarë të shenjtërisë së Tij. Por çdo ndreqje aty për aty nuk duket se sjell gëzim, por hidhërim; por më pas u kthen një fryt të paqshëm drejtësie atyre që janë ushtruar me anë të saj.

Fjala greke e përkthyer këtu si “fshikullon” dhe “ndëshkon” është *mastigóō*. I referohet asaj që në atë kohë ishte një praktikë e zakonshme judease (vendore dhe e ligjshme)⁷ e fshikullimit me thupër.⁸ Tek Hebrejtë, është përdorur në mënyrë figurative për Perëndinë, në kuptimin të ndëshkojë ose të korrigjojë.⁹

Fjala e përkthyer “dënon” tek Fjalët e Urta 23:13-14 është fjala hebraisht *nakah*, e cila i referohet disiplinës fizike me përdorimin e “thuprës”.

Si shkruesi i Fjalëve të Urta, ashtu edhe shkruesi i letrës së Hebrejve, të frymëzuar nga Fryma, na rikujtojnë se në dashurinë e Tij, ndonjëherë Perëndia na “fshikullon”.

Kur Perëndia na fshikullon, nuk e bën sepse është i zemëruar me ne, por sepse Ai dëshiron që ne të përjetojmë shenjtërinë e Tij, të ndajë me ne bukurinë e mirësisë së Tij.

Ndonjëherë kjo thupër na ruan nga vdekja; nga vdekja e marrëdhënieve, vdekja e intimitetit me Perëndinë, madje edhe nga vdekja fizike.

Edhe pse është e dhimbshme. Edhe pse nuk na pëlqen. Megjithë rrezikun e të qenit të keqkuptuar ose të refuzuar, Ai na “fshikullon” si një mënyrë për të na mësuar.

Dhe cili është përfundimi i pritshëm? Një jetë e tejmbushur me të korra të bollshme drejtësie dhe paqeje. Këto janë përfitimet për të cilat psalmisti foli kur shkroi: “shkopi yt dhe thupra jote (*shebet*) janë ato që më japin zemër” (Psa. 23:4).

Fakti që Perëndia përdor thuprën në jetët tona realisht është një provë e përkatësisë tonë ndaj Tij dhe dashurisë së Tij të thellë për ne.

Megjithëse Bibla nuk e përcakton kur ose sa shpesh duhet të përdoret thupra e disiplinës, na e ofron atë si një mjet të dashur dhe të disponueshëm për prindërit që ta përdorin në edukimin e fëmijëve të tyre.

Prandaj, jini të kujdesshëm ndaj çdokujt që ju nxit të përdorni thuprën si mjetin *parësor* ose *të vetëm* të disiplinës.

Paqartësia e qëllimshme e udhëzimeve të Perëndisë rreth thuprës, lë të kuptohet se për disa persona kjo mund të jetë një eksperiencë disiplinore vetëm për një herë. Për disa të tjerë, ndoshta ky

mund të jetë një mjet i përdorur efektivisht më shpesh. Dhe le të jemi të singertë - ka disa fëmijë që nuk duhet të fshikullohen kurrë, si dhe disa prindër që mund ta shohin si pjesën më të mirë të urtësisë abstenimin ndaj përdorimit të thuprës.

Thupra është një mjet, jo një kurë për gjithçka. Nëse përdoret me kujdes së bashku me mjetet e tjera, mund të jetë një mjet i mrekullueshëm për zbutjen e zemrës së fëmijës tuaj.¹⁰ Por, e përdorur pa vend dhe ashpërsisht, mund të bëhet shkak për plagosjen dhe izolimin e fëmijës tuaj, jo vetëm nga ju, por edhe nga Perëndia.¹¹

Është në dorën tuaj mami dhe babi, që *së bashku* të vendosni si dhe kur do ta përdorni thuprën në shtëpinë tuaj.

Ne jemi ngurrues kur flasim për këtë temë; disa nga ata që e lexojnë këtë material, mund ta marrin dhe si rezultat bëhen shumë të ashpër, madje edhe abuzivë ose shtypës, gjë që nuk është kurrë zemra e Perëndisë! Të tjerëve u duhet dhënë leje që ta përdorin siç duhet këtë mjet në mënyrë që të sjellin fëmijët e tyre nën kontroll pa humbur vetëkontrollin e tyre në këtë proces.

Thënë kështu, thupra duhet të përdoret me kujdes dhe me lutje vetëm në raste të rralla.

Kur po përgatitnim materialin për ta shpjeguar këtë pjesë në një konferencë, morëm një email të trishtë nga një grua që ishte e shqetësuar për atë që ne kishim planifikuar të mësonim lidhur me thuprën. Kjo grua e re kishte parë prindërit e saj, të cilët me qëllim të mirë, por jo me maturi, fshikullonin herë pas here me thupër vëllain e saj të vogël për çdo gjë dhe për një kohë të gjatë. Zemra i dhimbte për vëllain e saj, i cili përfundoi i plagosur në shpirt dhe i bindur që ishte një rast i pashpresë, i padenjë dhe i pavlerë.

Ja çfarë i duhej thënë atij djali: “Ti je djalë i mirë, i krijuar në imazhin e një Perëndie të mirë”. Ai djalë duhet të inkurajohej, të mësohej dhe udhëhiqej kur sjellja e tij e shtynte të gabonte. Duke keqpërdorur dhe mbipërdorur mjetin e fshikullimit, prindërit e lanë atë të mposhtej, duke ia shkatërruar besimin në dashurinë pa kushte të Perëndisë për të. Sa mund të dhembë zemra e Atit për këtë djalosh të plagosur!

Ka disa prindër të cilët mund të zgjedhin të mos i fshikullojnë asnjëherë fëmijët e tyre për arsye legjitime. Nëse jeni gjaknxehtë dhe jeni të prirur drejt veprimeve të dhunshme, atëherë është më mirë të

hiqni dorë nga ky mjet. Dr. Dobson parajalmëron: “Jepuni fëmijëve tuaj arsyetim maksimal që të duan të pajtohen me dëshirat tuaja. Zemërimi juaj është alternativa më e paefektshme”.¹²

Ose nëse fëmija juaj është i frikësuar më shumë se ç’duhet, siç mund të jenë shumë fëmijë të birësuar, përdorimi i këtij mjeti nuk do të ishte i zgjuar dhe as i efektshëm. Nëse jeni kujdestar i një fëmije të birësuar, ju duhet t’u bindeni rregullave të agjencisë që kurrë të mos e qëlloni atë fëmijë. Ky është një mjet që duhet t’a nxirrni jashtë kutisë së mjeteve. Shumë fëmijë të abuzuar dhe të braktisur nuk e pranojnë dot përdorimin e thuprës si një mjet të dashur disipline. Vuajtjet e shumta i kanë zbehur jetët e tyre të njoma, duke i injektuar thuprës (pavarësisht qëllimit të mirë) kuptime që asnjë prind ose kujdestar i dashur nuk do të donte të transmetonte.

Sa për ne, ne zgjodhëm t’a përdornim thuprën e disiplinës me të katër fëmijët tanë. Tashmë ata janë të rritur dhe kanë zgjedhur që edhe ata po ashtu t’a përfshijnë këtë mjet në rritjen e fëmijëve të tyre. Ashtu si ne, edhe ata po e përdorin me lutje e me kujdes, por edhe me vetëbesim gjithashtu. Secili prej fëmijëve tanë na kanë siguruar që nuk kanë kujtime të këqija nga koha kur ne patëm zgjedhur që me qetësi dhe dashuri t’u jepnim ndonjë thupër të lehtë në të ndenjura. Në fakt, më së shumti, kujtimet më të dhimbshme vijnë nga ato momente kur prindërit kanë goditur me fjalët e tyre në momente acarimi, pa ditur çfarë të bënin tjetër. Jemi të bindur se përdorimi i thuprës së disiplinës në një mënyrë që nderon Perëndinë, është një mënyrë disipline shumë më e sjellshme, më pak turpëruese e më pak manipuluese, e cila madje mund të parandalojë dhimbjet e stërgjata.

Për ju që dëshironi një vështrim edhe më praktik dhe më të thelluar për përdorimin e këtij mjeti, ju lutem vizitoni IntentionalParents.org. Aty tregojmë se kur kemi zgjedhur ta përdorim këtë mjet, si ecëm në këtë proces dhe çfarë nuk duhet të bëni kurrë kur përdorni thuprën e korrigjimit.

MJETE QË NUK DUHET TË MENDONI T'I PËRDORNI

Vini re çfarë mjetesh nuk kemi përmendur: dënimin me periudha kohore, humbja e privilegjeve (në vitet e para), dhe e ashtuquajtura “disiplinë krijuese”. Këto mjete disipline të përdorura gjerësisht mund të jenë efektive për njëfarë kohe, por mund të krijojnë pështjellim në zemrat e ndjeshme në plan afatgjatë. Ne i këshillojmë prindërit të mendojnë dhe të lutën *si, kur apo nëse* do t’ju duhet të përdorin këto forma disipline.

Dënimin me Periudha Kohore

Ne nuk i mbyllnim fëmijët tanë në dhomë as nuk i detyronim të uleshin në një qoshe siç bëjnë disa prindër që përdorin kështu dënimin me periudha kohore si ndëshkim.

Ja përse: Perëndia nuk na mbyll ne në dhomë në zemërim kur nuk bindemi. Ai merret me ne me dashuri, butësi dhe hir ekstrem. Dëbimi i fëmijëve larg jush kur ju acarojnë, mund t’u mësojë atyre padashje se Perëndia mund të zemërohet aq shumë me ta, saqë nuk i do as në praninë e Tij madje.

Por ju doni t’u mësoni atyre të kundërtën: që ata janë të ftuar të vrapojnë *tek* Perëndia kur janë mposhtur nga mëkati.

Sidoqoftë, ne përdorëm diçka që e quajtëm “kohë pushimi”. Një miku ynë përdorte “kohë për mbushje”. Dr. Karyn Purvis në *The Connected Child* flet për “kohë mirëkuptimi”. Koha e mirëkuptimit është një kohë e qëllimshme që ju e krijoni për të ndihmuar fëmijën tuaj të qetësohet dhe të gjejë perspektivë. Shpesh, njëri prej nesh ulej në divan me fëmijën e acaruar dhe i lexonte një histori, ose e ushqente me diçka të shëndetshme, ose dilte me të për një shëtitje në ajër të pastër.

A e kuptoni pse themi se këto lloj trajnimesh të qëllimshme marrin shumë kohë? Është më e lehtë t’i mbyllni fëmijët në dhomat e tyre, ose t’i detyroni të qëndrojnë për pak kohë në izolim, sesa të përdorni një kohë mirëkuptimi.

Çështja është kjo: **Kur synimi ynë është të zbutim zemrat e fëmijëve tanë në mënyrë që të duan të binden, dëbimi i tyre larg pranisë tonë në zemërim do t’u përçojë mesazhin e gabuar.**

Dr. Purvis thotë: “Një variant i kohës së mirëkuptimit do të thotë që fëmija të kalojë kohë në një vend të caktuar që është afër familjes dhe i ofron pak shpërqendrim. Kjo shndërrohet në një “kohë mirëkuptimi”, ku në vend që të dëbohet tutje, fëmija sillet më afër. Fëmija nuk shkon atje vetëm, por shoqërohet nga një i rritur që i qëndron pranë”.¹³

Kohët e pushimit apo kohët për mbushje dhe kohët e mirëkuptimit janë mjete efektive për trajnimin e fëmijëve tanë që të praktikojnë zakone të shëndetshme individuale kur të jenë më të rritur. Kur jeta rëndohet, në vend që të sulmojnë çdo person që kanë pranë, do të dinë si të marrin një kohë për t’u qetësuar dhe për të rifituar kontrollin mbi ndjenjën e zemërimit.

Heqja e Privilegjeve

Fëmijët shumë të vegjël nuk mund ta kuptojnë këtë formë disipline, veçanërisht kur serviret nga një prind tërësisht i acaruar. Ata nuk janë në gjendje të bashkojnë pikat midis gabimit të tyre dhe mospasjes mundësi të bëjnë diçka që ata e shijojnë. Kjo gjë çon shpesh në egërsim, duke e rënduar problemin, në vend që t’i mësohet fëmijës një mënyrë më e mirë e të vepruarit. Mos harroni, ju po rendni pas *ndryshimit të zemrës*.

Megjithëse kjo do të jetë një mënyrë efektive për të trajnuar fëmijët pak më të rritur (do të flasim më vonë për këtë), ne duam t’ju sigurojmë se fëmija juaj i vogël është në gjendje të kapë shkakun dhe pasojën përpara se ju t’i hiqni atij disa privilegje.

Shikojeni dhe dëgjojeni fëmijën tuaj për t’u siguruar nëse disiplina ka kuptim në mendjen e tij që është në proces zhvillimi. Gjithashtu, është e rëndësishme që privilegji që ju do t’i hiqni, të jetë disi i lidhur me qëllimin e veprimit disiplinues. Për shembull, marrja e një lodre të cilën fëmija juaj e përdorte për të goditur vëllain e tij më të madh në fytyrë do të ketë kuptim të menjëhershëm për të.

“Disiplina Krijuese”

Fjalët e Urta 26:4-5 përmban një paralajmërim të përshtatshëm për prindërit me fëmijë të vegjël: “Mos iu përgjigj budallait sipas

budallallëkut të tij, që të mos bëhesh dhe ti si ai. Përgjigju budallait siç *e meriton* budallallëku i tij, që të mos mendojë se është i urtë”.

Çdo trajner i denjë për orët për të cilat paguhet duhet të dijë të përfshijë kreativitetin në rutinat që ai përshkruan. Dikush që nuk ka synime të qarta për të arritur shpesh e humbet vrullin dhe një sportist i ardhshëm që është lodhur duke i përsëritur ushtrimet, shpesh e humb motivimin. Të gjithë e kuptojmë këtë.

Një herë, një mama e re me shumë krenari më tha se kishte zbuluar kurën për dilemën e zakonshme të vogëlushëve që kafshojnë. Kur djali i saj i vogël e kafshoi atë në zemërim, edhe ajo e kafshoi atë! Një shembull i thjeshtë i përgjigjes ndaj një budallai sipas budallallëkut të tij.

Përkundrazi, ne duhet t'i "përgjigjemi një budallai ashtu siç *e meriton* budallallëku i tij, që të mos mbahet i urtë në sytë e tij". Që prindërit të shmangin këto veprime "ma bëri - ia bëra", ata duhet të mendojnë dhe të luten për përdorimin e mjeteve të përshtatshme biblike për të trajtuar "budallallëkun" e veprimeve të pamatura fëmijëve të tyre.

Shpeshherë, disa libra të mirë prindërimi sugjerojnë pasoja "krijuese" në kufij të çuditshëm, si një libër që tregon historinë e një nëne që po ngiste makinën me katër fëmijët e saj brenda në pikun e trafikut dhe fëmijët e saj filluan të ziheshin. Pasi i paralajmëroi ata disa herë, ajo konstatoi se i biri në moshë shkollore po acaronte motrat e tij, duke i përkeqësuar kështu grindjet.

E bezdisur në maksimum, kjo mama e urdhëroi të birin ta ulte kokën në prehërin e tij për 20 minutat e ardhshme derisa të mbërrinin në shtëpi. Më pas u tha motrave të mos i flisnin fare - ai duhej të izolohej komplet nga biseda.

Pse? Që t'i jepte një mësim.

Çfarë lloj mësimi merr nga kjo gjë?

Ne duhet t'i shqyrtojmë këto libra (duke përfshirë edhe tonin) bazuar në Shkrim, dhe jo të bëjmë të kundërtën. Të gjithë ne që kemi zgjedhur të ndjekim Jezusin e shikojmë Fjalën e Zotit si udhëzuesin themelor me anë të të cilit ne mund të afrojmë jetët tona me rrugën e Jezusit. Dhe ajo është plot me të dhëna! Nëse do të kaloni kohë me Perëndinë në mënyrë të vazhdueshme, në Fjalën, duke dëgjuar Frymën, duke i kërkuar Perëndisë t'ju japë urtësi specifike për fëmijën tuaj specifik, Ai ka premtuar se do t'ju japë urtësinë që ju nevojitet.

Si përfaqësues të zemrës atërore të Perëndisë tek fëmijët tanë, si guxojmë të përdorim metoda ndëshkimore për edukimin e fëmijëve në momentet tona të zemërimit në mënyrë që t'u "japim një mësim" që është i i paidentifikueshëm?

Ne duhet të disiplinojmë, jo të ndëshkojmë.

Disiplina e perëndishme ndryshon nga ndëshkimi, megjithëse shpesh i përdorim fjalët në mënyrë të ndërsjellë. Fjalori i Webster e përkufizon kështu foljen ndëshkoj: "të japësh një dënim ose sanksion si shpagim për një shkelje". A është ky qëllimi që kemi për edukimin e fëmijëve tanë? Apo po fokusohemi në kultivimin e një dëshire dhe dashurie për Perëndinë në zemrat e tyre?

Disiplina e perëndishme është formuese, jo dënuese.

Fjalët greqisht të përkthyer si disiplinë tek Efesianët 6:4 dhe Hebrejët 12:5-11 janë *paideia* dhe *paideuo*. Kuptimi i tyre është: "të udhëzosh, të qortosh, të korrigjosh, të edukosh".¹⁴

Paideia duhet dalluar nga fjalët e përkthyer si "ndëshkuese": *kólasis*, që përcaktohet më së miri si një vepër penale ose dënim, dhe *timōria*, që nënkupton ndëshkim penal.¹⁵

Ndëshkimi thotë: "Ti merr atë që meriton", ose "Turp të të vijë!" Qëllimi është të penalizojë. Prandaj karakterizohet nga refuzimi dhe poshtërimi.

Disiplina thotë: "Lërmë të të ndihmoj të ndryshosh", ose "Në këtë mënyrë, jo në atë mënyrë". Qëllimi është të mësojë dhe të edukojë. Disiplina forcon vetëkontrollin dhe bindjen. Qëllimi i disiplinës së perëndishme nuk është të penalizojë, por të pajisë fëmijën tuaj që t'i bindet Perëndisë dhe një ditë të jetë i aftë të kontrollojë impulset e tij egoiste.

Në Psalmin 23 disiplina e Bariut përshkruhet kështu: "Shkopi yt¹⁶ dhe thupra jote, janë ato që më japin zemër mua".

Disiplina e perëndishme sjell një ndjesi rehatie dhe sigurie tek fëmija juaj, ashtu sikurse disiplina e Perëndisë na çon ne në një vend më të mirë, në një vend sigurie dhe mbrojtjeje.

Kështu, megjithëse fjala *ndëshkim* zakonisht përdoret si sinonim për *disiplinë*, prindërit duhet të kenë parasysh dallimin mes të dyjave. Për më tepër, duhet të jemi të kujdesshëm që të disiplinojmë fëmijët tanë me të njëjtën lloj dashamirësie me të cilën Ati na mëson dhe na korrigjon ne.

JINI TË PALËKUNDUR

Një nga mënyrat më të rëndësishme për ta bërë disiplinën sa më efektive të jetë e mundur është të qenit të palëkundur. Fëmija juaj mendon bardhë e zi. Ende nuk është në gjendje të arsyetojë në mënyrë abstrakte. Veçanërisht për një fëmijë me vullnet të fortë, një dështim në këtë pikë, mund të çojë në më shumë e më shumë testime kufijsh për të parë nëse e keni me të vërtetë atë që thoni apo jo.

PHIL:

Mbaj mend një ditë kur Diane më telefonoi në punë duke qarë ndërsa më thoshte: “U përpoqa ta korrigjoj dhe ta inkurajoj – i dhashë madje edhe një dackë! Dhe prapëseprapë më duket se ai ka fituar! Çfarë të bëj tani?”

Nuk kaloi shumë kohë pas asaj dite, kur në moshën katër vjeç e gjysëm, biri ynë i dha jetën Jezusit dhe ne pamë që të ndodhte një ndryshim i vërtetë. Zemra e tij filloi të zbutej, duke iu nënshtuar udhëzimeve tona. Kjo ngjarje kaq e vërtetë, e kombinuar me mësim të palëkundur e të vazhdueshëm, çoi në thyerjen e kokëfortësisë së birit tonë për të mos u bindur, pa ia thyer zemrën.

Sidoqoftë, nuk është gjithmonë e mundur dhe e këshillueshme të jeni 100% të palëkundur.

DIANE:

Si një perfeksioniste në rikuperim, perceptimi i nevojës time për të qenë e palëkundur për pak sa s’më çmendti! Këshilla “Ji e palëkundur!” më tingëllonte si një rregull i shkruar në gur.

Çfarë mund të bëja kur rrethana të justifikueshme më privonin nga disiplinimi i duhur? Po kur fëmija ishte i sëmurë? Ose kur isha në një vend publik ku nuk ishte e mundur të ndërmerre një veprim disiplinues? Çfarë mund të bëja kur acarimi i saj kishte të bënte më shumë me gjykimin tim të dobët duke e mbajtur jashtë më shumë se ç’duhej, ndërkohë që çfarë i nevojitej në të vërtetë fëmijës tim ishte një sy gjumë? Mund të shikoja se disa herë fëmijët e mi e humbisnin tërësisht kontrollin, pasi truri i tyre nuk mund të arsyetonte më për shkak të lodhjes ose stimulimit të tepërt. Po pastaj?

RRETHANAT E JUSTIFIKUESHME:

Këtu ndodhet një listë e shkurtër e rrethanave që mund të justifikojnë tërheqjen mbrapsht nga gjithçka, përveçse nga një disiplinë shumë e lehtë:

* Kur fëmija juaj është sëmurë

* Kur e keni mbajtur fëmijën për shumë kohë jashtë ose qëndron zgjuar deri vonë, dhe është i lodhur sepse truri i tij nuk mund të arsyetojë më.

* Kur fëmija juaj është stimuluar së tepërmi.

* Kur nuk ka asnjë mënyrë për të shkuar në një vend pa njerëz të tjerë përreth.

* Kur e dini që po ndodh diçka tjetër me të cilën duhet të merreni me shumë kujdes.¹⁷

* Kur fëmija juaj nuk është i aftë nga ana e zhvillimit për të kuptuar qëndrimin e dashur, por të rreptë që qëndron pas mjetit disiplinues që ju keni zgjedhur.

Në kohën kur filluam t'i shtronim vetes dhe të tjerëve këto pyetje, dolëm me një udhëzim tonin joapologjik dhe joshkencor: *Syno për 80%*.

RREGULLI I 80 PËRQINDËSHIT

Nëse jeni duke e disiplinuar vazhdimisht fëmijën tuaj në 80% të rasteve që e ka të nevojshme këtë gjë, po ia dilni për mrekulli! Shkëlqyeshëm! Gati më mirë se të gjithë!

Mbani mend që ju po synoni të influenconi *zemrën* e fëmijës tuaj, jo të krijoni makineri automatike. Jini aq të palëkundur sa mund të jetë e arsyeshme, por mbani mend që edhe po ta lini disiplinën të rrëshqasë në ndonjë rast, nuk do të ketë pasoja fatale për fëmijën tuaj. Jepini vetes dhe fëmijës tuaj pak kredite për të gjitha orët e kaluara duke shpjeguar dhe mësuar. Dhe jepini hapësirë Frymës të punojë përsosmërinë e Tij si në ju, ashtu edhe në fëmijën tuaj – në fund të fundit, a nuk është pikërisht kështu hiri? Me ndihmën, urtësinë, dhe aftësinë e Perëndisë, ju po hidhni një themel tek fëmija juaj, tullë pas tulle. Pjesa tjetër i takon Atij.

Kapitulli 9

Zemra me Vetëkontroll

Tipari i dytë i rëndësishëm i karakterit që ju dëshironi të shihni të zhvillohet tek fëmija juaj deri në fund të kësaj faze themelore është një zemër vetëkontrolli.

Çfarë është vetëkontrolli?

Bindja ka të bëjë me veprimet, por vetëkontrolli ka të bëjë me emocionet dhe mënyrën si i trajtojmë ato.

A na kontrollojnë emocionet ne, apo i kontrollojmë ne emocionet?

Vetëkontrolli është një nga frytet e Frymës të listuara tek Galatasve 5:22-23. Është domosdoshmëri në udhëheqësinë shpirtërore. “Sepse peshkopi, si administrator i shtëpisë së Perëndisë, duhet të jetë i paqortueshëm, jo arrogant, jo zemërak, jo i dhënë pas verës, të mos jetë i dhunshëm, jo njeri që lakmon fitim të turpshëm, por përkundrazi; të jetë mikpritës, mirëdashës, *me vetëkontroll*, i drejtë, i shenjtë dhe i disiplinuar” (Titit 1:7-8, theksim i yni).

Kjo do të thotë që nëse duam të rritim ndjekës pasionantë të Jezusit, vetëkontrolli është një fushë në të cilën nuk duhet të dështojmë për të trajnuar fëmijët tanë. Duke e përfshirë mësimin mbi vetëkontrollin që herët në jetën e fëmijës tuaj, ju në fakt po i jepni atij ose asaj mundësinë për t’u kualifikuar si udhëheqës në kishën e Jezusit.

Fjala greqisht për vetëkontrollin është *egkráteia*. Do të thotë vetëpërmbytje, ose zotërim. Vetëkontrolli përfshin aftësinë, nëpërmjet Frymës së Shenjtë brenda jush, për të zotëruar impulset dhe emocionet tuaja, vullnetin, gjuhën, sjelljen dhe humorin tuaj.

Dhe shikoni këtë: fjala e përkthyer si vetëkontroll, mund të përkthehet edhe *vetëpërmbytje*. E kundërta do të ishte mospërmbytje. Mendoni për reklamat e “Depends”! Mospërmbytja është e rrëmujshme, e shpifur, mban erë. Mungesa e vetëkontrollit do të thotë të jesh një mama ose

baba i papërmbajtur, ose një fëmijë i papërmbajtur që bëhet një adoleshent i papërmbajtur. Synimi juaj ndërsa i mësoni fëmijës tuaj vetëkontrollin është që t'i mundësoni atij të bëhet një i rritur që do t'i ketë nën kontroll emocionet e veta - emocione që çojnë në veprime dhe reagime.

Duke e mësuar fëmijën tuaj të kontrollojë vetveten në një moshë të hershme, ju e aftësoni atë *të zgjedhë* përgjigjet e tij ndaj njerëzve, të ketë kontroll mbi luhatjet e humorit, kontroll mbi acarimet dhe varjen e turinjve që i karakterizojnë shumë shpesh fëmijët dhe adoleshentët, të kenë kontroll mbi shtysat e fuqishme të zemërimit dhe të gjitha ndjesitë që kërcënojnë të marrin kontrollin e jetëve tona pavarësisht moshës.

Derisa fëmija juaj të mësojë të kontrollojë veten, duhet të jeni ju vetëkontrolli i tij.

Që prej lindjes, ju i mbani ata në kontroll duke synuar që, me kalimin e kohës, do të mësojnë të kontrollojnë veten e tyre.

Mbani mend që për shkak se besojmë që Bibla është e pagabueshme dhe themelore për jetët tona, ne e dimë që fëmijët tanë nuk lindin të pafajshëm. Teologët e quajnë këtë “mëkati fillestar”.

Disa njerëz thonë se nuk besojnë tek mëkati fillestar - padyshim, nuk janë bërë ende me fëmijë!

James Dobson, psikologu i fëmijëve që ka ndikuar dhe ndriçuar prindërit e krishterë për disa dekada, thotë: “Ndoshta kjo tendencë kundrejt egos personale është esenca e ‘mëkatis fillestar’ që është infiltruar në familjen njerëzore”.¹ Asnjë prindi nuk i është dashur ta mësojë fëmijën të thotë: “Është e imja!” Egoizmi vjen natyrshëm tek secili prej nesh.

Bibla na mëson se të gjithë kemi lindur me infeksionin e mëkatis që na pulson në vena. Davidi e dinte këtë kur shkroi: “Ja, unë jam mbraujtur në paudhësi, dhe nëna ime më ka ngjizur në mëkat” (Psalmi 51:5).

Si prindër, duhet të jemi të vetëdijshëm për këtë dhe vigjilentë ndaj keqkuptimeve që reklamohen shpesh nga botimet e prindërve të sotëm modernë, të cilat në thelb pohojnë që të gjithë fëmijët lindin të papërpunuar dhe më pas përpunohen nga mjedisi që i rrethon - *ne!*

Ajo foshnjë e vogël që mbani në krahë nuk është e pafajshme. Ka lindur me dëshirën për të kontrolluar. Është i bukur - një reflektim i Vetë Perëndisë, krijuar në imazhin e Tij - por mos bëni gabim të

mendoni se është veç pastërti dhe mirësi në ato muajt e parë dhe pastaj papritmas, nga asgjëja, në ditëlindjen e dytë vesh natyrën mëkatore! Epo, përpara se të mbushë dy vjeç, perfeksionisti yt i vogël do të fillojë të protestojë me zë të lartë, kur nuk merr atë që dëshiron në momentin kur e dëshiron.

Çelësi që kemi gjetur është t'i kapim gjërat herët në mënyrë që të na duhet të disiplinojmë sa më pak.

Në vend që të prisni që ulërimat e fëmijës tuaj të arrijnë atë nivel intensiteti sa t'ju shpojnë veshët, merruni me ato shpërthimet e çastit dhe disiplinoni me vendosmëri. Fëmija juaj do ta mësojë që herët se shpërthimet e zemërimit janë joefektive. Sidoqoftë, disa fëmijë, ndoshta *shumica* prej tyre, do të kenë nevojë për trajnim të vazhdueshëm që të mbajnë nën kontroll emocionet e tyre të pamatura.

DIANE:

I mbaj mend shumë mirë shpërthimet emocionale të të parëlindurit tonë. Një herë, po merrja qeset e pazarit nga makina, dhe ai donte diçka TANI. Kur i thashë se i duhej të priste, ai u shtri përtokë duke reaguar në mënyrë dramatike.

Më kishin thënë se po t'i injoroje shpërthimet emocionale duke mos u kushtuar vëmendje, fëmijët thjesht do të ndalojnë vetë.

Fatkeqësisht, biri im kokëfortë nuk e njihte këtë pjesë!

Kështu, ai u përpëliti në dysheme edhe disa herë të tjera, pasi nuk mori përgjigje nga mami. Me gjithë këmbënguljen që e bën atë një drejtues fantastik sot, John Mark mbyllej në dhomën e tij, hipte në krevatin e tij të lartë, dhe hidhej në dysheme. Pastaj fillonte të qante vërtet!

Aty kuptova që duhet të merresha seriozisht me shpërthimet e tij emocionale, ose në të kundërt ai do të lëndonte veten vërtet. Për pak më shumë se një javë, e displinoja atë çdo ditë për disa reagime dramatike apo shpërthime emocionale të vullnetshme.²

Disa vite më vonë isha komplet e përgatitur të merresha me Rebekën, por krizat e saj emocionale ishin një lloj shpërthimi femëror. Ajo kërrusej në dysheme mes ngashërimesh dhe lotësh. Kur e kuptuam më në fund se kjo ishte shprehja e krizës emocionale të vajzës tonë, vendosëm që të përballeshim me të në të njëjtën mënyrë: duke e disiplinuar në mënyrë të prerë dhe me dashuri për

t'i mësuar asaj se mund dhe duhet të kontrollonte emocionet e saj.

Fëmija ynë i tretë, Elizabeth, e kishte parë të gjithë dramën me motrën dhe vëllain e saj, si dhe pasojat që vinin më pas, dhe pikërisht atëherë dhe aty vendosi që ajo nuk do të kishte shpërthime të tilla.

Vajzë e zgjuar!

Ndihesha shumë mirë për këtë gjë. Isha gati të shkruaja librin me temë "Si të Përballesh me Krizat Emocionale".

Derisa lindi Matt.

Matt-man, siç e quanim ne atëherë, shkroi librin mbi shpërthimet emocionale! Ai ishte tetëmbëdhjetë muajsh kur filloi çdo ditë, ndonjëherë çdo orë, atë reagim të tmerrshëm shtrirje në dysheme - jashtë kontrollit. E imagjinoni atë mamin që ndihet e turpëruar duke pritur në radhë për të bërë pagesën në dyqan? Oh po, mos gjykoni ju lutem - ajo isha unë!

Matt donte të bëhej siç donte ai dhe e donte "tani"!

Unë tundohesha që të hiqja dorë. Ta lija me aq. Të mblidhja shpatullat dhe të thoja: "Epo, kështu është Matt! Kjo është mënyra e tij ... Unë do të bëj më të mirën e mundshme dhe pjesën tjetër le ta mësojë vetë".

Por Phil nuk më linte ta bëja këtë. Kjo është pjesa ku ideja e llambës dhe dritës tek Fjalët e Urta 6 është kaq e vlefshme!

Kur shikoj pas tani sesa e vështirë ishte ajo periudhë tetëmbëdhjetëmujore e jetës time, jam shumë mirënjohëse që zgjodhëm ta vazhdonim trajnimin. Jam e lumtur që e kufizova jetën time për ato muaj, në mënyrë që të ndërtonim në karakterin e Matt fuqinë e vetëkontrollit. Por në atë kohë, gjithçka që mund të shihja ishte që trajnimi s'po funksiononte.

Unë doja që ai ta kalonte fazën e shpërthimeve emocionale brenda një jave, ose një muaji. Por për tetëmbëdhjetë muaj, çdo ditë u përballëm me shpërthimet emocionale të Matt.

PHIL :

Më kujtohet dita kur Diane më tha: “Nëse do të më duhet të shkoj prapë për të bërë pazarin me gjithë fëmijët, do të vdesim urie!”

Meqenëse gatimet e gruas më pëlqejnë shumë, dola vullnetar që të hënave në mbrëmje të ushqeja fëmijët (sigurisht ushqimi ishte gatuar që më parë nga Diane), t'i laja, të bënim leximin e Biblës, dhe t'i shtrija në krevat ndërkohë që Diane bënte pazarin me qetësi. Ajo përshkonte lart e poshtë shkallët, duke shijuar kohën e saj vetëm! Mendoja që s'do të kthehej kurrë!

Do të dëgjoni nga persona të ndryshëm që do t'ju rekomandojnë t'i anashkaloni shpërthimet emocionale të fëmijëve ose të mundoheni të arsyetoni me ta ndërkohë që prisni që kjo gjendje të kalojë. Ne nuk biem dakord. Shpërthimet emocionale nuk janë vetëm të rrezikshme, por janë fillimi i një fryme rebele dhe mund të çojnë në probleme serioze me mëkatën e zemërimit.

Kur prindërit i injorojnë ose shmangin shpërthimet emocionale, ato mund të zhduken për njëfarë kohe, por do të shfaqen sërish pa asnjë ndryshim në vitet e mëvonshme si sjellje manipuluese jashtë kontrollit.

Nëse temperamenti i një fëmije nuk trajtohet që në vitet e hershme të fëmijërisë, James Dobson paralajmëron se: “ferrat që kanë mbirë mund të rriten e të zaptojnë arën gjatë ditëve të trazuara të adoleshencës”.³

Jini shumë të vëmendshëm në këtë pikë! Nëse një prind i shmang reagimet shpërthyesë të fëmijës duke iu lutur të qetësohet ose duke u përpjekur ta manipulojë që të dalë nga ajo situatë, fëmija mëson që zemërimi është një mënyrë efektive për të kontrolluar njerëzit rreth vetes. Fjalët e Urta 29:11 paralajmëron: “Budallai e shfryn gjithë zemërimin e tij, por i urti e frenon dhe e ul”.

Mësojeni fëmijën ta kontrollojë zemërimin, që të mos bëhet një i rritur, zemërimi i të cilit dikton përgjigjet e pakontrolluara ndaj njerëzve dhe ndaj jetës.

Mbani mend, fëmijët nuk rriten duke lënë pas ndonjë gjë, përveçse rrobat e tyre!

Të gjithë ne njohim të rritur që kanë probleme me shpërthimet emocionale. Shumë prindër ende përpiqen të fitojnë kontrollin mbi temperamentin e tyre, pasi prindërit e tyre nuk ia kanë dalë t'i edukojnë në vetëkontroll. Turpi mund të duket si i papërballueshëm dhe mund të bëjë që babai ose mamaja të ndihen të pakualifikuar për të edukuar fëmijën e tyre në vetëkontroll.

Mos e bëni këtë gabim! Përkundrazi, përpiquni t'i kërkonit të falur fëmijës kur e humbisni durimin, duke i shpjeguar pse është lënduese dhe e gabuar. Tregojuni fëmijëve tuaj që jeni duke i kërkuar forcë Perëndisë për të jetuar një jetë me vetëkontroll, ndërkohë që po ndihmoni edhe ata të bëjnë të njëjtën gjë. Mos harroni, Perëndia është Perëndi i vetëkontrollit, dhe Fryma e Tij jeton në ju. Ndërsa i afrohemi Atij, duke mbushur shpirtërat tanë me hirin dhe bukurinë e Tij, Ai derdh vetëkontroll në karakterin tonë, duke na bërë ç'ka ne nuk mund të bëhemi me forcat tona.⁴

Jini të kujdesshëm teksa disiplinoni temperamentin e fëmijës tuaj. Ju e doni atë mjaftueshëm sa t'i jepni mjetet që i nevojiten, në mënyrë që të mos mposhtet nga tërbimi i emocioneve të tij.

Djali ynë Matthew është burrë tani dhe është një person jashtëzakonisht paqësor! Nuk zemërohet kollaj dhe nuk shfaq tendencë të një temperamenti të dhunshëm. Kur durimi i arrin kulmin, Matt di se si të përballet me të në mënyrë të hirshme, duke mos qëndruar aspak pasiv. Ai është një udhëheqës i fortë dhe i admirueshëm, me vetëkontroll për të administruar emocionet në mënyrë të shëndetshme dhe të perëndishme.

Teksa e përmbledhim këtë kapitull për disiplinën dhe zhvillimin e bindjes dhe vetëkontrollit tek fëmija juaj, mendojini me kujdes këto fjalë për trajnimin e udhëheqësve të pjekur shpirtërorë nga J. Oswald Sanders:

“Ne duhet të jemi të gatshëm të paguajmë një çmim më të lartë nga ai që të tjerët janë të gatshëm të paguajnë . . . rraskapitja është çmimi i udhëheqësisë . . . bota drejtohet nga burra të lodhur”⁵

Pesë vitet e para janë shumë të lodhshme, do t'ju bjerë bretku, pasi duhet të hidhni themel të fortë për vitet që do të vijnë. Megjithatë, nuk ka asgjë më të rëndësishme! Çdo moment meriton plotësisht vëmendjen tuaj. Mbretit Solomon iu deshën shtatë vjet e gjysmë për të ndërtuar tempullin e tij të parë në Jerusalem. Në pjesën më të madhe të kohës gjatë katër viteve përpara kësaj, ai merrej me përgatitjet: duke gërmuar pjesën kodrinore, duke ndërtuar mure mbrojtëse prej guri, duke sjellë ujin, si dhe duke bërë punë nëntokësore që nuk ishin të dukshme derisa u ndërtua tempulli.

E gjitha ishte punë themeli!

Ashtu si në projektin ndërtimor të Solomonit, prindërit që ngrenë pesha të rënda në këto vite themelore krijojnë një bazë solide mbi të cilën mund të ndërtohet e sigurt pjesa tjetër e jetës së fëmijëve të tyre. Është punë rraskapitëse! Por shumë e vlefshme!

Megjithëse fëmija juaj do ta mbajë mend shumë pak, trajnimi që do të bëni në këto vite të hershme do të bëjë ndryshimin lidhur me personin që fëmija juaj do të bëhet. Mendoni këtë - për shumicën prej nesh, kujtimi më i hershëm mund të jetë rreth moshës tre deri në pesë vjeç. *Deri atëherë prindërit tuaj kanë qenë padyshim të rraskapitur dhe prapë ju nuk mbani mend asgjë për këtë!* Për ju që momentalisht gjendeni në këtë fazë, vazhdojeni punën e vështirë! Do të jeni shumë të lumtur që e bëtë. Një ditë, do të qëndroni e do të shikoni çfarë burri apo gruaje e perëndishme fëmija juaj është bërë dhe do të thoni: “Ja ka vlejtur gjithçka!”



Rritja e Ndjekësve Pasionantë për Jezusin

Hedhja e themelit

(Nga lindja – 5 vjeç)

Synimi është të ndihmohen fëmijët tuaj që të zhvillojnë një zemër të bindur dhe vetëkontroll. Kjo fazë e hershme në shtëpi është si një kamp plot trajnime.

Pranë fundit të kësaj faze, fëmija juaj...

- Bindet kur i jepen urdhra.

- Shfaq vetëkontroll.

- E pranon "Jo-në" si përgjigje përfundimtare.

- Kupton që mund t'i kontrollojë sjelljet e veta.

- Reagon pozitivisht ndaj historive për Jezusin dhe heronjtë e Biblës

- Ka filluar të memorizojë Shkrimin.

- Lutet në mënyrë autentike.




1. Tregojani butësisht fëmijës tuaj gabimin. Mos e injoroni, shfaqësoni, ngrini zërin, apo të mendoni se do rritet dhe do ndryshojë. Përdorni Rregullin 10 vjeçar – pyesni veten: Si do të jetë kjo sjellje pas 10 vitesh?

2. Paralajmëroni me repretësi dhe mëshojni fort. Kjo duhet bërë në privatësi, jo në një mënyrë që i turpëron ata publikisht. Një paralajmërim që injorohet duhet të pasohet gjithmonë nga një veprim, jo më paralajmërimë boshe.

3. Qëndroni pranë tyre për t'i ndihmuar, ngushëlluar, dhe për t'u dhënë kurajo. Ky është mjeti më i rëndësishëm – përdoreni vazhdimisht & bujarisht. Fëmija juaj do të bëhet ai/ajo që ju i thoni se e shihni të bëhet.

4. Trajnojini fëmijët tuaj përmes praktikës. Mësojini vazhdimisht: "Jo ashtu.....kështu".

5. Thupra është një koncept biblik dhe duhet të trajtohet me lutje dhe me kujdes.... Asnjëherë në publik apo në zemërim, dhe asnjëherë për të lënduar.



Pjesa 3



Ndërtimi i Strukturës

Moshat 6-12 vjeç

“Shtëpia ndërtohet me dituri dhe bëhet e qëndrueshme me maturi. Nëpërmjet dijes mbushen dhomat me lloj-lloj thesaresh të bukura dhe të rralla.”

Fjalët e Urta 24:3-4

Kapitulli 10

Ndërtojini Ata

Në këtë pjesë do të fokusohemi kryesisht në vitet e shkollës fillore, moshat gjashtë deri në dymbëdhjetë vjeç. Por mos harroni: *Këto janë faza, jo mosha!* Çdo fëmijë zhvillohet në hapin e vet, duke u rritur në aftësinë për të përthithur ato që i janë mësuar, ndërsa rritet në maturi për t'i ndjekur ato. Përgjatë gjithë rrugës, duhet t'i kërkojmë Perëndisë që të mund të kemi depërtim për të parë në zemrat e fëmijëve tanë. Nëse nuk e bëjmë, mund të humbasim udhëzime specifike që Ai dëshiron të na japë rreth mënyrës se si Ai e ka krijuar këtë fëmijë.

Dhe Ai ka dëshirë t'ju flasë! Herë pas here dëgjojmë shprehjen e Jezusit: “Ai që ka veshë për të dëgjuar, le të dëgjojë” (Mat. 11:15). Teksa qëndroni gati për të dëgjuar, ju do t'a dëgjoni Atë t'ju flasë, t'ju mësojë, t'ju bindë, dhe t'ju tregojë se si të punoni me Të teksa Ai u jep trajtë fëmijëve tuaj duke i bërë ato “thesare të rrallë e të bukur” (Fjalët e Urta 24:4).

Kjo shtëpi që ju po ndërtoni me Perëndinë, po bëhet diçka e bukur dhe e rrallë.

Faza e strukturimit në ndërtimin e një shtëpie është shumë argëtuese. Deri në këtë pikë, për javë të tëra keni vështruar një shtresë të zhveshur betoni, duke u përpjekur të imagjinoni si do të ngjajë më pas. Pastaj shfaqet skuadra e punës, dhe vetëm në pak ditë mund të shikoni teksa shtëpia juaj e re fillon të marrë trajtë.

Tamam ashtu si në ndërtimin e një shtëpie, kjo fazë e rritjes së fëmijëve të perëndishëm është shumë argëtuese. Gjithë puna e vështirë që keni bërë gjatë viteve themelore fillon të japë fryt. Ju shikoni një zemër të bindur të marrë trajtë në përgjigjet e fëmijës tuaj. Jo bindje perfekte, por të paktën një tendencë drejt dëshirës për t'ju bindur si dhe një kuptim për pasojat e mosbindjes.

Megjithëse do të vazhdoni të punoni në trajnimin e fëmijës tuaj në aftësitë e vetëkontrollit, ju tashmë po filloni të shikoni frytin e mësimave tuaja. Shpërthimet emocionale pothuajse janë zhdukur. Fëmija juaj është i aftë të heqë dorë më shpejt nga një sjellje e keqe, duke i rezistuar tundimit për të shpërthyer në zemërim.

Gjatë kësaj faze ju dëshironi të fokusoheni në zhvillimin e një zemre të urtë tek fëmija juaj.

Fjalët e Urta 23:15-16 shpreh qëllimin e kësaj faze:

“Biri im, nëse zemra jote është e urtë, edhe zemra ime do të ngazëllojë; zemra ime do të ngazëllojë, kur buzët e tua do të thonë gjëra të drejta.”

Dhe më poshtë në vargun 24,

“Kush ka lindur një të urtë do t'ia ndjejë gëzimin”.

Është detyrë e prindit që të drejtojë dhe mbikqyrë zhvillimin e kësaj faze strukturimi tek fëmija. Dhe Perëndia ju tregon si t'a bëni këtë tek Efesianët, kapitulli gjashtë.

Në kapitullin e mëparshëm ne studiuam Efesianët 6:1-3, duke u fokusuar në udhëzimet e Perëndisë ndaj *fëmijëve*. Tani, në vargun 4 ne shohim urdhërimin e Tij drejtuar prindërve, veçanërisht etërve. Ky urdhërim i Perëndisë ka dy anë: njëra është negative (ajo që *nuk duhet* të bëni), dhe tjetra është pozitive (ajo që duhet të bëni).

Le të shikojmë fillimisht negativën. Le të shohim Efesianët 6:4:

“Etër, mos provokoni për zemërim fëmijët tuaj”.

Kjo ngre një pyetje me vend: çfarë nënkupton Perëndia kur i udhëzon prindërit që të shmangin nxitjen e provokimit tek fëmijët e tyre?

Fjala greke *parorgízō*, e përkthyer *acaroj* ose *provokoj*, do të thotë të zemërosh ose ta çosh në një pikë zemërimi. Si përkufizim pune do të ishte: “një model ose trajtim i vazhdueshëm që ndërton gradualisht një pakënaqësi të thellë që zien e zien, derisa në fund shpërthen”.

Tek Kolosianët 3:21 shohim të njëjtin urdhërim të përsëritet:

“Ju etër, mos provokoni për zemërim bijtë tuaj, që të mos dekurajohen”.

Në Biblën New American Standard (Standardi i Ri Amerikan), është përkthyer paksa ndryshe:

“Ju etër, mos provokoni për zemërim bijtë tuaj, që të mos i lëshojë zemra”.

Bibla e Amplifikuar (The Amplified Bible) e zgjeron në këtë mënyrë:

“Etër, mos i provokoni, irritoni ose zemëroni fëmijët tuaj - mos jini shumë të ashpër me ta ose mos i ngacmoni; që të mos dekurajohen, të mos bëhen të vrazhdë, të acarohen apo të ndjehen inferiorë dhe të irrituar; mos ua thyeni zemrën”.

A e kapni pamjen?

Megjithëse fjala greke e përkthyer etër (*patér*) i referohet vetëm prindit mashkull, kjo ide mund të vlejë për të dy prindërit. Edhe mamaja mund të bëjë të njëjtën gjë: të jetë shumë e ashpër me fëmijët e saj, duke i bërë të ndihen inferiorë dhe të acaruar. Për disa prej jush, ka qenë mami dhe jo babi që ju ka lënduar vazhdimisht në këtë mënyrë.

Të dyve na është dashur të përballemi me tendencën tonë të brendshme për të provokuar zemërim tek fëmijët tanë - ashtu si çdo prind që ne njohim. Diane, duke *i bezdisur* ata pafundësisht, duke qenë shumë përzgjedhëse dhe perfeksioniste për imtësira, dhe Phil duke *pritur shumë prej tyre*, në disa raste më shumë nga sa u kërkohej.

Gatishmëria për të identifikuar modelet e “provokimeve” tuaja personale ju jep mundësinë që t'i sillni ato mangësitë negative

të karakterit tek Perëndia - të përlunni veten përpara Atij dhe përpara fëmijëve tuaj dhe më pas të ecni në fuqinë e Frymës së Shenjtë për t'i kapërcyer ato.

Për shkak se ky është një problem shumë i përhapur tek prindërit, përfshirë edhe prindërit e mirë dhe të qëllimshëm, kemi listuar disa mënyra se si prindërit i përkeqësojnë fëmijët e tyre, duke i çuar në një pakënaqësi të thellë dhe në atë pikën e vlimit të brendshëm. Këto nuk janë të vetmet mënyra nëpërmjet të cilave prindërit mund t'i përkeqësojnë fëmijët e tyre, por janë pesë më të zakonshmet.

PESË MËNYRA SI PRINDËRIT I PROVOKOJNË FËMIJËT E TYRE

Duke folur në mënyrë të pakëndshme ose ashpër me ta.

Ne po flasim për fjalë të tipit: “Prapë e bërë?!”; “Çfarë nuk shkon me ty?”; “Më acarove nervat!”; “S’ia dal dot me ty!” Jini shumë të kujdesshëm me përdorimin e fjalëve fyese dhe dekurajuese që e etiketojnë fëmijën tuaj si të paaftë apo të padashur. Fjalët e Urta 18:21 paralajmëron: “Vdekja dhe jeta janë në fuqinë e gjuhës”. Këto fjalë, të folura në mënyrë të pakujdesshme, nguliten në kokën e fëmijës tuaj për një kohë shumë të gjatë.

PHIL:

Një ditë isha lart në zyrën time duke punuar pikërisht me këtë pjesë të materialit të prindërimit të qëllimshëm kur dëgjova djaln tonë Matt të thërriste: “Pafshim mami dhe babi; po dal unë!”

Në atë kohë Matthew ishte student në universitet, njëzetenvjeçar dhe jetonte në shtëpi. Ai ishte një djalë i perëndishëm, luftonte për pastërtinë, ndiqte Kolegjin Biblik dhe po trajnohej për t'u bërë pastor. E kishim lënë të përdorte pa qira apartamentin tonë të katit përdhes, të rimodeluar së fundmi.

Por, le të themi që ai nuk e kishte trashëguar dashurinë e mamasë së tij për pastërti dhe rregull!

Diane ishte përpjekur për një javë ta bënte të pastronte gjërat aty poshtë; një familje do të vinte nga jashtë qytetit dhe do të duhej

të flinin aty. Por Matt kishte qenë aq i zënë sa që nuk kishte gjetur kohë të pastronte.

Atëherë, Diane e acaruar erdhi tek unë dhe tha: “Jam përpjekur të sillem mirë me të, por Matt thjesht nuk do t’a bëjë atë që i kam kërkuar. Do të flasësh ti me të? Do i thuash që nuk mund të dalë me shokët derisa ta ketë pastruar vendin?”

Për këtë arsye, atë mëngjes, unë i thirra: “Matt, e bëre atë që të tha mamaja të bëje?”

“Jo babi,” erdhi përgjigjja e tij, “Do ta bëj pastaj!”

E humba toruan! Duke ngritur zërin, bërtita: “Sa herë duhet të të themi për të bërë diçka?!”

Heshtje.

Më pas dëgjova zërin e butë të Matt.

“Babi, më duket sikur unë nuk mund t’ju kënaq kurrë!”

Pikërisht ndërsa po shkruaja këto fjalë në kompjuter!

U largova nga tavolina, eca deri në krye të shkallëve dhe me hirin e Perëndisë, kërkova falje teksa pashë shpatullat e varura të Matt në shenjë disfate. Ishte sikur të kisha marrë një thikë dhe të kisha plasur një tullumbace.

Më erdhi direkt në mendje Fjala e Urtë që kisha lexuar atë mëngjes: “Kush flet pa mend është si ai që shpon me shpatë, por gjuha e të urtëve sjell shërim” (F. e Urta 12:18).

Meqë ra fjala, një kërkesë faljeje e përlulur dhe e sinqertë është *mënyra e duhur dhe më e mirë* për të sjellë shërim kur e keni katranosur me fëmijët tuaj. Kërkojuni falje atyre. Përmendni atë që keni bërë gabim. Tregoni se si falët që keni thënë e kanë lënduar fëmijën tuaj dhe sesa keq e keni trajtuar situatën. Jo vetëm që do të rikuperoni marrëdhënien tuaj me atë fëmijë, por do t’u tregoni atyre që edhe ju gjithashtu, jetoni nën autoritetin e Jezusit. Ata do të shikojnë mënyrën se si Ai ju ndryshon dhe ju rrit, dhe do të inkurajohen teksa ju ndryshoni dhe rriteni së bashku *në hir*.

A po i ndërtoni fëmijët tuaj me fjalët që thoni, apo po i rrëzoni ata?

Duke i krahasuar

Fëmijët tanë supozohet të jenë të ndryshëm! Zoti e bëri secilin prej tyre të veçantë, dhe Ai i shijon nuancat e personalitetit të tyre. Atij i pëlqen mënyra si i ka formuar! Kur prindërit kanë një ideal të qartë se si duan që të jenë fëmijët e tyre, ata rrezikojnë t'i dekurajojnë dhe t'i acarojnë ata fëmijë.

Njëlloj si të rriturit, fëmijët ecin me ritme të ndryshme. Ata piren ndaj aktiviteteve të ndryshme; zhvillojnë interesa dhe pasione të ndryshme. Ata kanë aftësi dhe mundësi të ndryshme. Bëni kujdes që të mos i krahasoni fëmijët me njëri-tjetrin, ose me veten tuaj!

E mbani mend historinë e Jakobit dhe Esaut? Ata ishin djemtë binjakë të Isakut dhe Rebekës, stërnipërit e Abrahamit dhe Sarës. Armiqësia e tyre me njëri-tjetrin ishte legjendare, e shtrirë në një hark kohor prej disa dekadash! Kjo frazë na çon tek rrënja e problemeve:

“Isaku . . . donte Esaun, por Rebeka donte Jakobin” (Zan. 25:28).

Krahasoni historinë tragjike të familjes së tyre me studimet e bëra nga George Barna dhe skuadra e tij. Ata zbuluan që “nëntëdhjetë e gjashtë përqind e Prindërve Revolucionarë që intervistuan morën kohë dhe u përpoqën të mësonin natyrën unike të secilit prej fëmijëve të tyre, si dhe të ndërtonin një kornizë prindërimi rreth veçorive të secilit fëmijë”.¹

Për t'ju ndihmuar të mësoni e të kuptoni natyrën e fëmijëve tuaj, shikoni Shtojcën C. Ne kemi listuar disa libra dhe burime që na kanë ndihmuar në përpjekjen tonë për të njohur zemrën e fëmijëve tanë.

Duke i mbrojtur ata më shumë se ç'duhet.

Ky është ai model prindi që ia merr frymën fëmijëve të tij, duke i kufizuar më shumë se ç'duhet, duke mos u besuar kurrë, duke vënë në pikëpyetje vazhdimisht gjykimet e tyre, me pritjen që ata të dështojnë. Prindi që ndjek këtë model mund ta gërryëjë vetëbesimin e fëmijës, pasi fëmijët instinktivisht e ndjejnë mungesën e besimit të prindërve tek ata.

Kjo lloj mbikqyrje jo e shëndetshme ndërton gradualisht një barrierë midis prindit dhe fëmijës, një barrierë që duhet të thyhet nëse

doni të keni një ndikim të rëndësishëm tek fëmija juaj ndërsa ai rritet.

“Nuk është e lehtë të ulesh këmbëkryq, duke i mbajtur duart dhe opinionet për vete teksa shohim fëmijën tonë të luftojë për të zgjidhur problemet në kohën dhe mënyrën e vet. Por ky është sikleti i nevojshëm i të mësuarit. Kreativiteti përfshin gjykim të imtësishëm dhe gabime. Ne nuk duam që t’ua mohojmë fëmijëve tanë këtë privilegj”.²

E vetmja mënyrë që ne dimë që ju aftëson për ta bërë këtë, është t’ia besoni fëmijën tuaj Atit çdo ditë, duke ditur se Ai ju udhëheq, duke ju dhënë urtësi dhe mençuri ndërsa ju e kërkonin atë, e më pas të bëni atë që Ai ju thotë të bëni për atë fëmijë.

Duke i shtyrë përtej asaj që janë të aftë të arrijnë.

Ekziston një vijë shumë e hollë mes besimit në aftësitë e fëmijës tuaj dhe të priturit më shumë prej tyre nga sa ata janë në gjendje të ofrojnë. Ndërkohë që secili prej fëmijëve tanë kishte gjithë inteligjencën që i duhej për të marrë 10-ta në shkollë, dy prej tyre kishin personalitete që nuk performonin dot në atë nivel gjithë kohën, për shkak të presionit.

Vajzës tonë të mesme i nevojitet kohë dhe liri për të menduar dhe mbledhur informacion. Në këtë ritëm të qëndrueshëm, mendja e saj bashkon pikat, duke nxjerrë përfundime që dalin nga goja e saj me mençuri të mahnitshme. Ne vumë re se kur e shtynim shumë fort - shumë shpejt, nga nxitimi ajo humbiste pjesët më të mira të vetvetes. Në gjimnaz, kjo u përkthye në shumë 8-ta që i merrte për shkak se nxitonte duke shtyrë veten për tek niveli i notës 10. Ne duhet të duartrokisnim për 8-at e saj po aq sa për 10-at.

Shumë fëmijë heqin dorë plotësisht kur mendojnë se sado fort të punojnë, nuk i kënaqin dot prindërit e tyre. Ose mund të ndodhë e kundërta: ata bëhen të rritur të pashëndetshëm emocionalisht, ku etja e vazhdueshme për mbiarritje deformon personalitetin e tyre dhe i privon nga gjetja e qetësisë.

Kini parasysh që: *nuk do t’ia dilni dot në mënyrë të përsosur.* Jo më larg se javën e kaluar Diane përjetoi dhimbje teksa po fliste me vajzën për mënyrat se si ia kishte përcjellë të bijës tendencat e saj perfeksioniste. Ndërsa përpiquej ta mësonte atë që të punonte mirë, t’a

bënte në mënyrën e duhur, Diane padashje kishte krijuar një mentalitet të heshtur që qëndronte mbi shpatullat e Rebekës. Të dyja së bashku po qanin për barrën që kjo mënyrë të menduari krijon. Nuk kishte akuza apo zemërim, por ishte një kohë ku ato ndanë dhimbjen për humbjen e qetësisë (pushimit) dhe të paqes që perfeksionizmi sjell.

Jini të zgjuar dhe të mprehtë (dallues) - njihni fëmijët tuaj! Pastaj ruajini zemrat e tyre teksa i ndihmoni të njohin vetveten. Dhe pranoni tendencat tuaja të pashëndetshme emocionale, që të mos i ngarkoni fëmijët me çështjet tuaja të pazgjidhura.

Duke i neglizhuar.

Në këtë epokë, kur të dy prindërit shpesh punojnë me orë të gjata ose janë të shpërqëndruar nga mesazhet, email-et, dhe përgjegjësitë e pafundme, rrezikojmë të lëmë pas dore nevojën që fëmijët kanë për marrëdhënie. Por ashtu si autorja dhe blogerja Rachel Stafford mëson në *Hands Free Mama*: “Për të kapur çfarë ka rëndësi, duhet të hiqni dorë nga ajo që nuk ka rëndësi”.³

Ka një lloj vdekje të jetës personale kur bëhemi me fëmijë! Është koha kur duhet të vendosim nevojat e fëmijëve përpara dëshirave tona personale. Por kjo është ajo që Oswald Chambers e quajti “vdekje të mirë,” kur heqim dorë nga ambicjet dhe interesat tona për të vendosur në radhë të parë nevojat e fëmijëve tanë dhe duke i dorëzuar jetët tona tek Perëndia në një besim absolut. Kjo nuk është njëlloj me prindërimin që ka në qendër fëmijën; është thjesht një mënyrë e matur për të përmbushur privilegjin e rritjes së këtij fëmije që Perëndia ju ka dhuruar.

Padyshim, versioni ekstrem i neglizhencës ndodh kur mamaja ose babai e lënë familjen. Braktisja nga prindi lë shenjë tek fëmija për gjithë jetën. Por kjo ndjenjë neglizhence ndodh edhe kur jeni shumë të zënë ose shumë të shpërqëndruar për të dëgjuar fëmijën tuaj, për të njohur ëndrrat e tyre dhe për të ëndërruar bashkë me ta. Ata mund të mendojnë në fakt që ju nuk i doni mjaftueshëm sa për të kaluar më shumë kohë me ta nga sa është absolutisht e nevojshme.

Mendoni për këtë! Ju ndoshta po tregoni që e doni fëmijën tuaj duke punuar shumë më fort se ç’duhet në mënyrë që ai/ajo të ketë gjithçka që i nevojitet, ndërkohë që djali apo vajza juaj e interpretojnë ngarkesën tuaj si mosinteresim.

Mami dhe babi janë shumë të fokusuar në jetën e tyre që të kujdesen për timen.

Një ditë më parë, djali ynë tridhjeteshtatëvjeçar e falenderoi Phil që e kishte marrë atë me vete në një udhëtim ku do të kalonin natën në një kamping kur ai ishte tetë vjeç. Ai ende e kujton atë! Phil mban mend se si kishte krijuar hapësirë në orarin e tij shumë të ngjeshur për këtë - një kamping njëzetekatërorësh disa kilometra larg shtëpisë. Diçka kaq e thjeshtë vazhdon të sjellë kujtime të bukura pothuajse tri dekada më vonë.

DIANE:

Babai im u rrit në varfëri. Të dy prindërit e tij punonin aq sa për të siguruar ushqim në tavolinë, dhe kjo ishte gjithçka që kishin. Babai duke parë këtë mjerim ishte i vendosur të shkonte në universitet, të bënte një karrierë që do të bënte të mundur daljen nga varfëria që kishte përjetuar si dhe të merrte një pagë të mirë. Të siguronte mjaftueshëm mirë ishte një vlerë shtytëse e babait tim, ndaj punonte fort dhe me orë të gjata për të arritur suksesin.

Kur isha në gjimnaz, duke luftuar me ndjenja dështimi që më çuan në një rënie të notave, babai im u përkushtua që të më motivonte. Ishte vera mes vitit të dytë dhe të tretë të gjimnazit, kur arrita të gjeja punën time të parë pranë një këndi lojrash. Uniforma ishte ishte një fund i kuq me të bardhë i modës së vjetër dhe një bluzë e bardhë, dhe më kërkohet të vendosja një fjongo gjigande në kokë. Atletet e kuqe, qesharake dhe tepër jashtë mode për fundin e viteve '70, më bënin të ndihesha si kloun.

Babi më quante bukuroshe.

Gjatë gjithë asaj vere, të paktën një herë në javë ai dilte nga zyra në kohën e drekës, vishte çizmet e tij "cowboy", dhe blinte biletën të hynte tek parku Western për të ngrënë një hamburger të bërë nga unë për drekë. Faqet e mia bëheshin flakë të kuqe teksa ai u tregonte të gjithëve se vajza e tij bënte hamburgerat më të mirë. Ai mburrej për gjithçka që unë bëja në atë punë, duke më lavdëruar, duke më thënë se sa punëtore e mirë isha, duke më

bërë të ndihesha sikur kisha punën më të rëndësishme në botë dhe se çfarëdo që do të bëhesha në jetë, me siguri do të isha shumë e suksesshme!

Gjithçka ndryshoi për mua atë verë. Qëndroja drejt me krenari, duke fituar vetëbesim dhe nxitjen që më duhej për t'u kthyer në shkollë si vajza e suksesshme që babi më thoshte se isha. Dhe tërë kohën, babi më bindte se e shijonte çdo çast që mund të vidhte që të mund të qëndronte me mua tek Fshati Frontier.

Në vend që të më linte pas dore teksa merrej me suksesin e karrierës së tij, babai im u mor me mua. Ai më dëgjonte kur as unë vetë nuk dija çfarë doja. Dhe më shpëtoi duke më treguar udhën e Atit shumë më mirë nga sa do të ma tregonte një predikim.

Kur fëmijët perceptojnë indiferencën e prindërve në gjërat që kanë rëndësi për ta, shpesh zemërimi i kaplon zemrat e tyre. Gjetja e kohës për të bërë pyetje, për të marrë pjesë në lojra, ose për të dëgjuar historitë e tyre e motivon fëmijën tuaj në një mënyrë të dukshme. Jini prezentë në jetën e tyre, duke treguar interesin që u nevojitet për të lulëzuar.

Le të vazhdojmë më tej! Pasi u thotë etërve çfarë *nuk* duhet të bëjnë “Etër, mos provokoni për zemërim fëmijët tuaj”, urdhërimi i dytë tek Efesianët 6:4 është pozitiv për atë që duhet të bëjmë:

“por rritini me disiplinën dhe këshillat e Perëndisë”.⁴

Shprehja “rritini” përmban një koncept tërheqës dhe shumë të anashkaluar.

Fjala në greqisht është *ektréphō*. Do të thotë “të përkujdesesh deri në pjekuri/ maturi”.

Përkujdesja nuk lidhet vetëm me sigurimin e ushqimit dhe veshjeve, por përfshin edukimin e fëmijëve tanë në të gjitha aspektet e jetës: duke i ndihmuar të rriten në shëndet dhe pjekuri emocionale e shpirtërore. Kjo është e njëjta fjalë që është përkthyer “kujdeset” ose “ushqen” tek Efesianët 5:29, ku burrat urdhërohen që të duan gratë e tyre ashtu si Krishti e deshi kishën.

NJË FJALË PËR MARTESËN

Pasi e udhëhiqni djalin ose vajzën tuaj tek Jezu Krishti, dhurata më e madhe që mund t'ju jepni fëmijëve tuaj është ajo e një martese të mirë!

PHIL:

Pasi e lashë grupin në të cilin kisha luajtur muzikë për nëntë vjet, fillova punë në një kompani çimentoje, ndërkohë që po përfundoja diplomimin tim në biznes. Kamionët me çimento mbërrinin njëri pas tjetrit teksa hidhnim themelet e ndërtesave industriale gjigande.

Përpara se të mbërrinin kamionët me çimento, në tokë vendoseshin disa shufra të trasha çeliku të lidhura me tel që quhen armaturë. Ndërkohë që derdhej çimentoja, ishte detyra ime ta ngrija armaturën me ndihmën e një leve, dhe ta vendosnim në mes të dyshemesë së çimentos. Kjo krijonte një dysheme të fortë, të trashë dhjetë centimetra, të pathyeshme, me shufra çeliku në mes që mund t'i rezistonte pothuajse gjithçkaje.

Të kesh (dhe të mbash) një martesë të mirë është si të vendosësh armaturën prej çeliku në themelin e shtëpisë tënde!

Ashtu si ne, edhe ju do të bëni shumë gabime teksa rritni fëmijët tuaj, por nëse keni një martesë të mirë me Jezusin në qendër - nëse fëmijët ju shohin duke e dashur njëri-tjetrin dhe duke i kërkuar falje njëri-tjetrit kur është e nevojshme - do t'ju jepni fëmijëve një dhuratë të shkëlqyer. Ata do ta dinë thellë në shpirtin e tyre që mami dhe babi e duan dhe nuk do ta braktisin kurrë njëri-tjetrin. Themeli i shtëpisë tuaj do të qëndrojë i fortë dhe fëmijët tuaj do të lulëzojnë.

Po në lidhje me atë frazën e fundit: “rritini me disiplinë (në trajnimin) dhe në këshillat e Perëndisë”? Janë tri pika kyçe që duhet të kuptoni aty:

Trajnim (paideía): Përkthyer *disiplinë*; i referohet trajnimit sistematik të fëmijës tuaj. Përfshin edhe edukimin.

Këshillat (nouthesia): Kjo fjalë greqisht do të thotë “të shtiesh në mendje”. Janë lloji i këshillave që gjenden në librin e Fjalëve të Urta, trajnim që nuk ka të bëjë shumë me dhënien e fakteve plotësuese, sesa me qëndrimet dhe parimet e duhura për të jetuar një jetë me virtyte. Kjo fjalë përfshin si udhëzimin edhe korrigjimin.

E Perëndisë: Mos e harroni këtë frazë të fundit! Prindër, ju duhet t’i rritni fëmijët tuaj në disiplinën dhe këshillat e *Perëndisë*! Ky është një edukim teocentrik, ose me Zotin në qendër.

Prindërit duhet të modelojnë një mënyrë jetese që ka Perëndinë në qendër.⁵ Ata duhet t’i udhëheqin fëmijët e tyre në mësimin e rrugës së Jezusit dhe në përjetimin e misionit të Tij.

Së bashku, familja juaj “po përpiqet të mësojë çfarë e kënaq Perëndinë” (Efe. 5:10). Në shtëpinë tonë kjo përfshinte çfarë filmash do të shihnim dhe cilët do të shmangnim, çfarë muzike dëgjonim dhe në cilat revista abonoheshim. Për më tepër, kjo mënyrë jetese për të “kënaqur Perëndinë” frymëzoi tek ne dëshirën për t’i lënë vend aromës së këndshme të Jezusit (2 Kor. 2:15) që të përshkonte muret e secilës dhomë, gjë e cila nga ana tjetër na drejtonte e bindte si t’i flisnim njëri-tjetrit, si të zgjidhnim mosmarrëveshjet, si të donim.

GJITHË DITURIA VJEN NGA ZOTI

Gjithë dituria vjen nga Perëndia. “Frika e Zotit është fillimi i diturisë, dhe njohja e të Shenjtit është zgjuarsi” (F. e Urta 9:10). Kështu që, sa më shumë të njoh rrugën e Jezusit, aq më i zgjuar do të jem. Dhe sa më shumë ta njohin fëmijët e mi rrugën e Jezusit, aq më të mençur do të jenë.

Autorët dhe studiuesit Steven Southsivk dhe Dennis Charney, në librin e tyre Vendosmëria (*Resilience*), identifikuan dhjetë faktorë kyç që i aftësojnë njerëzit të kapërcejnë tragjeditë dhe traumat. Çdo cilësi e karakterit që ata identifikuan mund të gjendet në Shkrim. Besimi në një të ardhme më të ndritur (optimizmi), guximi, altruizmi,

besimi, pjesëmarrja në bashkësi, mësimi prej mentorëve, elasticiteti, vetëkontrolli mbi mendimet, ndjenjat dhe trupin.⁶ Ashtu siç e kemi theksuar shpesh, hulumtimet sociale konfirmojnë urtësinë që Perëndia na ka dhënë bujarisht në Fjalën e Tij.

Çfarë ju po përpiqeni të bëni në këto vite strukturimi është të ndërtoni një grua apo burrë të perëndishëm, jo duke administruar sjelljen e jashtme, por duke i afruar fëmijët me zemrën e Perëndisë në mënyrë që Ai të fillojë procesin e bukur jetësor të transformimit. Kjo është urtësi.

Të jesh ndjekës i Jezusit nuk ka të bëjë vetëm me respektimin e rregullave, as nuk është parësore ndjekja e një kodi sjelljeje të krishterë. Ju dëshironi fort që fëmija juaj të njohë dhe të dojë Perëndinë që ka bërë rregullat!

Qëllimi që ju keni është të kultivoni tek fëmija juaj një zemër urtësie, pasi fëmijët nuk rriten automatikisht në njerëzit që Perëndia do që ata të jenë. Ata duhet të *mësohen* si ta jetojnë jetën ashtu si Perëndia e ka projektuar që të jetohet!

Përpara se t'ju japim disa udhëzime specifike se çfarë t'u mësoni atyre në këtë fazë, duam t'ju prezantojmë një mënyrë si të përmblihdhni të gjitha aspektet e një trajnimit të mençur në një format të punueshëm, diçka që e quajmë thjesht Kutia.

Kapitulli 11

Kutia

Ndërsa përpiqeni të zhvilloni një zemër të urtë brenda fëmijës tuaj, duam t'ju prezantojmë me Kutinë. Çfarë është *Kutia*? Na vjen mirë që pyetët!

Kutia është korniza që ne ndërtojmë rreth jetës së fëmijëve tanë, në mënyrë që t'ju ofrojmë një vend sigurie të mbushur me gëzim, ku ata mund të lulëzojnë dhe të rriten në personin që Zoti do që ata të jenë. Është një mekanizëm që prindërit mund ta përdorin për të sjellë të gjithë elementet e rritjes së fëmijës së orientuar tek Perëndia në një mënyrë kohezive, bashkëpunuese dhe të qetë të jetuari - edhe kur fëmijët nuk janë aspak bashkëpunues dhe të qetë!

Kutia është një mënyrë për t'i përmbledhur të gjitha së bashku, një format që duhet ndjekur kur nevojitet disiplina dhe trajnimi. Është një udhëzues për t'u siguruar që gjithë ajo punë e bërë nga ju po krijon tek fëmija një zemër të plotë e të shëndetshme kundrejt Perëndisë dhe prindërve.

Kutia fillimisht është e vogël dhe e ngushtë. Mami dhe babi kontrollojnë gjithçka në ato ditët e hershme të foshnjërisë dhe varësisë absolute. Duke ditur se çfarë është më e mira për fëmijën tuaj, ju krijoni një atmosferë të ngrohtë dhe të përgjegjshme teksa e ushqeni dhe kujdeseni për të si për një dhuratë të Perëndisë.

Dalëngadalë, Kutia fillon të zgjerohet ndërsa fëmija rritet. Atij i jepet më shumë liri, më shumë pavarësi, ndërsa ju përjetoni gëzim në zbulimin dhe shpalosjen e kësaj dhurate të bukur nga Perëndia, që është fëmija juaj. Me këtë zgjerim vijë më pak qasje të drejtpërdrejta, pasi fëmija fillon të mësojë si të jetojë në shtëpi.

Ndonjëherë Kutia duhet të ngushtohet sërish kur fëmija kalon në ato periudhat e pashmangshme të humbjes së kontrollit duke ju testuar. Gjatë atyre kohëve, Kutia e sjell në sinkron me atë që ai/ ajo është dhe si të përparojë.

Kutia rritet dhe zgjerohet deri në ditën kur ju e arrini synimin tuaj: jo më Kutë.

Çfarë gëzimi u sjell ajo ditë prindërve! Marrëdhënia me fëmijën tuaj ndryshon në mënyrë dramatike kur ata fillojnë të krijojnë Kutinë e tyre, të administruar dhe të imponuar prej vetë atyre, teksa rriten në një marrëdhënie të gjallë me Krishtin.

BAZAMENTI I KUTISË ËSHTË JEZUSI

Bazamenti i Kutisë duhet të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm, një themel mbi të cilin do të ndërtohet pjesa e mbetur e jetës. Ai themel është *Jezusi*. Jo kisha, jo mënyra e jetesës së krishterë, jo AWANA, as ndonjë program tjetër - vetëm *Jezusi*.

Pali e ka shprehur në këtë mënyrë: “Që të mund ta njoh Atë” (Fil. 3:10). Fjala greke *ginosko*, e përkthyer ta njoh, është një pamje e intimitetit, e një besimi dhe lirie të thellë në Të. Pali lutej për miqtë e tij në Efes, që ata të mund ta *përjetonin* dashurinë e Krishtit.¹

Që nga momenti kur ata lindin, ne flasim për Të. I vëmë në gjumë me këngë për Të, lutemi në emrin e Tij. Ne i ngushëllojmë fëmijët tanë në atë mënyrë që i hap zemrat e tyre për të dëshiruar ngushëllimin që Fryma e Shenjtë u jep atyre që qëndrojnë në Të.

Teksa rriten, u tregojmë atyre histori për forcën e Perëndisë dhe i mbushim imagjinatat e tyre me histori për fuqinë e Tij.

Për nipërit tanë, Jezusi është superheroi më i madh! Aq sa një të dielë Pashke, kur Duka pesëvjeçar duhej të ngjyrote një vizatim të ringjalljes së Jezusit, ai e pa dhe nuk ishte i kënaqur nga rezultati. Pasi meditoi rreth saj për pak kohë, e dinte se diçka mungonte: një shpatë drite! Kështu që Duke vizatoi një të tillë, dhe ja ku ishte, Jezusi *Luftëtari i Yjeve*!

Megjithëse qeshëm teksa fotoja e vizatimit të tij iu dërgua të gjitha tezeve dhe xhaxhallarëve që janë të çmendur pas Star Wars (Luftëtarët e Yjeve), po ashtu lavdëruam të kuptuarit e tij për forcën dhe fuqinë e Jezusit.

Më pas, kur rriten edhe pak më shumë, gërmojmë më tepër në Fjalën e Zotit që t’ua zbulojmë Atë drejt fëmijëve tanë: kush është Ai, si mendon Ai, çfarë do Ai. Jo shumë akademikë, por thjesht Atë - *Jezusin*. Ne duam që fëmijët ta duan Atë, kështu që pikturojmë një pamje tërheqëse për atë që Ai është.

NJËRA ANË E KUTISË ËSHTË DISIPLINA

Ka disa raste kur pjesa disiplinore në jetën e një fëmije duhet të jetë pak më e rreptë. Ju e dini, e shikoni dhe ndërhyni për ta ngushtuar këtë anë të Kutisë. Në vend që thjesht të reagoni, ju shikoni për mundësi që ta adresoni problemin.

DIANE:

Ju kam treguar për shpërthimet emocionale famëkeqe të Matthew dhe si tundohesha për t'u dorëzuar. Megjithëse ai ishte fëmijë i lezetshëm e gazmor, temperamentit i tij ishte shumë më i fortë se i imi, dhe unë shpesh tkurresha nga konfrontimi që mund të pasonte.

Një nga ato ditë, në vend që të merresha në mënyrë të prerë me sjelljen e tij, e nisa në dhomë. Nuk mund të vazhdoja me përvojën e hidhur të thuprës në të ndenjura sërish.²

Matt-man (siç e thërrisim ne atëherë) ngjiti shkallët me hapa të rëndë, shkoi në fund të korridorit për tek dhoma e tij dhe përplasi derën nga pas. Unë thjesht u ula në kolltuk, e frikësuar për tim bir. Pse nuk po depërtojmë dot tek ai? Pse nuk po funksiononte?

Më pas dëgjova një zhurmë të fortë! Në fakt ndjeva muret që u drodhën, si në ato tërmetet e Kalifornisë që mbaja mend nga fëmijëria, shoqëruar me një ndjesi faji. Duhet të ngjitesha lart dhe të shikoja se çfarë po ndodhte, por ahh, sa po i druhesha një përballjeje tjetër.

Kur arrita atje, Matt qëndronte ulur krejt i qetë dhe oh-shumë-pafajësisht në anë të krevatit. Por rafti mbi kokën e tij, ku zakonisht vendosnim lodra dhe libra me vlerë, ishte bosh. Matt kishte hipur mbi krevatin e tij dhe në një shpërthim zemërimi i kishte hedhur poshtë të gjitha, ndërsa një nga lodrat që ishte një kamion metali antik kishte mbetur i varur në mur.

Tani, me celularët dhe rrjetet sociale, me shumë mundësi do e kishim hedhur në Instagram foton e atij kamioni të ngecur në gips - por në atë moment nuk ishte aspak për të qeshur!

Dukej qartë se ishte koha ta ngushtonim Kutinë!

ANA TJETËR ËSHTË RREGULLI

Disiplina e një jete të organizuar mirë do ta ndjekë fëmijën tuaj që nga foshnjëria deri në moshë madhore. Është thjesht koncepti i mësuar përmes Shkrimit dhe i jetuar nga njerëzit në jetën e përditshme, se *ka një kohë të përshtatshme për çdo gjë*.

Në librin e Predikuesit, mbreti Solomon shkroi atë që kishte mësuar duke dëgjuar dhe vrotuar diturinë e Perëndisë. Fjalët e tij janë thesar për prindërit:

“... zemra e urtë do të dallojë kohën dhe mënyrën e duhur. . . në çdo rast” (Pre. 8:5-6).

“Çdo gjë ka stinën e vet, çdo situatë ka një kohë nën qiell” (Pre. 3:1).

“Ai e ka bërë çdo gjë të bukur në kohën e vet” (Pre. 3:11).

Nëse dështojmë në ngritjen e kësaj ane të Kutisë, fëmijët tanë do të jetojnë në një gjendje të vazhduar kaosi dhe çrregullimi. Ata do të jenë të stresuar dhe të keqpajisur për të funksionuar në mënyrën e duhur.

Duke theksuar thjeshtësinë dhe minimalizmin, fjala e urtë nga koha e prindërve tanë tingëllon më e vërtetë se kurrë: “Një vend për gjithçka dhe gjithçka në vendin e vet”.

Ne jemi të bindur se i parëlinduri ynë mund të ishte etiketuar si fëmijë me mungesë përqendrimi dhe çrregullime hiperaktive (ADHD) nëse nuk do ta kishim kuptuar nevojën e tij për rregull që në moshë të hershme. Që ai të shtrihej të flinte kur ishte i vogël, ose të ulej për të studiuar kur ishte më i rritur, duhet të siguroheshim që hapësira përreth tij të ishte e rregullt. Rrëmuja dhe kaosi e bënin hiperaktiv dhe të vështirë për t'u zbutur.

Disa fëmijë kanë nevojë për këtë lloj rregulli më shumë se disa të tjerë. Ka fëmijë që përparojnë në rutinë, edhe pse mund të jenë të hallakatur dhe të shpërqendruar. Fëmijët që janë krijues dhe ekstremisht

të ndjeshëm ndaj mjedisit që i rrethon shpesh kanë nevojë për ndjesinë e një hapësire të bollshme dhe pa pengesa në mënyrë që të japin më të mirën.

Kur udhëzohen me parametra të qartë, të gjithë fëmijët i përgjigjen rregullit me një ndjenjë kënaqësie. Ushqimi i shëndetshëm bën që trupi të funksionojë mirë, duke parandaluar efektet e dokumentuara të nivelit të lartë të sheqerit ose ushqimit të përpunuar. Një rutinë e mirë gjumi e lejon trurin të pushojë e të qetësohet pavarësisht sikletit apo shqetësimeve që vijnë si pasojë e lodhjes së tepërt.

Ne zbuluam që fëmijët tanë rezistonin të shtriheshin për gjumë po të mos i mbanim në një rutinë pushimi. Kështu, mbrëmjet tona ishin kohë me zë të ulët, muzikë të qetë dhe histori të bukura. Rregulli mund ta mposhtë frikën që ndonjëherë rritet në sipërfaqen e zemrës së fëmijës teksa largohet nga kontrolli. Rutinat që përfshijnë banjo të ngrohta dhe batanije të buta krijojnë ndjenja sigurie, duke e ftuar fëmijën e frikësuar që të pushojë. Një rutinë kaq e thjeshtë bën të mundur që fëmijët të na besojnë, të varen tek ne - dhe t'i besojnë Atit që na mban të gjithëve të sigurtë nën kujdesin e tij.

Fëmijët përparojnë duke patur një strukturë elastike që skicon ditët e tyre. Djali ynë i vogël zgjohej çdo mëngjes me dy pyetje të njëjta:

1. Ku janë të tjerët? (Ai është padyshim ekstroverti ynë!)
2. Çfarë do të bëjmë sot?

Dija se ku ishin të gjithë të tjerët dhe një orar i përcaktuar që në mëngjes e shtynin atë të ngrihej i gëzuar dhe të bënte gjërat që duheshin bërë.

Fëmijët tuaj duhet të dinë çfarë të presin që të mos ju pyesin vazhdimisht. Duke qenë elastikë dhe të qëndrueshëm ndërsa krijoni një botë të sigurt dhe të rregullt, ju i përgatitni fëmijët tuaj për sukses.

Por mos harroni pjesën e sipërme të Kutisë sepse është shumë, shumë e rëndësishme.

PJESA E SIPËRME E KUTISË ËSHTË AFEKSIONI (DASHURIA), AFIRMIMI DHE ARGËTIMI!

Fëmijët tanë duhet ta dinë deri në palcë se ne i duam, se janë gjithë bota për ne, dhe se jemi shumë të lumtur që janë tanët - qofshin tre, trembëdhjetë ose tridhjetë e tre vjeç.

Pastori dhe autori Dave Stone, i cili i kushton një libër të tërë nevojës shpesh të anashkaluar për argëtim dhe hare në familjet tona, këshillon: “E qeshura dhe gëzimi nuk duhet të jenë mysafirë në shtëpinë tuaj; ata duhet të jenë banorë të përhershëm në jetën tonë të përditshme”³

Po!

Me gjithë shpresën dhe lirinë që Jezusi sjell në jetët tona, shtëpitë tona duhet të shpërthejnë nga gëzimi! Fjalët e afirmimit dhe demonstrimet e dashurisë të kombinuara me argëtim sjellin të qeshura dhe gëzim drejt e në zemrën e familjeve tona.

Kjo është Kutia.

Ky është çelësi: Kur t’ju duhet t’ia ngushtoni Kutinë fëmijës tuaj pasi nuk sillet siç duhet, futet në telashe, ose shkakton zënka dhe pështjellim, mos iu vërsulni direkt me disiplinë. Duhet t’i përdorni të katërta anët e Kutisë së bashku - Jezusin, disiplinën, rregullin, dhe pastaj afeksionin, afirmimin dhe argëtimin që ta riktheni fëmijën tuaj në një vend qetësie, një vend gëzimi dhe sigurie. Kur i ngushtoni të katërta anët e Kutisë njëkohësisht, fëmija juaj përparon. Në vend që të acarohet dhe zemërohet, ai rrezaton gëzimin e një fëmije të rrethuar me dashuri. Fëmijët e keqedukuar nuk janë të lumtur! Thjesht mbani mend: Ngushtoni çdo anë të Kutisë *njëkohësisht*. Ky është ndryshimi mes disiplinës së rëndë dhe trajnimit biblik me dashuri.

PHIL:

Ne e testuam konceptin e Kutisë një ditë kur po kujdeseshim për nipërit tanë që janë në moshë shkollore. Ata po qëndronin me ne për një javë ndërkohë që djali ynë dhe gruaja e tij ishin në Angli. Në atë kohë, ne jetonim tek shtëpia e një miku, pasi po rimodelonim ambientin tonë. Distanca e përditshme nga shtëpia në shkollë ishte shumë e gjatë, dhe fundjava na gjente shumë të lodhur. Kur ktheheshim në shtëpi pas takimit të kishës të dielën në mbrëmje, ishim të gjithë të rrsakapitur - dhe kjo reflektohej! Atë ditë, fëmijët filluan të grindeshin në sediljet e pasme, duke tallur njëri-tjetrin me ato sarkazmat e zakonshme që përdoren në shkollë. Në atë çast Diane dhe unë pamë njëri-tjetrin dhe e kuptuam: Oh, duhet të bëjmë diçka!

U ktheva nga fëmijët dhe u thashë: “Hej fëmijë, kjo duhet të marrë fund. Nuk duhet t’i flasim kështu njëri-tjetrit”. Thjesht një korigjim i lehtë për t’u dhënë të kuptojnë se çfarë prisnim. Kjo ishte ana e disiplinës tek Kutia.

Babai i tyre na kontaktoi atë mëngjes për të pyetur si ishim dhe po më tregonte për një drejtues të ri adhurimi dhe shumë interesant, i cili kishte kënduar një këngë që e mbante mend nga koha kur unë ia këndoja atij sa ishte i vogël: “Emrin Tënd lavdëroj”. Kjo më bëri të ndjeja se ndoshta isha ende paksa në modë! Ose të paktën nuk isha krejt i dalë mode!

Kështu që u tregova fëmijëve për telefonatën dhe më pas u thashë: “A doni që ta dëgjoni këngën?”

Asnjë përgjigje.

Gjithsesi e këndova!

Prapë asnjë përgjigje.

“Hej, a doni ta dëgjoni këngën e parë që babi juaj shkroi kur ishte dhjetë vjeç?”

U dukën disi të interesuar, por pa asnjë shenjë entuziazmi - kishte qenë vërtetë një javë shumë e gjatë dhe trafiku nuk po lëvizte pothuajse fare në autostradë.

Kështu që e këndova.

Gradualisht atmosfera në makinë filloi të ndryshonte; shumë më pak armiqësi dhe rrëfimi i një historie. U kërkova ta këndonin me mua dhe ashtu bënë!

Një këngë për Jezusin, duke e sjellë Atë aty - ishte baza e Kutisë. Pasi kënduam disa herë së bashku, ata filluan të buzëqeshnin dhe të bashkoheshin me entuziazëm – dhe ja ku ishin afeksioni, pranimi, dhe argëtimi në krye të Kutisë!

Sapo arritëm në shtëpi, Diane u tha fëmijëve të vishnin pizhamet, ndërkohë që ajo do gatuate “quesadillas” (ushqim meksikan). Ata marshuan me bindje dhe bënë me gëzim çfarë iu kërkua. Në fund të darkës, ndiheshin të ngopur me ushqim të mirë, ishin argëtuar dhe ishin sjellë mirë me njëri-tjetrin; gjithë grindjet u harruan. Këta janë fëmijë fantastikë që kanë nevojë për vëmendje në fund të fundit.

Diane dhe unë u kthyem nga njëri-tjetri duke buzëqeshur dhe thamë: “Sapo bëme Kutinë! Funkسیون!”

Përdorimi i Kutisë bëri të mundur që ta shndërronim atmosferën plot tension dhe ankesa në atmosferë argëtuese dhe miqësore - dhe e bëme këtë me një disiplinë minimale, gjë që na lumturoi të gjithëve.

Ngushtojeni Kutinë kur fëmija juaj ka nevojë për ndihmë dhe ju do të shikoni që mënyra se si Ati na disiplinon është rruga që na çon në liri dhe gëzim.

Ne do të flasim më shumë rreth Kutisë përgjatë librit në mënyrë që t’ju ndihmojmë t’a përdorni atë në çdo fazë të rritjes dhe zhvillimit të fëmijës tuaj. E kemi parë këtë strategji të funksionojë mirë veçanërisht gjatë viteve të adoleshencës, kur shumica e prindërve e humbin fillin dhe nuk dinë çfarë të bëjnë. Shumë prindër e konsiderojnë konceptin e Kutisë si një alternativë të mrekullueshme ndaj tensionit që krijohet kur mbështetemi vetëm në disiplinën negative.

Afeksion, Afirmim dhe Argëtim



JEZUS

Formimi i Karakterit

Përgjatë këtyre viteve strukturimi, ndërsa punoni drejt synimit për të krijuar një zemër të urtë në çdonjërin prej fëmijëve tuaj, ekzistojnë tre aspekte kryesore që gjenden pikërisht në Shkrim, në të cilat duhet të përqendrohemi. Në Ungjillin sipas Lukës, Perëndia thotë kështu për Jezusin kur Ai ishte dymbëdhjetë vjeç:

“Dhe Jezusi rritej në urtësi, në shtat dhe në hir përpara Perëndisë dhe njerëzve” (Luka 2:52).

Teksa fëmija juaj vijon të zhvillohet fizikisht (në shtat),¹ ju do të doni që në mënyrë të qëllimshme të fokusoheni në tri fushat në të cilat vetë Jezusi vazhdonte të rritej:

1. Zhvillimi i karakterit (rritej në urtësi)
2. Ndërtimi i marrëdhënieve (në hir përpara njerëzve)
3. Trajnimi shpirtëror (në hir përpara Perëndisë)

Fillimisht le të shohim zhvillimin e karakterit.

Kur rrëfimi biblik thotë se Jezusi “rritej në urtësi”, përse e quajmë “zhvillim karakteri”?

Fjala e përkthyer *urtësi* në greqishten e vjetër është *sophia*. Do të thotë: “aftësi në çështjet e jetës, duke përfshirë logjikën e mirë dhe gjykimin e shëndoshë”.

Se si Jezusi, i cili ishte plotësisht njeri dhe plotësisht Perëndi, ishte i aftë të rritej në këto aspekte të jetës është një mister teologjik i pashpjegueshëm, por megjithatë Bibla thotë se Ai po rritej! Nëse vetë Jezusi u rrit në urtësi, e duke u aftësuar për çështjet e jetës së përditshme, sa më shumë duhet që edhe ne të bëjmë të njëjtën gjë, përkrah fëmijëve tanë!

Ndërsa synoni të kultivoni një karakter si ai i Krishtit në fëmijën tuaj, duke e ndihmuar atë të rritet në urtësi siç u rrit Jezusi, janë katër aspekte “madhore” ku duhet të fokusoheni.

MËSOJINI TA KOMANDOJNË VAZHDIMISHT SHPIRTIN E TYRE

Fjalët e Urta 16:32 deklarohen: “Ai që nuk zemërohet shpejt vlen më tepër se një luftëtar i fortë, dhe ai që *e komandon shpirtin e tij* vlen më tepër se ai që mposht një qytet”.

E kundërta e të qenit “i ngadaltë në zemërim” është të jesh gjaknxehtë dhe i paduruar. Një burrë ose grua gjaknxehtë ka mungesë vetëkontrolli për t’u përgjigjur urtësisht nën stres ose për t’u përgjigjur me qetësi në biseda të tensionuara. Në vend që të dinë si ta “komandojnë shpirtin e tyre”, ata thjesht “zbrazin gjithçka”, duke nxjerrë çfarëdolloj gjëje që ndiejnë në atë çast.

Njerëzve Gjaknxehtë u Mungon Vetëkontrolli.

Duke e mësuar dhe edukuar vazhdimisht fëmijën tuaj se si të kontrollojë veten kur është i zemëruar, ju po e përgatitni atë për sukses. Nga ana tjetër, nëse i shihni shpërthimet e tij dhe nuk bëni asgjë, kjo do t’i shkaktojë atij një pafundësi problemesh. Ai mund të pushohet nga puna një ditë, mund të shkaktojë probleme në martesë, e po ashtu edhe në prindërimin e tij.

Njerëzit do të duan ta shmangin djalin ose vajzën tuaj nëse temperamentit i tij/ saj i paduruar ndikon në marrëdhëniet e tyre. Fjalët e Urta 22:24 thotë: “Mos lidh miqësi me njeriun zemërak dhe mos u shoqëro me njeriun idhnak”.

Prindër, tregohuni të kujdesshëm! Ju nuk doni që djali apo vajza juaj të jetë personi me të cilin prindërit e tjerë nuk duan që fëmijët e tyre të shoqërohen! Bibla na mëson se kjo mungesë karakteri mund të vihet nën kontroll nëpërmjet një trajnimi të kujdesshëm. Sidoqoftë, përpara se ta filloni atë trajnim, duhet t’i bëni vetes disa pyetje:

A je një mami ose babi që shpërthen në zemërim?

A po mësoni t'i kontrolloni shpërthimet tuaja emocionale?

Ekzistojnë dy lloje kryesore të zemërimit mëkatar: zemërimi shpërthyes dhe zemërimi që zien përbrenda. Të dy janë njëlloj të dëmshëm. A është zemërimi një fushë në jetën tuaj që ka nevojë për pendesë dhe të sillet përditë tek Jezusi për shpengim? Nëse po, mësimi si të komandoni shpirtin tuaj do të bëhet çështje familjare!

Ne zbuluam se duke mësuar përmendsh së bashku Efesianëve 4:25-32 dhe duke u fokusuar në vargun 29 funksionoi për mrekulli në fashitjen e shpërthimeve të zemërimit në shtëpinë tonë, qoftë tek ne apo tek fëmijët tanë!

Vargu thotë: “Asnjë fjalë e keqe le të mos dalë nga goja juaj, por ajo që është e mirë për ndërtimin, sipas nevojës, që t`u japë hir atyre që dëgjojnë”.

Ne e citonim vazhdimisht në shtëpinë tonë këtë varg të mbushur me urtësi! Dhe pastaj ne shpesh shtonim vargjet 31 dhe 32 që të punonim me fëmijët tanë në ato çastet e nxehta mes vëllezërish e motrash:

“Le të flaket larg jush çdo hidhërim, zemërim, inat, trazirë dhe shpifje me çdo ligësi. Por jini të mirë dhe të mëshirshëm njëri me tjetrin, duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin”.

Dy vargjet pasuese e shpjegojnë më shumë pse-në:

“Bëhuni, pra, imitues të Perëndisë, si bij shumë të dashur, edhe ecni në dashuri, sikurse edhe Krishti na deshi dhe e dha veten e tij për ne, si ofertë e flijim ndaj Perëndisë, si një parfum erëmirë” (Efe. 5:1-2).

Mami dhe babi, është detyra juaj t'i ndihmoni fëmijët si të zgjidhin konfliktet në një mënyrë që nderon Perëndinë. Nëse u lihet atyre, më i forti do të fitojë çdo herë!

Mësojuni fëmijëve tuaj se:

- Askush nuk ka fuqi t'ju zemërojë.
- Sharja në zemërim është zgjedhje - diçka që mund të zgjedhim të mos e bëjmë.

Po, mund të ndodhin gjëra që do t'ju zemërojnë, njerëzit do

të jenë të pasjellshëm dhe të ligj, mësuesit ndonjëherë do të duken të padrejtë, dhe gjërat nuk do të përfundojnë aq shpejt ose aq mirë sa ju mendoni se duhet të përfundojnë. Por kjo nuk i jep askujt të drejtën ose justifikimin përpara Perëndisë që të reagojë me shfaqje fizike ose verbale të zemërimit të pakontrolluar. Zemërimi mëkatar nuk është kurrë mënyra e Perëndisë.

Ne donim që fëmijët tanë të kuptonin të vërtetën se përgjigja e tyre është përgjegjësia e tyre.²

Nuk mund ta nënvlerësojmë rëndësinë e mësimit të kësaj të vërtete fëmijëve tuaj përpara se ata të kapërdijnë gënjeshtren e dyanshme:

- Është faji yt që jam i zemëruar.
 - Kjo është çfarë abuzuesit besojnë në zbatimin më ekstrem të kësaj gënjeshtre!
- Është faji im kur dikush është i zemëruar me mua.
 - Kjo është çfarë viktimat e abuzuesve besojnë, që shpesh i mban të lidhur ndaj abuzuesve të tyre!

Ekziston edhe diçka e tillë si zemërimi i drejtë, që zakonisht nuk na fut në telashe. Zemërimi vërtet i drejtë përmbush gjëra të mira, duke manifestuar fuqishëm rrugët e Perëndisë, si atëherë kur Jezusi ktheu përmbys tavolinat e tregtarëve në oborrin e tempullit.³ Ne e përjetojmë këtë lloj zemërimi kur shohim padrejtësi, si p.sh., fëmijë të vegjël që trafikohen ose abuzohen. Në Psalmin 97:10 na thuhet: “urreni ligësinë, ju që doni Perëndinë” dhe Efesianët 4:26 thotë: “Zemërohuni dhe mos mëkatoni!”

Perëndia zemërohet me mëkatin! Me Perëndinë, shpirtërat tanë kërkojnë drejtësi me një zemërim të zjarrtë dhe imponues - lloji i zemërimit që na drejton të reagojmë ndaj padrejtësive. Nga ana tjetër, zemërimi i mëkatshëm, është kur ne duam të lëndojmë të tjerët, kur padurimi ose egoizmi ynë kacafyten për kontroll.

Atëherë, çfarë mund të bëni me djalin ose vajzën tuaj që shfaq shpërthime zemërimi apo flet në mënyrë të pahijshme? A ka ndonjë mënyrë të sigurt për ta hequr zemërimin nga përgjigjet e para të fëmijës

tuaj? Ndonjë plan të thjeshtë dhe që ka efekt në mënyrë universale për të eliminuar zemërimin?

Fatkeqësisht, emocionet e forta nuk mund të kurohen lehtësisht me një plan të thjeshtë trehapësh që garanton të sjellë sukses. Ja pse ne e marrim seriozisht Jakobin 1:5:

“Por në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtia, le të kërkojë nga Perëndia, që u jep të gjithëve pa kursim, pa qortuar, dhe atij do t’i jepet”.

Kërkojini Perëndisë urtësinë e Tij lidhur me zemërimin e fëmijës tuaj. Cila është rrënja e atij zemërimi? Pse e godet vëllain e tij të vogël? Çfarë lidhet me shpërthimet zemërake të vajzës tuaj?

“Theksimi i Biblës në origjinën e brendshme të zemërimit, sugjeron se ndihma që mund t’u jepet fëmijëve që kanë problem me zemërimin përfshin më shumë sesa thjesht teknika për administrimin e zemërimit. Për të zgjidhur problemin e zemërimit të fëmijës tuaj, ju duhet të shënjestroni burimin e zemërimit: zemrën e tij”.⁴

TRE SHKAQE RRËNJËSORE TË ZEMËRIMIT

Kemi parë që zemërimi, mund të gjurmohet zakonisht në tre shkaqe rrënjësore.

Kontrolli

Duket sikur disa njerëz kanë lindur me një nevojë të jashtëzakonshme për të kontrolluar gjithkënd dhe gjithçka përreth tyre. Ndonjëherë këta fëmijë janë të zhurmshëm dhe të padurueshëm - zakonisht djemtë, por jo gjithmonë. Shpeshherë vajzat e vogla, por edhe ato jo aq të vogla, mund të bëhen manipuluese dhe shumë zemërake kur dikush nuk i nënshtrohet kontrollit të tyre - përfshirë edhe ju!

Lajmi i mirë është ky: Nëse e kapni herët këtë gjë në zhvillimin e tyre, dhe nuk e anashkaloni duke mos u kujdesur për të, mund të jetë e thjeshtë të rregullohet (megjithëse ka vështirësinë e vet).

Në vend që të reagoni në zemërim ose të dorëzoheni përpara zemërimit të fëmijës tuaj, kërkoni pak në atë rutinë e mjeteve disiplinuese nga Pjesa 2 për të vendosur se cili është mjeti i përshtatshëm për këtë situatë. I mbani mend ato mjetet biblike? *Korrigjimi, qortimi, inkurajimi, mësimi me durim, thupra e disiplinës*. Duke kuptuar fëmijën tuaj dhe

arsyen e zemërimit të tij, ju mund të zgjidhni cilindo mjet që do të prekë më efektivisht zemrën e tij. Flisni së bashku me bashkëshortin/en tuaj për mënyra specifike që do të përdorni për t'u marrë vazhdimisht me zemërimin e këtij fëmije.

Mami dhe babi, sigurohuni, që jeni të mbushur me dhe nën kontrollin e Frymës së Shenjtë kur të ndërmerri hapa për të korrigjuar çështjet e zemërimit të fëmijës tuaj. Mbani mend Jakobin 1:20: “sepse zemërimi i njeriut nuk kryen drejtësinë e Perëndisë”. Nëse i përgjigjeni zemërimit të tyre me zemërimin tuaj mëkatar, kjo nuk do të sjellë përfundimin e dëshiruar që kënaq Perëndinë. Përkundrazi, zemërimi juaj mund t'i përforcojë fëmijës bindjen se zemërimi mëkatar funksionon! Dhe, po, zemërimi është një mjet për të kontrolluar njerëzit, por nuk është mënyra e Perëndisë!

Andrew Murray doli në përfundimin se sekreti i madh i një shtëpie të paqetë është që si prindër “të jemi ne vetë së pari ata që duam që fëmijët tanë të jenë”. Në fund të fundit, ka të bëjë me modelimin, apo jo? Kështu që mos u mërzitni me fëmijën tuaj; përkundrazi, mësojeni dhe trajnojeni atë që të jetë i urtë dhe me vetëkontroll - të jetë i fuqishëm frymërisht.

Acarimet

Disa fëmijë (dhe shumë të rritur) duket se kanë një fitil që merr flakë shpejt kur bëhet fjalë për pengesa në rrugën e tyre. Ky është ai model fëmije që i flak gjërat kur ato nuk dalin ashtu siç ai i donte ose shpërthen në lot zemërimi kur limitet e veta e pengojnë për të bërë atë që do.

Fëmija juaj nuk ka probleme. Ai ka zemërim.

Po, ekzistojnë probleme si: disleksia, reaksione shqisore ndaj rrobave të parehatshme, etj., por ato janë thjesht nxitës të zemërimit të papërshtatshëm, jo shkak. Fëmija me ndihmën tuaj, mund të mësojë të kontrollojë përgjigjet e tij dhe të jetë i duruar me veten dhe me të tjerët.

Pra, çfarë mund të bëni ju për të ndihmuar fëmijën tuaj të acaruar?

Zgjidhja është kaq e thjeshtë dhe e paraqitur mjaft qartë në Shkrim: ngadalësoni ritmin e jetës tuaj!

Fëmija juaj mund të ketë shumë lodra, shumë njerëz që tërheqin vëmendjen e tij, shumë stimule, por jo kohë të mjaftueshme për të ecur në ritmin e tij.

PHIL:

Kur vajza jonë Rebeka ishte në këtë fazë strukturimi në jetën e saj, ne vumë re, krejt papritur, se ajo po fillonte të belbëzonte. Ajo mundohej t'i nxirrte fjalët, por irritohej aq shumë saqë s'arrinte ta thoshte një fjali të tërë pa iu marrë goja dhe pa qarë. Na trembi!

Isha rritur me një shok të cilit belbëzimi i ishte bërë zakon dhe e kufizonte shumë deri kur hyri në universitet. Ai kishte një zemër prej ari dhe mund të këndonte shumë bukur, pa asnjë hezitim, por biseda ishte pothuajse e pamundur. Të gjithë ata që e njihnin Fredin e donin dhe na dhembnin zemrat kur ai vuante t'i nxirrte fjalët nga goja. Kështu që, kur Rebeka filloi të belbëzonte, kisha shumë frikë për të ardhmen e saj.

Pas shqetësimit, vendosëm të luteshim për të! A nuk sillemi shpesh në këtë mënyrë? Kur u lutëm, Perëndia na foli të dyve, duke na zbuluar se belbëzimi i vajzës sonë të vogël ishte për fajin tonë.

Jeta dhe shërbesa jonë ishin bërë të furishme. Unë isha drejtues adhurimi në një kishë që po rritej me gjashtë takime çdo të dielë, dhe shpesh isha jashtë pesë net të javës. Diane dhe unë po e jetonim jetën me një ritëm të vrullshëm dhe Rebekës i dukej sikur duhet të nxitonte të nxirrte fjalët, përndryshe nuk do të dëgjohej dot.

Perëndia më zbuloi që duhet të ngadalësonim përmes Shkrimit, gjatë kohës time të leximit të rregullt të Biblës! Po lexoja tek Zanafilla dhe u ndesha me historinë e ribashkimit të Jakobit dhe Esaut. Pas disa vitesh në marrëdhënie të ftohta me njëri-tjetrin, Jakobi ishte shumë i frikësuar se mos i vëllai do ta realizonte kërcënimin për ta vrarë. Por përkundrazi, Esau e fali, dhe ata u pajtuan,

“Pastaj Esau tha: ‘Le të nisemi, të fillojmë të ecim dhe unë do të shkoj para teje.’ Por Jakobi u përgjigj: ‘Zotëria im e di që fëmijët janë në moshë të vogël ... Le të kalojë zotëria im para shërbëtorit

të tij, dhe unë do të lëviz më ngadalë me hapin e kafshëve që më paraprijnë dhe me hapin e fëmijëve, derisa të arrij te zotëria im në Seir” (Zan. 33:12-14).

Do të lëviz më ngadalë me hapin e fëmijëve. Perëndia më tregoi se çfarë duhet të bënim, pikërisht në atë çast dhe në atë vend.

Duhet të ngadalësonim.

Kështu bëmë. Uleshim përtokë kur Rebeka na fliste, duke i dhënë hapësirë që të shprehte mendimet e saj. U përpoqëm që ta bënim të ndihej sikur ne kishim gjithë kohën e botës për ta dëgjuar. Brenda një jave, belbëzimi i saj ndaloi.

Herën e parë që e ndamë këtë histori në konferencën tonë të prindërimit, në fund një grua erdhi tek ne dhe u prezantua. Pasi na dha emrin, ajo tha: “Unë jam pediatre patologe për të folurit, dhe thjesht doja që të dini se kur prindërit vijnë të alarmuar se fëmija i tyre ka filluar të belbëzojë, kjo është gjëja e parë që ne u themi të bëjnë: “*Ngadalësoni!*”

Atëherë kuptuam se disa herë zemërimi i fëmijëve tanë, irritimi, ose belbëzimi ishte për fajin tonë. Ne ende po përpiqeshim të ecim me hapat që bënim përpara se të kishim fëmijë, duke i tërhequr edhe ata pas vetes, duke nxituar kur duhet të ngadalësonim. Ngadalësimi nuk ishte aspak i thjeshtë. (Ende nuk është!) Por me kalimin e kohës ne përvetësuam një ritëm më të ngadaltë të jetës dhe teksa e bëmë këtë, pamë që Rebeka filloi të çlirohej.

Jini të kujdesshëm, mama dhe baballarë, që të mos harroni të jetoni me një ritëm që funksionon mirë për fëmijët tuaj. Thjeshtoni çdo fushë të jetës tuaj në mënyrë që të krijoni një mjedis shtëpiak të thjeshtë dhe qetësues. Fëmijët tuaj do të përgjigjen menjëherë, duke rritur aftësinë e tyre për të jetuar jetën paqësisht.

Dhe mbani shënim këtë të vërtetë të fuqishme: Pasazhi i Shkrimit që Perëndia përdori për të na folur për këtë situatë serioze nuk kishte të bënte fare me belbëzimin ose shpërthimet e zemërimit. Megjithatë, Perëndia e përdori atë për t'i folur Phil, për të na çuar në një zgjidhje të mundshme për problemin tonë. E kemi parë këtë herë pas

here. Perëndia na ka dhënë urtësi drejtpërdrejt nga Shkrimi *kur ia kemi kërkuar*. E tillë është fuqia që kanë në dispozicion të gjithë ata që ndjekin Jezusin.

Kokëfortësia

Deri më tani shkaku më i përhapur i shpërthimeve të zemërimit tek një fëmijë është kokëfortësia: *E dua sipas mënyrës time dhe e dua tani!*

Kjo është arsyeja përse ndodhin shumica e krizave emocionale. Për këtë arsye ndodhnin të gjitha shpërthimet e zemërimit tek Matthew!

Ne zgjodhëm që të përdornim vazhdimisht thuprën e disiplinës - një thupër e lehtë në të ndenjura, e kujdesshme dhe e kontrolluar, që nderon Perëndinë - për të trajnuar fëmijët tanë që të kontrollojnë kokëfortësinë e tyre. Heqja e privilegjeve apo dërgimi i tyre në dhomë, shumë rrallë bënin atë që ishte e nevojshme për të zbutur zemrat e fëmijëve tanë ose t'i aftësonin ata për të dorëzuar vullnetin e tyre të fortë. Megjithëse disa fëmijë sigurisht që mund të përgjigjen me një mjet discipline më pak autoritar, tanët nuk e bënin. Ne vendosëm që një shpërthim zemërimi me kokëfortësi ishte i papranueshëm në shtëpinë tonë.

Do t'ju duhet të vendosni së bashku se cilin mjet do të përdorni për t'i mësuar fëmijës tuaj që shpërthimet e zemërimit nuk do të tolerohen. Do t'ju marrë kohë dhe durim, por vetëkontrolli që do të pasojë, do t'ia vlejë.

Trajtimi i frikës

Sidoqoftë, ekziston një ndjenjë që shpesh maskohet si zemërim - *frika*. Edhe fëmija më i mirë në botë mund të bëhet kokëfortë dhe zemërak kur është i mbërthyer nga një frikë e fshehur. Frika është një ndjenjë e fuqishme dhe e paarsyeshme që asnjë masë korrigjimi, qortimi, trajnimi ose disiplinimi nuk mund ta reduktojë. Ju thjesht do ta përshkallëzoni frikën e fëmijës tuaj duke u përpjekur ta bëni të arsyetojë, ose edhe më keq, ta qëlloni për ta imponuar.

Mbesa jonë Scarlet është një nga ato fëmijë që mbërthehet nga frika. Ajo bindet me qejf, ndihmon jashtëzakonisht shumë, dhe ka shumë dëshirë që t'i kënaqë të tjerët - deri në kohën e gjumit. Fakti që ajo do ta humbë kontrollin dhe do të flejë gjumë e çon atë në një spirale frike.

Kur vjen ndonjë natë tek ne, ajo e paramendon çdo hap të procesit:

“Si fillim, unë do të shtrihem në sallon ku mund të të shoh ty. Më pas kur ti të jesh në dush Amma, do të shkoj tek krevati yt. Do të ta ngroh krevatin dhe do mbulohem me batanijen tënde të butë! Kur të mbarosh dushin, mund të përkëdhelemi një çikë. Pastaj do të më zërë gjumi dhe ti mund të më çosh në krevatin tim. Në rregull?”

Nevoja e Scarlet për të kontrolluar procesin e të fjeturit gjumë nuk është mosbindje ose fiksim. Në fakt, në këtë mënyrë ajo mëson të mposhtë frikën e saj duke organizuar mjedisin përreth dhe duke shtyrë veten drejt guximit. Butësia në fytyrën e saj pasi e ka zënë gjumi, na lë të kuptojmë se ajo ka gjetur qetësi, dhe se ndihet e sigurt.

Një fëmijë që ka frikë kërkon durim të madh nga ana e prindit. Nevojitet një nivel urtësie që nuk e keni në veten tuaj - por urtësia e vërtetë vjen nga Perëndia i cili premton t’ju japë nëse ju e kërkonit atë me sinqeritet. Nëse nuk ndiheni të sigurt, dikush tjetër mund të jetë i aftë të dallojë frikën tek fëmija juaj. Kërkojini ndihmë një gjyshi, një gruaje më të moshuar, një pastori apo një këshilluesi. Ju dëshironi të jeni ata që sillni të vërtetat e Frymës në frikën e fëmijës tuaj dhe shpesh është komuniteti përreth jush që ju ndihmon të shihni se si mund ta bëni këtë.

Është e rëndësishme të theksojmë këtu se emocionet në vetvete nuk janë të këqija. Në fakt, një prind i urtë e merr fëmijën dhe e ndihmon të identifikojë atë që po ndjen, në vend që thjesht t’i shtyjë ato ndjenja që e bezdisin. Disa herë shpërthimi emocional i një fëmije është një alarm i kuq që diçka po ndodh brenda tij apo saj. Ftojeni Perëndinë në këtë situatë, duke e lejuar Atë t’ju drejtojë tek lëndimi apo mendimet e gabuara që e kanë çuar fëmijën tuaj në këtë pikë.

Rritja e Udhëheqësve

Disa fëmijë që në fillim janë më të vështirë se të tjerët! Ata janë po aq të çmuar e të dashur, por dhjetë herë më shumë sfidues. Mos u dorëzoni! Do të fitoni shumë thinja në kokën tuaj, por qëndroni fort - ia vlen!

Juve ju është besuar privilegji i trajnimit të një udhëheqësi.

Mendoni pak për udhëheqësit që njihni: politikanë, biznesmenë, udhëheqës lëvizjesh apo kishash. A mund t'i imagjinoni ata si fëmijë të vegjël? Është e dyshimtë që këta drejtues të fortë dhe të prerë të kenë qenë fëmijë të urtë e të bindur! Merrni zemër, jini këmbëngulës dhe insistoni në bindje. Mësojini fëmijët tuaj me vullnet të fortë që ta komandojnë shpirtin e tyre.

DIANE:

Biri ynë Matthew predikoi për të parën herë në Ditën e Nënës disa vite më parë. Si pastor i të rinjve, atij i ishte dhënë mundësia të fliste përpara gjithë kishës atë të diel dhe unë isha në audiencë. Ai më dhuroi një buqetë shumë të bukur lulesh me një buzëqeshje të ëmbël në fytyrë. Gjithçka që mund të mendoja në atë çast ishte se ky ishte djali që në zemërim e sipër e kishte fluturuar atë kamionin lodër nëpër dhomë duke e ngulur në mur!

A mund t'ju japim shpresë që të mbaheni fort dhe t'a vazhdoni këtë punë të vështirë besnikërisht? Aftësojini bijtë dhe bijat tuaj me vullnet të fortë që të arrijnë të zotërojnë vullnetin e tyre, duke i çliruar ata për të qenë udhëheqësit që janë krijuar për të qenë. Një ditë mund të merrni lule!

MËSOJINI SI TË SILLEN ME URTËSI

Fjalët e Urta 20:11 thotë: “Nëpërmjet veprimeve fëmija tregon veten nëse ajo që bën është e pastër dhe e ndershme”.

Shprehja, “tregon veten” do të thotë “zbulon vetveten”. Të gjithë kemi një reputacion, madje edhe fëmijët e vegjël. Një reputacion i mirë është një pasuri e çmuar.

Fjalët e Urta 22:1 thotë: “Një emër i mirë është më i pëlqyeshëm se pasuritë e mëdha, dhe hiri është më i pëlqyeshëm se argjendi dhe ari”.

Ndonjëherë ne mendojmë se ajo që po bën djali ose vajza jonë është diçka e lezetshme dhe e padëmshme, kur në realitet për të tjerët është acaruese.

DIANE:

Kur Matthew ishte tetë vjeç, ne shkonim në një kishë ku kishte shumë djem të rinj e të fortë që drejtonin shërbesën e fëmijëve. Meqë vëllai i madh i Matt, John Mark, ishte një prej këtyre drejtuesve, Matt përpiquej fort që të përfshihej dhe të tërhiqte vëmendjen e tyre.

Siç bëjnë djemtë zakonisht, ai filloi t'i godiste djemtë e tjerë sa herë që i shihte. Bam!

Në fillim nuk mendoja aspak për këtë gjë – nuk ishte ndonjë gjë e madhe, thjesht disi e lezetshme, me ato flokët e tij të shpupuritura dhe atletet e tij që rrëshkitnin. Por më pas, një ditë prej ditësh vura re reagimin e një grupi me tre prej këtyre drejtuesve teksa dalluan Matthew që po afrohej. Ata instinktivisht bënë një hap pas dhe morën pozicione mbrojtëse.

Tani, unë e njihja Matt si një djalosh të vogël e të ëmbël, por reputacioni i tij si një kërcënim i bezdisshëm i paraprinte!

Një pjesë e problemit, në mënyrë të qartë, ishte gjatësia e tyre dhe gjatësia e Matt dhe zona trupore ku godisnin grushtat e tij.

Ajo që mua më dukej diçka e lezetshme, për këta djem ishte e bezdisshme.

Mami dhe babi, është detyra jonë si prindër që të mbrojmë reputacionin e fëmijëve tanë duke parë qëllimisht përtej faktorit të lezetshëm dhe të sigurohemi që sjellja e tij/ saj është e pastër dhe e drejtë.

Ne e marrim këtë rol në vitet e fëmijërisë së hershme, jo sepse kemi frikë se çfarë do të mendojnë të tjerët, por sepse bijtë dhe bijat tona po ndërtojnë reputacionin e tyre. Pa ndërhyrjen tuaj, ata mund të fillojnë të zhvillojnë një imazh negativ për veten për shkak të reagimeve të njerëzve ndaj sjelljes së tyre, në vend që të rritin vetëbesimin që ju po përpiqeni ta rrënjosni brenda tyre.

Detyra juaj është t'i ndihmoni fëmijët të mësojnë të sillen me urtësi sepse “budallallëku lidhet me zemrën e fëmijës”.⁵ Fëmijët nuk lindin me gjykim të mirë; ata duhet të mësohen urtësisht dhe qëllimisht.

MËSOJINI SI TË ECIN NË INTEGRITET

PHIL:

Kur John Mark ishte tetë vjeç, ai filloi të shfaqte interes për modele trenash. Ai kishte shumë dëshirë të shkonte në dyqanin e trenave afër zonës tonë të banimit me plane të qarta se çfarë trenash duhet të kishte për të kompletuar koleksionin e tij. Por, koleksionimi i trenave ishte një hobi i shtrenjtë, dhe kuota e tij javore nuk i mbulonte këto shpenzime, kështu që bashkë me shpërndarjen e gazetave,⁶ ai filloi të mblidhte kanaçe pijesh që të fitonte më tepër para. Pikërisht afër një dyqani lodrash ishte një makineri riciklimi ku ai çonte qesen e tij të kanaçeve dhe i këmbente në para. Makineria i nxirrte paratë pasi futeshin kanaçet ose shishet boshe aty brenda.

Atë ditë, në vend që makineria të nxirrte dy dollarë, aq sa e kishte vlerën qesja me kanaçe, i nxori atij njëzet e dy dollarë – një kartmonedhë njëzetshe e re fare ishte ngjitur tek njëra nga kartmonedhat një-dollarëshe! Sytë e John Mark shkëlqyen! Por më pas, kur e kuptoi çfarë kishte ndodhur, ai u kthye nga unë dhe më pyeti:

“Babi, çfarë do bëjmë me këto paratë shtesë?”

Lu përgjigja pyetjes së tij me një pyetje tjetër: “Çfarë mendon se duhet të bëjmë bir?”

U mendua për pak sekonda, dhe më pas tha: “Mendoj se duhet të shkojmë brenda në dyqan dhe t'i kthejmë”. Pamja në fytyrën e tij ishte një përzierje e bindjes dhe zhgënjimit. Gjithë sa më erdhi në mend t'i thoja ishte:

“Perëndia do të të bekojë për sinqeritetin tënd, John Mark”.

Prapë, ai u fut në dyqan duke ecur me hapa të rëndë e me supet e rëna të një tetëvjeçari i cili duhet të hiqte dorë nga një pasuri e vogël.

Përgjegjësi i dyqanit nuk kishte asnjë mundësi që të lidhej me kompaninë që kishte hapur vendin për atë makineri, kështu që i

tha t'a mbante!

Djali im i vogël më pa me sy të mrekulluar.

Unë? Unë u bëra profet! E dija që Perëndia do t'a bekonte atë edhe nëse nuk do t'i mbante ato para.

Gjëja më e mirë ishte se, John Mark mund t'i mbante paratë me një ndërgjegje të pastër, pasi ai refuzoi që të merrte diçka që nuk i përkiste atij. Ai kishte treguar integritet. Ndërkohë që unë i thashë se Perëndia do ta bekonte atë shpirtërisht, Perëndia kishte vendosur që t'i jepte një mësim dhe ta bekonte edhe financiarisht.

Si e dija unë se si ta ndihmoja tim bir të bënte atë gjë? Sepse mbaja mend që kisha parë tim atë njëherë kur gjeti një kartmonedhë njëzetdollarëshe në dyshemenë e një dyqani kur unë isha i vogël. Dhe më kujtohet që shkova me të tek zyra e përgjegjësit për ta kthyer.

Nuk mbaj mend të më ketë thënë: "Bir, do të të jap një mësim rreth integritetit!" Ai ma mësoi integritetin me shembullin e tij - mjetin më të rëndësishëm të mësimin.

Fjalët e Urta 20:7 thotë: "Një njeri i drejtë ecën në ndershmërinë e tij; sa të bekuar do të jenë bijtë e tij". Im atë ishte një njeri me integritet dhe unë u bekova për shkak të tij. Tani unë isha në gjendje që ta kaloja atë bekim tek im bir.

Fjala hebraisht e përkthyer si *integritet* është *tom (/tome/)*. Ka të bëjë me atë që ne jemi si person dhe me atë që do të bëjmë ose nuk do të bëjmë.⁷

Integriteti thotë: "Do të bëj gjënë e drejtë, pavarësisht se sa do të më kushtojë." Është një cilësi karakteri që duhet modeluar në jetën tuaj, e më pas në mënyrë të qëllimshme t'ua mësoni fëmijëve tuaj.

Në Psalmin 101:2-3, Davidi thotë: "Do të ec me zemër të pastër brenda shtëpisë sime. Nuk do të vë para syve të mi asgjë të keqe".

Mami, babi, a jeni ju një person me integritet? Nëse po ecni pranë me Perëndinë, fëmijët do ta shohin integritetin tuaj dhe do ta kopjojnë atë. Mos e lejoni kurrë veten që të rrëshkisni nga ndershmëria. Jobi tha: "deri në regëtimat e fundit nuk do të heq dorë nga (integriteti) ndershmëria ime" (Jobi 27:5).

MËSOJINI TË PUNOJNË ME GJITHË ZEMËR

Tek Ungjilli sipas Gjonit, Jezusi i tha Atit të Tij: “Unë të kam përlëvduar mbi tokë; e kam kryer veprën që më ke dhënë të bëj” (Gjo. 17:4).

Një nga privilegjet që ju keni si prindër është t’u mësoni fëmijëve tuaj të vërtetën e mrekullueshme se Perëndia në fakt ka përgatitur “vepra të mira” që ata t’i realizojnë (Efe. 2:10). Ashtu siç Jezusi kishte detyra specifike për të përmbushur ndërkohë që jetoi në tokë, kështu edhe biri ose bija juaj kanë punë të rëndësishme për të bërë.

Për ta fiksuar këtë të vërtetë tek fëmijët tuaj, mësojuni atyre vargje si Kolosianët 3:23-24:

“Dhe çdo gjë që të bëni, bëjeni me gjithë zemër, si për Zotin dhe jo për njerëzit, duke ditur se nga Zoti do të merrni shpërblimin e trashëgimisë, sepse ju i shërbeni Krishtit, Zotit”. 8

Shprehja “bëjeni me gjithë zemër” mund të përkthehet gjithashtu “punoni me zemër”. Do të thotë t’i futeni plotësisht asaj pune, të jepni më të mirën tuaj. Ashtu si me gjithçka tjetër në jetë, ju do të duhet ta modeloni këtë etikë pune dhe më pas t’ua mësoni me durim fëmijëve tuaj se si ngjan një punë e bërë mirë.

PHIL:

Babai im na thoshte shpesh mua dhe dy vëllezërve të mi: “Puna e rëndë nuk ka varrë njeri”. E urrenim kur na e thoshte këtë gjë! Por e mësuam rëndësinë e punës së palodhur kur shikonim dhe dëgjonim vlerën e babait tonë që vazhdimisht jepte më të mirën në punën e tij, pavarësisht se çfarë ishte.

Si pasojë, të tre ne e kemi kaluar të njëjtin theks mbi vlerën e të punuarit me zemër tek fëmijët tanë. Për vite me radhë, vëllezërit e mi dhe unë shpërndanim gazetën “San Jose Mercury” herët në mëngjes. Ne kishim 60-70 klientë, dhe gazetat duhet të dorëzoheshin në orën 6:30 të mëngjesit në 365 ditë të vitit. I palosnim gazetat, vendosnim një llastik rreth secilës, më pas i

shpërndanim me biçikletat tona. Fillimisht këtë gjë e bënte vëllai më i madh dhe më pas ai ma kaloi mua. Unë ia kalova vëllait tim më të vogël. Ne shpërndanim gazetat në të njëjtën rrugë për tetë ose nëntë vite!

Çdo muaj duhet të shkonim derë më derë dhe të thonim: “Pagesa për San Jose Mercury”. Më pas paguanim faturën e gazetave dhe mbanim pjesën që tepronte.

Detyra ishte kjo: babai ynë na bënte që ta vendosnim gazetën fiks në hyrjen e përparme në mënyrë që kur klienti të hapte derën të gjente gazetën pikërisht aty duke e pritur. Ishte një burrë që telefononte në shtëpi nëse gazeta nuk ishte jashtë derës së tij deri në 6:30 fiks!

Ato vite që punonim me gazetat na mësuan të treve të punonim me gjithë zemër. Shumë pak prej atyre rrugëve të lagjes janë të disponueshme për fëmijët në moshë shkollore tani, por nëse bëheni pak krijues, mund të gjeni edhe mënyra të tjera që t’u mësoni fëmijëve tuaj si të punojnë mirë.

Diane lexoi dikur se një nga mënyrat më të mira për të rritur vetëbesimin tek fëmijët tuaj është t’i mësoni ata të bëjnë punë shtëpie, kështu që ajo vendosi t’i bënte fëmijët tanë fëmijët me vetëbesimin më të lartë në lagje! Fëmijëve tanë në të vërtetë nuk u pëlqente kur ajo bënte si komandante dhe fillonte t’u jepte urdhra, megjithatë, një ditë, Phil na e bëri ditën argëtuese me gallatat e tij duke krijuar një lojë.

Phil mund ta dallonte tensionin që krijohej teksa Diane u thoshte të gjithëve të nxitonin për të kryer punët e shtëpisë. Meqenëse ai është zakonisht personi që sjell argëtimin në rrethin tonë familjar, ai hartoi një plan. Ai i mori fëmijët mënjanë dhe i udhëzoi të rreshtoheshin në një vijë përpara mamit të tyre dhe ta përshëndetnin duke thënë: “Gati për punë mami!”

Kjo u bë një mënyrë argëtuese për të ç’tensionuar fëmijët tanë që nuk donin të bënin punët e shtëpisë, si dhe mamanë e tyre, e cila po mundohej t’i mësonte të bëheshin punëtorë të mirë.

DIANE:

Kjo përshendetje u rrënjos në traditën tonë familjare, madje e përforcuam disa vite më parë, kur ne të gjashtëmbëdhjetë po kalonim një javë së bashku tek shtëpia e prindërve të mi në “Sierra”, tek ai që e quajmë “Kampi Comer”. Një mbrëmje, pas një dite argëtuese duke luajtur tek lumi Stainslaus, të gjithë ishim shtrirë sa gjerë gjatë të djegur nga rrezet e forta të diellit dhe po shihnim një film. Pashë përreth rrëmujën që kishim krijuar - tridhjetë e dy këpucë në korridor, banaku i kuzhinës mbante një piring enësh të palara nga darka dhe s’mund të rrija pa menduar se si do të reagonin prindërit e mi nëse papritur ata vendosnin të ktheheshin nga pushimet e tyre më herët.

Qetësisht, dola pa rënë në sy dhe shkova në kuzhinë. E dija që do të mernte të paktën dy cikle të lavastoviljes për të pastruar dhe larë gjithë ato pjata dhe gota. Teksa po punoja, ndjeva disa hapa këmbësh pas meje dhe kur u ktheva pashë të gjithë fëmijët tanë, bashkëshortët e tyre, dhe fëmijët e tyre të rreshtuar nga më i gjati tek më i vogli me duart në pozicion përshëndetjeje “Gatitu!”

Sapo kuptuan që kishin vëmendjen time, thirrën së bashku: “Gati për punë, mami!”

Phil e udhëhoqi familjen tonë me idenë që puna së bashku është argëtuese. Në fakt, ai ia doli që t’a bënte gjithçka argëtuese!

Të Bërit e Ca Miljeve më Shumë

Tek Luka 17, Jezusi u tregoi ndjekësve të tij një histori për një padron dhe shërbëtorin e tij. Në histori, Ai u rikujtoi atyre që një punëtor nuk duhet të presë të falënderohet thjesht se ka bërë gjërat që i janë kërkuar të bëjë. Por, Jezusi i nxiti ndjekësit të thonë: “Jemi shërbëtorë të padobishëm. Kemi bërë *vetëm* detyrën” (Luka 17:10). Me fjalë të tjera, një “shërbëtor i dobishëm” shkon përtej detyrës së tij duke bërë më shumë nga sa i është kërkuar të bëjë. Ne e quajmë këtë të bërit e ca miljeve më shumë.

Ne mendonim se kishim bërë një punë të mirë duke i trajnuar fëmijët tanë që të punonin me gjithë zemër dhe ta bënin me qejf. Por më pas, miqtë tanë Waggoner, na habitën! Ata i kishin mësuar fëmijët e tyre që të raportonin tek mami ose babi pasi ta përfundonin punën e caktuar dhe të thonin: “Mami, e bëra atë që më kërkove të bëja, ka ndonjë gjë tjetër që dëshiron të bëj?”

Ua! Do të donim t’u kishim menduar më parë këtë! Filluam ta implementonim këtë si një nga mënyrat më të urta që kemi dëgjuar për t’u mësuar fëmijëve vlerën e bërjes së disa miljeve më shumë. Pa dyshim, ata fëmijë do të rriten e do të jenë një surprizë e këndshme për punëdhënësit e tyre të parë!

Ndërtimi i Marrëdhënieve

Përveç zhvillimit të karakterit (rritja në urtësi), Luka 2:52 thotë që Jezusi rritej në hir përpara njerëzve. Ne do t'a quajmë këtë *ndërtimi i marrëdhënieve*.

Jezusit i pëlqente të ishte rreth njerëzve dhe njerëzve u pëlqente të ishin rreth Jezusit. Luka 4:22 thotë se ata që e dëgjuan Atë duke folur “mrekulloheshin nga fjalët e hirshme që dilyn nga goja e Tij”. Prindër, të qenit joegoistë dhe të kujdesshëm ndaj të tjerëve nuk vjen natyrshëm tek shumica e fëmijëve. Është në dorën tuaj t'u mësoni si të jenë të hirshëm.

E mbani mend Urdhërimin e Madh? Mandati ynë është të duam Perëndinë me gjithë zemrën, mendjen, shpirtin dhe forcën tonë. Jezusi e lidhi atë me një urdhërim tjetër: duajeni të afërmin tuaj porsì vetveten (Mat. 22:39).

Duajeni Perëndinë me pasion dhe duajini njerëzit me qëllim: këto janë dy thirrjet e mëdha që valëviten dhe nënvizojnë gjithçka që ne po trajnojmë, mësojmë, disiplinojmë dhe zhvillojmë, gjithçka që po derdhim në formimin e fëmijëve tanë.

Së pari dhe shumë e rëndësishme për ju, mami dhe babi, është që duhet t'i mësoni fëmijët tuaj si të duan njerëzit me qëllim dhe si të duan të afërmin porsì vetveten.

Kur duam ashtu si Perëndia do që ne të duam, duam në mënyrë të pakushtëzuar. Dashuria e Tij është një lloj dashurie pavarësisht-gjithçkaje. Është bujare, *dorëlëshuar*,¹ dhe e kujdesshme.

Të duash në mënyrën e Perëndisë është sakrifikuese; do të thotë të heqësh dorë nga jeta jote për hatrin e të tjerëve, pa pritur asgjë në këmbim. Jo të ngatërrojmë identitetin tonë me të tjerët, por të kemi një mënyrë jetese që sjell *jetë* te njerëzit përreth nesh.

Kur duam ashtu si Perëndia dëshiron që ne të duam, ne duam në mënyrë të vazhdueshme - tërë kohën. Në ditë të mira, kur fëmijët

tanë janë të adhureshëm, si edhe përgjatë stinëve të pashmangshme në jetën e fëmijëve tanë, kur ata janë gjithçka, përveçse të mrekullueshëm.

Megjithatë, le të jemi të sinqertë. As Phil, dhe as Diane nuk arrijnë dot të duan pa kushte, në mënyrë sakrifikuese dhe të vazhdueshme. Askush nuk mundet! Sidoqoftë, “fuqia e tij hyjnore na dhuroi të gjitha gjërat që i takojnë jetës dhe perëndishmërisë” (2 Pje. 1:3). Ose, si thotë Jon Courson:

“Pa Atë nuk mundem,
Pa mua, Ai nuk do”²

Pjesa juaj, mami dhe babi, është të njihni dhe të përjetoni dashurinë e Perëndisë në mënyrë që të mund ta derdhni dashurinë e Tij tek fëmijët tuaj. Njerëzit që e kanë më të vështirë të pranojnë dashurinë e pamerituar të Perëndisë, *hirin* e Tij, janë ata, prindërit e të cilëve nuk ishin në gjendje t’ua shfaqnin këtë lloj dashurie.

Pse? Sepse prindërit që ende nuk e kanë përjetuar vetë dashurinë e Perëndisë e kanë të vështirë t’ua shprehin këtë dashuri fëmijëve të tyre. James Dobson e shpjegon në këtë mënyrë:

“Shumica dërrmuese e fëmijëve tanë nuk janë të shkëlqyeshëm, brilantë, tejet të zgjuar, shumë të koordinuar, tmerrësisht të talentuar, ose të njohur botërisht! Ata janë thjesht fëmijë normalë me nevojë të jashtëzakonshme për t’u dashur dhe pranuar ashtu siç janë”³

MIRËSJELLJA

Të qenit joegoist, i vëmendshëm ndaj të tjerëve, duke treguar kujdes për njëri-tjetrin - një dashuri e tillë nuk vjen natyrshëm tek një fëmijë. Si prind, ju duhet të merrni përgjegjësinë parësore për t’i mësuar fëmijës tuaj mënyra për të mirëpritur dhe për t’i dashur njerëzit.

Edukimi i fëmijëve tuaj për të dashur njerëzit me qëllim përfshin të mësuarit e aftësive të njerëzve të mirë. Ne e pamë këtë gjë të funksiononte tek nipi ynë, Jude.

PHIL:

Jo shumë kohë më parë, nipërit tanë Jude, Moses, dhe Sunday po rrinin tek shtëpia jonë, ndërkohë që John Mark dhe Tammy kishin ikur. Një mik nga jashtë qytetit erdhi në shtëpinë tonë për darkë, dhe kur hyri brenda, e prezantova atë me Jude.

“Jude, ky është z. Kimball. Ai është një mik i yni, dhe e njeh edhe babin tënd”.

Menjëherë dhe instinktivisht, Jude i dha dorën Dan për ta përshëndetur dhe tha: “Gëzohem që ju takoj, z. Kimball!”

Miku im Dan (i njohur si z. Kimball) u befasua nga përshëndetja e Jude. Atë e mahniti fakti se si një gjashtëvjeçar u tregua kaq i guximshëm dhe me vetëbesim në një prezantim të shkurtër!

Më riktheu në një ditë, tridhjetë vite më parë, kur e prezantova John Mark gjashtëvjeçar me Dan, i cili asokohe ishte një student universiteti. Mbaj mend që isha aq krenar për tim bir kur i shtrëngoi dorën dhe i tha: “Gëzohem që ju takoj, z. Kimball!”

John Mark dhe Tammy po i mësojnë fëmijët e tyre që t'i duan njerëzit me qëllim, duke u dhënë atyre aftësitë që iu duhen për të qenë të sjellshëm dhe të dashur me të tjerët. Një gjest i tillë, kaq i thjeshtë në dukje, duke thënë: “Gëzohem që ju takoj!” është një mënyrë për t'i bërë njerëzit të kuptojnë se ata janë të rëndësishëm dhe se ju interesoheni për ta.

Njerëzit më të vështirë ndaj të cilëve duhet t'i mësoni fëmijët tuaj të jenë të sjellshëm janë - surprizë, surprizë – motrat dhe vëllezërit e tyre! Asnjë prind nuk duhet të befasohet nga fakti që vrasja e parë në historinë e njerëzimit u krye nga një vëlla që ishte xheloz për vëllain e tij të vogël!⁴

DIANE:

Fëmija ynë i tretë, Elizabeth, kishte një vëlla më të madh dominues dhe një motër më të madhe me vullnet të fortë. Ajo nuk ishte as dominuese, as me vullnet të fortë, kështu që për të përballuar hierarkinë në të cilën kishte lindur, ajo zhvilloi atë që ne

e quajtëm Shikimi. Ajo mund ta zhdukte vëllain e saj më të madh, shefin, me atë Shikim!

Prandaj, vëllai i vuri nofkën Mbretëresha Elizabeth: mbretërore dhe e ftohtë. Shikimi ishte metoda pasive e rezistencës së Elizabetës. Kur ajo ndihej e mbizotëruar apo e frikësuar prej vëllait dhe motrës së saj, ajo thjesht i ngrinte ata.

Një pasdite po shkoja me makinë bashkë me fëmijët e mi tek shtëpia e një mikeshe të mirë në anën tjetër të qytetit. Peggy është një nga femrat më të gjalla që unë njoh. Dashuria e saj e pakufishme e mbështillte familjen tonë sikur ne t'i përkisnim asaj. Tre fëmijët dhe bashkëshorti i saj Jeff, na përqafojnë secilin prej nesh, duke na marrë me vete në pushime dhe duke u kujdesur për ne kur Phil shkonte në udhëtime misionare trejavore në ishujt Filipine. Ne ishim më tepër sesa miq; ishim familje.

Atë pasdite, kur shkuam në shtëpinë e tyre, Peggy me padurim hapi derën e makinës dhe tha me entuziasëm: "Përshëndetje Elizabeth!"

Unë u shtanga kur Elizabeth u ngrysi ndaj mikes time, duke i hedhur Shikimin në mënyrën më të egër. Më pas pashë fytyrën e Peggy që u pre teksa instinktivisht bëri një hap mbrapa, sikur Elizabeth t'i kishte dhënë ndonjë shuplakë.

Ai Shikim duhet të largohet!

Pa dyshim, duhet të merreshim me atë gjë! Nuk mund të funksiononte më që të thonim: "Është e ndrojtur". Shikimi nuk ishte më diçka e lezetshme dhe zbavitëse, por një shprehje jomikpritëse dhe e padëshirueshme që shprehte rezistencë. Duhet ta mësonim vajzën tonë si të ishte e sjellshme.

Trajnimi për Mirësjelljen

1. Mësojini fëmijët që t'i shohin njerëzit në sy kur flasin me ta. Lërin të kuptojnë se një veprim i tillë shpreh vlerësim dhe interes.
2. Mësojini fëmijët që të përgjigjen gjithmonë kur dikush u bën një pyetje.

Shpjegojuni atyre që bisedat e shkurtra janë një mënyrë për të filluar një marrëdhënie të vërtetë.

3. Vazhdoni më tutje dhe inkurajojini fëmijët që edhe ata të bëjnë pyetje, në mënyrë që biseda të ketë vazhdimësi. Të mësuarit për të qenë të pranishëm në një bisedë është po aq i thjeshtë sa të hedhësh një top andej-këndeje. Nëse njëri person del nga biseda, është si të heqësh topin në mes të lojës.

4. Mësojeni fëmijën tuaj të falenderojë mamën ose babin e një shoku/ shoqeje që e lejoj të shkonte në shtëpinë e tyre për të luajtur, për drekën dhe për mirësjelljen e tyre. Kur fëmija juaj të vijë në shtëpi, pyeteni nëse e ka bërë këtë gjë. Në këtë mënyrë djali apo vajza juaj do të kuptojë që shprehja e falënderimit është e rëndësishme.

5. Mësojini fëmijës tuaj që si fillim ta përshëndesë shitësin e dyqanit, pastaj të kërkojë ndihmën apo shërbimin e tij. “Përshëndetje! Si po ju shkon dita?” Është një shprehje kaq e thjeshtë, por që komunikon rëndësinë që u kushtojmë njerëzve.

6. Mësojeni fëmijën tuaj që të kujdeset për të tjerët, të bëjë atë që Filipianët 2 na këshillojnë të gjithëve të bëjmë: “me përaulësi, secili ta çmojë tjetrin më shumë se veten. Mos të mendojë secili për interesin e vet, por edhe atë të të tjerëve” (Fil. 2:3-4).⁵

Kjo është mirësjellja në të vërtetë. Kjo urtësi i atribuohet gurusë së sjelljeve të mira Emily Post: “Mirësjellja është perceptim i ndjenjave të të tjerëve. Nëse e keni këtë perceptim, ju keni sjellje të mira, pavarësisht se çfarë mënyre përdorni”. Sjelljet e mira janë aftësi njerëzore që tregojnë se e kushtojmë që edhe të tjerët kanë rëndësi. Ata janë të rëndësishëm për Perëndinë, prandaj duhet të jenë të rëndësishëm edhe për ne.

Mënyra se si fëmijët tanë i trajtojnë njerëzit në jetën e tyre - që nga shitësit deri tek motrat apo vëllezërit reflekton thellësinë e të kuptuarit të tyre rreth dashurisë së Perëndisë. Teksa fillojmë të perceptojmë se sa shumë dashuri Perëndia ka për çdo person që takojmë, ne bëhemi më të hirshëm.

Nuk ka asnjë dyshim që fëmijët tuaj do të kenë debate, por kjo nuk do të thotë që ne thjesht të ngremë supet dhe të mos bëjmë asgjë. Dikush mund të japë atë Shikimin, një tjetër mund të shajë verbalisht. Është detyra jonë të ndërhyjmë!

DASHURI PËR NJËRI-TJETRIN

A e keni dëgjuar ndonjëherë këshillën e supozuar “ta them nga përvoja” që u jepet prindërve të fëmijëve që zihen me njëri-tjetrin? Është pak a shumë kështu: “Mos ndërhyini! Ata duhet të mësojnë se si t’i zgjidhin gjërat vetë. Thjesht lërin!”.

Por cili është rezultati aktual i atij qëndrimi statik? Mendojeni pak!

Më hileqari fiton - gjithmonë!

Nga ana tjetër, nëse i mësoni fëmijët tuaj me durim si t’i zgjidhin konfliktet në një mënyrë të perëndishme dhe të hirshme, do t’i përgatitni ata për një të ardhme me maturi në marrëdhënie. Ata do të jenë të aftë të kuptojnë të tjerët, duke ditur si të “gëzohen me ata që gëzojnë dhe të qajnë me ata që qajnë” (Rom. 12:14).

Në vitet tetëdhjetë, kur po rritnim fëmijët tanë, ishte një këngë e njohur për fëmijë që na ngrinte humorin pikërisht kur ishte e nevojshme. Fjalët e refrenit ende kumbojnë në kokën time kur rriten tensionet e marrëdhënieve:

*Aftësia-për-miqësi, aftësia-për-miqësi, aftësia-për-miqësi,
vjen nga ti vetë!*

*Aftësia-për-miqësi, aftësia-për-miqësi, vjen nga Perëndia
kur e do me të vërtetë!*

Sado e rëndomtë që mund të tingëllojë tani, është lloji i së vërtetës ngjitëse.

Jezusi foli për dashurinë për njerëzit me qëllim tek Predikimi në Mal, kur tha: “Lum ata që përpiqen për paqen, sepse ata do të quhen bij të Perëndisë” (Mat. 5:9). Ai i ktheu përmbys normat kulturore duke u thënë ndjekësve të tij: “Duani armiqtë tuaj, beconi ata që ju mallkojnë, u bëni të mirë atyre që ju urrejnë, dhe lutuni për ata që ju keqtrajtojnë dhe ju përndjekin, që të jeni bij të Atit tuaj, që është në qiej” (Mat. 5:44-45).

Pjetri, pasi kishte parë Jezusin, na këshillon t’u përgjigjemi fyerjeve njësoj si Jezusi, duke thënë: “Kur e fyenin, nuk e kthente fyerjen me fyerje, kur vuante, nuk kërcënonte, por dorëzohej tek ai që gjykon drejtësisht” (1 Pje. 2:23).

Dishepullizimi i vetë fëmijëve tuaj, trajnimi i tyre me këtë koncept antikulturor për të dashur njerëzit - veçanërisht motrat/vëllezërit - është thirrja e lartë e prindërve që ndjekin Jezusin.

Ka një milion mënyra për të dashur mirë; disa njerëz duan duke bërë dhurata të mirëmbuara, ndërsa të tjerë duke folur fjalë shprese, duke treguar mëshirë apo mirëkuptim. Ndoshta mënyra juaj e të dashurit të njerëzve është duke u shërbyer atyre me gjëra të bukura. Babai i Diane-s rregullonte gjëra, mamaja e Phil-it gatuate vakte që të kënaqnin shpirtin. Zhytuni në këtë gjë me fëmijët tuaj, dhe zbuloni së bashku kënaqësinë që vjen kur i duam njerëzit me qëllim!

Mënyra e Duhur për të Kërkuar Falje

Një nga praktikat kyçe për t'u mësuar fëmijëve tuaj që të duan me mençuri është të kërkojnë falje në mënyrën e duhur. Kjo aftësi e vetme mund ta përgatitë fëmijën tuaj për zgjidhje të shpejtë konfliktesh! Ja se si funksionon:

Kërko ndjesë për një ofendim konkret.

“Më vjen keq nëse të kam lënduar” është një ndjesë e zbrazët. Përkundrazi, mësojini fëmijët tuaj të jenë të përulur, të guximshëm dhe të sinqertë për gabimet e tyre. Për shembull: “Më fal që të quajta budalla”.

Prano përgjegjësinë.

Sërish, jini specifik dhe mos ia hidhni fajin personit tjetër. “Unë thashë këtë-dhe-atë, sepse ti bëre këtë-dhe-atë” e hedh fajin mbi personin tjetër për zgjedhjet tuaja. Në vend të kësaj thjesht thoni: “Nuk duhet t'a kisha thënë atë që thashë”. Mbani mend: përgjigjja ime është përgjegjësia ime!

Kërko faljen e Perëndisë

Mëkati dhe egoizmi lëndojnë Perëndinë së pari. Kur unë gaboj ndaj një fëmije të Perëndisë, jam duke gabuar ndaj Vetë Perëndisë.

Kërkoji falje personit tjetër.

Duke thënë: “Të lutem a do më falësh që të quajta budalla?” ka më shumë peshë sesa një “Më fal” e zyrtë dhe me hatërmbetje. Kërkesa

e faljes është një mënyrë pranimi se ajo që bëtë e ka lënduar, bezdisur ose ka ndikuar në mënyrë reale tek personi që keni ofenduar.

Restauro marrëdhënien.

Barra për rimëkëmbjen e një marrëdhënieje bie drejtpërdrejt mbi supet e ofenduesit.⁶ Mos e humbisni këtë hap të fundit, përndryshe djali apo vajza juaj mund të presin që një ndjesë e shpejtë mund të rregullojë gjithçka që ata thyejnë.

Kur djali plangrishës u kthye në shtëpi tek i ati, pasi e kishte shkapërderdhur trashëgiminë e tij, ai nuk priste që të kthehej në një pozitë të lartë. Ai thjesht shpresonte që të mund të pranohej si një shërbëtor. Fjalët e tij na japin një shembull të bukur të një ndjese të vërtetë:

“Atë, mëkatova kundër qiellit dhe para teje; nuk jam më i denjë të quhem biri yt; trajtomë si një nga shërbëtorët e tu” (Luka 15:18-19).

Babai i tejkaloj pritshmëritë e tij duke e përqaftuar dhe marrëdhënia e tyre u rimëkëmb.

Aftësitë që do të bëjnë të mundur që fëmija juaj të rritet për të qenë një punëtor i mirë, një bashkëshort i dashur dhe një prind i perëndishëm duhet t’u mësohen pikërisht në shtëpi. Shtëpia është terreni trajnues parësor i marrëdhënieve. Është një botë në miniaturë.

Në çdo moment që ju harxhoni duke trajnuar fëmijët tuaj se si të duan me qëllim, ju po i përgatitni ata për një të ardhme të mbushur me marrëdhënie të kënaqshme.

Kush nuk do ta donte këtë për fëmijët e vet?

Trajnimi Shpirtëror

Luka 2:52 thotë që, përveçse rritej në urtësi dhe në hir (favor) përpara Njerëzve, Jezusi gjithashtu rritej “në favor përpara Perëndisë”. Fjala greqisht për favor është *cháris*, në vende të tjera është përkthyer “*hir*”.

Jezusi rritej në hirin e Perëndisë.

Edhe si djalosh, Jezusi kishte një marrëdhënie në rritje me Atin e Tij që nuk ishte as pasive, as statike. Ecja e Tij me Perëndinë ishte e gjallë dhe energjike, intime dhe në rritje.

Këto vite strukturimi janë një kohë ideale për trajnim shpirtëror intensiv, duke i ndihmuar djalin ose vajzën tuaj të “rriten në hirin e Perëndisë”. Në fillim të kësaj faze të jetës, fëmijët përgjithësisht janë të aftë të perceptojnë fakte konkrete dhe fillojnë të kuptojnë metaforat që zbatohen në situatat e tyre. Prindërit janë në pozicionin perfekt për t’u ardhur në ndihmë fëmijëve të tyre në përditshmërinë reale të jetës, për të folur për rrugët e mbretërisë të mësuara në mënyrë specifike nga Jezusi.

Por ku duhet të filloni? Si mund t’i mësoni fëmijës tuaj atë që sapo keni filluar ta kuptoni ju vetë? A nuk duhet t’u lihet kjo profesionistëve? Predikuesve, drejtuesve të trajnuar nëpër seminare, ose të paktën mësuesve të shkollës së të dieles?

Këto janë pyetjet që na shqetësonin, duke u lënë vend dyshimeve dhe pasigurisë rreth aftësive tona për t’i mësuar fëmijët tanë. Ne ishim ende besimtarë relativisht të rinj kur fëmijët tanë hynë në këtë fazë të jetës, dhe kishim frikë se mos gabonim. Ishim të frikësuar nga sasia e atyre që mendonim se duhej të mësonim, por në të njëjtën kohë po rriteshim në bindjen që të mësuarit, udhëheqja dhe influencimi i fëmijëve tanë për të ecur me Perëndinë ishte para së gjithash përgjegjësia jonë. Në fund të fundit, kush mund t’i donte fëmijët tanë më shumë se ne?

Pas orëve të pafundme duke folur dhe duke u lutur së bashku, vendosëm që tre ishin gjërat kryesore që ne donim që fëmijët tanë të kapnin gjatë këtyre viteve - tre gjëra që ne dëshironim t'i shikonim të ndodhnin në zemrat e tyre. Ne besonim se nëse ata i merrnin këto të vërteta, do të ishin në rrugë të mirë për t'u rritur në hirin e Perëndisë, njësoj si Jezusi.

Ndërkohë që ka një larmishmëri materialesh të shkëlqyera,¹ nuk është thjesht informacioni ai që u duhet fëmijëve. Në fakt, informacioni i tepërt mund ta zbehë përqafimin entuziast të Jezusit prej fëmijës. Ajo që u duhet fëmijëve tuaj në këtë fazë të zhvillimit të tyre është që të lidhen me Perëndinë në një përvojë të vërtetë dhe personale.

Ata duhet të bien në dashuri me Të.

TRI DASHURITË

Dashuria për Jezusin

Ne donim të bënim gjithçka varej nga ne për t'u siguruar që fëmijët tanë të binin në dashuri me Jezusin. Ne donim që ata ta shikonin Atë si tërheqës dhe heroik, të denjtë për adhurimin e tyre. Në të njëjtën kohë, donim që të vështronim me kujdes dhe të largonim çdo mërzitje apo mungesë interesi përpara se të zinte rrënjë. Si të sapoardhur në besim, ne ishin në dashuri me Jezusin dhe rrugët e Tij plot hir. Ne donim që fëmijët tanë ta përjetonin atë dashuri bashkë me ne. *Por si?*

Këtu qëndron bukuria e kësaj çështjeje: ju keni privilegjin që t'ua përshkruani Jezusin fëmijëve tuaj. Ju do të jeni ata që do të pikturonin një imazh tërheqës të atij që Ai është.

Ju mund t'i dëshmoni fëmijës tuaj se si Ai reagonte ndaj dhimbjes së njerëzve, si i qetësonte frikërat e tyre, se si Ai dëshironte që fëmijët të vinin pranë Tij, ndërkohë që të rriturit donin t'i largonin tutje. Ju lexoni historitë dhe kaloni përmes rreshtave, duke i sjellë ato histori të gjalla në një mënyrë që fëmija juaj të mund t'i kuptojë.

Ungjijtë do të jenë vendi i duhur ku do të doni të shkoni për të zbuluar Jezusin e vërtetë, duke bërë që nocionet tuaja të paramenduara të bien teksa vendosni të zbuloni së bashku se kush është Jezusi dhe si është Ai në të vërtetë.

- Lexoni për miqësinë që Ai kishte me Llazarin dhe motrat e tij, Martën dhe Marinë tek Luka 10:38-41 dhe Gjoni 11.
- Tregojuni atyre historinë e dhembshurisë së Tij ndaj burrit që kishte lindur i verbër tek Gjoni 9.
- Theksoni se sa shumë Gjon Pagëzori, kushëriri i Jezusit e nderoi Atë tek Mateu 3:11, Gjoni 1:25-37, dhe Gjoni 3:30.
- Ndriçoni botëkuptimin e fëmijëve tuaj për qëndrimin plot respekt që Jezusi tregoi ndaj femrave duke lexuar historinë e Gruas tek pusi, Gjoni 4.
- Bëjeni Pashkën festën më të madhe të vitit duke treguar historinë e kryqit dhe të ringjalljes. Tregojeni atë në mënyrë personale, duke përsëritur fjalët plot falje të dashurisë së Jezusit përpara se të vdiste (Luka 23:34).

A e kapni idenë? Ju po e zbuloni Jezusin si heroin që Ai është, duke shtruar rrugën për secilin prej fëmijëve tuaj, që në mënyrën e tij apo të saj, të bien thellësisht në dashuri me Të.

Ndoshta mjeti më i fuqishëm që keni është vetë historia juaj e besimit. Tregojuni fëmijëve tuaj se si Jezusi jua ndryshoi jetën. Se si Ai ende vazhdon t'ju ndryshojë. Tregoni histori të përfshirjes së Tij në jetën tuaj të përditshme – si ato historitë e mrekullive që kanë lënë gjurmë, po ashtu edhe historitë në dukje rastësore që kthehen në histori të bukura dashurie dhe kujdesi të një jete të tërë. Bëjeni Atë të vërtetë në një mënyrë që fëmijët tuaj, me personalitetet e tyre të veçanta, të mund të lidhen me Të.

Dashuria për Fjalën e Perëndisë

Së dyti, ne donim që fëmijët tanë të donin Shkrimin. Sapo fëmijët tuaj të fillojnë të lexojnë, sigurohuni që secili prej tyre të ketë një Bibël personale, një që të kenë mundësi t'a lexojnë dhe t'a kuptojnë.²

Lëri ata t'ju shikojnë duke lexuar Biblën tuaj, duke studiuar dhe mësuar, duke u lutur dhe duke mbajtur shënime. Lëri ata t'ju shikojnë teksa meditojnë mbi të vërtetat që po mësoni.

Gjithashtu, sigurohuni që jeni të përfshirë në një kishë ku mësohet Bibla, ku udhëheqësit besojnë vendosmërisht në autoritetin e Shkrimit dhe e bëjnë atë të arritshëm dhe të zbatueshëm në jetën reale.

Merreni Biblën tuaj me vete çdo të diel që fëmijët tuaj të kuptojnë vlerën e pallogaritshme të Fjalës së Perëndisë. Ata do të shikojnë interesin tuaj, dhe kjo gjë do të ndezë interesin e tyre.

Dashuria për Kishën

Së fundmi, ne donim që fëmijët tanë të duan kishën e Perëndisë. Vitet tona në shërbesën pastorale na kanë treguar se askush nuk reziston për shumë kohë duke u endur si një i krishterë i vetmuar. Zoti e bëri kishën, këtë komunitet të madh, të larmishëm e të ndryshëm besimtarësh me gjithë problemet e saj, të jetë qendra e planit të Tij për ta kthyer botën prapë tek Vetja e Tij. Ne donim që fëmijët tanë ta shihnin kishën si familja që ishte bërë për ne; e papërsosur, por e bukur, përqafuese, një vend ku hiri dhe falja jetohen në kohë reale. Ne donim që fëmijët tanë të shihnin që kisha nuk është thjesht një vend ku shkon të dielave, por një bashkësi e gjallë dhe energjike ku njerëzit jetojnë bashkë.

TRI GJËRA

Për t'i përcjellë me sukses këto tri dashuri tek fëmijët tanë (dashurinë për Jezusin, për Shkrimin dhe për kishën), ne u fokusuam në tri gjëra. Këto janë tri praktika të lehta për t'u implementuar në mënyrë që të bëhen realitet tri dashuritë: kohë familjare me Biblën, mësimi i vargjeve përmendësh dhe dita e Perëndisë ose Shabati. Këto janë vetëm fillimi i sjelljes së asaj që shumë mësues e quajnë “disiplina shpirtërore” në strukturën e rregullt të jetës tuaj familjare. Ato janë një mënyrë e shkëlqyer për t'i bërë fëmijët tuaj që të kenë uri për më shumë!

Kohë Familjare me Biblën

Kjo praktikë e të mbledhurit rregullisht së bashku si familje për të lexuar Biblën me zë të lartë është duke u rralluar në familjet e krishtera. Një raport i bërë së fundmi nxori në pah të vërtetën e trishtë që në Amerikë, “më pak se një në dhjetë familje të rilindura sërish e lexojnë Biblën së bashku gjatë një jave të zakonshme”.³

Shumica e prindërve ndihen të frikësuar nga ideja e një praktike që ata vetë mund të mos e kenë përjetuar kurrë si fëmijë. Por nuk është dhe aq e ndërlikuar dhe as shumë e vështirë për të patur një kohë të tillë kur burimet biblike të fëmijëve janë kaq të bollshme. Gjithashtu, sa më herët të filloni, aq më mirë është! Duke e normalizuar këtë praktikë për sa kohë që fëmijët tuaj ende presin me padurim të mblidhen rreth jush në pizhama, ju do të keni atë që pak familje e përjetojnë: përbashkësi në një nivel të thellë shpirtëror.

Asnjëri prej nesh nuk kishte ndonjë eksperiencë me këtë koncept të një kohe të veçuar për të gërmuar në Shkrime së bashku, kështu që ne thjesht u munduam që ta bënim të funksiononte sipas mënyrës tonë. Nga provat dhe gabimet ne zbuluam pesë faktorë esenciale që na aftësuan të bëhemi të qëndrueshëm dhe ta shijonim vërtet atë që u bë një kohë e ëmbël miqësie në familjen tonë:

- Zgjidhni mjetet e duhura.
- Mos e zgjatni shumë.
- Bëjeni zbavitëse.
- Përfshini një kohë lutjeje.
- Planifikojeni menjëherë përpara gjumit.

NJË SHËNIM PËR MAMATË NGA DIANE:

Kam dëgjuar gra që kanë hapur zemrat e tyre tek unë në mënyrë private dhe në grupe të vogla, në kohë thyerjeje dhe në shpërthime zemërimi, për rreth katër dekada shërbese në kishë. Ajo që kam dëgjuar herë pas here është kërkesa që bashkëshortët duhet të marrin përgjegjësinë e udhëheqësisë shpirtërore në shtëpitë tona si dhe atë ndjesinë që nëse ata nuk e bëjnë këtë gjë, fëmijët tanë do të vuajnë e po ashtu edhe ne. Me kalimin e kohës, ky irritim shndërrohet shpesh në një hidhërim të brendshëm shpirtëror që burrat tanë rrallë e dallojnë, por ama gjithmonë e ndjejnë.

Megjithëse ka shumë të vërteta në shqetësimet tona, besoj se ka edhe shumë gjëra të gabuara gjithashtu. Diku përgjatë rrugës shumë prej nesh krijojmë disa ide në mendjet tona se si duhet

të jetë udhëheqësia shpirtërore. Ne përziejmë dëshirat tona të thella për unitet shpirtëror me bashkëshortët tanë me interpretime idealiste të asaj që jemi të sigurt që burrat e tjerë bëjnë. Është një nocion joreal që e kemi idealizuar si standardin e artë të udhëheqësisë shpirtërore.

Mama, a mund t'jua tërheq pak vëmendjen? Shpeshherë ne presim tepër shumë nga bashkëshortët tanë, ndërkohë që Bibla tregon qartë se trajnimi shpirtëror i fëmijëve është përgjegjësi e të dyve, e mamit dhe e babit. Llamba dhe drita, e mbani mend?

Edhe pse jam e bindur që përkushtimi i Phil për t'u lexuar dhe mësuar Biblën në mënyrë joformale fëmijëve tanë ka rezultuar në të rritur që e duan Fjalën e Zotit, nuk ka absolutisht asnjë arsye që një mama të mos bëjë të njëjtën gjë, nëse i shoqi nuk po e ndërmerret këtë rol.

Një shembull biblik për këtë tregohet në një nga paragrafët e një letre personale që Pali i shkroi Timoteut:

“Më kujtohet besimi yt i sinqertë, i cili më parë ishte te gjyshja jote Loida dhe te nëna jote Eunika, dhe jam i bindur se këtë besim e ke edhe ti” (2 Tim. 1:5).

Studiuesit besojnë se Timoteu pastoroi kishën më të madhe në botë asokohe - kishën e Efesit. Pa dyshim që ky burrë ishte një gjigand shpirtëror në kishën e hershme, një djalë i ri për të cilin çdo prind ndjekës i Jezusit do të ishte krenar.

Pali nuk e përmend babain e Timoteut. Shumë hamendësojnë se babai i tij nuk ishte një ndjekës i Jezusit. Nga tregimi i Lukës, ne dimë që Timoteu ishte një dishepull i ri “nëna e të cilit ishte një besimtare judease, ndërsa babai ishte grek” (Vep. 16:1).

Mund të supozohet që Timoteu u rrit në një shtëpi ku babai ose mungonte shpesh ose kishte pak apo aspak interes për të ndjekur Jezusin. Ndikimi i nënës dhe i gjyshes së tij të perëndishme ishte mjaftueshëm mbresëlënës sa të vihej re nga Pali.

Disa burra duhet të inkurajohen - jo të manipulohen, të turpërohen apo të shtyhen - në rolin që Perëndia u ka caktuar si udhëheqës shpirtëror për familjen e tyre. Nëse burri juaj është

besimtar, ai me shumë mundësi dëshiron që ta udhëheqë familjen e tij, majde edhe mund të ndihet i turpëruar përbrenda që ka qëndruar në heshtje për çështjet shpirtërore, por ai nuk di se si. Ai mund të mos e kuptojë plotësisht se çfarë pritet prej tij dhe ka mungesë vetëbesimi në aftësitë e tij për të përbushur këtë rol të paqartë, kështu që qëndron pasiv. Nuk është diçka e pazakontë që burrat të vendosin një fasadë mosinteresi kur e ndjejnë se nuk kanë mundësi për të patur sukses.

Mund ta bëjmë shumë më të lehtë për burrat tanë nëse, në vend që t'u hedhim fajin, përpiqemi të njohim zemrat e tyre dhe të veprojmë në përputhje me to. Duhet të duam më të mirën për bashkëshortët tanë, duke mos e bërë kohën familjare të leximit të Biblës si një provë të aftësive të tyre për udhëheqësinë shpirtërore. Përkundrazi, ne ndërhyjmë për të ndihmuar që kjo gjë të realizohet.

Ne (mamat) marrim librin me histori biblike (të cilin e kemi kërkuar dhe blerë) menjëherë pas darkës. Mbledhim fëmijët, ndoshta bëjmë një tas me kokoshka dhe ndezim një zjarr tek oxhaku për atmosferë. Kujdesemi për detajet! Kjo nuk do të thotë të marrësh kontroll; por do të thotë që jemi duke inkurajuar dhe ndihmuar burrat tanë, duke ditur nevojën e tyre për respekt në çdo fushë të jetës - veçanërisht në këtë rol frikësues si udhëheqës shpirtëror.

E kuptova që herët se Phil e kishte më mirë të bënte kohën e leximit të Biblës sesa të pastronte kuzhinën pas darke, kështu që këtë bënim shumicën e darkave. Unë pastroja, ndërkohë që Phil shtrihej në dysheme me fëmijët që i hipnin sipër dhe u lexonte Biblën e tyre me figura. Unë merrja kohën time të ëmbël, duke shijuar pak kohë vetëm për të pastruar (me këtë rrugë ushqeja perfeksionizmin tim maniak!) Ndërkohë që fëmijët tanë shijonin kohën e tyre me babin dhe mësonin për të dashur Shkrimin.

Baballarë, mos e nënvlerësoni ndikimin që ju keni tek fëmijët tuaj kur i mblidhni ata rreth vetes dhe lexoni Biblën së bashku! Madje, nuk është aq shumë ajo që u mësoni apo lexoni fëmijëve tuaj, sesa si ndjehen ata kur ju e bëni këtë gjë.

Ka diçka të ëmbël këtu, një lidhje që nuk mund të ndodhë në

asnjë mënyrë tjetër. Teksa lexoni Biblën së bashku dhe ngrini pyetje, duke dëgjuar mendimet e njëri-tjetrit për historitë, ju vini më pranë. Edhe ju mësoni, e po ashtu edhe fëmijët tuaj. Ndërsa koha kalon, ajo që fëmijët tuaj do të mësojnë më tepër se gjithçka tjetër është ta dëshirojnë atë lidhje që ndjenin kur i përkëdhelnit dhe u lexonit Biblën.

Më pas, teksa arrijnë në moshë madhore, ata e sjellin dëshirën për atë lloj lidhjeje në ecjen personale me Atin e tyre qiellor, dhe do të dinë si ta arrijnë vetë këtë gjë.

Rregulli JBJM

E mbani mend se argëtimi është në krye të listës së vlerave të Phil? Ai gjeti një mënyrë për ta bërë edhe leximin e Biblës argëtues për fëmijët tanë. Kur e pamë të arsyeshme që fëmijët tanë ishin gati të fillonin të zhvillonin vetë një kohë devocioni (kohë personale me Perëndinë) në mëngjes, ai u prezantoi atyre atë që ne e quajtmë: “Rregulli JBJM”:

Jo Bibël, Jo Mëngjes.

Ndërkohë që Diane e mbushte shtëpinë tonë me aromën e petullave teksa i gatuate në sobë, Phil i nxiste fëmijët që të merrnin disa minuta për të lexuar Biblën e tyre, duke cituar fjalët e Jezusit: “Njeriu nuk rron vetëm me bukë, por me çdo fjalë që del nga goja e Perëndisë” (Mat. 4:4).

Ne po u mësonim fëmijëve tanë në një mënyrë argëtuese dhe konkrete që ata kanë nevojë për ushqim shpirtëror për shpirtin e tyre të uritur po aq sa ata kishin nevojë për mëngjesin plot dashuri që mamaja e tyre po përgatiste. E mbajtëm në nivel të thjeshtë dhe të arritshëm, mjaftueshëm sa për të stabilizuar një zakon jetik pa e ngarkuar spektrin e vëmendjes së tyre të shkurtër. Ne u kërkonim që si fillim të lexonin shumë shkurt, ndoshta pesë ose dhjetë minuta: Një kapitull nga Fjalët e Urta, një Psalm, ndoshta një pasazh të një prej Ungjijve. Mjaftueshëm sa për të hapur oreksin, por jo aq sa të bëhej një disiplinë dërrmuese.

Ne pyetëm një mentor, këshillën e të cilit e kishim kërkuar shpesh për rritjen e fëmijëve të perëndishëm: “A është mirë që t’u kërkojmë fëmijëve tanë të lexojnë Biblën? A do të lodhen ata një ditë nga kjo gjë?”

Përgjigjja e tij e qartë dhe logjike kishte kuptim dhe na bëri të qeshnim: “Çdo ditë ju i bëni fëmijët tuaj të lajnë dhëmbët, apo jo? Dhe

nuk keni frikë aspak që ata do të rriten dhe të rebelohen ndaj larjes së dhëmbëve!”⁴

Në rast se keni merak ende, kini parasysh se ky zakon që ju po përpiqeni të injektoni tek fëmijët tuaj është për të mirën e tyre. “Zakonet e shenjta janë disiplina, rutina nëpërmjet të cilave ne qëndrojmë gjallë dhe të fokusuar tek Ai. Në fillim i zgjedhim dhe i zbatojmë; më pas ato bëhen pjesë e asaj që ne jemi. Dhe pastaj janë ato na mbajnë ne”⁵

Ne thjesht po “kërkonim” nga fëmijët tanë atë që ata kishin parë mamin dhe babin të bënë çdo mëngjes për aq kohë sa mund të mbanin mend. Në fakt, ata tani i kujtojnë me nostalgji ato mëngjeset kur zbrisnin poshtë dhe shikonin mamin e tyre që lexonte Biblën në karrigen që ne e quanim Big Green (Jeshilja e Madhe), ose kur zvarriteshin poshtë mbulesave të “krevatit të madh” ku babai i tyre lexonte Biblën e tij. Strukur në batanije me Biblat e tyre, ata mësuan të provonin dhe shihnin mirësinë e Perëndisë.

Tani që ata janë të rritur, kjo praktikë e leximit të Biblës me zemra të hapura për të dëgjuar Frymën e Shenjtë është rrënjësor në jetët e tyre. Na jep kaq shumë gëzim dhe konfidencë teksa i shohim ata duke kërkuar Zotin në mënyrë aktive, duke pritur e dëgjuar çfarë Ai do që ata të dinë.

Kur vizitojmë Rebekën në L.A., ajo na fton në papafingon e vogël të apartamentit të tyre për një kohë të qetë leximi nën dritën e qirinjve. Udhëtimet e saj në Orient e kanë nxitur që në mënyrë të qëllimshme të krijojë një hapësirë të paqte, si një vend ku ajo takohet me Perëndinë përpara se të fillojë punën.

Elizabeth zgjohet tmerrësisht herët në mënyrë që të kalojë atë kohën e qetë duke shijuar Fjalën e Perëndisë përpara se fëmijët e saj të vegjël të zgjohen. Ata zgjohen çdo mëngjes duke i gjetur mamin dhe babin e tyre të zhytur në Shkrime.

John Mark është duke punuar tashmë për kalimin e kësaj disipline që të jep kënaqësi shpirtërore tek fëmijët e tij. Edhe kur vijnë për të fjetur në shtëpinë tonë, ai i udhëzon ata që ta nisin ditën e tyre në Shkrime. Kur djali i tij Juda, vullnetarisht lexoi të gjithë librin e Eksodit, John Mark e shpërbleu duke i ofruar ta nxirrte për një mëngjes të veçantë atë-bir në mënyrë që të mund të flisnin për të.

Kur Mathew ndiqte shkollën biblike dhe ndjente që shpirti i tij fillonte të fishkej në thatësinë e debateve të shumta teologjike, ai e

ripërsërishte atë kohën e qetë të mëngjesit si një mënyrë për të marrë ushqimin e freskët me të cilin Fryma na ushqen kur kemi vullnetin të dëgjojmë.

Dhe asnjë prej tyre nuk e bën këtë për shkak të rregullit JBJM!

A po themi që stabilizimi i një rutine mëngjesi që përfshin leximin e Biblës ndërkohë që fëmijët tuaj janë të vegjël garanton faktin që ata do të jenë studiues entuziastë të Biblës kur të rriten? Jo. Por nëse do t'i ushqeni, shpërbleni dhe inkurajoni këto takime mëngjesi me Perëndinë përmes Fjalës së Tij, ju do të shtroni rrugën që ata të vendosin vetë nëse kjo mënyrë e fillimit të ditës së tyre sjell ndryshim vërtet. Në vitet që do të pasojnë, fëmijët tuaj me shumë mundësi do të kenë luhatje në përdorimin e kësaj praktike derisa të përjetojnë në mënyrë personale intimitetin jetëndryshues me Perëndinë që është i mundur nëpërmjet studimit të Fjalës së Tij, dhe nuk do të duan ta humbasin atë.

Memorizimi i Shkrimit

Këto vite strukturimi janë koha ideale për të mësuar përmendësh Shkrimin. Truri i tyre është jashtëzakonisht i shpejtë për të memorizuar vargje, dhe nëse e bëni këtë së bashku, shumica e fëmijëve në këtë moshë shtyhen më shumë duke patur pak konkurrencë të shëndetshme. Kjo është gjithashtu moshë kur Fjala e Perëndisë mund të rrënjohet në mënyrë efektive në zemrën e fëmijës tuaj dhe të fillojë punën e saj të thellë.

Tek 2 Timoteut 3:16-17, Pali thotë: “I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi, që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer, tërësisht i pajisur për çdo vepër të mirë”.

Fryma e Perëndisë sjell jetë në shpirtin tonë, dhe në shpirtin e fëmijëve tanë nëpërmjet fjalëve të frymëzuara prej Tij.

Fjalët që memorizojmë së bashku mund të jenë mjetet e Tij për të mësuar dhe edukuar fëmijët tanë (dhe veten tonë) pikërisht në ato momente kur kemi nevojë për udhëzimin e tij. Fryma e Perëndisë më pas i sjell këto vargje në mendjen tonë, duke përdorur vetë fjalët e Tij për të na treguar të vërtetën kur kemi nevojë.

A e dini që nëse ju dhe fëmijët tuaj do të memorizonit vetëm një varg çdo javë për katërmbëdhjetë vjet, që kur fëmija juaj është katër vjeç deri sa të jetë gati të shkojë në universitet në moshën tetëmbëdhjetë

vjeçare, do të jenë 728 vargje të ngulitura në mendjen dhe zemrën e fëmijës tuaj!

Mirë, le të jemi të sinqertë tani: shumica prej nesh nuk do t'i mbanin mend 728 vargje. Por po sikur të memorizonim 400? Ose edhe 100? Këto vargje do të përdreshin nga Fryma për t'i folur djalit apo vajzës tuaj kur ju të mos jeni atje. A mund ta përdorni më mirë se kaq kohën tuaj?

Një nga familjet të cilës ne i referoheshim, kishte një sistem të thjeshtë duke përdorur fletë shënimesh në të cilat shkruanin vargjet e tyre. Çdo natë në tryezë (po, në fakt ata hanin darkë së bashku), ata flisnin për ditën e tyre dhe e kalonin fletën dorë më dorë. Secili anëtar i familjes thoshte vargun me zë të lartë, duke e parë, duke e dëgjuar dhe duke e prekur, derisa ta memorizonin. Më pas fillonin një varg të ri.

Dhëndri ynë, Steve, na tregoi për një nga kujtimet e tij të preferuara të fëmijërisë. Ai ftohej shpesh tek shtëpia e shokut të tij të ngushtë për darkë, dhe gjithmonë pranonte pasi mamaja e shokut të tij ishte kuzhinieri shumë e mirë! Por ajo që i tërhiqte vëmendjen ishte ajo që ndodhte pasi të gjithë përfundonin së ngrëni darkën.

Nëse Steve dhe shoku i tij ngriheshin nga tavolina me nxitim për të shkuar kudo që donin të shkonin, babai i tij i ndalonte, duke thënë: “Prisni! Ne gjithmonë lexojmë së bashku një kapitull nga Bibla me zë të lartë pas darkës. Dëgjojeni, dhe më thoni çfarë do t’ju tërheqë më shumë - pastaj mund t’ia mbathni!”

Në vend që të shkaktonte pakënaqësi, kjo praktikë e intrigoj Steve-n kaq shumë sa që ai vendosi që të bënte të njëjtën gjë kur të bëhej me fëmijë. Mos harroni; ju jeni të fokusuar tek zemra e fëmijës tuaj. Ju doni që fëmija juaj të gjejë kënaqësi në Fjalën e Zotit ashtu si Jeremia:

“Me të gjetur fjalët e tua, i përpiva; fjala jote ka qenë për mua gëzimi dhe gazi i zemrës sime, sepse emri Yt kërkohet nga unë o Zot, Perëndi i ushtrive” (Jeremia 15:16).

Kur fëmija juaj mësohet të gjejë kënaqësi në Perëndinë dhe të lidhet me Të duke dëgjuar Fjalën e Tij, ai kurrë nuk do të kënaqet me pak ushqim! Përkundrazi ai do të jetë si njeriu që përshkruhet në Psalmin 1: “Lum njeriu që nuk ecën sipas këshillës së të pabesëve, që

nuk ndalet në rrugën e mëkatarëve dhe nuk ulet bashkë me tallësit, por që gjen kënaqësinë e tij në ligjin e Zotit, dhe që mendon thellë ditë e natë mbi ligjin e Tij. Ai do të jetë si një pemë e mbjellë gjatë brigjeve të ujit, që jep frytin e tij në stinën e tij dhe të cilit gjethet nuk i fishken; dhe gjithçka bën do të ketë mbarësi” (Psa. 1:1-3).

Dita e Zotit

DIANE:

Një ditë kur djali ynë i madh ishte rreth tetë vjeç, ai erdhi tek unë dhe pyeti: “Çfarë dite është nesër?” Kur unë thashë, “e diel,” mbloodhi supet dhe shumë i prerë më tha: “Oh! Kjo është dita më e keqe e javës!”

Për t’i rënë shkurt, ai koment më bëri të mendoja gjatë dhe shumë se si po e trajtoja stresin e të dielës në shtëpinë e një pastori.

Phil gjithmonë largohej herët për në kishë që të bënte gati gjërat për shërbesat e shumta, ndërsa unë duhet të nxirrja fëmijët nga dera pasi të ishin pastruar – të lija darkën gati duke u pjekur në furrë ose në tenxhere, dhe sigurisht – duhet të vishesha edhe vetë gjithashtu me rroba të mira që të dukesh si gruaja e përsosur e pastorit.

Ufffff!

Gjithë ai presion që kisha mbi vete kishte krijuar një atmosferë të tensionuar në shtëpinë tonë aq sa John Mark vetëm tetë vjeç, i kishte tmerr të dielat!

Komenti i tij i drejtpërdrejtë nga zemra më nxiti të bëja disa ndryshime, t’i lija ca gjëra të shkonin, dhe në mënyrë të qëllimshme të filloja t’i shndërroja të dielat e familjes tonë në ditën më të bukur të javës.

Një nga ndryshimet e preferuara të fëmijëve të mi ishte kur u thashë që të mos i rregullonin krevatët të dielave në mëngjes, gjë që për mua, si një maniake pastërtie, ishte një gjë shumë e madhe! Kjo është pikërisht ajo që nënkuptojmë kur shkruajmë se duhet të

jeni të kujdesshëm që vlerat tuaja të mos ia presin rrugën synimit tuaj për të rritur ndjekës të pasionuar për Jezusin! Unë mund të kuptoja që vlera ime për një shtëpi të pastër kishte zëvendësuar vlerën tonë, që fëmijët të donin kishën.

Për t'i motivuar ata të nxitonin pa pasur nevojë t'i mikloja për t'i nxjerrë jashtë derës, u premtova se do t'i çoja në plazh për pak minuta ndërsa shkonim rrugës për në kishë nëse ata bëheshin gati në kohë. Meqë jetonim më pak se 1 milje nga plazhi i Santa Cruz, ky premtim ishte shumë i lehtë për t'u përmbushur. Sa shumë e shijonin momentin kur hiqnin këpucët dhe çorapet e tyre për një vrap të shpejtë nga makina deri në breg të oqeanit përpara kishës! I kam ende para syve të qeshurat në fytyrat e tyre plot gëzim dhe mbaj mend erën e këndshme të rërës dhe detit që zgjaste derisa shkonim në kishë.

Sa për darkat e të dielave, e zgjidhëm me një udhëtim të shkurtër me makinë për të blerë ushqim të shpejtë - një qerasje e veçantë, rrugës për në shtëpi.

Fëmijët tanë filluan ta pëlqenin shumë vajtjen në kishë; fakti që mami i tyre i mendoj gjërat në atë mënyrë, e bëri të mundur këtë gjë!⁶

Është e rëndësishme të kuptojmë qëndrimet që inkurajojmë tek fëmijët tanë ndaj kishës. A po u tregojmë atyre që ne gjejmë gëzim dhe kënaqësi kur shkojmë në kishë? Apo i zvarrisim pas vetes pa dëshirë dhe më pas hamë një “përgojim pastori” për drekë? Fëmijët tanë i dëgjojnë të gjitha dhe ne mund të lemerisemi nëse do të hidhnim një sy brenda kokës së tyre!

Nëse fëmija juaj reziston të shkojë në kishë, shfrytëzoni aftësitë tuaja drejtuese më bindëse e argëtuese. Merrni kohë për të kuptuar mënyrën se si fëmijët tuaj reagojnë ndaj programit të tyre të së dielës në kishë. Ju mund të gjeni mënyra për ta bërë të funksionojë si për introvertin tuaj hezitues, ashtu edhe për ekstrovertin tuaj gjithëpërfshirës.

Kur fëmija ynë më introvert po hezitonte të shkonte në grupin e tij javë pas javë, Diane u këshillua me drejtuesen e shërbesës së fëmijëve. Kjo grua e urtë sugjeroi që të provonim të vinim pesëmbëdhjetë

minuta më herët dhe të ecnim aty përreth me të. Në këtë mënyrë ai do ambjentohej me mjedisin duke qenë me mamanë e tij në krah dhe duke biseduar me mësuesen teksa ajo përgatitej për shërbesën.

Mbërritja herët parandalonte gjithashtu që ky fëmijë shumë i ndjeshëm të mos mbingarkohej nga zhurma dhe aktivitetet në klasë, nga fëmijët që lëviznin, flisnin dhe bërtisnin me zë të lartë. Teksa fëmijët e tjerë mbërrinin një nga një, ai futej gradualisht në ujërat sociale pa u ndjerë sikur do të fundosej.

Po tani? I njëjti djalë drejton një kishë në qendër të qytetit në Portland, duke përdorur aftësitë e tij udhëheqëse për të motivuar njerëzit të ecin me të në rrugën e Jezusit.

Përgjatë viteve kemi dëgjuar prindër që në kuptimin e mirë mendonin se nuk kanë të drejtë t'i "detyrojnë" fëmijët e tyre të shkojnë në kishë nëse ata nuk e ndojnë që të shkojnë. Ata druhen që fëmijët e tyre do të rriten duke e urryer kishën, pasi u duhej të shkonin atje çdo javë. Kur këta prindër ofrojnë udhëheqësi bindëse, por edhe të vendosur, pa diskutim që fëmijët e tyre do të reagojnë. Kështu që vazhdoni përpara dhe ftojini në diskutime, bëni pyetje, ndaloni për petulla rrugës - thjesht *shkoni në kishë!*

E vetmja mundësi tjetër e juaja lidhet me një term që sociologët kanë evidentuar për fëmijët që insistojnë të diktojnë vlerat e familjes së tyre dhe prindërit që dorëzohen ndaj: *Fëmijësundimit!*

Fëmijësundimi (Kindergarchy) përkufizohet si "Gjendja ose fenomeni i dominimit të fëmijëve, veçanërisht në kontekstin kur nevojave dhe preferencave të fëmijëve, u jepet një status i barabartë ose më i madh me atë të të rriturve".⁷

Ky është një gabim shumë i madh! Nëse fëmija juaj është i sëmurë, përpiquni që t'ia bëni ditën të lumtur dhe argëtuese, por pa e lejuar atë të bëhet "gjeli" i shtëpisë.

Duke shkuar rregullisht në kishë, ne po i modelojmë fëmijët tanë duke mësuar që ndjekësit e pasionuar të Jezusit jetojnë në bashkësi dhe mblihen së bashku me trupin e Krishtit. Ne po u tregojmë atyre që ne mblihem me njëri-tjetrin, e ndjejmë apo së ndjejmë për t'u mbledhur, dhe që bëjmë çmos t'i vëmë ndjenjat tona në të njëjtën vijë me atë që e dimë se është e vërtetë: kisha është familja jonë. Ne shkojmë atje për të qenë pjesë e asaj familjeje, për të dhënë dhe po ashtu edhe për

të marrë. Ne e duam kishën, dhe donim t'i mësonim edhe fëmijët tanë që ta duan kishën!

Ashtu si judenjtë përgatiteshin për Shabatin, ne mësuam që të dielat në mëngjes ishin shumë më të lumtura për të gjithë kur bëheshim gati për në kishë që në darkë. Mbrëmjet e të shtunave u bënë një kohë argëtuese duke u përgatitur për ditën e nesërme, së bashku.

Diane bëri gjithçka që mundej për të lehtësuar nxitimin e mëngjesit duke i vendosur pelenat në çantë që në darkë, bashkë me rroba shtesë, ndërkohë që Phil u jepte fëmijëve paratë që u takonin dhe u mësonte atyre vlerën e të dhjetës. Çdo javë ai llogariste kursimet e fëmijëve dhe më pas i ndihmonte ata të hiqnin mënjane dhjetë përqind për Perëndinë. Fëmijët kënaqeshin kur ngjyrosnin zarfet, duke bërë shënime dashurie për Zotin dhe duke futur zarfet e tyre në xhep për në mëngjes. Ishte një gjë kaq e thjeshtë, por funksionoi për mrekulli për të ngjallur në zemrat e fëmijëve tanë një ndjenjë përkatësie dhe qëllimi. Ata marshonin në kishë me zarfet e përgatitur me aq dashuri, të etur për të qenë pjesë e diçkaje më të madhe sesa vetja e tyre.

Mësojuni fëmijëve tuaj që gjithçka që kemi vjen nga dora e një Ati të mirë (Jak. 1:17). Ndhimojini ata të kuptojnë se gjithçka që kemi në të vërtetë i përket Atij (Psa. 24:1) dhe se kemi privilegjin të bashkëpunojmë me Perëndinë si administratorë besnikë (1Kor. 4:1-2).

Lexojuni Malakian 3:10 fëmijëve tuaj dhe mësojini që herët t'i japin Perëndisë pjesën e parë të çdo leku që fitojnë. Dhe mos harroni t'i mësoni që të japin me gëzim, pasi Perëndia kënaqet nga dhënës të gëzuar (2 Kor. 9:7).

Kjo praktikë, një disiplinë e gjallë shpirtërore do të mbetet tek ata përgjatë gjithë jetës së tyre, teksa mësojnë t'i besojnë Perëndisë se Ai do të sigurojë për çdo gjë që kanë nevojë, dhe teksa mësojnë të jetojnë me më pak, në mënyrë që të tjerët të kenë atë që u nevojitet.

Ndërsa vijmë në fund të kësaj pjese, mbani mend që Luka 2:52 thotë se “Jezusi rritej në urtësi, në shtat dhe në hir përpara Perëndisë dhe njerëzve”.

Fraza kryesore këtu është *rritej në*. Kjo fjalë në greqishten origjinale është prokóptō. Pro do të thotë *drejt*, ndërsa kopto do të thotë *të shtysh*. Jezusi *shtyhej drejt* urtësisë, në shtat dhe në hir ndaj Perëndisë dhe njeriut.

Kjo fazë strukturimi zgjat rreth gjashtë vite. Fëmija juaj do të pengohet gjatë rrugës, dhe ndonjëherë do të duhet të vrapojë për të kapur ritmin. Është në rregull! Ata po shtyhen drejt qëllimit për t'u bërë ndjekës të pasionuar për Jezusin.

DIANE:

Vajza jonë Rebeka ishte një nga ata fëmijë që dëshironte shumë t'i kënaqte të tjerët. Ashtu si shumë fëmijë që duan t'i kënaqin njerëzit, ajo ndonjëherë gënjente në mënyrë që të shmangte futjen në telashe. Kur ajo ishte rreth dhjetë vjeçe, e zura në një gënjeshtër të gjatë e të vazhdueshme. Pa rënë në sy, ajo kishte mashtruar për detyrat e matematikës; jo se nuk i kuptonte, por sepse donte t'i mbaronte shpejt dhe të shkonte në hambarin pas shtëpisë, për të hipur tek kali i saj. Pak përpara se ta kuptonim gënjeshtërën, Phil dhe unë kishim qenë duke u lutur për urtësi, duke u përpjekur të zbulonim përse vogëlushja jonë e lumtur papritur ishte bërë e hidhur dhe nevrrike. Këtë bën mëkati i fshehur, apo jo? Na bën të hidhur!

Kur zbulova se Rebeka po kopjonte, ajo u dërrmua, ishte vërtet e penduar dhe madje e lehtësuar që doli në pah ajo gjë. Ishte një nga ato momentet e rralla nga të cilat mund të mësosh. Mund të kemi shumë pak momente të tilla teksa rritim fëmijët tanë. Zemra e Rebekës në atë moment ishte krejtësisht e hapur dhe e ndjeshme. Lotët filluan t'i rridhnin në faqe.

U ulëm në verandë së bashku dhe kaluam një kohë të gjatë e të mirë duke folur për dështimin. Atë që Pali thotë tek Romakët 7:18-19:

“Në fakt unë e di se në mua domëthënë në mishin tim nuk banon asgjë e mirë, sepse, ndonëse e kam dëshirën për të bërë të mirën, nuk ia gjej mënyrën. Në fakt të mirën që unë e dua nuk e bëj; por të keqen që s'dua, atë bëj”.

Nuk e ndëshkova atë, pasi ky do të ishte një gabim fatal! Por thjesht e shtëngova në krahë vogëlushen time teksa ajo qante.

I tregova gjithçka rreth hirit mahnitës të Perëndisë; që Perëndia e mbulon mëkatën e saj dhe se liria është vetëm një hap pendimi larg. Që Ai e pret atë me krahë të hapur pavarësisht dështimit apo gjithçkaje tjetër. Dhe se mënyra e hirit nuk do të thotë të ndjekësh rregullat përsosmërisht, por të kthehesh prapë tek Jezusi sërish e sërish duke thënë: “Pa Ty nuk mund të bëj asgjë. Nuk mundem as të jem i sinqertë”.⁸

Unë pashë besimin e Rebekës të bëhej i vërtetë atë ditë në verandën tonë. E pashë të binte në dashuri me Shpëtimtarin e saj. Pashë progresin e besimit të saj në shërbesën e fëmijëve tek përparonte në një lloj besimi të vërtetë e të gjallë për të ndjekur Perëndinë, i cili do ta mbante pranë Tij në vitet që do të pasonin.

Mos u frikësoni nga dështimet e fëmijëve tuaj! Ashtu si për Palin, Pjetrin, Jakobin dhe Davidin, gabimet mund të jenë realitetet që do t'i sjellin ata në një besim të tyrin autentik.

Albert Einstein theksoi se: “Në mes të çdo vështirësie qëndron një mundësi”.

Sigurisht që ne duam t'i mësojmë fëmijët tanë rreth rrezikut të zakoneve mëkatore, por edhe më shumë, ne duhet t'i prezantojmë ata me një Shpengues që është në gjendje të heqë të keqen nga ne dhe të na bëjë njerëz që jetojnë krejtësisht për Të. Jini të vëmendshëm ndaj atyre momenteve prekëse të thyerjes, dhe tregojuni fëmijëve tuaj rrugën e hirit të mahnitshëm të Perëndisë. Mësojini atyre të vërtetën e bukur nga Romakët 8:1

“Tani, pra, nuk ka asnjë dënim për ata që janë në Krishtin Jezus”.

John Lawrence tha: “Të qenit i shkëlqyeshëm nuk konsiston në mosbërjen e gabimeve, por në atë se si veprojmë me to”.⁹

Mama dhe baballarë, mbani mend këtë: Ju nuk po përpiqeni të rritni fëmijë të përsosur; ju po përpiqeni të rritni fëmijë të perëndishëm; njerëz që e duan Perëndinë me gjithë zemrën e tyre dhe po rendin pas Jezusit.



Rritja e Ndjekësve Pasionantë për Jezusin

Ndërtimi i strukturës

(6 – 12 vjeç)

Synimi është të ndihmoni fëmijët tuaj të zhvillojnë një zemër të urtë: të aftësohen për jetën. Në këtë fazë, mos i provokoni fëmijët tuaj përmes një modeli të rëndomtë keqtrajtimi që i thyen ata shpirtërisht dhe rrënjës një pakënaqësi të thellë brenda tyre.

Pranë fundit të kësaj faze, fëmija juaj...

- Ka pranuar Jezusin si Shpëtimtar dhe Mbret.

- Ka kuptuar etikën e punës.

- Kupton dhe konsideron pagëzimin.

- Shfaq ndershmëri dhe integritet.

- Lexon Biblën në mënyrë të pavarur.

- I trajton të tjerët me hir dhe respekt.

- Memorizon Shkrimin.




1. Tregojani butësisht fëmijës tuaj gabimin. Mos e injoroni, shfaqësoni, ngrini zërin, apo të mendoni se do rritet dhe do ndryshojë. Përdorni Rregullin 10 vjeçar – pyesni veten: Si do të jetë kjo sjellje pas 10 vitesh?

2. Paralajmëroni me repretësi dhe mëshojni fort. Kjo duhet bërë në privatësi, jo në një mënyrë që i turpëron ata publikisht. Një paralajmërim që injorohet duhet të pasohet gjithmonë nga një veprim, jo më paralajmërimë boshe.

3. Qëndroni pranë tyre për t'i ndihmuar, ngushëlluar, dhe për t'u dhënë kurajo. Ky është mjeti më i rëndësishëm – përdoreni vazhdimisht & bujarisht. Fëmija juaj do të bëhet ai/ajo që ju i thoni se e shihni të bëhet.

4. Trajtoni fëmijët tuaj përmes praktikës. Mësojini vazhdimisht: "Jo ashtu.....kështu".

5. Thupra është një koncept biblik dhe duhet të trajtohet me lutje dhe me kujdes.... Asnjëherë në publik apo në zemërim, dhe asnjëherë për të lënduar.





Pjesa 4

Instalimi i Sistemeve Funktionale

Moshat 13-17 vjeç

“Prandaj, ashtu si e keni marrë Krishtin Jezus,
Zotin, ashtu pra ecni në të, duke patur rrënjë dhe
duke u ndërtuar në Të tani, forcohuni në besim
ashtu
sikurse ju mësuan, dhe duke mbushulluar
në falënderim” (Kol. 2:6-7).



Rritja e Ndjekësve Pasionantë për Jezusin

Instalimi i sistemeve funksionale

(13 – 17 vjeç)

Synimi është për të ndihmuar fëmijën tuaj të zhvillojë një zemër të *perëndishme*.

Në këtë fazë ju dëshironi të shihni që besimi i tyre të bëhet personal.

Pranë fundit të kësaj faze, fëmija juaj...

- Kupton pse dhe si të përballet me tundimin.

- Është i përfshirë me komunitetin e kishës.

- Stabilizon një përkushtim pastërtie personal.

- I pëlqen të kalojë kohë me familjen.

- Di se çfarë është i / e aftë të bëjë.

- Ka zhvilluar një kohë personale të qëndrueshme me Perëndinë.

- Punon fort.

- Zgjedh miqtë me mençuri.

4

GJËRA QË DO T'JU NEVOJITEN...

1. *GUXIM* për të qëndruar kundër rrymës. (Joz. 1:9)
2. *KËMBËNGULJE* për ta vazhduar trajnimin. (Heb. 5:14; 1 Tim 4:8)
3. *VENDOSMËRI* për ta mbajtur familjen pranë.
4. *URTËSI* për të kaluar përmes kësaj stine. (Jak. 1:5; 2 Kro 20:12)

3

SEKRETE PËR TË DISIPLINUAR GJATË VITEVE TË ADOLESHENCËS...

1. *KUTIA*
2. *NDËRRONI ROLET*
3. *PROCESI DHE FUQIA E APELIMIT*

3

GJËRA PËR TË CILAT DO TË KETË NEVOJË ADOLESHENTI JUAJ...

1. *TË ZBULOJNË* për çfarë janë të aftë. (Fj. e U. 22:6; 22:9)
2. *TË RUAJNË* pastërtinë e tyre. (Fj. e U. 4:23)
3. *PËR JU*....
 - praninë tuaj,
 - inkurajimin tuaj,
 - afeksinion tuaj

Kapitulli 15

Katër Gjëra Që Do T'ju Nevojiten

Disa vite më parë, rajoni i policisë së Houston publikoi një broshurë me titull: “Si të Shkatërroni Fëmijën Tuaj”. E shkruar në një mënyrë të veçantë, kjo broshurë për rritjen e fëmijëve jepte garancinë se ishte 99% efektive. Pjesërisht thoshte kështu:

“Kurrë mos i jepni ndonjë mësim shpirtëror. Prisni deri sa të jetë 21 vjeç dhe lëreni të vendosë për veten e tij se çfarë beson”.

Kjo është shumë larg nga ajo që ndodhte në Bet Sefer, ekuivalentja e shkollës fillore të hebrenjve në ditët e Jezusit, ku fëmijët deri në moshën dymbëdhjetëvjeçare kishin memorizuar pjesë të shumta nga Torah - pesë librat e parë të Biblës!

Në këtë pjesë do të flasim për vitet e adoleshencës, atë fazë zhvillimi në jetën e fëmijës tuaj midis moshës trembëdhjetë dhe shtatëmbëdhjetëvjeçare. Mbani mend, këto janë *faza*, jo *mosha*. Mendoni pak për ndryshimet mes një djaloshi trembëdhjetëvjeçar dhe një vajze shtatëmbëdhjetëvjeçare – ata ndahen nga një hapësirë e gjerë gjykimi i matur dhe mendësie e sofistikuar! Megjithatë parimet për të udhëzuar djalin apo vajzën tuaj gjatë këtyre viteve tejet të trazuara vlejné për çdo adoleshent.

Në fazën themelore, synimi juaj ishte të zhvillonit një zemër të bindur. Më pas kaluat tek faza e ngritjes së strukturës duke u fokusuar në urtësinë e zemrës - aftësia për të jetuar me vlera.

Ndërsa në vitet e adoleshencës, synimi që keni është ta shikoni fëmijën tuaj të zhvillojë një *zemër të perëndishme*. Ju dëshironi ta shihni besimin të përvetësuar prej tyre.

Siç na thotë Kolosianëve 2:7, ju dëshironi që fëmijët tuaj të jenë të rrënjosur dhe të themeluar në besimin e tyre, pikërisht ashtu siç i keni udhëzuar.

Ndryshe nga gjashtëmbëdhjetëvjeçarët të cilëve nuk u është

dhënë asnjë udhëzim shpirtëror, fëmijët tuaj janë udhëzuar prej jush për vite me radhë! Tani ju mund t'i shihni të fillojnë të vënë në jetë ato që u janë mësuar. Madje edhe më mirë, do t'i shihni ata duke shijuar ecjen e tyre me Jezusin.

Dikush më tha njëherë: “Mund ta mësosh fëmijën të jetë falënderues, por nuk mund ta detyrosh atë të jetë mirënjohës”. Perëndia duhet ta bëjë këtë vepër në zemrën e fëmijës tuaj.

Vazhdojmë analogjinë e shtëpisë, në instalimin e sistemeve funksionale - sistemi i ngrohjes, elektricitetit, ajrimit, hidraulik, e shumë të tjerë... Ju nuk doni që shtëpia juaj të duket bukur vetëm nga jashtë; ju dëshironi që të funksionojë siç duhet edhe përbrenda.

Në të njëjtën mënyrë, në përfundim të kësaj faze ju dëshironi të shikoni fëmijën tuaj ta jetojë jetën - duke funksionuar - si një ndjekës i përkushtuar i Jezusit; një djalosh apo zonjushë që është rrënjësor dhe themeluar në besim.

Kjo mund të jetë faza më shpërblyese e të gjitha fazave në jetën e fëmijës tuaj - sinqerisht!

Kur ndërtoni një shtëpi, hedhja e themeleve është punë e rëndë. Është e vështirë të imagjinohet se si do të duket ajo shtëpi. Më pas strukturimi ju krijon një ide dhe bëhet edhe më shumë argëtuese. Imagjinata juaj zë vend dhe filloni të emocionoheni.

Më pas duket sikur krijohet një pauzë, teksa instalohen të gjitha sistemet. Nuk është shumë emocionuese, por ju e dini se në këtë mënyrë kjo shtëpi do të bëhet shtëpi e vërtetë, do të jetë e ngrohtë, me dritat që do të ndizen kur ju të keni nevojë për to.

Kjo është ajo që fillon të ndodhë në vitet e para të adoleshencës. Ju keni bërë gjithë atë punë dhe tani mund ta shihni të funksionojë. Dritat fillojnë të ndizen. Fëmija juaj fillon të ngjajë si një djalosh apo zonjushë që i përket Perëndisë. Ngrihet herët në mëngjes të lexojë Biblën, përpara se të shkojë për në punën verore tek Starbucks.

DIANE:

E mbaj mend shumë mirë herën e parë që pashë Rebekën të zgjohej çmendurisht herët që të lexonte Biblën përpara se të shkonte në punë tek një dyqan kafeje. U zgjova në katër të mëngjesit dhe vura re një dritë ndezur nga korridori. Mendova se mos ndoshta njëri nga fëmijët ishte sëmurë, kështu që u ngrita me nxitim nga krevati im i ngrohtë që të shikoja ç'bëhej.

Beka ishte zgjuar dhe qëndronte ulur në krevatin e saj duke lexuar Biblën.

Kur e pyeta se çfarë po bënte zgjuar, kur kishte edhe një orë kohë para se të nisej për në punë, ajo tha: “Unë thjesht nuk mund të shkoj atje pa këtë kohë me Perëndinë. Është më e vështirë nga sa e mendon mami. Kam nevojë për këtë”.

Ajo nuk po e bënte për shkak të rregullit të vjetër JBJM! Por po gërmonte nëpër Fjalën e Perëndisë pasi e ndjente të nevojshme në mënyrë personale. Mahnitëse! Ajo po ndërtohej dhe po themelohej në një besim të vetin, ashtu siç i kishim udhëzuar për vite me radhë. Por sërish, u shokova pak - kishte funksionuar! Vajza ime donte Jezusin.

Kjo më dha aq shumë gëzim sa nuk mund të rrija pa kërcyer ndërsa kthehesha për në dhomën e gjumit!

Mbani mend: ju jeni duke bashkëpunuar me Perëndinë, teksa Ai po ndërton një shtëpi frymore brenda fëmijës tuaj. Perëndia po e tërheq djalin ose vajzën tuaj drejt Vetes së Tij, dhe Ai dëshiron fort që ata të jenë pranë Tij - madje edhe më shumë se sa ju!

Ju, mami dhe babi, jeni instrumenti parësor në duart e Perëndisë për ta arritur këtë. Teksa ju qëndroni sa më pranë Tij, Ai do të punojë bujarisht brenda dhe nëpërmjet jush për ta afruar fëmijën tuaj në një marrëdhënie personale dhe autentike me Të.

Me këtë pamje në mendje, megjithëse e dimë që këto vite mund të jenë sfiduese, ne duam t'ju japim katër gjëra që do t'ju nevojiten për t'u orientuar gjatë këtyre viteve të adoleshencës.

GUXIM, PËR TË QËNDRUAR KUNDËR RRYMËS

Kur Izraelitët u përballën me pengesat e frikshme gjatë rrugës për të hyrë në tokën e premtuar, Perëndia i tha këto fjalë udhëheqësit të tyre, Jozueut:

“Ky libër i ligjit mos u ndaftë kurrë nga goja jote, por mendohu për të ditë e natë, duke kërkuar të veprosh simbas të gjitha atyre që janë shkruar, sepse atëherë do të kesh sukses në veprimet e tua, atëherë do të përparosh. A nuk të urdhërova unë? Ji i *fortë dhe i guximshëm*; mos ki frikë dhe mos u thyej, sepse Zoti, Perëndia yt, është me ty kudo që të shkosh” (Jozueu 1:8-9).

Mbani mend, ju jeni në partneritet me Perëndinë, i Cili ju jep guxim! Ai dëshiron fort që biri ose bija juaj ta dojë dhe t’i shërbejë Atij. Ai është duke punuar në zemrën e fëmijës tuaj. Teksa afroheni dhe luteni, Ai do t’ju japë guximin që ju nevojitet për të qëndruar kundër rrymës së të menduarit në mënyrë të gabuar që kërcënon të largojë fëmijën tuaj prej Tij.

Çdo prind e di se do të përballlet me disa sfida të vështira gjatë viteve të adoleshencës. Ndonjëherë mund të ndiheni sikur do të dorëzoheni, të hiqni dorë dhe të vraponi tutje duke i lënë fëmijët në mënyrat e tyre.

Këtu hyn guximi - dhe një sens humori i pakuptimtë!

Dikush pyeti një herë me shaka: “A e dini pse Perëndia i kërkoi Abrahamit të ofronte Isakun si sakrificë kur ai ishte dymbëdhjetë vjeç? . . . Sepse në moshën trembëdhjetëvjeçare nuk do të ishte më një sakrificë!”

Mark Twain ka thënë: “Kur një djalë mbush trembëdhjetë vjeç, duhet ta futni në një fuçi dhe ta ushqeni përmes një vrime . . . kur të mbushë gjashtëmbëdhjetë, duhet ta zini/blokonti vrimën!”¹

Sidoqoftë, nëse e keni bërë punën e vështirë në fazat e hershme, këto vite nuk kanë pse të jenë barrë; në fakt mund të jenë një kënaqësi!

Sigurisht, ka disa fëmijë që do të luftojnë kundër autoritetit të prindërve të tyre në këtë fazë. Ata i rezistojnë udhëzimeve dhe kjo i tondon prindërit të heqin dorë, të distancohen në një vend të sigurt,

ku thjesht do të rrinë të qetë, ose më keq, të pozicionohen në një lloj mosmiratimi agresivo-pasiv që ua heq trurin. Sarkazmat dhe fjalimet e fryra në rrjetet sociale janë shumë të zakonshme, jo vetëm mes adoleshentëve, por po ashtu dhe mes prindërve të adoleshentëve!

Kemi folur me shumë studentë në kishën tonë, të cilët në fakt ndiheshin sikur prindërit i kishin braktisur gjatë viteve të tyre të adoleshencës. Duam t'ju paralajmërojmë, sepse ne mendojmë që ata prindër nuk e kishin idenë se fëmijët e tyre do ta interpretonin tërheqjen nga ana e tyre si braktisje. Ata thjesht nuk dinin se si të bënin ato bisedat e parehatshme rreth seksit. Nuk mund të kuptonin se si t'u jepnin adoleshentëve të tyre pak liri të arsyeshme, dhe prapë se prapë të qëndronin të përfshirë në jetën e tyre sentimentale. Ata thjesht nuk dinin çfarë të bënin, kështu që tërhiqeshin pas.

Në këtë fazë të jetës së fëmijës tuaj, duhet të jeni të gatshëm të jeni i keq ndonjëherë. Maria, një grua shumë e urtë e cila rriti katër ndjekës të pasionuar të Jezusit, na dha këtë këshillë: *Luftoni për fëmijën tuaj!*

Ajo pikturoi një pamje të gjallë ndërsa përshkruante ndjesinë sikur ishte kapur pas bluzës së vajzës së saj teksa e bija, të cilën e donte aq shumë, qëndronte varur në cep të një shkëmbi. Vajza mund të kishte rënë nga ai shkëmb dhe të ishte thyer keq, nëse Maria nuk do të kishte këmbëngulur që të kapej fort pas saj. Ajo refuzoi ta braktiste të bijën në gjykimin e saj të dobët.

Refuzoni ta braktisni fëmijën tuaj!

Ndonjëherë gjatë viteve të adoleshencës, ndoshta do të duhet të jeni të gatshëm ta sakrifikoni përkohësisht marrëdhënien tuaj me adoleshentin/en tuaj në mënyrë që ta ruani atë nga vetëshkatërimi. Por merrni zemër! Dhe jini të duruar.

Adoleshenti juaj është i vetëdijshëm për dëshirën që ju keni për ta ndihmuar. Ai e di se është dashuria ajo që ju shtyn të hetoni një aktivitet; e kupton që ju po e mbron mirëqenien e tij nga kërcënimet e panjohura. Por gjithë ato hormone, presione dhe frikëra të përfshira në këtë fazë pothuajse-por-jomjaftueshëm – të rritur, shpesh i sabotojnë aftësitë e adoleshentit për të komunikuar me mirësjellje.

Një studim zbuloi se: “Gjetja e balancës së duhur mes lirisë dhe kufizimeve provoi të ishte një propozim taksativ për prindërit që intervistuum”²

DIANE:

Nuk është gjithmonë një kompliment kur vajza juaj thotë në këtë fazë: “Mami është shoqja ime e ngushtë”. Edhe pse ishim të afërta me njëra-tjetrën, asnjëra prej vajzave të mia nuk thoshte se unë isha shoqja e tyre e ngushtë kur ato ishin pesëmbëdhjetë vjeçe! Kjo vjen më vonë.

Vajzat tona kishin nevojë që unë të isha e gatshme të qëndroja e fortë për to, kur ato lëkundeshin, t’i ndihmoja të bënin gjënë e duhur, kur gjëja e duhur dukej e pamundur për to. Për asnjë çast nuk dyshonin në dashurinë time për to; në fakt, duke i dashur edhe në kohë sprovash ishte një mënyrë e thjeshtë për t’u treguar atyre dashurinë besnike të Perëndisë.

KËMBËNGULJE, PËR TË VAZHDUAR TRAJNIMIN

Është shumë shpejt të hiqni dorë. Ndoshta jeni lodhur, flokët tuaj mund të kenë filluar të thinjen, dhe po përballeni me vitet e tmerrshme të adoleshencës, duke u përshtatur me rebelimin që ju kanë thënë se është i pashmangshëm.

Ju *mund* të rritni fëmijë që nuk rebelohen. Josh McDowell i kujton prindërit se: “rregullat pa marrëdhënie çojnë në rebelim”.³ Po, ekziston një zmbropsje natyrore (ndonjëherë e rrëmujshe), por nuk janë rregullat tuaja përgjegjëse për rebelimin e tyre. Është marrëdhënia e thyer ose e dëmtuar që shpesh i shtyn fëmijët kundër prindërve të tyre.

Në këtë pikë të jetës së fëmijëve tuaj, synimi që ju keni është që ata të piquen shpirtërisht. Ata nuk janë më bebe; po fillojnë të kalojnë nga “qumështi” tek “mishi”. Kjo është ajo që autori i Hebrenjve nënkupton kur shkruan:

“Ushqimi i fortë është për të rriturit, të cilët, nga përvoja, i kanë të zhvilluara vetitë për të dalluar të mirën dhe të keqen” (Heb. 5:14).

Mbani mend se një nga fjalët greqisht e përkthyer *trajnim* është ajo nga e cila rrjedh fjala *palestër*. Palestra është një vend stërvitje ku ushtrohesh për t'i dhënë trupit një formë të mirë apo për të qëndruar në formë. Këtu është përdorur në mënyrë metaforike për të shprehur idenë e trajnimit me qëllim perëndishmërinë.

Pali donte që “biri i tij në besim”, Timoteu, të kuptonte që “ushtrimi i trupit është i dobishëm për pak gjë, kurse perëndishmëria është e dobishme për çdo gjë, sepse përmban premtimin e jetës së tanishme dhe të asaj që do të vijë” (1 Tim. 4:8).

Kështu që mos e ndalni stërvitjen! Vazhdojeni trajnimin; qëndroni të përfshirë në mënyrë aktive në jetën e adoleshentit tuaj.

VENDOSMËRI, PËR TË MBAJTUR FAMILJEN PRANË

Gjatë kësaj stine, mbajtja e familjes pranë do të jetë një nga sfidat tuaja më të mëdha. Nuk do të ndodhë pa përpjekje të bashkërenduara dhe planifikim të qartë. Duhet ta *bëni* ju të ndodhë.

DIANE:

Mama, kjo është më së shumti në dorën tonë. Do të duhet të jeni krijuese dhe të vendosura. Oraret e punës, stërvitjet e ndryshme, detyrat e shumta të shtëpisë, dhe nevojat shoqërore në rritje do të duket sikur komplotojnë kundër përpjekjeve tuaja për të mbajtur familjen të bashkuar. Mos hiqni dorë!

Meqë ra fjala, ky është një rol që do të duhet ta luajmë për gjithë pjesën tjetër të jetës në mënyrë që familjet tona të qëndrojnë të lidhura ngushtë. Edhe tani, me katër fëmijë të martuar dhe një grup nipërisë e mbesash që po rriten, jam më së shumti unë ajo që inicioj planifikimin e nevojshëm për ta mbajtur familjen pranë.

Katër Mënyra Për Ta Mbajtur Familjen Pranë

Darkat familjare

Gjithçka do të duket sikur punon kundër të mbledhurit të familjes tuaj rregullisht për të ngrënë një vakt së bashku. Por nuk ka asgjë që t'i për afrohet miqësisë që vjen kur ndani jetët tuaja rreth tryezës.

Sipas një studimi të vitit 2009, 4 adoleshentët që marrin pjesë rregullisht në vaktet familjare (pesë deri në shtatë vakte familjare në javë) janë më pak të prirur të përfshihen në sjellje të rrezikshme. Nga ana tjetër, fëmijët që rrallë ulen për të ngrënë vakte me familjen e tyre (më pak se tre herë në javë) janë dyfish më të prirur të përdorin duhan ose marijuanë dhe një herë e gjysmë më të prirur të përdorin alkool. Sikur të mos mjaftonte kjo, adoleshentët që kanë më pak se tre darka familjare mesatarisht gjatë një jave, në mënyrë të dukshme marrin nota më të ulëta përgjatë shkollës së mesme. Këto statistika janë serioze, por sërish mund t'u gjendet zgjidhja!

Përdorini vaktet për të diskutuar rreth problemeve që dalin gjatë jetës së fëmijëve tuaj, për të diskutuar rreth momenteve më të bukura ose të vështira të ditës së tyre. Sigurohuni që të ketë atmosferë miqësore dhe të qeshura. Shijojeni miqësinë e njëri-tjetrit teksa ushqeheni me ushqim të mirë.

Me sporte, aktivitete shkollore, dhe punë me kohë të pjeshme, mund të mos jetë e mundur të merrni pjesë në darka familjare çdo natë, por ju mund të planifikoni disa mbërme konkrete.

Miku dhe agjenti ynë letrar Bill Jensen e bëri darkën e të dielës momentin kryesor të javës së tyre familjare kur vajzat e tij ishin adoleshente. Puna që bënte zakonisht e mbante larg shtëpisë gjatë ditëve të javës, por ai gjithmonë bënte çmos që të ishte i pranishëm në shtëpi gjatë fundjavës. Duke qenë se atij i pëlqen të gatujë, dhe të gjithëve u pëlqen të hanë çfarëdo që ai gatuan, iu duk një mënyrë interesante për ta mbajtur familjen e tij pranë.

Bill ishte vërtetë i zgjuar! Ai e la ftesën të hapur në qoftë se të bijat donin të ftonin shoqe apo të dashurit e tyre në shtëpi në darkën e së dielës, dhe sigurohej që pasditja të ishte argëtuese për të gjithë.

Në librin e saj më të shitur *"Bukë dhe Verë"* (Bread and Wine), Shauna Niequist paraqet një tablo të asaj që përfaqëson darka familjare:

“Ne nuk vijmë në tryezë për t'u grindur apo për t'u mbrojtur. Ne nuk vijmë të vërtetojmë ose të hedhim poshtë, të kufizojmë apo të krijojmë telashe. Ne vijmë në tryezë sepse uria jonë na sjell aty. Ne vijmë me një nevojë, një brishtësi

dhe duke pranuar se jemi njerëzorë . . . Tryeza është vendi ku të bërit e gjërave ndalon, përpjekjet ndalojnë, maskat hiqen, dhe ne e lëmë veten të ushqehemi, si fëmijë. Ne lejojmë dikë tjetër të plotësojë nevojat tona . . . tryeza është një vend sigurie dhe pushimi njerëzor, ku na lejohet të jemi aq të brishtë sa ndihemi”.⁵

Lëreni tryezën *tuaj* të jetë ky vend ushqyes i sigurt për të gjithë familjen tuaj.

Shkoni për pushime së bashku

Asnjëherë nuk kemi patur mundësi financiare që t'i çonim fëmijët tanë me pushime luksi, por kemi gjetur mënyra që të shkojmë me pushime së bashku çdo vit, edhe kur fëmijët tanë ishin adoleshentë. Duhet të ishim krijues, dhe ndoshta kjo ishte një nga arsyet që argëtoheshim aq shumë.

Më së shumti shkonim për kamping ose tek shtëpia e pushimit e prindërve të Diane në Malet Sierra në Kaliforni. Notonim në liqenet akullnajore dhe kishim zbuluar disa pjesë të rrëshqitshme pranë disa lumenjve. Peshkonim dhe digjeshim nga dielli, bënim ngjitje në mal dhe kalonim kohë si kishë-familje atje lart nëpër male. Një herë teksa Phil po luante në kitarë me pamje mbi Sierrat, një gjarpër me zile i fshehur mbante ritmin me këngën tonë. Nuk mund t'ia mbathnim nga ai vend me shpejtësinë e mjaftueshme!

Refuzonim të merrnim shokët e fëmijëve me vete, sepse donim që adoleshentët tanë të shijonin shoqërinë e njëri-tjetrit. Në adoleshencë, jetët e tyre u bënë shumë të zëna, gjë që e vështirësonte gjetjen e kohës për të njohur, shijuar dhe thjesht për të qëndruar së bashku. Ne po shpresonim të krijonim një lidhje mes katër fëmijëve tanë që do të shkonte përtej kohës që ishin në shtëpi – një miqësi e vërtetë që do të zgjaste gjatë edhe kur ne të mos kishim më rolin autoritar në jetët e tyre.

Kur Matt ishte i vetmi që ishte ende në shtëpi, e lejonim atë të merrte një shok. Por siguroheshim që të ishte një shok që ai dëshironte ta sillte dhe që ne e pëlqenim! Dikush që të ishte i aftë të hynte në familjen

tonë thjeshtësisht dhe të ndihmonte e jo të pengonte aftësitë e djalit tonë për t'u argëtuar. Një herë madje blemë një biletë avioni kthimi për një shok të tij të cilit i duhej të kthehej për stërvitjen e bejsbollit. Ishte një investim i madh!

Meqë adoleshentët tuaj me shumë mundësi do të kenë një punë verore, do t'ju duhet të planifikoni kohë më parë, duke u dhënë paraprakisht datat në mënyrë që të marrin leje nga puna.

DIANE:

Adoleshentët djem e barazojnë kohën e lirë me ushqimin e mirë, kështu që kur shkonim me pushime gatuaja më shumë se kurrë! Një mentore e urtë më këshilloi që t'i shikoja pushimet familjare si një kohë të veçantë për t'u rritur më shumë si familje në vend që t'i shikoja si kohë pushimi për veten time. Në periudhën që kishim adoleshentët, e dija se koha jonë së bashku do të ishte e kufizuar, kështu që dëgjova këshillën e saj dhe u sigurova që djemtë e mi adoleshentë të kishin majftueshëm nga ushqimet e tyre të preferuara për sa kohë ishim në kamping ose në shtëpinë e pushimit. Dukej sikur ata e kishin kuptuar këtë disi, duke i bërë të vlefshme përpjekjet e mia.

Tani, me nipin tonë të madh në prag adoleshence, familja e tij çdo vit e kalon një pjesë të pushimeve verore me familje të tjera nga grupi i komunitetit përreth tyre. Kështu që nipërit tanë kanë avantazhin e të jetuarit me njerëz të ndryshëm të cilët e jetojnë jetën në mënyra të ndryshme. Në të njëjtën kohë, ata kanë mundësi të përjetojnë eksperiencat e familjeve me vlera të ngjashme dhe me një dashuri të përbashkët për Jezusin.

Jini aty kur adoleshenti juaj kthehet në shtëpi

Nëse ka ndonjë mundësi - dhe ne e dimë që nuk është gjithmonë e mundur - bëni çmos që njëri prej jush të jetë në shtëpi dhe të jetë i lirë kur adoleshenti juaj kthehet nga shkolla çdo ditë. Disave prej jush mund t'ju duhet të bëheni krijues në mënyrë që të realizohet kjo gjë.

Ndoshta do të thotë të ndërroni orët pas shkolle me një shoqe që ndan të njëjtat vlera si ju. Ndoshta do të thotë të lini një shënim inkurajues ose të telefononi sapo djali ose vajza juaj të shkojë në shtëpi.

Pse? Sepse kjo është një moshë e rrezikshme për të qenë vetëm dhe të pambikqyrur. Interneti është një plotësues i shpejtë vetmie. Që fëmijët tuaj të dinë se ju po i prisni të vijnë në shtëpi, se kanë vëmendjen tuaj të plotë, se mikpritja e tyre është e ngrohtë dhe pranuese - janë dhurata të rralla dhe një mbështetje e fortë për vajzën apo djalin tuaj adoleshent që ka dëshirë të ecë me Perëndinë, por gjykimi i të cilit është ende në zhvillim dhe emocionet e tyre mund të jenë shumë delikate. Nëse ju do të jeni aty me ndonjë gjë të lehtë për të ngrënë dhe me kohë për të dëgjuar, ato do të jenë disa nga bisedat tuaja më zbuluese dhe interesante.

DIANE:

Uroj ta kisha kuptuar se çfarë shërbese me ndikim të lartë kisha në dispozicion përgjatë kësaj faze të jetës së fëmijëve tanë. Unë isha një mama shtëpiake me një vogëlush që më mbante të zënë, ndërkohë që djali im më i madh kishte filluar gjimnazin. Lehtësisht mund të kisha ftuar shokët e fëmijëve në shtëpinë tonë pas shkolle!

Një shoqe e imja ishte nënë beqare dhe po rriste e vetme katër fëmijë. Tani shikoj pas me shumë keqardhje që isha aq e pavëmendshme ndaj nevojës së saj. Edhe pse nuk ishte e lehtë, ne arritëm t'ia dilnim me një rrogë të vetme, por për disa nga miqtë tanë kjo ishte totalisht e pamundur. Kjo është mënyra se si trupi i Krishtit funksionon më së miri: kur jemi të vëmendshëm ndaj nevojave të njëri-tjetrit dhe ofrojmë të hedhim një hap e të ndihmojmë me sa mundemi.

Bëjeni shtëpinë tuaj vendin ku miqtë e tyre kanë dëshirë të mblidhen

Kur fëmijët tanë ishin adoleshentë, u surprizuam ndërsa zbuluam se sa pak prindër ishin të gatshëm të hapnin shtëpitë e tyre për miqtë e fëmijëve të tyre. Duke qenë se adoleshentët pëlqejnë shumë të mblidhen në grup, kjo gjë bëhej problem.

Ashtu si prindërit tanë kishin bërë për ne, edhe ne i hapëm dyert e shtëpisë tonë për këta fëmijë. Sigurisht, ata “ia shkelnin” në shtëpinë tonë. Qilari juaj do të boshatiset, tapeti do të bëhet me njolla, divani juaj do të vuajë. Adoleshentët djem mbajnë me vete një lloj parfumi, ndërsa vajzat adoleshente ndonjëherë lënë gjurmë të manikyrit të thonjve në banakun e tualetit. Por është kaq e vlefshme! Nëse tregoni sado pak interes në jetën dhe mirëqenien e tyre, ata fëmijë do të bëhen përkrahësit tuaj më të mëdhenj. Dhe ju do të keni një shërbesë në jetët e tyre që do të korrë shpërblime të pallogaritshme!

Kur djali ynë i madh ishte në shkollë të mesme, gjithë shokët e tij mblidheshin tek shtëpia e Jaegers. Mamaja e tij, Myrna, organizonte festa spontane sa herë që fëmijët shkonin atje për vizitë. Në fakt, ajo kishte dedikuar një dollap të tërë nga kuzhina e saj me ushqime për fëmijët. Ajo pyeste secilin prej miqve se cili ishte ushqimi i tij i preferuar. Më pas ajo sigurohej që ta mbante rezervë këtë ushqim në dollap dhe të shkruante emrin e fëmijës me shkronja të zeza e të theksuara në pjesën e përparme të kutisë.

Myrna u bë mamaja e të gjithëve. Ajo kujdesej për miqtë e fëmijëve të saj, dhe ata e dinin se ajo e bënte këtë. Shtëpia e saj ishte një shtëpi e sigurt, e ngrohtë dhe mikpritëse - dhe plot! Sigurisht, fakti që ajo kishte dy vajza të bukura i shtohej listës.

Myrna po zbatonte modelin e Galatasve 6:10: “Prandaj, sa të kemi rast, le t’u bëjmë të mirën të gjithëve, por në radhë të parë atyre që janë në familjen e besimit”. Çdo komunitet ka nevojë për disa Myrna Jaegers që të hapë dyert e shtëpisë së saj si një vend i sigurt dhe argëtues ku adoleshentët mund të mblidhen.

URTËSI, PËR TË KALUAR PËRMES KËSAJ STINE

Gjatë viteve të adoleshencës, ju do të përballeni me vendim pas vendimi dhe nuk do të ketë një varg të qartë biblik që t’ju tregojë se çfarë duhet të bëni!

Disa herë ju mund të ndiheni si ai dreri që shtanget para fenerëve të makinës që i afrohet, nga ngjarje dhe vendime që vijnë tek ju aq shpejt, saqë ndiheni si të ngrirë në vend. Intensiteti i këtyre viteve është plotësisht ndryshe nga vitet e fëmijërisë, megjithatë të njëjtat ndjesi të të qenit të mbingarkuar do të rëndojnë mbi ju. Ju e doni djalin ose vajzën

tuaj me një përkushtim aq të madh, e megjithatë ndiheni të pafuqishëm për t'i mbrojtur ata nga një rrugë plot me zgjedhje të rrezikshme.

Ne e dimë. Kemi qenë në atë fazë. Megjithëse kishte më shumë kohë të mira se sa të këqija, frika, merak, mendimi se gjithçka mund të shkonte keq ishte pjesa më e vështirë. Tani ne shohim pas në ato re të zymta shqetësimi që shpeshherë përndiqnin netët tona, dhe nuk ndjejmë gjë tjetër përveç falënderimit me përlësi ndaj Perëndisë, i Cili ishte me ne në mes të frikës tonë. Jo sepse Ai ka zgjidhur çdo dilemë me të cilën përballëshim - nuk e ka bërë këtë, por sepse ngushëllimi i Tij na ka mbajtur kur jemi kthyer tek Ai, dhe Fryma e Tij na ka mësuar teksa i kemi thirrur Atit duke i kërkuar urtësinë që na mungonte. Ne përjetuam premtimin e shkruar tek Jakobi 1:5; “Por në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtia, le të kërkojë nga Perëndia, që u jep të gjithëve pa kursim, pa qortuar, dhe atij do t'i jepet”.

Herë pas herë, ne shtriheshim në krevat në darkë duke folur për fëmijët tanë. Në qetësinë e dhomës tonë të gjumit, pas një dite të gjatë prindërimi në mes të përditshmërisë së jetës dhe presioneve që ajo mbart, sillnim djemtë dhe vajzat tona adoleshentë tek Perëndia. Luteshim në mënyrë specifike dhe të vazhdueshme, duke u rikthyer sërish e sërish tek i Vetmi që ka përgjigjet që ne nuk i kishim.

Ne luteshim me lutjen që çdo prind adoleshenti ka nevojë ta dijë, e marrë drejtpërdrejt nga 2 Kronikat 20:12. Një situatë dërrmuese, e predispozuar për një fund jo të mirë, por e mirëpërballuar nga njerëzit e Perëndisë ndërsa i thërrisnin Atij:

“Ne nuk dimë çfarë të bëjmë, por sytë tanë janë tek Ti”⁶

Dhe ne e pamë Atë të përgjigjej sërish dhe sërish! Duke u lutur në mbrëmje, e më pas duke u ngritur herët në mëngjes për të hulumtuar Shkrimet rreth urtësisë për të cilën ishim të sigurt që Ai e mbante për ne, gjetëm përgjigjet - përgjigjet që funksiononin.

Tek Fjalët e Urta kapitulli dy, këto fjalë u bënë motoja jonë:

“Duke i vënë veshin diturisë dhe duke e prirur zemrën ndaj arsyes; në rast se kërkon me ngulm gjykimin dhe ngre zërin për të siguruar mirëkuptim, në rast se e kërkon si argjendin dhe fillon të rrëmosh si për një thesar të fshehur, atëherë do të ndjesh frikën e Zotit dhe ke për të gjetur kuptimin e Perëndisë” (F. e Urta 2:2-5); “dhe ke për të zbuluar njohjen e Perëndisë. Sepse Zoti jep urtësinë!” (F. e Urta 2:5, 6).

Për prindërit e adoleshentëve, kjo mënyrë për ti kërkuar urtësi Perëndisë vazhdimisht në Shkrim është diçka thelbësore. Nuk ka një rregullore për t'u ndjekur. Çdo fëmijë, çdo shtëpi, çdo situatë është mjaftueshëm e ndryshme, sa të kërkojë njohuri dhe të kuptuar të cilat, larg Perëndisë, thjesht nuk jemi të aftë t'i kemi. Kjo stinë e jetës tuaj nuk duhet të jetë një periudhë dembelizmi shpirtëror! Ju nuk duhet të lejoni të jeni neglizhentë në lutje, në devocionet personale, ose në përfshirjen tuaj në komunitetin e kishës.

Shumicën e kohës, kur kërkonim për urtësinë e Perëndisë, Ai na e jepte në mëngjes herët ndërsa dëgjonim nga Fjala. Shpesh herë Zoti na jepte qartësi në mes të një predikimi të së dielës që nuk kishte të bënte fare me dilemën tonë, ose në një koment kalimtar nga ndonjë mik i urtë i mbushur me Frymën e Shenjtë. Ne kërkonim këshilla nga njerëz më të urtë dhe me më shumë përvojë në rritjen e fëmijëve sesa ne, dhe fjalët e tyre shpesh e plotësonin menjëherë nevojën që ne kishim.

Fjalët e A.B Simpson janë një kujtesë me vend për çdo prind:

“Perëndia e ka fshehur çdo gjë të vlefshme në mënyrë të tillë që të jetë një shpërblim për të zellshmin, por një zhgënjim për dembelin ... E gjithë natyra është stolitur kundër përtacëve ... Arra është e fshehur në lëvozhgën e saj plot gjemba; perla qëndron e groposur nën dallgët e oqeanit; floriri është i burgosur nëpër shkëmbinj të maleve; guri i çmuar gjendet vetëm pasi ju thërrmoni shkëmbin që e mbështjell atë. Ndaj e vërteta dhe Perëndia duhen kërkuar me zell”.⁷

Kur ne e kërkonim urtësinë e Perëndisë, Ai e derdhte atë bujarisht mbi ne! Perëndia do të bëjë të njëjtën gjë për ju nëse ia kërkonit Atij, nëse do të kërkonit për të si për një thesar të fshehur, nëse do të vini tek Ai për atë që ju nevojitet. Fëmijët tanë tashmë të rritur po mësojnë atë që ne mësuam teksa i rritnim ata: Prindërimi nuk është një shkencë ekzakte me përgjigje të qarta, por Perëndia ka gjithë urtësinë që na nevojitet në duart e Tij, dhe Ai është më shumë se i gatshëm ta ndajë atë me ne.

Kapitulli 16

Tre Sekrete Që Funkcionojnë

Një nga gjërat më stresuese lidhur me prindërimin e adoleshenteve është ajo ndjesia gati-gati e vazhdueshme që nuk dini çfarë të bëni. Ndërsa vitet e para të rritjes së fëmijëve janë të rraskapitshme fizikisht, vitet e adoleshencës janë të ngarkuara emocionalisht. Shfaqen aq shumë situata befasuese në të cilat prindërit pyesin veten: “Si të veprojmë me këtë?” Kjo gjë shpesh na çon tek pyetja: “Si t’i disiplinojmë gjatë këtyre viteve? Ata janë të rritur për t’u dhënë ndonjë thupër dhe shumë të mëdhenj për t’i kapur dhe t’u thuash: “Më shiko në sy!” por nuk janë aq të rritur sa të varen plotësisht në gjykimin e tyre. Çfarë duhet të bëjmë?”

Për shkak se të njëjtat pyetje na kanë përndjekur edhe ne kur fëmijët tanë ishin adoleshentë, dëshirojmë t’ju përcjellim tre sekrete për të disiplinuar në vitet e adoleshencës, që funksionuan për mrekulli, duke sjellë shumë ndryshim kur fëmijët tanë ishin në këtë fazë. (Shsh! Mos ia trego adoleshentit/es tënde!)

NDËRRONI ROLET

Sekreti i parë për të disiplinuar gjatë viteve të adoleshencës që funksionoi si me magji për ne është shumë i thjeshtë për këdo që është i gatshëm ta provojë. Ne ndërruam rolet.

Kur fëmijët ishin më të vegjël, ishte Diane në fakt ajo që merrej me pjesën më të madhe të disiplinës.

Megjithëse edhe Phil-i disiplinonte, barra e trajnimit ra kryesisht mbi kurrizin e Diane, pasi ishte ajo e cila rrinte me fëmijët ditë e natë, ndërkohë që Phil punonte që të siguronte për familjen tonë prej gjashtë personash.

Gjatë viteve të adoleshencës situata duhej të ndryshonte. Ne vumë re se ndërsa fëmijët rriteshin filluan të kundërshtonin më shumë, duke e lodhur dhe dekurajuar tej mase mamanë e tyre. Dëshira e saj për të pasur një lidhje paqësore dhe të ngushtë me djemtë dhe vajzat e saj binte

në kundërshtim me dëshirën e tyre për t'u distancuar. Në të njëjtën kohë, gjykimi i tyre ende në zhvillim kërkonte korrigjim të shpeshtë dhe më shumë mbikëqyrje nga çfarë prisnin ata. Tensionin po rritej me shpejtësi!

Në një vëzhgim të thellë, kuptuam se zemra instinktivisht përkujdesëse e Diane u mposht lehtësisht nga ky tension në rritje. Phil ishte më i aftë për të reaguar pa u emocionuar. Ishte koha e Phil për të pranuar rolin disiplinor parësor në mënyrë që Diane të ishte e lirë për të qenë nëna e dashur për të cilën kishin nevojë fëmijët tanë.

Phil u bë djali i keq. Jo i egër dhe nevrík, por i rreptë dhe i vendosur, si një mur tulle. Ai qëndroi për perëndishmërinë pa justifikim, për respekt dhe standarde të larta. Ishte Phil ai që këmbënguli që fëmijët tanë të shkonin në kishë, donin apo nuk donin ata. Phil ishte ai që thoshte: "Jo do të thotë jo!" dhe qëndronte i vendosur megjithëse ishte e vështirë të thoje jo.

Diane u bë e mira. Pas vitesh të tëra duke luajtur rolin e prindit parësor në shtëpi, ajo që vendoste pjesën më të madhe të disiplinës, tashmë thjesht përforconte rregullat që vendoste Phil. Ajo ishte aty për të zbutur jo-të, për t'i shpjeguar Phil-it kush ishin fëmijët dhe për t'u shpjeguar fëmijëve kush ishte Phil. Ishte roli i saj për të dëgjuar dhe simpatizuar, për të kuptuar dhe përkrahur fëmijët, duke i ndihmuar ata të pranonin kufizimet e arsyeshme, e në të njëjtën kohë duke nderuar plotësisht udhëheqjen e Phil-it.

Ishte Diane ajo që i ndihmonte fëmijët të rifrazonin gjërat që donin të thonin në një mënyrë më të respektueshme. Ne donim që adoleshentët tanë të ishin të lirë të na thonin çdo gjë, por absolutisht duhej të ishin të gatshëm t'i nënshtroheshin vendimeve tona pavarësisht nëse ishin dakord apo jo. Ata duhet të ishin të respektueshëm. Ndonjëherë, ose më mirë të themi, shpeshherë, fëmijët tanë kishin nevojë për ndihmë si ta bënë këtë gjë.

Ky nuk është një moment i mirë në jetën e fëmijëve tuaj për të vendosur kufizime. Kjo funksionon kur ata janë më të vegjël, dhe në fakt është thelbësore kur fëmijët tuaj janë të vegjël. Megjithatë, bota ku fëmijët tanë po rriten është një botë e rrezikshme. Ka njerëz të këqinj të cilët përgjojnë nëpër stacione autobuzash, duke prituri për adoleshentin tuaj të larguar nga shtëpia. Të nxirrni jashtë birin ose bijën tuaj për mosrespektim në

këto kohë do të ishte keqpërdorim i rrezikshëm i “një dashurie të rreptë”. Duhet të bëheni një udhëheqës bindës në shtëpinë tuaj gjatë këtyre viteve, duke përshtatur taktikat që të mos i tjetërsoni fëmijët tuaj. Ne kemi punuar së bashku për këtë, duke inkurajuar dhe qetësuar butësisht njëri-tjetrin, ndërsa reagimi ynë i brendshëm ndaj mosmarrëveshjes së ndezur që ndonjëherë pasonte një “jo” na tundonte të humbisnim qetësinë.

Këto dy qasje, standardet e prera të kombinuara me inkurajimin bujar, morën gjithë presionin e atyre viteve.

Ajo që fëmijët tanë nuk e dinin ishte se më së shumti ishte Diane ajo që i thoshte Phil-it pas dyerve të mbyllura se duhet të qëndronin fort në gjërat e vendosura!

Siç Phil-it i pëlqen të thotë: “Bibla thotë se burri është koka e gruas. Megjithatë, gruaja është qafa. Ne të gjithë e dimë se është qafa ajo që e bën të mundur lëvizjen e kokës!”

DIANE:

Ajo që funksionoi aq bukur ishte se unë nuk u ndjeva e izoluar dhe e vetme kur fëmijët hezitonin ndaj insistimit tonë për të qenë më të përfshirë në jetën e tyre sesa ata e ndjenin të domosdoshme. Ai tension midis nevojës së fëmijëve tanë për t'u rritur dhe për t'u bërë të pavarur dhe vendosmëria jonë për të qëndruar pranë ndonjëherë e shtynte marrëdhënien tonë me fëmijët deri në pikën e thyerjes. Ka qark shumë biseda gjykuese në këto vite, por nuk ka rregulla të qarta për të garantuar një rezultat të mirë.

Kur Phil u thoshte vajzave: “Nuk mund ta vishni atë në shkollë sot!” (Sepse unë i thoja të thoshte kështu!) vajzat vinin tek unë duke qarë, duke u ankuar se babai i tyre nuk e kuptonte modën pasi ai ishte me të vjetrën. Ky ishte momenti kur unë u shpjegoja arsyen pse.

“Shpirt, babi thjesht po kujdeset për ju! Ai nuk ju lë ta vishni atë, sepse e di se çfarë do të mendojnë djemtë në shkollë ndërsa ecni nëpër korridor. Dhe kjo është gjëja e fundit që do të dëshironit! Pra, a mund të gjejmë një mënyrë se si ta veshim atë stil pa nxitur atë lloj reagimi?”

Ose kur Phil thoshte: “Jo, nuk mund të shkoni atje këtë të premte në mbrëmje!” Unë isha ajo që u shpjegoja se ai thjesht dëshironte t'i mbronte ato nga një situatë që ato nuk mund ta kontrollonin dot.

Një fjalë rreth shoqërive

Ndonjëherë kjo do të thotë t'u thuash jo disa miqve të caktuar.

Shkrimi thotë: “Mos u gënjeni; shoqëritë e këqija prishin zakonet e mira” (1 Kor. 15:33) dhe, “Kush shkon me të urtët bëhet i urtë, por shoku i budallenjve do të bëhet i keq” (E. e Urta 13:20).

Ju do të duhet t'u mësoni butësisht këtë të vërtetë fëmijëve tuaj, duke përdorur filtra dallues ndërsa flisni për njerëz në veçanti. Ju nuk do të donit të gjykoni ashpër vështirësitë e një tjetri, por të mbushur me dashuri e shpresë, si dhe besim të qartë se Zoti është Shpëtimtari që mund dhe ndryshon edhe zemrat më të vështira.

Të dy ne ndiejmë se e kemi kaluar cakun në mënyrë të përsëritur me përpjekjet tona të rrepta për të mos lejuar që adoleshentët tanë të përfshihen në një turmë që mund t'i çojë ata në ujëra të papastra. Shumë shpesh kemi vepruar nga frika. Mund të kemi qenë të saktë në vlerësimin tonë për disa fëmijë specifikë, por siç një miku ynë britanik pëlqen të thotë: “Jo vetëm që ishim të saktë, por kishim absolutisht të drejtë!”

Perspektiva jonë për njerëzit shpesh duhet të ndryshojë. Kur bëhet fjalë për adoleshentët, çfarë duket nga jashtë shpesh nuk përkon me atë që është përbrenda. Ata i lyejnë flokët e tyre çuditshëm dhe vishen me kostume si një mjet për vetëmbrojtje. Përgjithësisht fëmijët nuk janë ende mjaftueshëm të fortë për t'u përballur me një botë brutale.

Mënyra më e shpejtë për të njohur zemrën e një shoku për të cilin keni pasiguri, është ta ftoni atë në shtëpinë tuaj. Shpesh, kur e gjithë familja do ta përfshijë atë në tryezën e ngrënies, do të zbuloni një anë tjetër të shokut për të cilin ishit të shqetësuar. Ndonjëherë, në atmosferën argëtuese të rrethit tonë familjar, shokët e fëmijëve tanë ishin në gjendje të hiqnin maskat dhe të linin veten të ishin ata që ishin në të vërtetë.

Nga ana tjetër, disa miq mund të mos e kalojnë “testin e rrethit familjar” pavarësisht sa shumë mund të përpiqeni t'i mirëprisni ata. Kur një shok ulej në tryezën tonë dhe qëndronte i tërhequr ose i heshtur, adoleshentët tanë mund ta dallonin lehtësisht se nuk ishte një shok për të kaluar shumë kohë me të.

Ju duhet të jeni të gatshëm të mos inkurajoni - madje edhe ta ndaloni - adoleshentin/en tuaj të krijojë disa lloj shoqëri. Nëse shihni një shok që ka një ndikim negativ në qëndrimin dhe zgjedhjet e fëmijës tuaj, duke

dobësuar dashurinë e tij ndaj Jezusit, mund t'ju duhet të ndërhyjni. Nuk do të jetë e lehtë, por i mbani mend ato që thamë në kapitullin 15 për katër gjërat që prindërve do t'u nevojiten gjatë viteve të adoleshencës? E para ishte guximi.

Për prindërit që kanë vajza në shtëpi, ky guxim mund të marrë formën e vendosjes së një moratoriumi që shokët e djalit tuaj nuk mund të kalojnë natën tek ju. Kemi dëgjuar kaq shumë histori të trishta abuzimi seksual nga shokët e motrave dhe vëllezërve për ta vënë në dyshim domosdoshmërinë e kësaj praktike shoqërore.

DIANE:

Djali ynë kishte dy shokë shkolle, të cilët në mënyrë të sigurtë po shpresonte t'i ndihmonte përgjatë disa viteve të trazuara. Asnjëri nga këta fëmijë nuk po ecte me Zotin, por ata u intriguan nga besimi i sigurtë i djalit tonë. Ai nuk po ndikohej negativisht prej tyre në asnjë mënyrë, kështu që kur më pyeti nëse ata mund të kalonin natën tek ne, nuk dija çfarë t'i thoja, por nuk u ndjeva rehat për këta dy djem.

Diku nga mesi i natës u zgjova dhe kuptova pse isha e shqetësuar dhe nuk po gjeja rehati — isha e shqetësuar për sigurinë e vajzave tona. Pjesa tjetër e natës kaloi pothuajse pa gjumë, por të nesërmen në mëngjes bisedova me tim bir për këtë. Ai nuk e kuptoi dhe madje ndihej pak i fyer. E dija që duhej të isha e hirshme dhe e guximshme mjaftueshëm sa të qëndroja e vendosur duke besuar se një ditë ai do e kuptonte.

Ndërsa tani? Si baba i tre fëmijëve, ai është më mbrojtës nga sa isha unë. Ka dëgjuar të njëjtat histori të tmerrshme dhe ka guximin të marrë vendime të rrepta për sigurinë e fëmijëve të tij.

Kur Pjetri shkroi për të paralajmëruar popullin e tij për miqtë që mund t'i tërhiqnin ata larg besimit, ai u kujtoi atyre Lotin, “sepse ky i drejtë banonte në mes tyre e mundonte për ditë shpirtin e tij të drejtë duke parë dhe duke dëgjuar veprat e tyre të poshtra” (2 Pje. 2:8).

Ai i paralajmëroi kundër shoqërive “që shkojnë pas mishit në lakminë e fëlliqësisë dhe e përbuzin pushtetin” (2 Pje. 2:10). Pjetri e mbyll letrën e tij të dytë duke thënë: “Ju pra, shumë të dashur, duke i ditur këto gjëra,

ruajuni se mos ligështoheni në qëndresën tuaj, *të tërhequr nga gabimi i të pabesëve*. Por rrituni, në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht” (2 Pje. 3:17–18).

Të vëzhgoni miqësitë e adoleshentëve tuaj mund të jetë një nga gjërat më sfiduese që duhet të bëni si prind. Por ju e bëni këtë për shkak të dashurisë ndaj fëmijëve tuaj. Ju nuk dëshironi t’i shihni ata të bien e të largohen, por dëshironi që ata të jenë të rrënjosur dhe të themeluar në besimin e tyre.

PËRSHTASNI KUTINË

E mbani mend Kutinë për të cilën folëm në fazën e strukturimit? Katër anët, të cilat kur ngushtohen njëkohësisht, krijojnë një kornizë të sigurt rreth jetës së fëmijës suaj për të bërë të mundur lulëzimin dhe rritjen e fëmijës tuaj në personin e bukur që Perëndia e dizenoi të ishte.

Cilat ishin katër anët e Kutisë?

1. Jezusi: themeli bazë i çdo pjese të jetës
2. Disiplina: duke përdorur mjetet e dishepullizimit
3. Rregulli: një strukturë që i mundëson fëmijës tuaj lulëzimin
4. Argëtimi, afeksioni dhe afirmimi: mbajtja e marrëdhënieve tuaja të forta dhe të afërta.

Gjatë viteve të adoleshencës, do të ketë raste kur do t’ju duhet ta ngushtoni Kutinë. Edhe pse Kutia është shumë më e madhe sesa kur adoleshenti juaj ishte i vogël, ajo është ende aty. Kutia siguron ende kornizën për të cilën ka nevojë çdo adoleshent pasi shtrin muskujt e pavarësisë dhe i afrohet ditës kur do të jetë plotësisht i përgjegjshëm për veten.

Vitet e adoleshencës mund të jenë një periudhë e vështirë për fëmijët tuaj, veçanërisht në kulturën tonë. Shumë e shumë fëmijë që adoleshenti juaj njih mund të kenë pak ose aspak kufij. Edhe prindërit e krishterë në shumë raste do t’i lënë adoleshentët e tyre që ta komandojnë vetë veten.

Në të njëjtën kohë, shumica e adoleshentëve, ndonjëherë të paktën, tregojnë mungesë gjykimi të shëndoshë. Truri i tyre është ende në zhvillim në zonën e lobit frontal, i cili kontrollon vendimmarrjen, aftësinë për të planifikuar më përpara dhe kontrollin e impulsit. Adoleshentët tuaj nuk janë ende plotësisht të aftë të administrojnë gjithë emocionet, hormonet dhe informacionet që vijnë drejt tyre më shpejt nga sa ata mund të mbajnë.

Adoleshenti juaj mund t'ju thotë gjatë këtyre viteve: “Nuk keni besim tek unë?” Do të ndjeheni fajtorë, sikur besimi absolut tek djali ose vajza juaj adoleshente është vula e të qenit një prind i mirë. Kini kujdes me këtë - besimi fitohet, nuk meritohet.

Ndërsa mosbesimi mund ta dëmtojë fëmijën dhe të shkatërrojë marrëdhëniet, do të ishte budallallëk të besonim pa mëdyshje se adoleshentët tanë mund t'ia dalin vetë. Në vend të kësaj, mund të thoni: “Kam besim tek ti; e di që zemra jote është flori. Por hezitohet t'i besoj gjykimit tënd në disa rrethana. Le të punojmë së bashku për këtë”.

Ndërsa bëheni një skuadër së bashku duke lejuar kohën dhe komunikimin e hapur të ndërtojnë besimin në gjykimin e adoleshentit tuaj, inkurajoheni pa fund. Ju nuk dëshironi të jeni një prind zezek që rri ulur në cep, duke pritur të hidheni në sulm sapo adoleshenti juaj të gabojë. Të vepruarit në mënyrë antagonistike nuk është kurrë mençuri dhe sigurisht nuk do të nxitë respekt të ndërsjellë.

Ndërsa vini re që gjykimi i saj maturohet, ju e zgjeroni Kutinë, duke lejuar me kënaqësi më shumë liri për të cilën ka nevojë adoleshenti juaj ndërsa rritet. Në vend që të luftoni, ju jeni bashkë në këtë gjë, duke u përgatitur ta përcillni adoleshentin tuaj në fazën e pjekurisë.

Kur adoleshenti juaj bën ndonjë gabim - dhe ai do bëjë - në vend që t'i ktheheni me zemërim ose ta dënoni për gjashtë muajt e ardhshëm, në vend që të përshkallëzoni zemërimin apo turpërimin, refuzimin ose ndonjë lloj “ndëshkimi krijues”, thjesht shtrëngoni Kutinë. Po ju japim një shembull:

Së pari, uluni dhe flisni me të për atë që ka bërë. Pa të bërtitura, pa psherëtima dramatike ose rrotullim të syve (ëh-hë, po u flasim prindërve këtu, jo adoleshentëve!). Thjesht një bisedë e qetë, krahë për krahë në

mënyrë private. Jo në tryezën e ushqimit, jo në makinë ku janë edhe motrat dhe vëllezërit!

Niseni bisedën duke bërë pyetje të mira. Mos pyesni pse e bëri atë që bëri që të mos shfaqësojë sjelljen e tij në kurriz të dikujt tjetër. Por, tregoni se ju interesoheni për të duke pyetur: “Çfarë po ndodh?”

Lëreni të kuptojë që edhe pse duket keq, keni besim tek ai. Ju besoni se ai është një person me zemër të mirë. Tregojini se nuk jeni i zemëruar me të, thjesht po e ndihmoni të rritet dhe ju e dini se rritja ndonjëherë është e vështirë. Ftojini brenda; dëgjoni përtej sipërfaqes për të kuptuar se çfarë e shtyu atë të bëjë zgjedhjen që bëri.

Pastaj, sillni Jezusin në atë bisedë, jo si gjykatës, por si Shpenguesin e fëmijës tuaj. Atë që mbarti mëkatet tona në kurrizin e Tij, që të mos vuajmë përgjithmonë pasojat. Kujtojini adoleshentit tuaj se Jezusi nuk po kërkon përsosmëri, por dikë zemra e të cilit i përket Atij plotësisht.² Frymëzoheni atë të kujtojë se këtu gjendet gëzimi dhe paqja.

Një bisedë si kjo ju sjell në një nivel shpirtëror si bashkëndjekës të Jezusit. Këtu ndoshta mund të tregoni disa nga gabimet tuaja në mënyrë që adoleshenti juaj të shohë se nuk është vetëm dhe se ju e kuptoni atë. Ju jeni së bashku në këtë situatë.

Më pas, nëse nevojitet më shumë sesa një korigjim verbal,³ mund të shpjegoni arsyet e kufizimeve të përkohshme të lirisë së tyre. Ky nuk është dënim, si, p.sh., “Je i keq dhe e meriton këtë”. Ju po e shtrëngoni Kutinë, pasi së bashku, po punoni për të maturuar gjykimin e adoleshentit/es tuaj. Me shumë mundësi kjo do të përfshijë humbjen e disa privilegjeve.

Ju mund t’u jepni atyre një mundësi për t’i fituar ato privilegje sërish duke demonstruar një qëndrim të mirë dhe dëshirë për të vepruar drejt. Mos vendosni standard përsosmërie shumë të lartë që adoleshenti juaj të mos i humbë shpresat.

Jini të ndjeshëm ndaj asaj që Fryma mund të përpiqet t’ju tregojë lidhur me fëmijët tuaj. Vetëm Ai njuh gjithçka që zien brenda zemrave të tyre. Një prind i mençur varet tek Perëndia që Ai t’i japë urtësi. Nuk ka një rrugë bardh e zi dymbëdhjetëhapëshe për të rikthyer fëmijën tuaj në rrugën e duhur. Përkundrazi, Perëndia na fton të kërkojmë prej Tij urtësi specifike për situata të veçanta dhe pastaj Ai na kërkon që të presim derisa të na tregojë se çfarë të bëjmë ose të themi.

Pastaj, mund të jetë koha për të imponuar pak rregull në jetën e

adoleshentit tuaj, derisa ai të jetë në gjendje të rregullojë botën e tij që të funksionojë në mënyrë efikase dhe të përmbushë përgjegjësitë e tij. Kjo mund të nënkuptojë një kohë gjumi. Adoleshentit tuaj nuk do t'i pëlqejë kjo! Ose ndoshta, nëse problemi është që po bie nga notat, duhet të ndërhyri dhe ta ndihmoni të kuptojë pse. A po studion në mënyrë efikase? Mbase duhet t'i tregoni si ta bëjë këtë.

DIANE:

Kam luftuar vërtet me këtë kur isha adoleshente. Më pëlqente të lexoja dhe të shkruarit ishte pika ime e fortë, por asnjëherë në jetë nuk munda të administroja një projekt. Prindërit e mi, nga ana tjetër, janë njerëzit më të organizuar dhe efikas që njoh! Ata nuk mund ta konceptonin dot se si vajza e tyre dorëzohej përpara projekteve të mëdha që kërkonin organizim dhe planifikim kohor afatgjatë. E dija që nuk kishte të bënte me dembelizmin dhe sigurisht që nuk isha e pamotivuar - thjesht nuk dija nga t'ia nisja. Mund të kisha përfituar nëse do të bëja një listë dhe sistem të qartë ku mund t'i vendosja ato projektet e shkollës së mesme si synimet e ditës time. Por as prindërit e mi dhe as unë nuk e dinim këtë atëherë, kështu që unë rropatesha, ndërsa ata acaroheshin. Tani unë i këshilloj prindërit të shikojnë me kujdes mbi aftësitë dhe paaftësitë e fëmijës së tyre. Ata mund të kenë nevojë për ndihmën tuaj në mënyrë që të kenë sukses në atë që po kërkonin prej tyre.

Mos harroni të vendosni pjesën e sipërme të Kutisë! Nëse harroni, aty brenda mund të rrjedhin hidhërimi dhe rebelimi. Ju kujtohet pjesa e sipërme? Aty është gjithë argëtimi, afeksioni dhe afirmimi që fëmija juaj i dëshiron aq shumë.

Argëtim: Le të shkojmë për pazar! Vajzat tona e pëlqenin shumë këtë, duke dëshmuar se të paktën në këto vitet e adoleshencës, bërja pazar me babin ose me mamën ishte gjuha e tyre kryesore e dashurisë!

Afeksioni: Jepni shumë përqaftime. Përdorni nofka përkëdhelëse që tregojnë kontributin e tyre unik dhe të vlefshëm në familje. Kini kujdes

që të mos e kapërceni cakun me shaka të dëmshme që adoleshentët janë të prirur t'i marrin shumë seriozisht.

Afirmimi: Kjo është e kundërta e turpërimit. Ju keni besim se Zoti po punon në jetën e adoleshentit tuaj dhe disa herë ju duhet të besoni për ta. Do t'ju duhet t'i tregoni adoleshentit tuaj se çfarë po bën Perëndia dhe si Ai po i ndryshon ata.

Fëmijët mund të demoralizohen nga bashkëmoshatarët e tyre në këtë fazë të jetës, por edhe nga të rriturit që mund t'i trajtojnë ata pa respekt. Dhe ndonjëherë është faji i tyre! Por, kur prindërit ecin me Perëndinë dhe zgjedhin të manifestojnë dhembshuri dhe inkurajim ndaj fëmijës së tyre, ata kanë fuqinë t'i tërheqin fëmijët nga ky cikël i mbrapshtë. Fjalët afirmuese do ta forcojnë fëmijën tuaj, ndërsa ai ringrihet sërish për ta provuar nga e para.

Kjo ishte Kutia. Kaq e thjeshtë! Më pak stresuese për krejt familjen sesa gjithë të bërtiturat, dramat, turfullimat dhe sarkazmat që karakterizojnë shumë familje.

DIANE:

Do të doja ta kisha kuptuar më mirë këtë kur ishim duke rritur dy adoleshentët tanë të parë. E zhgënjyer nga vetja, mbaj mend disa nga ato “disiplinat krijuese” ndëshkuese që i përdorja kryesisht e irrituar nga zemërimi kur nuk dija çfarë të bëja.

Një që nuk më hiqet nga mendja ka të bëjë me djalin tonë të parë, John Mark. Ai ishte një adoleshent i perëndishëm, duke u rritur e duke ndjekur vërtet Jezusin në çdo fushë të jetës së tij. Ne ishim shumë krenarë për të, por ai kishte atë qëndrimin – e keni parasysh çfarë dua të them? Atë kryelartësinë superiore që i-ditë-gjitha, gjë që përbën një vel të hollë për të mbuluar pasigurinë. Phil duhej të udhëtonte shumë me punën e tij, dhe unë nuk dija çfarë të bëja me këtë fëmijë-burrë, qëndrimi i të cilit më ngrinte nervat në kulm. Kështu që veprova me atë që mendova se ishte një kurë e zgjuar: sa herë që ai përdorte atë qëndrim kryelartë me mua, e bëja të ulej me duar dhe gjunjët përtokë dhe të lante parketin që zinte një të tretën e dyshemesë tonë.

Doja t'i mësoja djalit tim të ishte i përlulur. Por tani e di se gjithçka po i mësoja në të vërtetë ishte të më përbuzte.

Nëse do ta kisha kuptuar Kutinë, thjesht do të isha ulur dhe do të kisha biseduar me të. Do t'i kisha bërë pyetje. Do të isha lutur me të. Duke kthyer shikimin pas, nuk kam as dyshimin më të vogël, se John Mark do të ishte përgjigjur me përulësi të sinqertë.

Pjesa më e bukur e kësaj historie ndodhi vetëm disa vite më parë. Ne po jepnim mësim për herë të parë në Konferencën e Qëllimshme dhe John Mark, një baba i ri tashmë, ishte ulur nga fundi duke dëgjuar. Më pas, kur e pyeta se çfarë mendonte, ai tha se nuk i kujtohej asgjë lidhur me ato seancat e pastrimit të dyshemesë.

“Mami,” këmbëngulte ai, “ti po e sajon këtë!”

“Ajo që ishte e sigurt ishte se dështimin më të keq të prindërimit tim, ai as nuk e kujtonte fare! Çfarë shembulli i bukur i mirësisë dhe hirit të Perëndisë.

Disa fëmijë do ta kalojnë më lehtë. Ata do të përshtaten automatikisht me kufijtë që ju vendosni. Por ka disa fëmijë që do të insistojnë në testimin e këtyre kufijve për t’u siguruar që Kutia është ende aty. Që këta fëmijë të ndjehen të sigurt, do t’ju duhet të jeni shumë të qëndrueshëm. Mos u dorëzoni! Ia vlen të punoni për adoleshentin tuaj.

Sigurisht adoleshenti juaj ka nevojë për liri që të fillojë të distancohet ndërsa rritet. Ata do të kenë nevojë të pyesin për gjëra, dhe disa do t’ju testojnë në mënyrë të vazhdueshme, por ju mund t’u qëndroni ende pranë. Do të duhet maturi dhe përpjekje nga ana juaj për ta bërë këtë të ndodhë. Edhe pse adoleshenti juaj mund të mos e kuptojë, ajo ende ka nevojë për udhëheqjen dhe disiplinën tuaj.

Kutia zgjerohet, por është sërish aty.

Ndonjëherë gjatë këtyre viteve, adoleshenti juaj do të provojë teknikën e famshme “përçaj dhe sundo”. Ajo do të përpiqet të fitojë simpatinë e njërit prind përkundrejt prindit që i përmbahet kufijve të vendosur; “Por babi tha që nuk ka problem për të!”

Sado që kjo situatë mund t’ju zemërojë, zgjidhja nuk është të shtoni disiplinën. Pamja e bukur e bashkëveprimit midis dy prindërve shumë të ndryshëm do t’i japë fëmijës tuaj një ndjenjë sigurie në mes të trazirave

të tij. E mbani mend llambën dhe dritën? Ju po punoni *së bashku* për të rritur një djalë ose një vajzë të perëndishme.

Jezusi tha: “Dhe në qoftë se një shtëpi përçahet kundër vetvetes, ajo shtëpi nuk mund të qëndrojë” (Marku 3:25).

Do të ketë raste kur dy prindërit nuk pajtohen me njëri-tjetrin, por ju duhet të flisni me një zë. Në vend që ta anashkaloni përballjen për këtë gjë, bisedoni me njëri-tjetrin. Lutuni së bashku, kërkoni këshillë të mençur nga dikush që ju njeh mirë, pastaj dëgjojeni njëri-tjetrin derisa të mund të vini në një pikë uniteti mbi atë situatë.

Kjo nuk ka të bëjë me të fituarit, por me dashurinë që keni ndaj fëmijës tuaj aq sa t’ju shtyjë të jeni në unitet. Ky është qëllimi përfundimtar i llambës dhe dritës,⁴ këndvështrime të ndryshme të shkrira së bashku për t’i sjellë dritë djalit ose vajzës suaj.

Edhe një sekret i fundit për të administruar në mënyrë të hirshme këto vite adoleshence:

MËSOJINI ADOLESHENTIT TUAJ PROCESIN DHE FUQINË E APELIMIT

Kur fëmija juaj fillon të futet në moshë madhore ndodhin dy ndryshime turbulluese, dhe nëse nuk jeni të përgatitur për këto ndryshime, mund ta humbisni kuptimin e tyre.

E para është nevoja e tij për të vënë në dyshim autoritetin tuaj. Në fëmijëri, vogëlushi juaj i rezistonte kontrollit tuaj. Ai madje edhe mund t’ju ketë shpërfillur. Por ju i keni qëndruar sfidës duke i vendosur atij kufizimet, trajnimin, korrigjimin dhe inkurajimin që i duhej për të vazhduar rrugën e tij drejt pavarësisë.

Tani ai është adoleshent - jo më një vogëlush që mund të manipulohet me një përqaftim dhe një ushqim që i pëlqen. Për vite me radhë keni qenë shefi i tij. Ju ishit në kontroll. Ai duhej të bënte atë që ju donit, kur ju donit. Kjo ishte e mirë dhe e drejtë kur ai ishte i vogël, por tani ka ndodhur një ndryshim sizmik, dhe ju duhet të përgatitni veten për ndryshimet.

Tani krejt papritur ai e di, pa asnjë pikë dyshimi, se ju nuk keni gjithmonë të drejtë. Në fakt, ai dyshon se keni gabuar shumë herë. Dhe ka të drejtë,

ju e dini këtë. Çdo prind bën thirrje për gjykim të vazhdueshëm. Çdo prind ka mendimet dhe mënyrat e veta për të bërë gjëra që kanë kuptim në një kohë të caktuar, por që lënë vend për diskutim. Pjesërisht, ne i vendosim rregullat të ndikuar nga frika dhe dështimet tona. Disa nga këto rregulla janë të mira. Na mbrojnë. Por shumë prej tyre janë thjesht si ne preferojmë ta jetojmë jetën.

Tani që adoleshenti juaj po hyn në moshë madhore, ai kupton se mënyra juaj e të jetuarit nuk është e pagabueshme. Në fakt, ai mund të jetë shumë i shpejtë për të treguar sa gabim e keni për gjithçka e çdo gjë! Ndryshimi i dytë që mund t'ju zërë në befasi nëse nuk jeni të përgatitur (kështu ndodhi me ne!) është nevoja e dukshme e adoleshentit tuaj për t'u dëgjuar. Për shkak se ata shpesh kanë një lëmsh emocionesh në këtë fazë të jetës së tyre, kjo nevojë legjitime shumë herë do të tingëllojë e ashpër ose kritike - madje edhe mosrespektuese. Vogëlshja juaj e ëmbël u shndërrua në armikun tuaj të dukshëm brenda natës!

Një formulë për katastrofë? Apo mënyrë për pavarësi të përgjegjshme? Përgjigja mund të ketë të bëjë më shumë me ju si prind sesa me fëmijën tuaj. Nëse ne jemi të gatshëm t'i njohim dhe t'u përgjigjemi këtyre nevojave reale e të vlefshme të zhvillimit, në vend që të reagojmë ndaj mënyrës së çuditshme dhe fatkeqe me të cilën adoleshentët tanë i shprehin ato, ne mund ta zbutim konfliktin e pashmangshëm dhe jo ta nderim atë.

Një koncept i thjeshtë biblik, por shpesh i anashkaluar i quajtur *apel* është sekreti i tretë i disiplinës gjatë viteve të adoleshencës.

Apeli është një mënyrë për të negociuar me respekt një ndryshim në vendimin e një autoriteti. Në sistemin tonë juridik, apeli është shpesh një mjet për të korigjuar supozimet e pavërteta në një vendim gjyqësor fillestar, një mënyrë për të pretenduar se vendimi i parë ishte i padrejtë ose i mungonte informacioni përkatës.

Në shtëpitë tona, apeli është një mënyrë për të nderuar si prindërit, ashtu edhe adoleshentin/en duke rihapur një vendim me informacion të ri ose me një qasje të re.

Lejimi dhe madje inkurajimi i procesit të apelimit dëshmon autoritetin e prindërve të dhënë nga Perëndia, si dhe i parandalon ata nga të qenit autoritarë. Është një mënyrë e përlulur pranimi se ndoshta me shumë

mundësi mund ta kemi gabim!

Për adoleshentin tuaj, apeli është një mjet i ligjshëm për t'u dëgjuar dhe respektuar, një platformë për të qetësuar konfliktin midis prindit dhe fëmijës pa qenë e nevojshme të përdorni mentalitetin “sepse kështu them unë”, që shumë prej nesh e përdorim kur ndihemi të kërcënuar. Apostulli Pal i shkroi Timoteut për apelimin. Pasi e inkurajoi dishepullin e tij të ri për të mësuar të vërtetën me guxim, ai tha:

“Askush të mos e shpërfillë moshën tënde të re” (1 Tim. 4:12).

Ky ishte një problem mjaft i përhapur në një kulturë që vlerësonte shumë urtësinë që vjen me moshën, deri në pikën e mosrespektimit të udhëheqësve të rinj. Pali i tregon Timoteut si ta mposhtë këtë:

“por bëhu shembull për besimtarët në fjalë, në sjellje, në dashuri, në Frymë, në besim dhe në dëlirësi” (1 Tim. 4:12).

Tingëllon si një fjalë e mirë për prindërit! Por le të vazhdojmë të lexojmë:

“Mos i flisni ashpër një burri të moshuar, por apeloni ndaj tij me respekt, ashtu siç do të bënit me atin tuaj” (1 Tim. 5:1).

Le ta shohim më nga afër këtë varg. Shprehja “flisni ashpër” mund të përkthehet edhe “qortoni” (1 Timothy 5:1) ose “qortoni ashpër”. Kështu, Pali po e udhëzon Timoteun që të mos u përgjigjet ashpër kritikëve të tij, por t'u apelojë atyre me respektin dhe dashurinë që do t'i tregonte një babai të mirë.

Fjala “apel” (*parakaléo*) vjen nga e njëjta fjalë e përdorur për Frymën e Shenjtë. Do të thotë të thërrasësh dikë për ndihmë, ose të ftosh dikë të bëjë diçka. Apeli është një ftesë për ndihmë, kërkesë për ndihmë në njëfarë mënyre. Një kërkesë me përlulësi.

Nëse kjo tingëllon si antitezë e komenteve debatuese, me të bërtitura dhe mashtrime, si dhe e përplasjes së dyerve që kultura jonë i gjykon normale gjatë viteve të adoleshencës - keni të drejtë! Është e kundërta polare.

A jeni gati të kuptoni si ta vini në zbatim këtë mjet të fuqishëm? Është shumë e thjeshtë dhe njëkohësisht efektive. Ja si funksionon:

Adoleshentja juaj sjell në shtëpi një disk të ri. E luan me volum të lartë, dhe në të njëjtën kohë këndon, kur ju dëgjoni disa fjalë nga teksti që ju alarmojnë. Ju ia ndaloni të dëgjojë muzikë të tillë që tingëllon kaq rebele. Është e drejta juaj dhe të dyja palët e dini këtë. Ju jeni shefi; kjo është shtëpia juaj.

Në këtë pikë, ndizet konflikti. Fëmija është fyer, madje është lënduar nga supozimi juaj se ajo është disi e keqe përderisa i shijojnë këto këngë. Ashtu si reagimi juaj i parë është t'i mëshonit autoritetit tuaj, përgjigja e saj e parë është të rezistojë, të debatojë. Për shkak se ndihet e parespektuar, ajo flet pa respekt.

Këtu futet apeli. Ajo e di se i lejohet, madje edhe nxitet, të shprehë në mënyrë të arsyeshme dhe me respekt këndvështrimin e saj se pse është mirë që ajo ta dëgjojë këtë disk. Çfarë bën ajo? Ajo apelon ndaj jush. Së pari, pranon autoritetin tuaj, të drejtën tuaj për të vendosur se çfarë muzike mund të luhet në shtëpinë tuaj. Ajo po tregon (dhe i kujton vetes) se ka nderim ndaj prindërve të saj, dhe se është e gatshme të bëjë atë që ju thoni.

Më pas, ajo pyet në mënyrë apeluase nëse mund të flasë lidhur me vendimin tuaj. “A mund të marrim një minutë për të folur për këtë, mami?”

Ky është sinjali për të përdorur arsyetimin tuaj. Merrni frymë thellë, zbrisni nga niveli juaj i lartë moral dhe ftoni Jezusin në bisedë. Shikojeni adoleshenten tuaj për atë që është: një vajzë e vogël që po rritet në një grua të bukur mu përpara syve tuaj. Ju nuk jeni e zemëruar me të ose kundër saj. Ju e doni këtë vajzë! Kaq shumë sa jeni e gatshme të përuleni dhe ta dëgjoni. Ju buzëqeshni dhe i thoni: “Sigurisht, e dashur! Çfarë nuk po kuptoj këtu?”

Kjo e lejon atë të qetësohet. Kjo nuk është një betejë për t'u luftuar, por një keqkuptim që duhet zbutur. Ajo ka një mendim dhe ndoshta mund të ketë të drejtë! Qetësisht dhe ëmbëlsisht, ajo lexon me zë të lartë vargjet e këngës për ju. Kjo është e gjithë historia, pjesa që mund të keni keqinterpretuar kur dëgjuat ato copëza ofenduese.

Tani, një nga këto dy gjëra ndodh. Ose ndërsa ajo është duke lexuar

tekstin, ju e kuptoni se edhe pse nuk e preferoni mënyrën se si e ka shkruar autori, në të vërtetë nuk është një këngë e keqe. Është thjesht një poezi që shpreh emocionin në një mënyrë intensive të përshtatur për adoleshentët. Ose, ndërsa ajo po lexon, e gjen veten në një pozitë jo shumë të mirë me fjalët që mendonte se ishin të pafajshme. Dhe për shkak se jeni e përlulur dhe me zemër të hapur, ju krijoni një atmosferë që nuk e bën t'i ikë fytyra.

Sigurisht që ekziston ende mundësia që ju të dyja të mos bini dakord. Nëse ndodh kështu, ju keni dy zgjedhje. Ose i përmbaheni autoritetit tuaj dhe i thoni asaj se nuk mund ta dëgjojë atë disk në shtëpi, ose i thoni se nuk jeni ende rehat me atë këngë, por do të merrni një mendim të dytë përpara se t'ia ndaloni.

Ky është apelimi. Kaq i thjeshtë! Kaq i arsyeshëm dhe i realizueshëm, i përlulur dhe i dashur!

Nevoja e ligjshme e adoleshentit/es tuaj *për të vënë në dyshim* vlerat dhe mendimet tuaja respektohet, ndërsa ju e plotësoni nevojën e tij/saj *për t'u dëgjuar*.

Dhe, megjithëse adoleshentët ose nënat e adoleshentëve rrallë janë aq të qetë sa mund të tingëllojë ajo bisedë e bërë, të paktën Lufta e Tretë Botërore është shmangur. Perëndia nderohet dhe dashuria rritet me hapa të mëdhenj, ndërsa ju vazhdoni rrugën së bashku drejt maturisë relative.

Kapitulli 17

Tri Gjëra Që Do T'i Nevojiten Adoleshentit Tuaj

Ashtu sikurse ka cilësi të karakterit dhe aftësi që ju nevojiten për t'ia dalë mbanë mirë dhe me mençuri gjatë viteve të adoleshencës, po ashtu ka edhe disa gjëra specifike të cilat do t'i nevojiten adoleshentit tuaj nga ju - mënyra me të cilat ju mund t'i ndihmoni të përparojnë në vend që të ngathtësohen përgjatë këtyre viteve. Këtu janë tri gjëra që ne kemi hasur: ndihuni të lirë të shtoni gjërat tuaja!

TË ZBULOJNË PËR ÇFARË JANË TË AFTË

Një nga vargjet më të cituara në Bibël dhe që ka të bëjë me rritjen e fëmijëve është po ashtu edhe një prej më të keqkuptuarve. Mund ta gjeni atë tek libri i Fjalëve të Urta:

“Mësoji fëmijës rrugën që duhet të ndjekë, dhe ai nuk do të largohet prej saj edhe kur të plakët” (Fjalët e Urta 22:6).

Prindërit e citojnë këtë varg kur janë të shqetësuar për drejtimin që po merr fëmija i tyre, duke menduar se ky është një premtim tek i cili mund të mbahen. Por siç thamë më parë, një lexim më i thellë i këtij vargu zbulon se është më tepër një vrotim sesa një premtim. Fjalët e Urta janë shprehje të shkruara në mënyrë poetike që japin një kuptim, vëzhgime rreth jetës, marrëdhënieve, të vërtetës dhe kulturës.

Kur shkruesi i Fjalëve të Urta (që mendohet të jetë kryesisht

Solomoni) shkroi këto fjalë nën frymëzimin e Shpirtit të Shenjtë, ai po theksonte diçka të rëndësishme. Ai nuk po nënkuptonte që nëse një prind e merr fëmijën në kishë, tek grupi i të rinjve ose tek takimi i fëmijëve, ai automatikisht do të rritet e do të bëhet Billy Graham i ardhshëm.

Siç thamë në kapitullin 8, çfarë ai nënkupton është kjo: Fëmijët që janë edukuar në mënyrë të vazhdueshme, ditë pas dite, javë pas jave, vit pas viti; dhe që janë korrigjuar, qortuar, inkurajuar, dhe mësuar me durim në atë që do të thotë të duash Perëndinë me pasion dhe të duash njerëzit me qëllim, me shumë mundësi nuk do të devijojnë nga ai mësim kur të rriten.

Shprehja “rrugën që duhet të ndjekë” mund të përkthehet gjithashtu “sipas mënyrës së tij” ose “sipas prirjes së tij”. Teksa ky varg ka një zbatim shpirtëror, po ashtu ka dhe një zbatim praktik. Kjo ka të bëjë me personalitetin e një individi - si Perëndia i ka formuar ata. Çdo fëmijë është krijuar në mënyrë të mrekullueshme nga Perëndia, duke zotëruar një takëm forcash unik.¹

Prindërit e zgjuar e kuptojnë që fëmijët e tyre jo vetëm duhen formuar, por po ashtu edhe duhen shpalosur.²

Ndërsa i vëzhgoni fëmijët tuaj në mënyrë të qëllimshme, duke vënë re ndryshimet ndërmjet tyre dhe duke i kushtuar vëmendje preferencave të tyre personale, ju do të shihni se si dalin në pah dhuntitë e tyre. Dhuntitë frymërore,³ si mëshira apo mësimdhënia, dhe aftësitë e dhëna nga Perëndia si të shkruarit, puna e dorës dhe arti krijues duhen identifikuar dhe zhvilluar. Duke zbuluar se në çfarë shkëlqen fëmija juaj në vitet e adoleshencës, do të jeni më të aftë t’i udhëzoni ata gjatë viteve të universitetit.

Fjalët e Urta 22:29 thotë: “A ke parë një njeri të aftë në punën e tij? Ai do të shërbejë në prani të mbretit dhe nuk do të qëndrojë para njerëzve të humbur”. Një prind që e kap këtë urtësi do të punojë me adoleshentin e tij për t’u fokusuar në atë gjë ku ata janë më mirë. Për shembull, për një djalë që nuk arrin të ketë rezultatet e kërkuara në algjebër, me shumë mundësi nuk do të ishte e përshtatshme një degë matematike në universitet. Një vajzë që shet më shumë biskota se sa të gjithë të tjerët në grupin e saj mund të jetë e prirur drejt marketingut.

Kjo është një nga pjesët më të mira të prindërimit të një

adoleshenti! Juve ju është dhënë kjo dhuratë - një person që mbështetet tek ju për të vënë re imago dei - imazhin e Perëndisë - që po zhvillohet brenda tyre në mënyrë unike.

Emri i mesëm i Rebekës, vajzës tonë është Ruth, që do të thotë “mike e dhembshur dhe e bukur”. Edhe kur ishte e vogël, ajo jetonte sipas emrit të saj. Ajo tërhiqej në mënyrë të parëzistueshme për të ndihmuar njerëzit, për t'i ngushëlluar dhe për të marrë përgjegjësi në raste emergjencash.

PHIL:

E vura re këtë gjë kur Rebeka ishte gjashtë vjeçe. Në kohë Krishtlindjesh, ne ishim tek qendra tregtare duke zgjedhur dhuratat dhe duke u përpjekur të qëndronim së bashku në turmë. Elizabeth ishte tre vjeçe, dhe e kishim vënë në karrocë, bashkë me disa qese të rënda që vareshin tek dorezat e pasme. E lëshova karrocën vetëm për një minutë, kohë e mjaftueshme që pesha e rëndë ta tërhiqte Elizabeth mbrapsht.

Teksa ajo lëshoi një ulërimë të tmerrshme, Rebeka nxitoi të vinte ta shpëtonte! Përpara se njëri prej nesh të mbërrinim aty, Rebeka e ngriti karrocën dhe na tregoi që motrës së saj të vogël po i dilte gjak nga koka. Diane-n e zuri paniku teksa unë qëndroja aty, duke parë Rebekën të hidhej në aksion.

Duke injoruar prindërit e saj të ngathët, Beka vazhdoi të hapte pjesën e pasme të flokëve të motrës së saj për të parë nga ku po rridhte gjaku. Më pas ajo filloi të jepte urdhra: “Mami, nuk ka problem, është thjesht një gërvishtje e vogël! Babi, më gjej disa façoleta! E kam situatën nën kontroll”. Ajo fshiu gjakun dhe e siguroi të motrën që do të bëhej mirë.

Nuk ishte ndonjë surprizë që Rebeka i hyri fushës së mjekësisë!

Nga ana tjetër, Elizabeth i urrente spitalet, ashtu si i ati. Ajo është si një profeteshë, plot urtësi dhe dallim. Mënyra e saj e balancuar e vëzhgimit të njerëzve dhe ngjarjeve dhe vendosja e fakteve së bashku në

një sequencë logjike e bën atë personin ku ne drejtohemi kur nuk dimë se çfarë të bëjmë. Secili prej nesh ka shkuar tek Elizabeth me dilemat tona dhe është kthyer me një plan kuptimplotë.

Ajo gjithashtu na shtoi bindjen se trupat tanë i përkasin Perëndisë dhe duhet të kujdesemi për to nëpërmjet pasionit të saj për gatimin, duke u bërë një mësuese e aftë për të ushqyerit e shëndetshëm.

Dy djemtë tanë, megjithëse ngjajnë në shumë mënyra, janë edhe shumë të ndryshëm po ashtu.

PHIL:

Nuk do ta harroj kurrë njëherë, në dimër, kur nuk mund ta përballoja më shiun e zymtë në Portland, dhe unë e Diane vendosëm të udhëtonim në jug derisa të gjenim pak diell. Dy fëmijët tanë më të rritur ishin adoleshentë dhe kishin disa përgjegjësi për shkak të të cilave duhet të rrinin në shtëpi, kështu që morëm Matt me vete drejt jugut, duke lënë John Mark-un në krye të detyrës.

Kur shkuam në Oregonin Jugor, telefonova në shtëpi me një listë rikujtesash: Mbani mend, nuk ka filma sonte, duhet të zgjoheni super herët nesër që të shërbeni në kishë. Mos harro të sigurohesh që vajzat të bëjnë punët e shtëpisë. Dhe, a do të sigurohesh që të keni një kohë studimi Bible të gjithë bashkë përpara se të shkoni në shtrat?

Nga përgjigja e tij, John Mark dukej pak i bezdisur: “Babi, i di të gjitha këto! Punët e shtëpisë kanë mbaruar, dhe e kemi kryer kohën e studimit të Biblës. E di ç’duhet të bëjmë!”

Ne e dalluam dhuntinë e udhëheqësisë dhe vajosjen e mësimdhënies tek djali ynë i madh që kur ai ishte në gjimnaz. Ishim dëshmitarë të ecjes së tij me Perëndinë shumë përpara kësaj. Duke kombinuar shtërëngimin e tij për të sfiduar gjendjen reale me dëshirën e tij të madhe për të mësuar nuk përbënte surprizë për ne që ta shikonim atë të bëhej një drejtues për brezin e tij. Tashmë mrekullohemi teksa ai e shpjegon Shkrimin aq qartë dhe fuqishëm në kishën që ai drejton në Portland, Oregon.⁴

Dhuntia e Matthew për t'i sjellë njerëzit bashkë është pjesë e thirrjes së tij të veçantë. Ai është si Pied Piper. Është e rrënjosur në personalitetin e tij, pjesë e asaj që e drejton atë - ai i do njerëzit, dhe njerëzit e duan atë. Përsa i përket Matthew, sa më shumë njerëz aq më mirë.

Kur ishte adoleshent dhe na pyeste nëse shokët e tij mund të vinin në shtëpinë tonë, e dinim që duhet të prisnim një turmë. Kur Matt thoshte: “Mami, babi, do të vijnë ca njerëz nga shtëpia jonë për një mbremje lojrash sontë”, Fil duhet të merrte çelësat dhe të shkonte të blinte pica, sepse e dinim që brenda një ore, njëzet e pesë adoleshentë do të shfaqeshin në shtëpinë tonë, dhe ne na pëlqente shumë kjo gjë! Mësuam të ishim të gatshëm ta mbështetnim dhuntinë që Perëndia i kishte dhënë Matt për udhëheqje dhe argëtim! Tashmë ai e shijon kënaqësinë e tij për të sjellë njerëzit së bashku si drejtues i të rinjve në kishën tonë.

Të dy djemtë tanë u rritën dhe u bënë pastorë, por me prirje krejtësisht të ndryshme në shërbesë. Ata mësojnë nga njëri-tjetri dhe i vlerësojnë veçoritë që kanë.

Njësoj si fëmijët tanë, edhe fëmijët tuaj do të kenë dhunti të veçanta për të sjellë mbretërinë e Perëndisë në botën tonë. Ndhimojini të zbulojnë në çfarë janë të mirë, më pas kalojeni pjesën e mbetur të jetës tuaj duke shijuar pamjen.

TË RUAJNË PASTËRTINË E TYRE

Një nga perceptimet më të vështira për një nënë ose baba është që fëmija i tyre është një person, jo thjesht një fëmijë, por një burrë ose grua në proces. Juve ju është besuar formimi i një personi, i cili nga ana tjetër do të formojë dhe ndikojë njerëz të tjerë.

Natyra njerëzore e djalit apo vajzës tuaj përfshin edhe seksualitetin e tyre. Të jemi ata që prezantojmë dhe ndikojmë fëmijët se si të trajtojnë seksualitetin e tyre, dhe si të nderojnë seksualitetin e të tjerëve gjithashtu - është një përgjegjësi që Perëndia na e ka dhënë. Çfarë privilegji!

Dhe sigurisht, Ai nuk ka qëndruar në heshtje rreth kësaj teme! Në fakt, Bibla është e mbushur me histori dhe vargje specifike, madje një

libër të tërë që detajon bukurinë, romancën, dhe rreziqet e seksualitetit tonë njerëzor.⁵

Deri më tani me shumë mundësi ju mund të keni biseduar me fëmijën tuaj për vite me radhë për seksualitetin e tij ose të saj. Në fakt, sa më herët aq më mirë. Hapja e kësaj teme me fëmijën tuaj në një kohë kur ai/ajo është ende pa përshtjellimet e fazës zhvillimore ose hormonet e tërbuara që ndërhyjnë në aftësinë e tyre për të menduar qartësisht, është mënyra më e zgjuar dhe e thjeshtë për të ushqyer ndjesinë e të qenit i hapur. Por tashmë, gjatë viteve të adoleshencës, diskutimet tuaja rreth seksit dhe seksualitetit lëvizin nga pjesa fundore në pjesën e përparme të furrës.

Ndërkohë që ne nuk mund të paraqesim një udhëzues të plotë se si të trajtojmë mësimin e fëmijëve rreth seksualitetit të tyre,⁶ shpresojmë që të hapim një derë në mënyrën tuaj të të menduarit duke ofruar një këndvështrim tredegësh.

Së pari, flisni me adoleshentët për pastërtinë seksuale.

Deri në momentin që fëmija juaj është në adoleshencën e tij/saj të heshme, ju duhet të keni stabilizuar një normalitet në bisedat rreth seksualitetit. Megjithatë detajet zakonisht është më mirë t'i lihen prindit që ka të njëjtin seks si fëmija, të dy prindërit duhet të mirëpresin pyetje dhe po ashtu të nxitin biseda të rehatshme rreth seksit dhe seksualitetit. Nëse prisni shumë gjatë, këto diskutime do të duken të njëanshme, madje edhe zaptuese.

Për ndjekësit e Jezusit, kjo fushë e jetës tonë duhet të jetë më shumë sesa rregulla dhe histori paralajmëruese. Perëndia na ka krijuar si genie seksuale unike, jo si kafshë që nxiten nga impulset.

Dhënia e dinjitetit (vlerave) dëshirave të një mashkulli dhe bukurisë fizike të një femre, në vend të shthurjes, që prej kohësh ka zënë vend në skutat e seksit, është një privilegj prindëror. Ne mund t'i prezantojmë fëmijët tanë me këtë mendësi të mrekullueshme të një burri dhe një gruaje.⁷

Duke qenë të parët në jetën e fëmijës tuaj që nderoni dhuratën e seksualitetit, ju do të keni mundësinë të formoni qëndrimin e tij ose të saj përpara se kjo botë të ketë një shans që të informojë mënyrën se si

ata mendojnë ose ndihen rreth kufijve dhe pastërisë seksuale që nderon Perëndinë.

Kini parasysh që të mos flasësh rreth seksit është po ashtu një formë komunikimi. Sa herë që shkoni në një qendër tregtare, ju përballeni me imazhe seksuale të forta. Nëse nuk thoni asgjë teksa ecni përpara një ekspozimi pornografik, çfarë i komunikon kjo fëmijës tuaj? Ose nëse ju zemëroheni ose e fajësoni atë për shkak se hodhi shikimin në atë drejtim, çfarë po thonë qëndrimet tuaja? Çfarë po dëgjon fëmija në heshtjen tuaj?

Nga ana tjetër, nëse ju kultivoni një pikëpamje respektuese të qëllimit që Perëndia kishte kur Ai krijoi bukurinë e seksit në kontekstin e një përkushtimi jetësor midis bashkëshortit dhe bashkëshortes, ju po e pajisni djalin ose vajzën tuaj me vizionin e asaj që Perëndia ka planifikuar për ta. Të presësh për këtë dhuratë mund të jetë mënyra më e mirë për ta mbështjellë atë në mrekullinë që meriton.

Për këtë qëllim, jini të kujdesshëm rreth shakave që mund të bëni rreth seksit. Vendosni një STOP të shpejtë ndaj të folurit pa takt për femrat. Le ta kuptojnë djemtë tuaj që një e folur e tillë nuk do të tolerohet në shtëpinë tuaj. Tregoni se çfarë do të thotë të nderohet femra, të vlerësohet bukuria e krijuar nga Perëndia. Vëreni së bashku se si është përdorur seksi për të shitur makina dhe rroba, buzëkuqe dhe pajisjet e fundit. Vendosni që ju do të nderoni Perëndinë me mënyrën se si do të flisni rreth seksit dhe seksualitetit.

Mësojini adoleshentët rreth pastërtisë seksuale.

Kjo duhet të jetë një bisedë e vazhdueshme, “kur ecën rrugës, kur ke rënë në shtrat dhe kur ngrihesh” (Ligji i Përtërirë 6:7). E megjithatë, do të vijë një moment në jetën e adoleshentit kur prindit i duhet të japë një mësim të plotë e të detajuar për seksin.

Po, bisedë për seksin!

Shumicës prej jush, prindërit tuaj nuk ju kanë thënë absolutisht asgjë, pasi as prindërit e tyre nuk u kanë thënë absolutisht asgjë! Shumica e prindërve janë të frikësuar sepse ata nuk dinë se si të flasin me bijtë dhe bijat e tyre rreth seksit. Por përderisa ne po i dishepullizojmë fëmijët tanë, duhet të guxojmë që të mos i lëmë të paditur ndaj tundimeve që

do të hasin në rrugën e tyre. Nëse jeni përpjekur të krijoni lirshmëri në komunikim rreth seksit dhe seksualitetit, të paktën kjo bisedë do të jetë pak më e thjeshtë.

PHIL:

Kam bërë nga një bisedë personale me secilin prej djemve të mi. Me njërin prej tyre nuk shkoi mirë fare, ndërsa tjetri ishte mirënjohës!

Ai që tha se nuk ishte mirë më vonë më tha: “Babi, e ke bërë shumë shpejt atë bisedë dhe e bërë të gjithën gabim!”

Unë i thashë: “Epo, të paktën e bëra!”

Im atë kurrë nuk më ka thënë asnjë fjalë rreth seksit, dhe e vërteta është që, nëse ai do ta kishte bërë, do ta kisha dëgjuar. Dhe do të doja të më kishte thënë diçka, sepse e katranosa në këtë fushë dhe kam plagë që e dëshmojnë këtë.

Me djalin tjetër, ishte e thjeshtë dhe ai ishte mirënjohës për përpjekjen time. Bëmë një ecje në plazh së bashku dhe në një pikë ai thjesht më tha: “Në rregull babi, kam dëgjuar mjaftueshëm. E kuptova. Nuk ke pse më thua më”.

Autori dhe mësuesi Jim Burns i rikujton prindërit se në një botë ku shumica e fëmijëve nuk marrin informacion fare nga prindërit, “diçka është më mirë se asgjë”.⁸

Mësojini adoleshentit/es tuaj çfarë thotë Shkrimi për seksualitetin: që ka për synim të sjellë dy zemra së bashku përgjithmonë. Që ia vlen të presësh për të në mënyrë që të mos mbarten një sërë bagazhesh në martesë. Mësojuni atyre që Zoti vetë është autori i seksualitetit. Ai e ka menduar atë! Dhe Ai vendosi disa kufij të bukur përreth tij. Brenda këtyre kufijve, seksi është një dhuratë nga Perëndia për kënaqësinë tonë.

Mësojini ata që nëse gabojnë, mund të falen plotësisht, por kjo do t'i lëndojë ata thellësisht. Do të ketë plagë. Mësojuni atyre që kujdesi dhe siguria e një burri dhe një gruaje për të jetuar një jetë në besnikëri është mënyra se si Perëndia ka dizenuar që të përjetohet seksi. Çdo gjë

tjetër dhe gjithçka më pak është një keqpërdorim i kësaj dhurate që Perëndia na ka dhënë.

Nëse keni gabuar në këtë fushë, ky është një moment i shkëlqyeshëm që ju të ndani historinë tuaj me djalin ose vajzën. Nuk keni nevojë të jepni detaje; kjo do të ishte e papërshtatshme. Por në vend që të tërhiqeni pas nga ndjesia e fajit, përdorini gabimet tuaja që të flisni hapur për mënyrën se si jeni lënduar nga zgjedhjet që keni bërë. Ata *do t'ju dëgjojnë!*

Gjithashtu, sigurohuni që t'ia bëni të ditur djalit ose vajzës tuaj se pastërtia seksuale është diçka për të cilën ata do të duhet të luftojnë gjatë gjithë jetës. Martesa nuk i jep fund nevojës për të ruajtur zemrat tona kur vjen çështja tek pastërtia seksuale!⁹ Disa fëmijë të rritur në familje të krishtera duket që e humbasin këtë fakt jetësor. Si prind, transparenca juaj në këtë çështje mund t'i japë fëmijës kurajon që i nevojitet për të vazhduar të luftojë për pastërtinë seksuale edhe kur të duket si diçka e madhe.

Jini të detajuar në mësimin rreth pastërtisë seksuale me adoleshentët tuaj. Fëmija juaj ka nevojë të dijë rreth përhapjes së seksit oral, rreth masturbimit, ëndrrave seksuale, dhe rrezeve të pornografisë. Fëmijët tanë po rriten në një kulturë të tejngopur me imoralitet. Nuk duhet t'ia lejojnë vetes të jenë të paditur në këtë fushë.

Së fundi, mbroni pastërtinë e tyre seksuale.

Adoleshenti juaj jo gjithmonë do t'ia kuptojë pse ia impononi rregullat dhe kufizimet të cilat mendoni se janë për të mirën e tij/saj. Ata nuk kanë pse t'i kuptojnë!

Statistikat përsa i përket ekspozimit të adoleshentëve ndaj pornografisë janë serioze: "Pothuajse gjysma e të rinjve thonë që ata ndeshen me pornografi të paktën një herë në javë - edhe kur nuk e kërkojnë atë".¹⁰ Si mund t'i mbrojnë prindërit fëmijët e tyre nga diçka kaq e përhapur?

DIANE:

Unë flas me shumë vajza të reja rreth të njëzetave, dhe e dini se çfarë më thonë? Ato do të dëshironin shumë që prindërit e tyre t'i kishin mbrojtur.

Ato pyesin veten pse prindërit e tyre nuk e merrnin mundimin të shikoni historikun e kërkimeve që kryenin në internet. Ato do të donin që prindërit e tyre të kishin bërë më tepër pyetje të tipit: “A je plotësisht e sigurt që prindërit e tij do të jenë në shtëpi?” Do të donin që prindërit e tyre të kishin patur një rol më aktiv duke u siguruar që ato nuk do ta futnin veten në pozita të cënueshme që nuk do të mund t’i përballonin.

Edhe pse këto vajza silleshin sikur ato nuk donin që mami ose babi të ndërhynte në atë kohë, tashmë ato uronin që prindërit e tyre të ishin kujdesur mjaftueshëm për mbrojtjen dhe sigurinë e tyre.

Tundimet janë goxha të forta. Pikërisht në momentin kur adoleshenti/ja juaj po zhvillon teologjinë e tij/saj të seksualitetit, pornografia kërkon të ekspozojë veten në çdo shtrembërim të mundshëm.

“Të parit e pornografisë nga adoleshentët i çorienton ata gjatë fazës së zhvillimit kur u duhet të trajtojnë seksualitetin e tyre dhe kur janë më të rrezikuar ndaj paqartësisë që kanë ndaj asaj që besojnë lidhur me seksualitetin dhe vlerat morale.”¹¹

Mbani mend që adoleshenti juaj jo gjithmonë do ta kuptojë pse ia impononi rregullat ose kufizimet që mendoni se janë për të mirën e tyre. Nuk ka problem; jini të guximshëm. Është detyra juaj ta mbikëqyrni fëmijën tuaj dhe të mbronni pastërtinë e tyre derisa të jenë të aftë ta bëjnë vetë këtë.

Në një nivel praktik, këtu keni disa mënyra për të mbrojtur pastërtinë e adoleshentit/es tuaj:

1. Sigurohuni që adoleshenti juaj të mos jetë vetëm ose i pa mbikëqyrur në shtëpi me një person të seksit të kundërt.
2. Nëse adoleshenti juaj është i ftuar në shtëpinë e dikujt tjetër, sigurohuni që prindërit të jenë në shtëpi dhe ata të kenë të njëjtat vlera si ju në mbrojtjen e pastërtisë së djalit apo vajzës së tyre. Me shumë mundësi do ta keni të vështirë për të filluar këto lloj bisedash, por për fëmijën tuaj ia vlen.
3. Mbajini celularët dhe kompjuterat në vende të hapura ku mund

të mbikqyren nga një i rritur. Celulari i adoleshentit tuaj nuk është privat. Ndaj, edhe celulari *juaj* nuk është privat. Jetoni haptazi dhe në mënyrë transparente në bashkësinë që është familja juaj. Në të njëjtën kohë, jini të qartë që historiku i përdorimit të internetit do të kontrollohet shpesh - jo se nuk keni besim, por sepse ju e kuptoni tërheqjen e pornografisë.

4. Qëndroni të përfshirë në jetën sentimentale të adoleshentëve tuaj. Është në dorën tuaj që të *punoni me ta*. Mos hiqni dorë nga kjo përgjegjësi vetëm sepse djali apo vajza juaj kundërshtojnë; rreziqet janë shumë të larta. Jini të këndshëm, dëgjoni, jini të arsyeshëm dhe të hapur, por prapë jini prindi!

5. Ndhimojini vajzat tuaja të gjejnë një balancë midis modestisë dhe modës. Mësojuni atyre se Perëndia i ka krijuar burrat që të reagojnë vizualisht. Bëjini të kuptojnë nevojën për të respektuar djemtë e rinj aq sa të zgjedhin të vishen dhe të sillen me modesti. Por kini kujdes këtu! Ju nuk do të donit t'i komunikoni vajzave tuaja se është faji i tyre nëse djemtë u shkojnë pas.

6. Kontrolloni materialet që lexon adoleshenti juaj, revistat, filmat, muzikën dhe serialet. A promovojnë këto materiale imoralitet? Pyetini ata. Lërinë të kuptojnë se shikimi dhe leximi i gjërave të tilla ju ndikon negativisht, dhe më pas lërinë *t'ju* kontrollojnë edhe juve gjithashtu!

Kur vajza jonë Elizabeth filloi të takohej me Brook, djalin me të cilin do të martohej më pas, ajo jetonte ende në shtëpinë tonë. U kishim kërkuar atyre që të na prisnin në verandë nëse ne nuk kishim mbërritur ende në shtëpi. Të dy ata na kanë treguar më pas se sa shumë i ka ndihmuar kjo gjë që të mbajnë marrëdhënien e tyre të pastër, dhe Brook është i bindur se kjo gjë e ndihmoi po ashtu të ruante mendimet e tij. Kishte raste që kjo situatë ishte e sikletshme për të gjithë ne, por ia ka vlejtur.

Kur djali ose vajza juaj flasin me ju për betejën e tyre për pastërtinë seksuale, jepni përgjigje të buta dhe plot hir. Nëse ata kanë frikë nga reagimi juaj, me shumë mundësi do të fshihen, aty ku ju nuk do të jeni dot pjesë e procesit të tyre të arsytimit. Dhe ju duhet të jeni

pjesë e atij procesi, edhe pse mund të na bëjë të mos ndihemi rehat ndonjëherë.

Miqtë tanë kanë dy djem binjakë. Duke qenë se ata po luftonin të shmangnin tundimet gjithmonë prezente të të parit pornografi, folën me prindërit e tyre dhe së bashku arritën në një zgjidhje që i ndihmoi. Sa herë që ndonjëri prej djemve do të shkonte në tualet, një vend që përbënte tundim për ta pasi ishin vetëm me internetin, duhet ta linin celularin e tyre jashtë në dysheme pas derës. Mamaja e tyre buzëqeshte dhe kujtohej që duhej të lutej për djemtë e saj teksa ecte përpara celularit që ndodhej në dysheme. Sot ata djem të rinj shërbejnë në të njëjtën anije në Marinë, dhe ende vazhdojnë të nxitin njëri-tjetrin në përkushtimin e tyre për pastërti.

PHIL:

Unë besoj fort se një baba duhet të mbrojë pastërtinë e vajzës së tij dhe të jetë i përfshirë në jetën e saj gjatë fazës që ajo po takohet me një djalë. Kur Elizabeth filloi të takohej me Brook, i cili ishte baterist, bëja shaka me të dhe i thoja që nëse dëgjoja që e prekte vajzën time në mënyrë të papërshtatshme, do t'ia thyeja duart, dhe ai nuk do t'i binte më kurrë baterisë.

Kjo gjë u tha shumë qetë dhe me shaka, por ai e kapi mesazhin! Doja që ai ta dinte se po e vëzhgoja. Doja që ta kuptonte se ishte privilegj për të të dilte me vajzën time, dhe se unë po i jepja leje të kufizuar ndaj saj, ndërkohë që ai më provonte se do ta nderonte atë.

Megjithëse Elizabeth ishte pak në siklet nga përfshirja ime, tashmë Brook dhe Elizabeth janë të martuar, dhe Brook thotë që do të jetë po aq i ashpër, ose ndoshta edhe më shumë, kur vajzat e tyre të jenë adoleshente. Fjalët e mia ndaj tij si adoleshent kishin qëlluar në shenjë. Ai e vlerësoi vajzën time edhe më shumë, sepse kishte parasysh çmimin e lartë që kërkohej për të qenë me të.

Oh, dhe meqë ra fjala, Brook dhe unë ishim dhe ende jemi miq shumë të mirë!

Adoleshenti juaj ka nevojë për ju

Adoleshenti juaj ka nevojë për *ju*. Ai mund të mos e kuptojë këtë. Ajo mund të mos e pranojë kurrë. Por mos u mashtroni nga këto! Prania juaj aktive, përfshirëse, e interesuar dhe mbrojtëse në jetën e tyre është thelbësore. Ne kemi identifikuar pesë gjëra në të cilat adoleshenti juaj ka nevojë për ju.

Adoleshenti Juaj Ka Nevojë Për Praninë Tuaj

PHIL:

Unë isha trembëdhjetë vjeç kur një shoku im erdhi dhe më tha: “Le të fillojmë një grup rroku!” Unë thashë: “Po unë i bie vetëm trumpetës”. Ai tha: “Epo, unë nuk i bie asnjërës!” Kështu që, unë zgjodha baterinë, ai zgjodhi kitarën, dhe për nëntë vitet e ardhshme, ai grup ishte jeta ime.

Gjëja e mrekullueshme ishte kjo: Në vend që të rrotullonin sytë dhe të ankoheshin për muzikën e re dhe të zhurmshme, prindërit e mi na ftonin që të praktikonim në dhomën e ndenjes.

Mami na ushqente me ëmbëlsirat që gatuante vetë, ndërkohë që babi jepte miratimin e tij të pakursyer për mënyrën se sa fort kishim punuar për ta bërë grupin tonë të suksesshëm. Babi vinte kur luanim në festat e gjimnazeve të qytetit. Ai qëndronte në fund të sallës dhe na thoshte sa mirë po ecnim në rrugën tonë drejt suksesit!

Shumë vite më vonë, pasi i thashë “po” Jezusit dhe “mirupafshim” grupit tim muzikor, unë bëra predikimin tim të parë. Babai im ishte sërish aty në fund, me lot në sy, dhe me zemrën plot krenari.

Babai im i linte punët e tij për të treguar interes në jetën time. Në çfarëdo gjëje që përfshihesha, edhe ai përfshihej gjithashtu. Tashmë e di që kjo lloj mbështetjeje është e rrallë. Shumë e rrallë. Pa shumë fjalë, babai im më dha veten e tij: interesimin e tij, kohën e tij, dhe praninë e tij. Me pak fjalë, ai besoi në mua! Çdo bir ka nevojë për një baba që ka besim tek ai.

Kur fëmija juaj hyn në vitet e fundit të adoleshencës, është tunduese që të mendojmë se ata nuk kanë më nevojë për ju ashtu siç kishin dikur. Adoleshenti juaj është i pavarur; është i aftë dhe i zgjuar, nuk varet më nga çdo fjalë e juaja, nuk ka nevojë ose nuk kërkon mbikqyrjen tuaj të vazhdueshme. Ai tashmë ka idetë e tij dhe ndonjëherë nuk është edhe aq diplomatik në mënyrën se si i shpreh opinionet e tij që ndryshojnë vazhdimisht.

Këto sjellje i tundojnë prindërit që të tërhiqen, të vendosin një distancë të sigurt indiferentizmi ndërmjet tyre dhe vajzës apo djalit të tyre adoleshent. Por shikoni gjetjet e një studimi të ri:

“Kupa e Shenjtë për të ndihmuar të rinjtë të qëndrojnë aktiv në jetën e besimit edhe kur të rriten ka qenë në shtëpi përgjatë gjithë kohës: prindërit! Nënata dhe baballarët që praktikojnë atë që predikojnë dhe predikojnë atë që praktikojnë janë ndikimi më madhor që lidhet me ruajtjen e besimit tek adoleshentët në të 20-at e tyre”.¹²

Baballarë, mbani mend që pjesa e hershme e fëmijërisë dhe pjesa e fundit e kësaj faze (vitet e paraadoleshencës) janë periudha të shkëlqyera për t’i mbajtur fëmijët tuaj pranë vetes në përditshmërinë tuaj. Pse? Sepse në këto vite ata në fakt duan të kalojnë kohë cilësore me ju! Ata mendojnë se ju nuk bëni gabime dhe se ju dini gjithçka! Përfitoni nga kjo periudhë, sepse më pas vijnë vitet e adoleshencës kur papritmas ata do të mendojnë se ju nuk dini asgjë! Siç thotë shprehja: “Punësoje një adoleshent ndërkohë që ai ende di gjithçka”.

Kaloni kohë në mënyrë të qëllimshme me adoleshentin tuaj. Dilni nga programi dhe bëhuni pjesë e gjërave që i interesojnë atij apo asaj dhe përfshijini në të gjitha aspektet e jetës tuaj.

DIANE:

Kur fëmijët tanë më të mëdhenj ishin adoleshentë, unë shokohesha nga modelet e flokëve të disa prej shokëve të tyre! Flokë të ngrira, të ngritura lart që i bënin të dukeshin si dinozaurë të ditëve moderne - isha e sigurt që fëmijë të tillë duhet të ishin rebelë! Por Rebeka me durim më tregoi një anë tjetër të historisë.

Ajo më sfidoi të shihja se çfarë po thoshte në të vërtetë ai fëmija në dukje i egër ishte se ai ishte unik. Në vend që të ndiqte stilin e turmës - ato që unë i konsideroja si prerje të rregullta dhe plotësisht të pranueshme, ai ishte i vendosur të ishte vetvetja.

Në të njëjtën kohë, të dy adoleshentët e mi më tregonin se çfarë ndodhte pas atij stilit të rregullt që më pëlqente mua: festa me dehje, imoralitet, dhe një stil jetese që veç i pastër nuk ishte.

Jo, fëmijët e mi nuk ishin gjithmonë të ëmbël dhe të këndshëm kur më korrigjonin. Ndonjëherë tendencat e mia gjykuese i irritonin adoleshentët e mi. Por Perëndia i përdori ata për të ndryshuar mënyrën se si unë e shihja këtë brez individualistësh, dhe do t'u jem përgjithmonë mirënjohëse fëmijëve të mi që më sforcean të shihja se çfarë donin të thoshin në të vërtetë.

Shërbeni së Bashku

Kjo është mënyra se si Jezusi i trajnoi dishepujt e Tij: duke punuar dhe jetuar, duke qeshur dhe duke folur *shumë* bashkë me ta! Dishepujt (disa prej të cilëve mund të kenë qenë adoleshentë) panë me sytë e tyre, teksa Jezusi u përgjigjej kritikëve të Tij. Ata e panë teksa falte të pafalshmen. E panë teksa derdhte mëshirën e Tij tek njerëzit që kishin nevojë për të. Ata e dëgjuan teksa Ai i lutej Atit të Tij.

Gjithë ajo që panë dhe jetuan, si dhe të qenit pjesë e jetës së Tij krijoji një lidhje që i bëri ata të binin në dashuri me Atin.

PHIL:

Teksa udhëtoja me ungjilltarin ndërkombëtar Luis Palau, vajza ime Rebeka vinte me mua si asistente personale që kur ishte pesëmbëdhjetë deri në moshën njëzet e tre vjeçe. Ajo pati mundësinë të shikonte një pjesë të madhe të SHBA-së dhe të udhëtonte në Angli, duke parë se si mijëra persona i jepnin jetën Jezusit.

Këto vite udhëtimi dhe shërbese e formuan Rebekën, duke i dhënë vetëbesim dhe duke ndezur dashurinë e saj për udhëtime. Ne ndërtuam një marrëdhënie të ngushtë të cilën e ruajmë ende, duke ndarë histori që janë vetëm tonat, kujtime babë/bijë të kohëve të bukura. Tani kur rastis të takoj bashkëpunëtorë me të

cilët kam punuar, në mënyrë të pashmangshme ata duan të dinë gjithçka lidhur me Bekën.

Më pas, kur mbollëm kishën në Portland, vajza ime Elizabeth këndonte në grupin e adhurimit ndërsa unë e drejtoja këtë kohë. I kemi shijuar shumë ato vite shërbese së bashku.

Djali ynë i vogël, i cili ishte dymbëdhjetë vjeç në atë kohë, u mësonte katërvjeçarëve mësimin e tyre nga Bibla. Çdo të shtunë, pasi mbaroja përgatitjet për predikimin, ndihmoja Matt-in me mësimet e tij. E lexonim historinë së bashku dhe flisnim se çfarë do t'u mësonte ai dhe si. Dhe në fund, kur Diane dhe unë mbollëm një kishë përkrah John Mark-ut, përjetuam shumë emocione duke parë Perëndinë të lëvizte fuqishëm. Të premtëve në mbrëmje, ai drejtonte një kohë adhurimi të quajtur "Rrugë", që u rrit në mbi 1000 fëmijë. Ne qëndronim në fund të sallës dhe mrekulloheshim kur shihnim se çfarë po bënte Perëndia nëpërmjet djalit tonë.

Kultivoni Miqësi së Bashku

Diçka pothuajse magjike fillon të ndodhë përgjatë viteve të hershme të adoleshencës, dhe nëse ju e kapni dhe tregoheni të kujdesshëm me të, do të përfitonit prej saj për pjesën e mbetur të jetës tuaj.

Fëmija juaj fillon të rritet në urtësi dhe njohuri shpirtërore, dhe ai ose ajo e derdh atë njohuri të freskët mbi ju. Një situatë ndodh, dhe ajo tërheq dorën tuaj për t'u lutur së bashku, sepse e di që jeni të shqetësuar, dhe e di gjithashtu që ilaçi më i mirë ndaj ankthit është lutja. Ose, ndoshta ju nuk dini çfarë të bëni, dhe djali ju jep mençuri drejtpërdrejt nga Fjala - dhe merr kuptim!

Askush nuk na ka folur asnjëherë për këtë aspekt të mrekullueshëm të prindërimit të adoleshentëve. Kishim dëgjuar vetëm histori të frikshme të rebelimit dhe mosrespektimit, sikur kjo të ishte ajo që duhet të prisnim. Por teksa secili prej fëmijëve tanë adoleshentë u rrit në marrëdhënien me Perëndinë, ata u bënë motrat dhe vëllezërit tanë më të afërt. Në fakt, kështu janë ende! Ata na kujtojnë se çfarë është vlera e vërtetë, e drejtë dhe reale. Ata na nxitin dhe ndonjëherë na korrigjojnë

kur të menduarit tonë nuk është siç duhet. Ata luten me ne dhe për ne, dhe na ofrojnë urtësi të vërtetë kur na nevojitet.

Ata kanë nevojë për praninë tuaj sigurisht, por kanë nevojë për më shumë.

ADOLESHENTI JUAJ KA NEVOJË PËR INKURAJIMIN TUAJ

Ne vumë re një cikël gjatë kësaj faze në jetën e adoleshentëve tanë. Pas një korrigjimi të çfarëdoshëm - heqje vërejtje, qortimi apo kufizimi - ata dekurajoheshin.

Kur ishin më të vegjël, ata thjesht e hidhnin pas, por si adoleshentë nuk hiqnin dorë kollaj. Me gjithë luhatjet hormonale, presionin e vazhdueshëm nga bashkëmoshatarët dhe gjithë sjelljet e pahijshme që hasnin në shkollë, kur i korrigjonim, ata *fundoseshin*. Qëndrimet e tyre fundoseshin bashkë me ta, gjë që sillte më shumë qortim dhe më shumë dekurajim.

Këtu zbuluam rishtazi fuqinë e inkurajimit. Inkurajimi është thjesht *dhënia e kurajos*. Duke u dhënë kurajo dhe forcë, ata ndjenin besimin që ne kishim tek ata kur besimi i tyre tek vetja dobësohej.

Në statistikën e mbledhura në vitin 2015, rreth tre milion adoleshentë të moshës dymbëdhjetë deri në shtatëmbëdhjetë vjeç kanë kaluar të paktën një episod depresiv madhor në vitin e mëparshëm. Më shumë se dy milion kanë raportuar të kenë përjetuar depresion që ka dëmtuar aftësitë e tyre funksionale të përditshmërisë. Rreth 6.3 milion adoleshentë kanë pësuar një çrregullim ankthi.¹³ Këto statistika duket që tregojnë se të thuhet që adoleshenti juaj ka nevojë për inkurajimin tuaj është një zvogëlim vulgar!

Ta inkurajoni me bollëk adoleshentin tuaj të dekurajuar është mënyra më e sigurt që të ndërtoni kurajon e tyre në mënyrë që të mund të ngrihen dhe të vazhdojnë përpara.

ADOLESHENTI JUAJ KA NEVOJË PËR AFEKSIONIN TUAJ

Po, adoleshenti juaj ka nevojë për mbrojtjen dhe disiplinën tuaj, dhe sigurisht ata kanë nevojë për inkurajimin tuaj. Por më shumë se gjithçka tjetër, ata kanë nevojë për *afeksionin* tuaj. Jepuni përqaftime me shumicë,

edhe nëse ata janë të ngurtë ose largohen tutje.

Një studim i bërë nga psikologia Virginia Satir doli në përfundimin se njerëzit kanë nevojë për të paktën dymbëdhjetë përfaqime në ditë në mënyrë që të rriten dhe të lulëzojnë. Tetë përfaqime në ditë nevojiten për të mbajtur një nivel të qëndrueshëm të shëndetit emocional, dhe minimumi katër përfaqime në ditë konsiderohen të nevojshëm për mbijetesë.

Afeksioni fizik rrit shumë ndjenjën tonë të lumturisë. “Një përfaqim, një përkëdhelje në kurriz, madje edhe një shtërëngim miqësor duarsh përpunohen nga qendra e reagimeve në sistemin nervor qendror, dhe kjo është arsyeja pse ato mund të kenë një ndikim kaq të fuqishëm në psikikën njerëzore, duke na bërë të ndjejmë gëzim dhe lumturi”.¹⁴

Është e natyrshme dhe normale që adoleshenti juaj të largohet prej jush, por prindërit nuk duhet të largohen nga djemtë dhe vajzat e tyre adoleshentë. Adolehentët kanë nevojë për sigurinë dhe ndjesinë e mbrojtjes që afeksioni juaj verbal dhe fizik siguron, dhe ata kanë nevojë që të jeni ju të parët që e jepni atë afeksion pa kërkuar asgjë në këmbim. Afeksioni i jep sigurinë adolehentit tuaj që ju e pëlqeni atë edhe atëherë kur duket sikur askush *nuk e pëlqen* - edhe atëherë kur atyre nuk u pëlqen shumë vetja.

Kini kujdes me atë sensin e humorit sarkastik që i bënte të qeshnin fëmijët tuaj kur ishin në 9-vjeçare. Në vitet e adolehencës, ai lloj humorit vlerësohet shumë rrallë dhe mund të dëmtojë ndjeshëm emocionet e brishta të adolehentit/es tuaj.

A është adolehenti juaj më i ndjeshëm se ç’duhet? Me shumë mundësi, po. Por mbindjeshmëria e tyre është vetëm një simptomë. Ai ose ajo mund të jetë duke treguar se sulmet nga bota ku jetojnë, çmenduria e ndryshimeve në trupin e tyre, dhe ndjenja e përgjithshme e të mos qenit mjaftueshëm i mirë po komplotojnë që t’i ulin poshtë ata. Kur ju i jepni siguri adolehentit tuaj me fjalë përkëdhelëse dhe afeksion të ngrohtë, mund të jeni duke e shpëtuar atë nga një vend me cënueshmëri të rrezikshme.

Ky është një rast tjetër kur ju vjen në ndihmë koncepti i llambës dhe dritës. Duke punuar së bashku dhe duke dëgjuar njëri-tjetrin, ishim në gjendje të tregoheshim më të vëmendshëm ndaj nevojave emocionale

të adoleshentëve tanë. Shpesh ishte Diane ajo që shikonte përtej fasadës që fshihte emocionet e brishta të adoleshentëve tanë. Nga ana tjetër, ndërsa ajo rritej, ishte babai i saj që më së shumti dallonte nevojën e Diane për butësi dhe përkëdheli. John Eldredge kishte të drejtë kur thoshte se çdo djalë pyet: *A kam atë që duhet?* Dhe çdo vajzë pyet: *A jam e bukur?*

Baballarë, ju i keni përgjigjet e të dyja pyetjeve. Bijtë dhe bijat tuaja janë duke parë nga ju, në gjithë brishtësinë e tyre, që t'u jepni një "Po!" të fortë. Nëse nuk ua jepni këtë konfirmim, ata mund ta kërkojnë diku tjetër. Fatkeqësisht, kjo diku tjetër mund t'ju krijojë plagë të dhimbshme.

Phil pati një nga ato rastet e rralla për të hapur një derë për vajzën tonë Elizabeth kur ajo ishte në gjimnaz. Një moment i vështirë që mund ta kishte çuar në hidhërim, por në fakt e çoi atë drejt një besimi të guximshëm.

PHIL:

Po jetonim në Oregonin Jugor kur për mua dhe Dianën u bë e qartë se Perëndia po na thërriste në veri, të mbillnim një kishë në Portland. Erdhi dita kur duhet të uleshim dhe t'i tregonim vajzës tonë Elizabeth që do të shpërnguleshim.

Ajo ishte gjashtëmbëdhjetë vjeçe dhe do të fillonte vitin e tretë të gjimnazit. Gjithçka po shkonte për bukuri në jetën e saj. Kishte miq të mirë, po ecte shumë mirë me mësimet dhe ishte e përfshirë me shumë entuziazëm në një kishë të madhe. Ajo po lulëzonte në gjithçka.

Kur u ula me të për t'i dhënë lajmin, më tha: "Babi, a mund të më japësh pak minuta?" Ajo shkoi në dhomën e saj dhe mbylli derën. Pas dhjetë minutash doli jashtë, me një pikë loti që i rrëshqiste në faqe, dhe tha: "Duhet të shkojmë. Babi, do të më këndosh një këngë adhurimi?"

Mora kitarën dhe fillova të këndoj një këngë nga ato të kishës që të dy e dinim. Me lotët që tashmë i rridhnin në të dyja faqet, filloi të këndonte bashkë me mua. Kur e pyeta ku kishte mësuar të këndonte ashtu, ajo tha: "Nuk e di". Por në atë moment dallova që ajo kishte një zë shumë të mirë dhe mund të këndonte edhe pjesët harmonike! Pa e kuptuar, ajo kishte

mësuar si të këndonte gjatë shërbesave të adhurimit në kishën ku bënim pjesë. I thashë se kur të mbillnim këtë kishë, do të doja që ajo të këndonte me mua në grupin e adhurimit.

Kur protestoi, duke thënë: “Babi, unë nuk do e bëja dot kurrë këtë!” i thashë se ajo mundej; ajo kishte zërin dhe kishte marrëdhënien me Perëndinë.

“Ti mund ta bësh këtë”, i thashë, “e di që mundesh”.

Kështu filloi një aventurë e re për të gjithë ne, dhe për disa vite të mrekullueshme një baba me të bijën i shërbyen Perëndisë krah për krah njëri-tjetrit në shërbesë së bashku. Dhe e dini kush ishte pas nesh duke luajtur në bateri! E gjetët! Brook, djaloshi që më pas do të bëhej bashkëshorti i saj.

Do të dëgjoni njerëz të thonë: “Kurrë mos i shpërngulni fëmijët tuaj gjatë gjimnazit”. Në shumicën e rasteve, do të pajtoheshia me këtë mendim. Por ka një përjashtim: Shpërnguluni nëse Perëndia po ju shpërngul! Kur ai drejton, dhe ne e ndjekim me besim, Ai bën të mundur që gjithçka të shkojë sipas qëllimeve të Tij.

Kur ia dhamë lajmin atë ditë, vajza jonë nuk filloi të përplasej dhe të bërtiste duke thënë: “Si mund të ma bëni këtë? Si mund të më largoni nga të gjithë miqtë e mi pikërisht përpara maturës?” Ajo ishte në gjendje të shkonte në dhomën e saj dhe të kalonte disa minuta me Jezusin, duke iu dorëzuar planit të Tij për të, dhe më pas të dilte e të thoshte: “Duhet të shkojmë!”

Elizabeth ishte në gjendje ta bënte këtë, pasi ajo ishte “rrënjosur dhe themeluar” në besimin e saj personal e të vërtetë. Ne lutemi që ju të mund të përjetoni diçka të ngjashme një ditë me adolehentin/en tuaj. Nuk ka të krahasuar kjo ndjesi!

Do t’ju marrë jashtëzakonisht shumë kohë që përgjatë viteve të adolehencës të mund të orientoheni mirë dhe me zgjuarsi. Si shkrimtar, mësues, dhe prind Charles Swindoll ka thënë: “Mos u mashtroni nga miti i “kohës cilësore”. Ajo që kërkohet nga ju si prind është koha sasiore - roli juaj kryesor në jetë përgjatë viteve që do të pasojnë. Duhet kohë që ta njihni thellësisht një person tjetër. Shumë kohë. Kohë që mund të mendoni se nuk e keni në dispozicion, por duhet ta gjeni. Kohë për të ndaluar, për të parë, dëgjuar, inkurajuar dhe për të dashur. Kohë, që kur të ktheni kokën pas, të mos keni asnjë pishman”.¹⁵

Sa mirë e ka thënë!




Pjesa 5

Përmbyllja e Punës

Moshat 18-22 vjeç

Kështu Solomoni e përfundoi shtëpinë e
Perëndisë
dhe pallatin mbretëror, dhe përfundoi me sukses
gjithçka që kishte planifikuar të bënte
në shtëpinë e Perëndisë
dhe në pallatin e tij.
2 Kronikat 7:11



Kapitulli 18

Kutia Tani

Faza përfundimtare e ndërtimit të një shtëpie quhet përmbyllje e punës. Banaku vishet me pllaka ose mermer. Parketi dhe moketi mbulojnë dyshemenë. Muret e dhomave zbukurohen me elegancë, ndërsa oxhaku shndrin nga veshja e punuar me shumë finesë.

Shtëpia juaj tashmë ka përfunduar!

Pas disa muajsh punë, ju bëni një hap pas dhe buzëqeshni me kënaqësi për pamjen që keni përpara jush. Ëndrrat dhe planet tuaja janë përmbushur, dhe shtëpia juaj i ngjan asaj që kishit ëndërruar për familjen tuaj.

Të dyja herët që kemi ndërtuar shtëpi, kur vinim në këtë fazën e dorës së fundit, gjendeshim pa para, pasi na kishin mbaruar! Është shumë acaruese kjo gjë, pasi kjo është pjesa ku gjithë bukuria e dizenjimit vjen së bashku. Përmes vështirësive mësuam që buxheti nuk i mbulon të gjitha shpenzimet. Për shkak se na mbaronin lekët, nuk mund ta përfundonim fazën përmbyllëse!

Duam t'ju këshillojmë, që të mos mbeteni pa “para” në vitet e fundit të rritjes së bijve dhe bijave tuaja! Ruajini edhe për pak kohë, nuk keni përfunduar ende. Kushdo që vendos t'u thotë prindërve se puna e tyre përfundon kur fëmija mbush tetëmbëdhjetë vjeç e ka komplet gabim. Ka ende punë thelbësore për t'u bërë.

Përfundimi i mirë është një refren që përsëritet shpesh në Shkrim. Bibla thotë: “Dhe kështu Moisiu e përfundoi punën e tij” (Eks. 40:33).

Pali deklaroi: “Luftën e mirë e luftova, e përfundova vrapimin, e ruajta besimin” (2 Tim. 4:7).

Pali i këshilloi korintasit: “Tani çojeni deri në fund atë që keni filluar të bëni, ashtu siç patët dëshirën për ta filluar, ashtu edhe përfundojeni sipas mundësive që keni” (2 Kor. 8:11).

Moisiu e përfundoi punën e tij, Pali e përfundoi punën e tij, dhe Pali paralajmëroi korintasit që ta përfundonin punën e tyre.

Mbi të gjitha, Jezusi e përfundoi punën e Tij. Ai i tha Atit: “Unë të kam përlëvdur mbi tokë duke e kryer veprën që më ke dhënë të bëj” (Gjo. 17:4).

Ju filluat tetëmbëdhjetë vite më parë, duke punuar fort për të hedhur një themel të fortë. Ia dolët t’i mbijetonit edhe viteve të fëmijërisë, edhe atyre të adoleshencës! Mos u dorëzoni tani! Përfundojeni! Përfundojeni! Përfundojeni!

E mbani mend Kutinë? Baza është Jezusi, njëra anë disiplina, ana tjetër rregulli, dhe pjesa e domosdoshme, ajo e sipërmja, është afeksioni, afirmimi, dhe argëtimi që fëmijët tanë i dëshirojnë aq shumë. Në këtë fazë përmbyllëse, Kutia është sërish aty, por forma e saj ka ndryshuar në mënyrë drastike. Ja si duket ajo:



Jezusi është ende aty, bisedat tuaja vërtiten sërish rreth Tij. Ai do të jetë gjithmonë themeli i marrëdhënies me fëmijët tuaj. Dhe afeksioni, afirmimi, dhe argëtimi janë më të rëndësishme se kurrë më parë.

Kjo është koha kur duhet të bëheni miq! Ju keni kaq shumë gjëra të përbashkëta tani, ndërsa bijtë e bijat tuaja kanë nevojë për inkurajimin tuaj që të kalojnë përmes asaj që ekspertët na paralajmërojnë të jetë faza më pështjelluese e jetës dhe e prirur drejt ankthit.¹ Por rregulli në jetën e tyre të përditshme nuk është më përgjegjësia juaj parësore, edhe disiplina që përdornit për t’i mësuar dhe për t’i dhënë formë karakterit të tyre tashmë është minimale dhe e rrallë.

Përgjatë këtyre viteve përmbyllëse, duhet të keni parasysh një parim të rëndësishëm: *mos korrigjoni më tepër se ç’duhet!* Mos u grricni me djalin ose vajzën tuaj në këtë fazë të rritjes së tyre. Ndoshta ka diçka që jeni munduar shumë që t’ua mësoni, por ata sërish nuk po e bëjnë atë gjë sipas dëshirës tuaj.

Ju nuk doni ta mundni djalin tuaj ose ta shtypni vajzën tuaj teksa bëjnë përpjekjet e para drejt pavarësisë së moshës madhore. Nuk është kjo mënyra se si Perëndia vepron me bijtë e Tij. Billy Graham theksoi me urtësi: “Perëndia nuk na disiplinon ne që të na nënshtrojmë, por që të na përshtatë për një jetë të dobishme dhe të bekuar”.²

Biri ose bija juaj (megjithë papërsosmëritë) po hyn në një jetë ndërveprimesh. Jepini miratimin tuaj për gjërat e bëra në mënyrën e duhur. Ndërtojini dhe nxitini në marrëdhënie me Jezusin.

Siç thotë Bob Goff: “Perëndia nuk është redaktor. Ai është krijues. Ai nuk shikon gabimet e jetëve tona, por shikon bukurinë e tyre”.³ Le të jemi ne lloji i prindërve që shikojnë të bukurën në jetën e fëmijëve tanë!

Nëse për shumë vite keni qenë duke trajnuar fëmijët tuaj për të qenë ndjekës të Jezusit, në këtë fazë ju thjesht do t’i udhëzoni ata, duke i rikujtuar dhe rafinuar, duke bërë ndërhyrje të vogla teksa u jepni ende edhe më shumë përgjegjësi për jetët e tyre.

Kjo është ajo fazë e jetës së tyre kur ju doni të respektoni ndryshimet midis jush, teksa pranoni që Perëndia dëshiron që djali ose vajza juaj ta jetojnë jetën sipas thirrjes unike të tij/saj.

QËLLIMET DHE VLERAT

Në fillim të këtij libri, kemi folur për dallimin midis qëllimeve dhe vlerave. Qëllimi kryesor që keni është që fëmija juaj të rritet duke dashur Zotin, Perëndinë e tij me gjithë forcën, mendjen, dhe zemrën, dhe duke dashur njerëzit me qëllim.

Sa për atë listën e vlerave, ato mënyrat e jetesës që ju shpresonit që ata të mund t’i adoptonin në veten e tyre, por thjesht nuk i kanë marrë - epo, në këtë fazë thjesht duhet t’i lini pas. Nuk po flasim për vlerat morale këtu, por për mënyrat e përditshme të jetesës. Ju keni bërë më të mirën, dhe djali juaj ende nuk e kupton përse një garderobë përsosmërisht e rregullt, e koordinuar sipas ngjyrave, është një problem kaq i madh! Ose pse mbajtja e bërrylit jashtë tavolinës teksa ha është kaq e rëndësishme.

Thjesht harrojeni! Le të kalojë!

Ndoshta nuk keni arritur dot t'i mësoni mirësjelljen, por tashmë është problemi i tij, jo i juaji. Në fakt, do të jetë problemi i bashkëshortes së tij! Shefi i tij, miqtë, dhe kolegët do të vënë në peshore gjithçka që i bezdis ata. Tashmë është koha për ju të zmbropseni dhe thjesht t'i jepni atë dashurinë e rrallë dhe pa kushte që çdonjëri prej nesh e dëshiron.

Mos e shkatërroni marrëdhënien me fëmijët tuaj pothuajse të rritur duke këmbëngulur që ata t'u përmbahen vlerave tuaja specifike. Nëse i shtyni fëmijët të përvetësojnë çdonjërin prej vlerave tuaja teksa rriten, do t'i tjetëroni ata. Duke ndjerë mosmiratimim tuaj, ata do të zmbropsen. Pra, në vend që ta shtyni djalin apo vajzën tuaj që të pajtohet me mënyrën se si juve ju pëlqen të jetoni, jini mirënjohës që ai ose ajo po rend drejt synimit për të ndjekur Jezusin. Ç'mund të jetë më mirë se kaq?

Mijëra vite më parë, nëpërmjet profetit Isaia, Perëndia paralajmëroi për një popull, adhurimi i të cilit ndaj Perëndisë “nuk ishte gjë tjetër veçse rregulla të mësuara nga njerëzit” (Isa. 29:13). Kjo është gjëja e fundit që duam për fëmijët tanë! Ne duhet të jemi të kujdesshëm të mos e zbehim pasionin e fëmijëve tanë për Perëndinë duke u imponuar rregullat tona njerëzore teksa arrijnë në moshë madhore.

Mbani mend, mami dhe babi, që edhe pse puna juaj është drejt përfundimit, Perëndia ende nuk ka përfunduar; keni ende shumë punë! Ati nuk do të ndalojë asnjëherë së punuari në ju dhe në fëmijën tuaj. Pali e përshkruan bukur këtë tek Filipianët 1:6:

“Jam i sigurt se ai që nisi një punë të mirë në ju, do ta përfundojë deri në ditën kur të vijë Krishti Jezus”.⁴

Kapitulli 19

Lista

Numërimi mbrapsht ka filluar. Në vetëm pak muaj, tetëmbëdhjetë—njëzetedyvjeçari juaj do të jetë komplet më vete. Gati ose jo, do të jetë koha që ju do ta lëshoni djalin ose vajzën tuaj në botë. Detyra juaj parësore do të përfundojë.

Disa fëmijë do të jenë gati dhe duke pritur me padurim për të ikur. Disa do të mbeten pak më mbrapa, duke e dashur lirinë, por duke hezitur të marrin përgjegjësitë që vijnë me maturimin. Në fakt, në vitin 2015 “fjala e re e vitit” në anglisht ishte një folje: *adulthood* (maturimi). Fjalori i Webster e përshkruan kështu:

“Nëse ende nuk e keni dëgjuar (ose nuk e keni përdorur), do ta dëgjoni së shpejti: “maturohem” si folje: “Ju lutem dikush të më mësojë si të maturohem”.

Nëse djalit apo vajzës tuaj i duket pak i vështirë *maturimi*, mos u dëshpëroni! Përkundrazi, përvetësoni këndvështrimin e duruar të Palit, i cili harxhoi vite të tëra duke udhëzuar dhe mësuar njerëzit se si të zbatonin vlerat e perëndishmërisë në jetën e tyre të përditshme, ndërsa kuptoi se ende kishin nevojë për më shumë:

“Së fundi, o vëllezër, ju mësuat prej nesh sesi duhet të jetoni ashtu siç i pëlqen Perëndisë. Ju lutemi dhe ju bëjmë thirrje në emër të Zotit Jezus që të vazhdoni të jetoni kështu, madje të përparoni edhe më shumë” (1 The. 4:1).

Shumë, në mos shumica e të rinjve kanë më shumë nevojë për udhëzimin dhe mësimin tuaj të duruar gjatë kësaj faze. Keni edhe këtë mundësi të fundit për të mbushur boshllëqet, përpara se djali apo vajza juaj ta lënë strehën tuaj të ndikimit. Mbani mend se përparësia juaj më e lartë është të rritni fëmijë që jo thjesht *pretendojnë* se besojnë, por të cilët në fakt zotërojnë një besim të vërtetë, fëmijë që e duan Perëndinë me gjithë zemrën, shpirtin, mendjen dhe forcën e tyre dhe që i duan njerëzit me qëllim.

DHJETË GJËRA QË DUHET T’U MËSONI FËMIJËVE TUAJ

Disa vite më parë, Phil ishte i ftuar në një drekë me pastorë në zonën e Portland ku ishte folës Francis Chan. Në vend që të fliste për rritjen e kishës, si të predikojmë mesazhe të shkëlqyera, ose ndonjë nga temat e mundshme për një takim pastorësh, Francis i foli në mënyrë shumë personale dhomës së mbushur me drejtues rreth asaj që ai kishte në zemër teksa vajza e tij po hynte në vitin e fundit të gjimnazit.

“Së shpejti vajza ime do të largohet për në universitet”, tha ai. “Më ka mbetur vetëm një vit me të nën çatinë time, dhe ka shumë gjëra që dua ta di nëse ajo i kupton, gjëra për të cilat dua të sigurohem që janë bërë pjesë e jetës së saj”.

Çdo pastor në dhomë u zgjat paksa përpara teksa Chan rreshtoi një listë me dhjetë gjëra që ai ndihej i detyruar t’ia nguliste vajzës së tij përpara se ajo të linte shtëpinë për të shkuar në universitet. Duke qenë se djali ynë i fundit, Matthew, jetonte në shtëpi me ne ndërsa ndiqte universitetin që ndodhej aty pranë, Phil mbajti shënim çdo gjë të mundur!

Folëm deri vonë atë natë rreth listës së Chan dhe ndjenjës së tij të urgjencës që na përkiste edhe ne. Më pas bëmë një listë tonën, me disa gjëra specifike për të cilat kishim folur dhe e kishim udhëzuar djalin tonë dhe për të cilat duhet ta këshillojmë atë, ashtu si thoshte Pali, gjithnjë e më shumë.

Ju inkurajojmë të bëni të njëjtën gjë. Bëni një listë, listën tuaj personale, të gjërave për të cilat ka ende nevojë djali apo vajza juaj.

Madje më mirë, fillojeni atë listë herët në jetën e fëmijës tuaj.

Së bashku, krijoni listën me 10 (ose 20) gjërat kryesore për të cilat ju e dini që ka ende nevojë djali ose vajza juaj në mënyrë që të jetë një ndjekës plotësisht i përkushtuar i Jezusit.

Këto nuk janë gjëra me të cilat duhet të filloni të punoni në moshën tetëmbëdhjetëvjeçare. Ato janë vlerat që do t'u mësoni fëmijëve tuaj ndër vite, duke filluar kur janë shumë të vegjël, me qëllimin, shpresën, dhe lutjen që ato do të bëhen bindje personale të qëndrueshme në jetën e djalit ose vajzës tuaj. Më pas, me procesin e taktikës së anasjelltë, ju vendosni kur dhe si do t'ia mësoni fëmijës tuaj secilën prej dhjetë gjërave kryesore që keni listuar. Ju dëshironi që fëmija juaj jo vetëm të kuptojë *si të*, por në të vërtetë *të jetë në gjendje* t'i zbatojë në praktikë këto vlera.

Të qëndrojnë të palëkundur

Të rinjtë tanë deri në këtë moshë duhet të zhvillojnë me vetëdije bindjet e tyre, bindje se si të jetojnë dhe me kë të miqësohen, apo rreth marrëdhënieve të sinqerta e të shëndetshme. Ata duhet të kenë një kuptim të vlerave të tyre personale, vlera që i nxitin ata, të shoqëruara nga një vendosmëri e brendshme për të jetuar sipas këtyre bindjeve.

Tek Efesianët 6:10-11, Pali përdor një metaforë lufte për të ndihmuar njerëzit të kuptojnë se çfarë do të thotë të qëndrojnë fort kundër kurtheve dhe tundimeve të vazhdueshme me të cilat të gjithë ne përballemi. Ai na parajamëron që të mos asimilohemi nga bindjet dhe vlerat e botës që na rrethon:

“Së fundi, vëllezër, forcohuni në Zotin dhe në forcën e fuqisë së tij. Vishni gjithë armatimin e Perëndisë që të mund të qëndroni të palëkundur kundër dredhive të djallit, sepse beteja jonë nuk është kundër mishit dhe gjakut, por kundër principatave, kundër pushteteve, kundër sunduesve të botës të kësaj bote të errët, kundër *forcave* të liga në *vendet* qiellore. Prandaj merrni të gjithë armatimin e Perëndisë, që të mund t'i bëni ballë ditës së ligë dhe të qëndroni të palëkundur pasi të keni luftuar deri në fund”.

Pali i bashkëngjijt një listë nxitjes së tij për të qëndruar të palëkundur përpara armikut, një listë me mënyra specifike për t'u mbrojtur dhe për të forcuar veten në mënyrë që të mund t'i bëjmë ballë e jo të biem në "ditën e ligë". Kini parasysh që fjala greke e përkthyer "e ligë" në këtë pasazh (*ponēros*) nuk po flet për shtëpi me fantazma apo lëvizje të frikshme. Fjala i referohet "ligësisë në kuptimin moral ose shpirtëror . . . ligësi që korrupton të tjerët, që është keqdashëse".¹

Ju dëshironi që djali apo vajza juaj të jenë të fortë në Zotin, aq të qëndrueshëm në bindjet e tyre saqë të mos lëkunden nga presioni i bashkëmohatarëve. Nëse e gjejnë veten në një situatë ku nuk duhet të jenë, me shokë që i shtyjnë të bëjnë gjëra të cilat nuk duhet t'i bëjnë - s'ka problem! Ata do ta dinë kur të ngrenë zërin për të folur dhe kur të largohen që aty.

Do të bënim mirë t'u mësonim fëmijëve tanë që të ushtrojnë vendosmërinë e tyre duke u ngjitur pas asaj që besojnë. Duke ditur që presioni i bashkëmohatarëve dhe kënaqja e njerëzve janë forca madhore që mund të devijojnë vendosmërinë tonë për të qëndruar besnikë ndaj bindjeve tona, ne qëndrojmë përkrah fëmijëve tanë për t'u dhënë zemër të qëndrojnë fort në bindjet që kanë. Ne i mësojmë të marrin vendime të qëllimshme duke mos u bazuar në ndjenjat e momentit, por në bindjet që kanë përvetësuar.

Atëherë, dhe vetëm atëherë, do të kenë atë që Jezusi premtoi kur tha: "Vjedhësi nuk vjen veçse për të vjedhur, për të vrarë e për të shkatërruar; por unë kam ardhur që të kenë jetë e ta kenë me bollëk" (Gjo. 10:10).

Të Qëndrojnë të Pastër Seksualisht

Tek 1 Thesalonikasve 4:3-6 Pali thotë:

"Sepse ky është vullneti i Perëndisë: shenjtërimi juaj; të hiqni dorë nga kurvëria; që secili prej jush të dijë ta mbajë enën e vet në shenjtëri dhe me nder, jo me pasione epshi, si paganët që nuk e njohin Perëndinë, dhe që askush të mos mashtrtojë ose t'ia hedhë vëllait ose motrës së vet".

Mos ndaloni asnjëherë së foluri për pastërtinë seksuale! Vazhdojeni

bisedën. “Si po ia del me tundimet e internetit bir?” “A keni arritur në një marrëveshje me të dashurin rreth kufijve fizik, shpirt?” Këto biseda duhet të bëhen “kur jeni në shtëpi apo kur ecni rrugës, kur uleni dhe kur ngriheni” (Li. i Për. 6:7).

Kjo nuk ka të bëjë vetëm me virgjërinë e tyre, sado e bukur dhe e rëndësishme që mund të jetë për ju që fëmija juaj i pamartuar ta ruajë atë. Ka të bëjë me pastërtinë seksuale, që përfshin po ashtu frenimin e epshit, të dinë si të veprojnë ndaj tundimit, çfarë standardesh të mbajnë në një lidhje, çfarë filmash apo vendesh nxitin tundimet dhe si të shprehin afeksion pa e kaluar kufirin drejt pasionit. Si mamaja, ashtu edhe babai duhet të jenë duke i mësuar fëmijët e tyre në mënyrë aktive dhe të hapur pse dhe si të ruajnë pastërtinë e tyre seksuale përgjatë gjithë jetës.

Më shumë se gjithçka, fëmijët tuaj duhet të kuptojnë se ruajtja e pastërtisë është diçka që zgjat për gjithë jetën. Ne jemi të gjithë së bashku në këtë gjë, duke nderuar Perëndinë me seksualitetin tonë. E dimë se është e vështirë; të gjithë ndeshemi me dështime përgjatë rrugës, por ne i sjellim ato lëmshe tek Ati duke kërkuar falje dhe forcë për të vazhduar më tej.

PHIL:

Pas universitetit dhe dy punëve në spital në qytetin e saj të lindjes në Portland, Oregon vajza ime Rebeka filloi një punë të përkohshme në zonën e Los Anxhelos si terapiste respiratore. Ajo më tha: “Babi, mendoj ta marr këtë punë udhëtuese për tre deri në gjashtë muaj. Jam gati për pak aventurë!”

Pak para se të planifikonte të kthehej në shtëpi, Rebeka takoi Steve-in, i cili në fakt u bë bashkëshorti i saj. Duke mos e njohur Steve-in fare, por duke parë se marrëdhënia e tyre po bëhej serioze, i hipa avionit dhe shkova ta takoja atë.

Dolëm për kafe, gjë që e bëri Rebekën të ndihej shumë nervoze.

“Vajza juaj është shumë e bukur në çdo aspekt”, më tha Steve gjatë kafes.

“E di që është”. E pashë në sy dhe i thashë: “E kam ruajtur pastërtinë e Rebekës gjatë gjithë jetës së saj, dhe kërkoj që edhe ti të bësh të njëjtën gjë”.

Vite më parë, i kisha dhënë Rebekës një unazë të vogël diamanti si një “unazë premtimi”, një shenjë e besëlidhjes së saj me Perëndinë për ta mbajtur veten të pastër deri në ditën e martesës. Ajo që unë nuk dija deri përpara dasmës së tyre ishte që babai i Steve, një pastor në Kanada, kishte bërë të njëjtën gjë me birin e tij!

Një ditë, pak para dasmës, më ra celulari. Ishte Beka.

“Babi, ti do të bësh pjesën e premtimeve në ceremoni dhe të na japësh unazat. Duam që t’u tregosh miqve tanë që Steve dhe unë e kemi ruajtur veten të pastër për njëri-tjetrin, dhe që unazat tona të premtimit i shkrimë në unazën e tij të martesës”.

Me zor i mbaja lotët teksa kisha në duar ato unaza për disa momente përpara se Steve dhe Rebeka t’i vendosnin ato në gishtat e njëri-tjetrit. Nuk do ta harroj kurrë.

Ndërkohë që kjo mund të mos jetë historia që i ndodh kujtdo – nuk më ka ndodhur as mua kështu - pse të mos luteni që djemtë dhe vajzat tuaja të qëndrojnë të pastër seksualisht dhe të hyjnë të virgjër në martesë? Ky është plani i Perëndisë, dhe është shumë i bukur!

Të Dinë Si të Zgjedhin një Bashkëshort Apo Bashkëshorte

Kur djemtë tanë ishin në fazën e rinisë së hershme, secili prej tyre ka shkuar tek Diane me të njëjtën pyetje: *Si do ta di me kë duhet të martohem? Për çfarë duhet të jem duke parë tek një bashkëshorte?* Në të dy rastet, Diane, duke qenë shkrimtare, u shkroi një seri letrash djemve të saj për t’iu përgjigjur pyetjeve të tyre.

Letrat e saj për John Mark-un i quajti: “Në kërkim të Evës”, dhe i dërgonte me postë të ngadaltë një herë në disa javë përgjatë vitit të tij të parë të universitetit. Teksa John Mark-u lexonte ato letra, ai filloi të kuptonte që “Evën” e tij e kishte mu përpara syve. Motra e shokut të tij të ngushtë, Tammy, dukej se shfaqte shumicën e atyre tipareve të

karakterit që Diane artikulonte javë pas jave. Plus, ai mendonte që ajo ishte mahnitëse!

Ndërsa ai vëzhgonte mënyrën e sjellshme në të cilën ajo bashkëvepronte me miqtë dhe familjen e saj, bukurinë, dhe jetën e saj me një zemër shërbyese, ai filloi ta lejonte zemrën e tij të dashurohej me të. Ajo ishte gruaja me të cilën donte të kalonte pjesën e mbetur të jetës së tij: një bashkëpunëtoreshë që do ta mbështeste në thirrjen e tij, ajo lloj gruaje që do ta ndihmonte në rritjen e fëmijëve me vlerat e tyre të përbashkëta, dhe një partnere me të cilën do të bashkohej për të zbuluar misionin e tyre së bashku.

Në kohën kur Matt bënte të njëjtat pyetje, Diane kishte hapur një faqe këshillash në internet. Me lejen e tij, ajo postoi secilën prej letrave për të si pjesë e një serie të quajtur “Letra Drejtuar Tim Biri”² si një mënyrë për t’u mësuar edhe meshkujve edhe femrave se kush duhet të luftojnë të jenë, si dhe çfarë të kërkojnë tek partneri i jetës.

Teksa Matt lexonte çdo postim, ai mori njohuri se për çfarë të shihte, çfarë të shmangte, dhe si të ishte vetvetja kur të dilte me një vajzë. Ndërsa ai lexonte këshillat e mamasë së tij, të njëjtën gjë po bënë edhe qindra të rinj të tjerë, shumë prej të cilëve janë martuar tashmë.

Më vonë John Mark shkroi një libër të titulluar *Dashurologjia*.³ Ai parashtrroi aty një teologji biblike rreth dashurisë, seksit, dhe martesës për një brez të rinjsh të rritur me një imazh imagjinar dhe përrallor për dashurinë dhe romancën. Ju këshillojmë fort që ta merrni këtë libër dhe ta lexoni me djalin apo vajzën tuaj. Do të përftoni një pamje të qartë të qëllimit dhe planit të Perëndisë për lidhjet dhe martesën.

Mos ia lini këtë vendim kaq të rëndësishëm rastësisë. Mësojeni djalin apo vajzën tuaj, duke u dhënë atyre njohuri të dobishme për ç’ka dini rreth tyre. Një nga historitë më të trishta që kemi dëgjuar të përsëritet është ajo e disa prindërve të mirë të krishterë që mendojnë se nuk u takon të “ndërhyjnë” në këtë gjë.

Pasi bashkëshorti i një mikeshës tonë e la atë për një grua tjetër, prindërit e saj i thanë: “Ja kishim merakun kësaj gjëje që kur filluat të dilnit bashkë. Kemi shpresuar dhe jemi lutur që të mos martoheshe me të”. Kjo grua e dashur i rriti të dyja vajzat e saj e vetme, duke luftuar që t’i falte prindërit e saj që nuk kishin folur përpara dasmës. Respekti i saj ndaj prindërve ishte aq i madh saqë ishte e sigurt se do t’ua kishte vënë veshin.

Duhet t'i kërkoni Perëndisë guxim për të ngritur zërin - me butësi dhe përlësi - kur ndjeni gjëra që ju shqetësojnë. Megjithëse biseda mund të jetë e vështirë, pas ca kohësh mund të jeni të lumtur që e bëtë.

Të Dinë Si të Administrojnë Paratë

Përpara se djali apo vajza juaj të fillojnë të jenë të përgjegjshëm për financat e tyre, sigurohuni që ata të njohin konceptet bazë dhe themelore të Biblës rreth administrimit të financave: si të krijojnë një buxhet, si t'i përmbahen atij buxheti, si të qëndrojnë larg marrjes hua, çfarë të bëjnë me ofertat e kartave të kreditit ose debitit, dhe pse është e rëndësishme pagesa e faturave në kohë.

Bëjeni këtë gjë me vigjilencë, pasi në qoftë se nuk e bëni, dhe ata futen në probleme financiare, e dini se kë do të telefonojnë të parin? Ju!

Ndihmoheni fëmijën tuaj të rritur që të bëjë zgjedhje të ndërgjegjshme për stilin e jetës që do të donte të jetonte dhe sa do t'i kushtojë. Përpara se të zgjedhin një degë universiteti ose karrierë, sigurohuni që të jenë realistë për sa i përket përfitimeve financiare dhe kërkesave që do të ketë profesioni i zgjedhur.

Mësojuni atyre gëzimin e të dhënit dhe besimin që përfshihet tek e dhjeta (dhënia e 10% të të ardhurave të tyre) që në fillim.⁴ Sa më herët që të mësojnë gëzimin dhe disiplinën e të dhjetës, aq më mirë është. Nëse mësojnë të japin të dhjetën kur fitojnë dhjetë mijë lekë në javë, do të jetë e lehtë që të vazhdojnë kështu edhe kur të fitojnë njëqind mijë lekë në javë. Ata që thonë: “Do të filloj ta jap të dhjetën një ditë që do të kem më shumë para”, po gënjejnë veten. Ndodh e kundërta. Ndërsa tregohemi besnikë në pak (në gjëra të vogla), Perëndia siguron më shumë.⁵ Tregojuni atyre që duke hequr mënjanë kursime në mënyrë të vazhdueshme që në moshë të hershme rrit interesin dhe siguron për të ardhmen e tyre.

Më shumë se gjithçka, mësojini fëmijës se çdo pjesë e jetës së tyre i përket Perëndisë, që ata janë administratorë të çdo qindarke në xhepat e tyre, që duke lejuar Perëndinë t'i udhëzojë dhe kontrollojë shpenzimet e tyre do t'u sigurojë një jetë plot aventura dhe besim.

Të Kenë një Kohë të Qëndrueshme me Perëndinë

Të dy ne e kemi njohur Perëndinë në rininë tonë të hershme. Kisha që na mirëpriti dhe na mësoi e theksonte shumë rëndësinë e zhvillimit të një kohe personale në mëngjes të ndarë mënjanë për leximin e Biblës. Kishte botime të gatshme në dispozicion për ata që ndiqnin disiplinën e të lexuarit të Biblës në një vit, dhe të dy ne e ndërmorëm këtë sfidë. Kështu filloi ritmi i leximeve (devocioneve) herët në mëngjes në të cilat ne ushqeheshim me Fjalën e Zotit.

Kalimi i kohës me Fjalën e Zotit mëngjes për mëngjes është një disiplinë shpirtërore që shpresojmë se fëmijët t'ju kenë parë ju duke e bërë në mënyrë të vazhdueshme përgjatë viteve, një zakon që, tani, ju nuk mund të imagjinoni ta humbisnit. Gjithashtu, ju shpresoni, të jetë një zakon që as fëmijët tuaj të mos e imagjinojnë ta humbasin. “Zakonet e shenjta janë: disiplina, rutina nëpërmjet të cilave ne qëndrojmë gjallë dhe të fokusuar tek Ai. Në fillim ne i zgjedhim dhe i zbatojmë; pas pak kohe ato bëhen pjesë e asaj që ne jemi. Dhe ato na mbajnë ne”.⁶

DIANE:

Përgjatë gjithë viteve që e kam njohur atë, Phil e ka lexuar të tërë Biblën çdo vit. Në janar ai fillon me Zanafillën, duke lexuar dy kapituj në Dhiatën e Vjetër, një nga Fjalët e Urta, një Psalm, dhe një kapitull të Dhiatës së Re. Çdo mëngjes, ai zgjohet, përgatit një filxhan me kafe të fortë, ulet në karrigen e tij të preferuar dhe hap Biblën e tij. Lexon kapitujt që ka caktuar të lexojë dhe plotëson kutitë përkatëse. Çdo mëngjes! S'është çudi pse e quaj konkordanca ime e gjallë! Unë mund t'a pyes ku është ai vargu që thotë ... dhe ai e di; nëse nuk e di saktësisht kapitullin dhe vargun, të paktën e di se në cilin libër të Biblës është dhe ku është për afërsisht, ose në cilën anë të faqes.⁷

E ndoqa shembullin e Phil-it për vite me rradhë, duke bërë rrugën time nga fillimi në fund, duke gjetur urtësi në çdo histori, në çdo faqe. Në fakt, ky zakon për mua u kthye në një detyrim që

duhej bërë, si një nga ato punët e shtëpisë që duhet bërë patjetër. E lexoja Biblën sepse e ndieja që duhet ta bëja, sepse të qenit e disiplinuar është e rëndësishme, sepse e dija se duhet bërë. Më pas, disa vite më parë, fillova të lutesha nëse kjo metodë ishte e duhura për mua. Teksa vendosa të mos e dëgjoja më atë “duhet bërë”, kuptova që metoda që për Phil-in funksiononte aq mirë, për mua nuk po funksiononte më.

Çdo ditë, kur lexoja Biblën, kisha miliona pyetje që lypnin përgjigje, studim, kërkime dhe për meditime të mëtejshme. Acarohesha gjithnjë e më shumë teksa të njëjtat pyetje që më ngacmonin kureshtjen, mbeteshin pa përgjigje vit pas viti.

Vendosa të ngadalësoja, të lexoja, të studioja, të hapja komantarë dhe të meditoja gjatë rreth atyre pasazheve. Më pëlqeu shumë kjo metodë! Ndihesha e ngopur dhe e kënaqur. Fillova të ngrihesha më herët në mënyrë që të kisha më shumë kohë të festoja me Fjalën e Perëndisë. Nuk e shihja më si disiplinë, sepse zemra ime e kërkonte çdo ditë e më shumë!

Ato mëngjese herët teksa dëgjoja Perëndinë dhe përtypja ngadalë Fjalën e Tij u bënë koha më e preferuar e ditës. Ai më flet nëpërmjet Fjalës së Tij, duke ecur me mua në ritmin tim të ngadaltë, e duke më dhënë urtësinë e nevojshme për ditët në vazhdim.

Dy njerëz të ndryshëm, me dy metoda të ndryshme, që rezultojnë me të njëjtin shpërblim. Asnjëri prej nesh nuk do ta konsideronte kurrë mospasjen e asaj kohe personale me Perëndinë në Fjalën e Tij. Secili prej nesh kemi gjetur një metodë që na përshtatet më së miri me atë që ne jemi.

Kur të hyjnë në fazën e rinisë së hershme, fëmijët tuaj duhet të kenë zbuluar jo vetëm rëndësinë e të paturit të kohës së tyre të qëndrueshme me Perëndinë, por edhe mënyrën e tyre për t'u lidhur me Fjalën e Tij, mënyrën që funksionon më mirë për atë që ata janë dhe për fazën e jetës në të cilën ndodhen.

Synimi dhe lutja juaj është që kur ata të largohen nga shtëpia do të zgjohen vazhdimisht *herët* për t'u ulur tek këmbët e Jezusit - ashtu

siç bëri Maria - me Biblën e tyre dhe një stilolaps në dorë. Luka nxjerr në pah se “Jezusi tërhiqej shpesh në vende të vetmuara dhe lutej” (Luka 5:16).

Ata duhet të kenë një kuptim të qëllimit pse e lexojnë Biblën e tyre çdo mëngjes: të ushqehen në Vetë Perëndinë, të marrin urtësi, të dëgjojnë dhe të mësojnë rreth asaj që Fryma e Shenjtë do t’u flasë. Kjo është shumë më tepër sesa një disiplinë e rreptë! Larja e dhëmbëve është disiplinë – të zhyteni në Biblën tuaj për të dëgjuar dhe mësuar nga Perëndia është kënaqësi!

Të Dinë Ku të Gjejnë Pasazhe Kyç në Shkrim për Sfidat e Jetës

Fëmijët tanë duhet të dinë ku të shkojnë kur jeta i godet fort. Për ato raste të pashmangshme kur kanë dështuar dhe ndiejnë turpin e fajit të tyre - a ka ndonjë varg apo histori për ta?

Ose kur shqetësimi i mban të mbërthyer - a ka ndonjë rrugë drejt paqes, një fjalë në Fjalën e Perëndisë që do ta lehtësojë merakun e tyre përpara se të kthehet në stres?

Po për rastet kur tundimi seksual duket i pakalueshëm? A ka ndonjë vend në Shkrim ku mund të shkojnë për të marrë një kuptim më të thellë se për se bëhet fjalë dhe çfarë mund të bëjnë për këtë situatë?

Si prindër, nuk mund t’ia lejojmë vetes të jemi të paditur! Nëse ju, në të njëzetat, tridhjetat, dyzetat ose më pas, ende nuk dini ku të shikoni për përgjigje lidhur me dilemat e jetës së përditshme, fëmijët tuaj të rritur janë të prirur ta shmangin Biblën si pa lidhje, madje dhe arkaike. Në fund të fundit, nëse babi ia ka dalë mbanë pa ditur se ku të shohë në Bibël, është e qartë se nuk qenka dhe aq e rëndësishme!

PHIL:

Kur John Mark-u ishte 9 vjeç, erdhi tek unë dhe më pyeti: “Babi, ku flitet në Bibël rreth të kapurit pas gjërave?” Pastaj, të nesërmen: “Ku është historia e Samaritanit të mirë?” Ne duhet të dimë si t’i gjejnë këto përgjigje teksa udhëheqim fëmijët tanë drejt të vërtetës!

Meqë ra fjala, nuk ka problem nëse thoni: “Nuk e di, por le ta gjejnë së bashku!”

Një këshillë: mbajini shënim zbulimet që hasni teksa shfletoni Shkrimin dhe që ndihmojnë të kalosh përmes kohërave të vështira ose tundimeve. Shkruajini në hapësirat boshe të Biblës tuaj ose në një ditar që e mbani për këtë qëllim. Më pas, kur adoleshenti juaj të vijë me një problem, ju do të dini ku ta drejtoni. Do të keni historinë tuaj personale se si e zbuluat këtë pasazh dhe si ju ka ndihmuar. Nëse e bëni këtë, do të jeni duke përçuar një trashëgimi të pasur!

John G. Mitchell, i cili themeloi Universitetin Multnomah, i shtynte me humor studentët e tij që të njihnin Fjalën e Perëndisë duke i pyetur: “Ku ndodhet ky varg?” Dhe kur askush nuk përgjigjej, ai thoshte: “A nuk e lexoni ndonjëherë Biblën ju njerëz?” Ai kishte memorizuar shumë pasazhe nga Bibla duke qenë se e kishte lexuar për dekada me rradhë. Sot, një pllakadë përshëndet ata që vizitojnë librarinë e universitetit me fjalët e Dr. Mitchell.

Për të qenë prindër të urtë, ne duhet të zhytemi thellë në Shkrime vetë dhe më pas të inkurajojmë fëmijët tanë të bëjnë të njëjtën gjë.

Të Jetojnë Misionarisht

Çfarë do të thotë të jetuarit misionarisht? Që qëllimi ynë në jetë nuk është të ndërtojmë një vend të krishterë, të këndshëm e të ngrohtë, por ta jetojmë përditshmërinë tonë duke shërbyer, duke dashur dhe duke prezantuar Jezusin në çdo kënd.

Kur fëmijët tanë ishin të vegjël, tema e nxehtë në shumë kisha ishte ungjillizimi: si të ndani besimin tuaj dhe të sillni dikë në njohjen shpëtuese të Shpëtimtarit. Të drejtoje dikë tek Jezusi zakonisht do të thoshte një shpjegim i shpejtë i ungjillit dhe një lutje përsërit-pas-meje për të pranuar Krishtin. S’ka asgjë të keqe në këtë!

Tani një brez i ri predikuesish po na zbulon një mënyrë të jetuari në një komunitet autentik, një mënyrë e të jetuarit së bashku që është aq tërheqëse për të tjerët, sa që njerëzit përreth nesh do të duan të dinë më shumë se kush është Perëndia. Në vend që thjesht t’i ftojme në kishë, ne sjellim kishën tek ata.

Kështu, kisha bëhet më shumë një vend shërbimi, sesa thjesht një vend për të shërbyer. Ne i shërbejmë njëri-tjetrit, i shërbejmë

komuniteteve tona. Ungjillizimi ka të bëjë me dhënien, dashurinë, t'u bësh mirë të tjerëve, të prekësh nevojat e tyre reale. Më pas ne mund të ndajmë shpresën që kemi në Jezusin, duke i prezantuar ata që janë gati me Atë që na urdhëron të duam.

Koha jonë i përket Jezusit, dhe ne jemi të thirrur ta përdorim atë për ta bërë këtë botë një vend më të mirë. Shtëpia jonë i përket Atij, kështu që ne ftojmë fqinjët tanë për një vakt, duke ndarë bujarinë dhe dashurinë tonë me ta. Dhe teksa jemi duke dashur dhe duke u shërbyer fqinjëve tanë, lutemi për një derë të hapur për të ndarë Lajmin e Mirë.

Ndërsa të krishterët e bëjnë veten shërbëtorë të botës përreth tyre, në vend që të mbyllën brenda një fluske të pastruar me kujdes, bota e vë re këtë dhe i përgjigjet mesazhit tonë të shpengimit. Çfarë mënyre plot respekt dhe nderuese ndaj Jezusit për të jetuar me fqinjët tanë!

Kur jetojmë misionarisht, jo përsosmërisht, jemi në gjendje t'u përgjigjemi pyetjeve të njerëzve rreth dashurisë së Perëndisë që shkëlqen përmes nesh.

Të Duan Kishën

Sigurohuni që fëmijët tuaj ta kuptojnë rëndësinë e të qenit pjesë e një kisha që studion Biblën, është e fokusuar tek Jezusi, dhe udhëhiqet nga Fryma - një kishë ku Ai është në qendër, në fron, dhe qartësisht i ngritur lart në çdo lloj mënyre. Në këtë lloj kisha fëmijët tuaj do të rriten duke “dashur Jezusin, duke mësuar rrugët e Tij, dhe duke jetuar në misionin e Jezusit”.⁸

Në këtë përbashkësi të ngushtë me njerëzit e Perëndisë fëmijët tanë do të mësojnë, do të rriten dhe do të përparojnë duke rendur pas Jezusit. Siç shkruan Jan Johnson: “Jam bindur që mësojmë më mirë për Perëndinë përmes marrëdhënieve me njëri-tjetrin. Ka disa gjëra të caktuara për Perëndinë që nuk i përthithim dot, derisa i shohim tek një person tjetër . . . përbashkësia mundëson transformim, sepse disiplinat shpirtërore kapen aq sa mësohen”.⁹

Fëmijët tuaj pothuajse të rritur duhet të dinë që kisha nuk është “thjesht një vend ku shkoj, por diçka në të cilën unë bëj pjesë”. Ju dëshironi që ata të kuptojnë se kisha në fakt është familja e Perëndisë,

dhe ata janë një pjesë përbërëse e saj.

Ju dëshironi t'i rritni fëmijët kaq të rrënjosur në këtë bindje, sa që kur ata të largohen, gjëja e parë që do të bëjnë do të jetë të gjejnë një kishë të mirë, dhe as që do ta çonin nëpër mend të mos shkonin në takimin e të dielës për të qenë pjesë e përbashkësisë.

PHIL:

Gjithmonë më bekon kur ndonjë nga të rinjtë e kishës tonë më dërgon email ose vjen tek unë dhe më thotë: “Do të shpërngulem ne Siatëll . . . ose në L.A . . . ose në Boise. A dini ndonjë kishë të mirë atje?” Kjo gjë më tregon se ata tashmë e dinë se kjo është diçka jetësore në ecjen e tyre me Jezusin. Se ata e kanë vendosur tashmë që duhet të mblidhen së bashku me njerëzit e Perëndisë.

Të Mësojnë të Dëgjojnë Frymën

Ne vazhdojmë të befasohe mi dhe të tronditemi nga realiteti që shumica dërrmuese e burrave dhe grave në kishat tona ende duhet të mësojnë të dëgjojnë Perëndinë.

Studimi dhe leximi i Biblës janë të mrekullueshëm dhe na bëjnë të urtë, por nëse nuk mësojmë të dëgjojmë Perëndinë i cili na flet gjithësecilit prej nesh në mënyrë individuale, po humbasim intimitetin për të cilin jemi krijuar ta dëshirojmë. Çdonjëri prej nesh ka një dëshirë të zjarrtë për atë lidhje të ngushtë me Atë që na do si askush tjetër.

Jezusi ia dedikoi bisedat e Tij të fundit me dishepujt pothuajse plotësisht kësaj aftësie thelbësore:

“Këto gjëra jua thashë sa jam ende me ju; por Ngushëlluesi, Fryma e Shenjtë, që Ati do ta dërgojë në emrin tim, do t`ju mësojë gjithçka dhe do t`ju kujtojë të gjitha këto që ju thashë. Po ju lë paqen, po ju jap paqen time: unë nuk jua jap paqen siç jua jep bota; zemra juaj mos u tronditë dhe mos u frikësoftë”.

(Gjoni 14:25-27)

“Kam edhe shumë gjëra të tjera për t`ju thënë, por tani nuk mund t`i mbani. Por, kur të vijë ai, Fryma e së vërtetës, ai do t`ju drejtojë tek e gjithë e vërteta”.

(Gjoni 16:12-13)

“Ai i thërret delet e tij me emër dhe i prin jashtë. Dhe, pasi i ka nxjerrë delet e tij, shkon para tyre; dhe delet e ndjekin, sepse njohin zërin e tij. . . Unë jam bariu i mirë, dhe i njoh delet e mia dhe ato më njohin mua, ashtu siç më njeh Ati mua dhe unë e njoh Atin dhe lë jetën time për delet. . . Delet e mia e dëgjojnë zërin tim, unë i njoh dhe ato më ndjekin”. (Gjoni 10:3-4, 14-15, 27)

Perëndia ka folur dhe Ai ende flet.

“Perëndia, mbasi u foli së lashti shumë herë dhe në shumë mënyra etërve me anë të profetëve, së fundi, këto ditë na ka folur me anë të Birit, të cilin e bëri trashëgimtar të të gjitha gjërave, me anë të të cilit e krijoi dhe gjithësinë” (Hebrenjve 1:1-2).

Kur lexojmë fjalët e Jezusit, është duke folur Perëndia Bir. Dhe mbani mend që Perëndia flet kryesisht përmes Shkrimit:

“I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi, që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer, tërësisht i pajisur për çdo vepër të mirë” (2 Tim. 3:16-17).

Vini re se në vargun që i paraprin këtij pasazhi, Pali është duke i kujtuar Timoteut të ri trashëgiminë e tij qiellore:

“Por ti qëndro në ato që mësove dhe u binde plotësisht, duke e ditur prej kujt i mësove, dhe se që nga fëmijëria i njeh Shkrimet e shenjta . . .” (2 Tim. 3:14-15).

Kjo është një e vërtetë në të cilën çdo prind, ashtu si edhe çdo gjysh/e që ndjek Jezusin, mund të qëndrojë fort!

Por Perëndia flet edhe në mënyra të tjera po ashtu.

Përmes krijimit:

“Qiejtë tregojnë lavdinë e Perëndisë dhe kupa qiellore shpall veprën e duarve të tij. Një ditë i flet ditës tjetër dhe një natë ia tregon tjetrës. Nuk kanë gojë, as fjalë; zëri i tyre nuk dëgjohej; por harmonia e tyre përhapet mbi gjithë dheun dhe mesazhi i tyre arrin deri në skajin e botës . . .”
(Psalmi 19:1-4).

Perëndia e ka zbuluar që u flet individëve përmes ëndërrave dhe vizioneve,¹⁰ përmes profetëve dhe njerëzve në kishë,¹¹ përmes atyre me të cilët kemi përbashkësi të ngushtë, si dhe përmes pamjeve.¹²

Fjalët e Perëndisë ndaj nesh fillimisht ndihen, një ndjesi që nuk ngjason me mënyrën se si ne i flasim vetes tonë, një ndjesi që Ai po drejton, që Ai ka gjëra për të na treguar nëse ne thjesht i kushtojmë vëmendje. Mbreti David e mësoi këtë aftësi përmes një jete të tërë duke adhuruar dhe dëgjuar:

“O Zot, më trego rrugët e tua, më mëso shtigjet e tua. Më udhëhiq në të vërtetën tënde dhe më mëso, sepse ti je Perëndia i shpëtimit tim; unë shpresoj shumë te ti gjatë gjithë ditës” (Psa. 25:4-5).

Ndërsa ulemi përpara Perëndisë, me Bibla të hapura, me zemrat gati për t’u bindur, Ai na tregon rrugët e Tij! Na inkurajon, na tërheq vërejtje, ndonjëherë edhe na qorton. Por qortimet e Tij janë si balsam për shpirtin tonë. Shpeshherë, Ai na jep urtësinë specifike që i kërkojmë, duke na ndihmuar si të orientohemi me uljet dhe ngritjet e jetës. Kur vjen puna tek prindërimi, Ai është bujar për të na dhënë doza të mëdha njohurie për fëmijët tanë!

Pasi një burrë, grua, ose fëmijë mëson të dojë dhe të njohë zërin e Perëndisë, të ulet e të dëgjojë çfarë Ai është duke i thënë personalisht, atëherë ata bëhen plotësisht, në gjithçka, ndjekës të devotshëm të Jezusit.

Pa atë njohje, pa atë lidhje të ngushtë, besimi ynë mund të bëhet thjesht një takëm i ndërlikuar kodesh morale sipas të cilëve duhet të jetojmë. Rrezikojmë të bëhemi ato që Dallas Willard i quajti “kufoma të përshtatshme për të mbushur karriget”.¹³

Në librin e Diane, *Ai Flet në Heshtje* (He Speaks in the Silence), ajo tregon historinë e saj se si ka mësuar të dëgjojë Perëndinë dhe si ai dëgjim e drejtoi në një marrëdhënie të afërt me Perëndinë për të cilin i digjej zemra.¹⁴

Të Kenë Një Teologji Biblike për Vuajtjet

DIANE:

Kur isha njëzet e gjashtë vjeçe, u diagnostikova me një humbje progresive të dëgjimit - po bëhesha e shurdhër. Doktorët më dhanë shumë pak shpresë për kurim, ndërkohë që më këshilloni të përshtatesha me aparatet e dëgjimit, duke më paralajmëruar se me atë ritëm të humbjes së dëgjimit, brenda pak viteve do të isha plotësisht e shurdhër.

Kisha tre fëmijë të vegjël, një burrë të perëndishëm, dhe një teologji që nuk mund ta pranonte konceptin se Perëndia do të lejonte që ta humbisja dëgjimin.

Besimi im filloi të shpërbëhej po aq shpejt sa dëgjimi im. Isha aq e zemëruar me Perëndinë, duke dyshuar në mirësinë e Tij, duke vënë në pikëpyetje karakterin e Tij, duke shpërthyer keq ndaj Perëndisë për faktin se Ai po tregohej jo besnik dhe i padrejtë ndaj meje. U ndjeva e braktisur dhe e keqpërdorur nga një Perëndi të cilit i isha përkushtuar t'i shërbeja me gjithë jetën time.

Rashë në një depresion të thellë e të errët nga i cili nuk mund të dilja - e gjitha sepse kisha një teologji të gabuar për vuajtjen. Në thelb ishte kështu:

Perëndia më do dhe ka një plan të mrekullueshëm për jetën time. Prandaj, sigurisht që Perëndia do të më shërojë! Sepse nëse unë do të isha Zoti, do ta shëroja veten.

Kur Ai nuk e bëri, rashë tatëpjetë në dëshpërim dhe në një keqardhje të madhe për veten, dhe gënjeshtër e lashtë e Satanit zuri vend brenda meje tamam ashtu siç ndodhi kur tundoi Evën. Pak a shumë tingëllonte kështu:

Unë e di që Perëndia mund të më shëronte nëse Ai do të donte ta bënte këtë. Nuk ka nevojë për shumë besim për të ditur se Ai që krijoi veshët e mi është në gjendje edhe t'i rregullojë ato. Atëherë përse nuk po e bën?

Përfundimi im? Perëndia mund të mos jetë i mirë, përndryshe Ai nuk do të kishte lejuar të më ndodhte kjo gjë.

Pikërisht ky është përfundimi që mund të nxjerrin disa prej fëmijëve tuaj kur përballen me vuajtje në jetën e tyre. E kemi parë të ndodhë shpesh, mjaftueshëm sa për të dalluar një model të rrezikshëm për të cilin ndihemi të detyruar që t'i paralajmërojmë prindërit: të rinj nga familje shumë të mira, të perëndishme, me Jezusin në qendër që përfundojnë duke e refuzuar Jezusin - jo në një xhirim të ngadaltë mosinteresi, por në një shpërthim të tmerrshëm zhgënjimi dhe zemërimi. Dhe kur fillon të gërmosh pak në historitë e tyre, shpesh vjen në këtë pikë: një kuptim i dobët biblik i vuajtjes. Ashtu si Diane, edhe ata mendonin se të ndjekësh Jezusin do të thotë se çdo gjë do të shkojë mirë në jetën e tyre.

Ajo që pothuajse e shkatërroi besimin e Diane, mund të shkatërrojë edhe besimin e djalit apo vajzës tuaj në Perëndinë. Si prindër, kemi privilegjin dhe mundësitë reale të jetës t'u mësojmë fëmijëve tanë një teologji solide, tërësisht biblike rreth vuajtjes.

Jezusi u tha ndjekësve të Tij që do të vuanin. Ai tha: "Jua kam thënë këto gjëra, që ta keni paqen në mua; në botë do të keni mundime, por merrni zemër, unë e munda botën!" (Gjo. 16:33). Dhe apostulli Pal u lut: "që të njoh atë dhe fuqinë e ringjalljes së tij dhe pjesëmarrjen në

mundimet e tij” (Fil. 3:10). Gjëra të këqija u ndodhin edhe njerëzve të mirë - madje edhe njerëzve të Perëndisë! Kjo nuk do të thotë se Perëndia i shkakton vuajtjet, por Ai është mjaftueshëm i hirshëm dhe i dashur që t'i vlerësojë ato - Ai do ta përdorë vuajtjen për të mirën tonë.

DIANE:

Fatmirësisht, historia ime nuk mbaron me refuzimin tim të zemëruar ndaj Perëndisë. Me këshillën e Phil, shkova tek pleqtë e kishës dhe ju kërkova të më vajosnin me vaj dhe të luteshin për shërim. Ajo që ndodhi më pas ishte një përjetim i Perëndisë që ishte aq intim dhe befasues, saqë e ndryshoi komplet jetën time! Perëndia solli shërim atë ditë në dhomën e pasme të një kisha në Santa Cruz, Kaliforni - një shërim që unë as nuk e dija që më nevojitej - një shërim të zemrës sime. Pak kohë më pas, Ai më dha Psalmi 40 si një këngë që do ta këndoje për gjithë pjesën e mbetur të jetës time.

Psalmi 40:6 thotë:

“i ke hapur veshët e mi . . .”

Ose siç e zbulon një përkthim tjetër:

“Tani që më ke bërë të dëgjoj, më në fund kuptoj . . .”

Ai më bëri të njihja dhe të përjetoja dashurinë e Tij dhe gjithë intimitetin e bukur me Shpëtimtarin që as nuk e dija madje se ishte e mundur.

Ai nuk më shëroi veshët, por më shëroi mua.

Diane është e shurdhër tani - plotësisht, shurdhim i parikuperueshëm. Në vlerësimin që bëri për librin e mamasë së tij për rrugëtimin e saj të shurdhër, John Mark shkroi këto fjalë:

“Kur kujtoj fëmijërinë time, një kujtim qëndron i ngjitur fort pavarësisht gjithçkaje tjetër; çdo mëngjes zbrisja shkallët dhe gjeja mamanë time të ulur në karrigen e saj,

me Biblën të hapur, me stilolaps në dorë, e me sy të fokusuar diku larg. Ajo dëgjonte atë zë që mund të depërtonte përtej shurdhimit të saj. Mamaja ime më mësoi se si të dëgjoja Perëndinë...”

DIANE:

Tani unë shoh ato gjëra që nuk i kuptoja dot gjithë ato vite më parë; se duke lejuar veshët e mi të dështojnë, Perëndia po më jepte dhuratën më të madhe që mund të kërkoja ndonjëherë: një mënyrë që fëmijët e mi të përjetonin Zotin bashkë me mua, çdo ditë të jetës së tyre.

Ata e dinin se unë varesha tek Ai për t'i mbijetuar qetësisë që mbështillte ditët e mia dhe që kufizonte botën time. Ata më shihnin ndërsa mbushesha me dashurinë e Tij çdo mëngjes dhe teksa pija prej Tij nëpërmjet faqeve të Shkrimit.


Fëmijët e mi kishin një karrige në rresht të parë duke parë vuajtjen dhe realitetin tim, dhe disa herë përvoja e dhimbjes time drejtonte secilin prej tyre, veç e veç, në dashurinë e tyre personale për Shpëtimtarin.

Këto janë Dhjetë Gjërat që ne donim të ishim të sigurt që fëmijët tanë t'i kuptonin përpara se të largoheshin nga shtëpia jonë. Ju do të keni dhjetë gjërat tuaja, listën tuaj të ideve dhe idealeve që dëshironi që fëmija juaj t'i kuptojë plotësisht dhe të dijë si të jetojë. Siç e kemi thënë, ne ju inkurajojmë që t'i shkruani dhe të mendoni rreth tyre. Ndhuni të lirë të shtoni dhe të zgjeroni listën tonë teksa përgatitni fëmijët tuaj pothuajse të rritur që të dalin më vete në botë.

Kapitulli 20

Vendosja e Çatisë

Nuk mund ta përfundojmë këtë pjesë pa theksuar lutjen. Në ç'mënyrë tjetër vallë, mund të shpresojë ndonjë prej nesh që të rritë fëmijë që e ndjekin Perëndinë me pasion dhe këmbëngulje? Dhe për të vazhduar analogjinë e ndërtimit të një shtëpie shpirtërore, kemi arritur të kuptojmë, pas disa orësh dhe vitesh lutjeje për fëmijët tanë, disa herë edhe duke luftuar në lutje për ta, se *lutja është si vendosja e çatisë*. Ndërsa lutemi për fëmijët tanë, në fakt, po i mbrojmë ata nga sulmet që do të kenë gjatë rrugës së tyre.



Ndërsa po rrëmonim mes materialeve që kishim ruajtur ndër vite me idenë se një ditë do të shkruanim këtë libër, gjetëm një ditar të Diane nga koha kur fëmijët tanë po rriteshin. Ato faqe janë një rikujtesë e gjithçkaje që Perëndia ka bërë për familjen tonë, gjithë ato herë që i kemi thirrur Atij për urtësi, për kuptim, për ndihmë. Dhe tani, pas gjithë këtyre viteve, duke parë sesa specifikisht është përgjigjur Ai, pikërisht në atë vend ndaluar dhe adhuroar!

Ditari është i mbushur me vargje me të cilët Diane ishte lutur për fëmijët tanë. Vargje si Jeremia 32:40:

“do të shtie një dëshirë në zemrën e tyre që të më adhurojnë, dhe nuk do të më lënë kurrë”.

Kjo është ajo që i kemi kërkuar Perëndisë të bënte në zemrat e fëmijëve tanë, herë pas here. Ne e dinim shumë mirë se fëmijët tanë kanë lindur me një mundësi zgjedhje për ta ndjekur Perëndinë ose jo. Perëndia nuk do ta detyrojë fëmijën tuaj që ta dojë Atë! Por ne po ashtu nuk kishim asnjë dyshim që Ai i dëgjonte thirrjet tona për ndihmë dhe se Ai dërgon Frymën e Tij për të tërhequr fëmijët tanë drejt Vetes.

Historia e Oseas u bë lutja jonë për punën e Frymës së Perëndisë:

“Prandaj, ja, unë do ta tërheq atë pas meje, do ta çoj në shkretëtirë dhe do t’i flas zemrës së saj” (Osea 2:14).

Diane i kërkoj Perëndisë që t’i tërhiqte fëmijët tanë drejt Vetes së Tij. Duke përdorur Romakëve 10:1 si udhëzues, ajo u lut që secili prej fëmijëve tanë të shpëtohej në një moshë të re: “Vëllezër, dëshira e zemrës sime dhe lutja që i drejtoj Perëndisë për ta është për shpëtimin e tyre”.¹

Ne luteshim që secili prej fëmijëve tanë të shihte nevojën e tyre të vërtetë për Zotin, dhe njëkohësisht të kishin sy për të parë dhe veshë për të dëgjuar dashurinë e Tij të vërtetë për ta. Që në foshnjërinë e tyre, Diane u lut për ta sipas Efesianëve 3:19: “*që të përjetoni* dashurinë e Krishtit e cila është shumë e madhe për t’u kuptuar plotësisht. Atëherë do të mbusheni me gjithë plotësinë e jetës dhe forcës që vjen nga Perëndia” (theksimi ynë).

DIANE:

Njëherë, ndërsa po ankoheja tek mentorja ime që ishte një grua në moshë dhe e mençur, sepse isha shumë e lodhur, sepse bebi nuk flinte gjatë natës, ajo më sfidoi që atë kohë ta kaloja duke u lutur për të.

Dhe kështu bëra. U luta për çdo skenar të mundshëm dhe çdo fazë të jetës së tij.

U luta për bashkëshorten e tij të ardhshme, që Perëndia do ta ruante dhe të kujdesej për të, duke e mbrojtur nga tmerrret që mund të ndikonin martesën e tyre. U luta për zgjedhjen e karrierës, për shokë të perëndishëm, për shëndet dhe lumturi. Për ca kohë madje u luta edhe që të merrte nota të mira - derisa lehtësimi i shpirtit tim ndërsa lutesha ma ndryshonte perspektivën.

Në fakt, fillova të lutesha që çdonjëri prej fëmijëve të mi të bëhej një burrë dhe grua me një dashuri të thellë për të mësuar.

Kur isha shtatzënë, mësova të lutesha në vend që të ankohesha, duke u mbështetur tek Isaia 46:3-4:

“ju kam përkrahur që kur keni lindur, jeni mbajtur nga unë qysh në bark të nënës. Deri në pleqërinë tuaj do të mbetem po ai, do t’ju mbaj deri sa të thinjeni. Unë ju kam bërë dhe unë do t’ju përkrah; po, do t’ju mbaj dhe do t’ju shpëtoj”.

Fëmijët e mi u rritën duke e ditur që unë lutesha për ta. Kjo ishte diçka që e dija se mund ta bëja. Jo gjithmonë isha e duruar, dhe jo gjithmonë do të memorizoja vargje me ta ashtu siç duhej, por mund të lutesha.

Ne jemi lutur *me* fëmijët tanë si dhe *për* ta. Është shumë e thjeshtë të thuash: “Do të lutem për ty”, por ndonjëherë duket si betejë në fakt të ndalosh pikërisht në atë çast dhe në atë vend e të lutesh me ta.

Nëse fëmija ju thotë: “Mami, lutu për mua. Kam një provim të vështirë në algjebër sot pasdite”, ndaloni dhe lutuni pikërisht aty, në atë çast! Vendosni duart në shpatullat e fëmijës tuaj përpara se të dalë nga dera dhe lutuni, edhe nëse ju duket e çuditshme në fillim!

Tashmë fëmijët tanë të rritur e bëjnë këtë për ne, duke na mbështjellë me besimin e tyre, duke na rrethuar me afeksionin e tyre. Dhe neve na pëlqen kaq shumë kjo gjë!

Tre nga pesë skedat që gjetëm në një kuti kujtimesh kohët e fundit, kishin të shkruar me shkrim dore nga Diane tekstin e Kolosianëve 1: 9 -12:

“Prandaj edhe ne, nga dita që e dëgjuam këtë, nuk pushojmë të lutemi për ju dhe të kërkojmë që të mbusheni me njohjen e vullnetit të tij me çdo urtësi dhe mençuri frymërore, që të ecni në mënyrë të denjë për Zotin, që t’i pëlqeni atij në çdo gjë, duke sjellë fryt në çdo vepër të mirë dhe duke u rritur në njohjen e Perëndisë, duke u forcuar me çdo fuqi, pas pushtetit të lavdisë së tij, për çdo ngulm e durim, me gëzim, duke e falënderuar Perëndinë Atë...”.

Diane ecte nëpër kodrat që rrethojnë lagjen teksa lutej për vajzën tonë, të cilës i ishte ofruar një vend pune në L.A, dhe për herë të

parë do të jetonte vetëm. Ne pyesnim veten dhe shqetësoheshim nëse ajo ishte e fortë mjaftueshëm për të qëndruar me Jezusin, nëse besimi i saj kishte zhvilluar atë lloj qëndrese që e dinim se do t'i duhej.

Në vend që të vazhdonim të dyshonim në vetëbesimin e saj duke merakosur veten tonë, filluam “Të premtet e agjërimit” vetëm për këtë vajzë që e donim kaq shumë. Dhe ajo qëndroi fort, duke mësuar ta veshte besimin në mënyrën e saj, duke manifestuar vlerat dhe bindjet e saj të dhëna nga Perëndia.

Një tjetër lutje erdhi nga Luka 22:32, e njëjta lutje që Jezusi bëri për djaloshin e Tij, Simon Pjetrin: “Por unë jam lutur për ty, që besimi yt të mos mpaket”. Vendosni emrin e fëmijës tuaj në vend të Pjetrit, dhe lutuni me besim se Perëndia po ju dëgjon.

Ka momente kur ne ndërhyjmë për fëmijët tanë në lutje.

Një nënë i tregoi Diane me një qëndrim agresiv atë që i kishte ndodhur: “Pashë atë që po i ndodhte vajzës time në shkollë, dhe një ditë ndërsa po lutesha, thjesht përplasa këmbën, ngrita grushtin tim ndaj Satanit dhe i fola troç: “Jo me vajzën time! Ajo i përket PERËNDISË!” Ajo vajzë tani është një grua plot besim, duke rritur në mënyrë të qëllimshme ndjekësit e saj të pasionuar për Jezusin.

Kur fëmijët tanë ishin adoleshentë, Diane lutej specifikisht për bashkëshortet/ët që ata do të takonin një ditë. Duke e kapur veten të rënë në zakonet e keq të shqetësimit gjatë viteve të lidhjeve të tyre të mundshme, ajo shikonte dhe lutej, teksa secili prej fëmijëve tanë fillonin të kuptonin llojin e personit për të cilin ata kishin nevojë dhe me të cilin/cilën dëshironin të martoheshin.

Kur djali ynë i parë takoi bashkëshorten e tij të ardhshme, Tammy, dukej sikur gjithë copëzat e lutjeve të Diane ishin mbledhur së bashku. Tammy ishte shtatëmbëdhjetë vjeçe kur u takuan për herë të parë, dhe që atëherë ishte një vajzë e pjekur e me një trashëgimi të pasur besimi. Kur John Mark i kërkoi dorën për martesë, Diane kishte siguri brenda saj që Tammy ishte gruaja për të cilën ajo ishte lutur përgjatë gjithë atyre viteve. Kjo njohje e siguri i dha shumë gëzim, si dhe një lidhje zemre që vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Sërish e njëjta situatë, shumë vite më pas, kur i vogli ynë, Matthew, filloi të dilte me vajzën me të cilën do të martohej më pas. Nuk ka asnjë dyshim që Simona është përgjigje e shumë orëve lutje - bukuria

e saj e ëmbël i shton pasuri familjes tonë.

Efesianëve 3:14-19 është bërë lutja e zemrave tona për brezin e ardhshëm të Comers që do të vazhdojnë aty ku do ta lëmë ne.

“Kur mendoj për të gjitha këto, bie në gjunjë dhe i lutem Atit, Krijuesit të gjithçkaje në qiell dhe në tokë. Lutem që Ai t’ju fuqizojë nëpërmjet Frymës të tij sipas pasurive të tij të pafundme e të lavdishme, në njeriun e brendshëm. Dhe ndërsa i besoni Atij, Krishti do të bëjë banesën e tij në zemrat tuaja. Rrënjët tuaja do të shkojnë më thellë në dashurinë e Perëndisë, duke ju mbajtur fort. Lutemi të keni fuqinë për të kuptuar, po ashtu si të gjithë njerëzit e tjerë të Perëndisë, sa e gjerë, sa e gjatë, sa e lartë dhe sa e thellë është dashuria e tij. Përjetofshi dashurinë e Krishtit, edhe pse është shumë e mrekullueshme për ta kuptuar plotësisht. Atëherë do të bëheni të plotë, me tërë plotësinë e jetës dhe fuqinë që vjen nga Perëndia.” (NLT)

Ne e nisëm këtë pjesë, Përmbyllja e Punës me 2 Kronikat 7:11

“Kështu Solomoni përfundoi shtëpinë e ZOTIT dhe përfundoi me sukses gjithçka që kishte planifikuar të bënte. . .”

Tani lexoni vargun pasardhës!

“Pastaj Zoti iu shfaq natën Solomonit dhe i tha: “E kam dëgjuar lutjen tënde dhe e kam zgjedhur këtë vend për Vete si shtëpi flijimesh” (2 Kronikat 7:12).

Perëndia i dëgjon lutjet e një nëne për bijtë dhe bijat e saj. Baballarë, edhe lutjet tuaja janë po aq të fuqishme gjithashtu. Të dy ne besojmë plotësisht se përveç hirit të Perëndisë kundrejt fëmijëve tanë, janë edhe lutjet që kemi bërë për fëmijët tanë që kanë patur ndikim të madh teksa shihnim secilin prej tyre të bëhej ndjekës i pasionuar i Jezusit.

E.M. Bounds ka thënë: “T’u flasësh njerëzve për Perëndinë është diçka e mrekullueshme, por t’i flasësh Perëndisë për njerëzit është një gjë edhe më e mrekullueshme”.²

Fillojini listat tuaja të lutjes me vargjet që gjeni. Merrini ato të vërteta me vete ndërsa luteni dhe bëjini vend Perëndisë që të punojë në jetën e fëmijëve tuaj. Mbani mend, lutja është njësoj si të vendosësh çatinë për të mbrojtur fëmijët nga shirat që e dimë se do të vijnë.



Rritja e Ndjekësve Pasionantë për Jezusin

Instalimi i sistemeve funksionale

(18 – 21 vjeç)

Synimi është të ndihmohen fëmijët tuaj për t'u maturuar. Mos u dorëzoni (mos hiqni dorë) pas viteve të adoleshencës. Përfundojeni atë që keni nisur.

Pranë fundit të kësaj faze, fëmija juaj - pothuajse i rritur...

- Ka aftësinë të qëndrojë vetëm.

- Vazhdimisht ruan pastërtinë e vet seksuale.

- Kupton si të zgjedhë bashkëshortin apo bashkëshorten.

- Di si të menaxhojë paratë me mençuri.

- Ka marrëdhënie të qëndrueshme me Perëndinë.

- Di si të gjejë vargje kyç nga Shkrimi për sfidat e jetës.

- Po mëson të dëgjojë nga Fryma.

- Jeton misionarisht dhe e do kishën.

- Kupton teologjinë biblike të vuajtjes.

GJËRA PËR TË CILAT DO TË KETË NEVOJË ADOLESHENTI JUAJ...

1. *Kutia është sërish aty në këtë fazë, por forma e saj ndryshon në mënyrë dramatike. Kini parasysh që të mos disiplinoni, strukturoni apo korrigjoni më shumë se ç' duhet.*

2. *Në këtë fazë, kujtojini vetes që të bëni dallimin ndërmjet Qëllimit kryesor dhe Vlerave tuaja personale – qëllimi është sërish i njëjti për fëmijët tuaj, që ata të duan Jezusin dhe të tjerët ndërsa vlerat e tyre personale vazhdojnë të zhvillohen.*

Ndikim, Afirmim dhe Kënaqësi

Disiplinë

**KUTIA E
RISHIKUAR**

Rregull

JEZUSI


Pjesa 6



Hapja e Derës

“Perëndia, para të cilit ecën etërit e mi Abrahami dhe Isaku, Perëndia që ka qenë bariu im qysh prej lindjes sime deri më sot, Engjëlli që më ka çliruar nga çdo e keqe, i bekoftë këta bij! Le ta ruajnë emrin tim dhe emrin e etërve të mi Abrahamit dhe Isakut, dhe pasardhja e tyre u shumoftë fort mbi tokë!”

-Jakobi, Zanafilla 48:15-16



Kapitulli 21

Bekimi, Kutia dhe Çelësi

Dita që shtëpia më në fund ka përfunduar dhe është gati për t'u bërë e juaja është një nga ditët më të bukura! Kjo është ajo për të cilën keni punuar me aq zell. Më në fund, u realizua; është koha për të hyrë brenda.

Gjëja e fundit që bën sipërmarrësi juaj, sapo shtëpia juaj të ketë përfunduar, është që të vendosë derën kryesore të përhershme. Deri në këtë moment aty ka qenë një derë e thjeshtë, një derë e përkohshme, në mënyrë që të ruhej dera e zgjedhur prej jush, nga prishja apo gërvishtja ndërsa grupi i punës hynte e dilte. Tashmë është koha që ta zëvendësoni atë derë të përkohshme me derën e zgjedhur nga vetë ju me aq kujdes.

Përmes kësaj dera do të hyjnë familja dhe miqtë tuaj dhe do të shijojnë shtëpinë që keni krijuar. Ky është momenti. Pasi i bëni sipërmarrësit pagesën e fundit (ah!), ai ju dorëzon çelësat e shtëpisë.

Në këtë kapitull të fundit, duam t'ju japim disa udhëzime të detajuara se si ta lini të shkojë - dhe të shkojë *mirë* - djalin apo vajzën tuaj. Ka ardhur koha t'u dorëzoni atyre çelësat, t'i lëshoni zyrtarisht në jetë.

Herë pas here kemi parë tensionin e krijuar kur prindër të mirë e humbasin fillin në momentet e fundit të prindërimit aktiv. Lëndimi dhe keqkuptimet tek të dyja palët shumë shpesh hedhin hije mbi vitet e prindërimit të qëllimshëm me në qendër Jezusin. Shpesh janë disa prindër të krishterë shumë të mirë të cilët, duke hezituar të dorëzojnë skeptrin, e mbajnë pak si shumë gjatë, duke shkaktuar tensione dhe konflikte të panevojshme. Nuk ka pse të jetë kështu! Ne duam t'ju bëjmë të mendoni dhe të planifikoni për heqjen dorë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Ndërkohë që ju do të jeni gjithmonë mami dhe babi i tyre, roli juaj *do të* ndryshojë - duhet të ndryshojë - në mënyrë që t'ua delegoni përgjegjësinë për jetën e tyre, fëmijëve tuaj të rritur tashmë.

Ajo që keni dëgjuar miliona herë është e vërtetë: fëmijët tuaj do të rriten më shpejt se ç'mund ta imagjinoni. Sa hap e mbyll sytë, vogëlushi juaj të cilin keni kaluar orë të tëra duke e mësuar, adoleshenti që ju mendonit se nuk do të rritej kurrë, do të largohet tutje me gjithë ato kujtime. Duhet të ndodhë një ndryshim i madh në rolin tuaj *nëse* dëshironi të vazhdoni të keni ndikimin e jashtëzakonshëm që prindërit e mençur dhe të perëndishëm mund të kenë tek fëmijët e tyre të rritur. Nëse e humbisni këtë, fëmijët tuaj do të humbasin thesaret e çmuara që u nevojiten ndërsa fillojnë të ndërtojnë familjet e tyre.

A është e mundur të shmanget gjithë ai tension me të cilin shumë prindër të qëllimshëm, të perëndishëm dhe dashamirës përballen teksa fëmijët e tyre fluturojnë nga kafazi? Po! Është e mundur!

A është një fole bosh kaq shumë dëshpëruese? Jo, mund të jetë kënaqësi!

Pse duhet të jetë kaq e vështirë t'i lësh të shkojnë, kaq e mbushur me keqkuptime dhe konflikte? Këto janë pyetjet që dëgjojmë zakonisht nga prindër në moshën tonë, dhe këto janë pyetjet që prindërit e rinj na bëjnë.

Bashkohuni me ne teksa ju tregojmë një mënyrë ndryshe: mënyrën e mbretërisë për t'i lënë të shkojnë, një rrugë që në mënyrë të pashmangshme i kthen fëmijët drejt jush sërish, jo më si përgjegjësi nën autoritetin tuaj, por si miq dhe si partnerë në trashëgimi. Dëshirojmë të ndajmë me ju tre perceptime që na kanë ndihmuar tmerrësisht shumë në këtë proces lëshimi: Bekimi, Kutia, dhe Çelësi.

BEKIMI

Në familjet patriarkale të Dhiatës së Vjetër, ne zbulojmë bukurinë e Bekimit të përcaktuar nga Perëndia. Jakobi bekoi Jozefin dhe bijtë e tij kur tha: "Perëndia, para të cilit ecën etërit e mi Abrahami dhe Isaku, Perëndia që ka qenë bariu im qysh prej lindjes sime deri më

sot, Engjëlli që më ka çliruar nga çdo e keqe, i bekoftë këta bij! Le ta ruajnë emrin tim dhe emrin e etërve të mi Abrahamit dhe Isakut, dhe pasardhësit e tyre u shumofshin fort mbi tërë tokën!” (Zan. 48:15-16).

Më poshtë janë katër mënyra si t’ua përcillni Bekimin fëmijëve tuaj:

Bekojini të rinjtë tuaj duke u besuar atyre

Përpara se fëmijët tanë të bëhen përgjegjës për veten e tyre, ata kanë nevojë për aprovimin dhe afirmimin tonë, një veprim simbolik i të lënit të shkojnë. Jo sepse duhet ta bëjmë këtë gjë, as sepse datëlindja e tyre na detyron që ta bëjmë, por pasi e kuptojmë që janë gati për të drejtuar jetët e tyre. Ne u japim fëmijëve tanë një guxim të pamasë kur themi: “Ne e shohim karakterin tënd, aftësinë tënde, dhe thirrjen tënde - *kemi besim tek ti*. Ne të njohim ty më së miri dhe besojmë shumë fort tek ti”.

E vërteta është se, fëmijët tuaj nuk do jenë kurrë gati që të marrin vendime jetësore të pagabueshme. Ata nuk janë gati për përsosmëri, dhe as nuk janë gati që të jetojnë saktësisht sipas vlerave tuaja. Ata po lihen të lirë të shkojnë në një jetë nën drejtimin dhe mbrojtjen e Perëndisë. Pozicioni juaj po ndryshon, por vendi i Atit në jetën e tyre do të marrë një rëndësi edhe më të madhe teksa nevoja e tyre për t’u mbështetur tek Ai rritet. Mos harroni, Ai që e nisi një punë të mirë tek fëmijët tuaj, pikërisht në shtëpinë tuaj, do ta përfundojë atë.¹

Bekojini të rinjtë tuaj duke zgjedhur të mos i kritikoni

Bekimi është më shumë sesa thjesht t’i afirmoni ata; duhet të përfshijmë këtu edhe vendosjen e një shenje të qartë që i ndalon reagimet tona të natyrshme për të mësuar dhe korrigjuar fëmijët tanë. Ishte e drejta dhe përgjegjësia jonë kur ata ishin më të vegjël, por tashmë ka ardhur koha që nuk duhet t’i korrigjojmë më fëmijët tanë, koha kur ne zgjedhim të mos i kritikojmë ata! Kurrë! Koha kur nuk ia lejojmë vetes t’i ngacmojmë, të komentojmë ose të flasim rreth çfarë apo si mund të kishin bërë ndryshe. Kur nuk na takon më neve që të vlerësojmë gjykimet jo të mira apo gabimet e tyre. Kur asnjë lloj qëndrimi i rreptë

mosaprovues nuk duhet të kenë vend në zemrat tona. Dhe koha kur, edhe midis bashkëshortit dhe bashkëshortes, nuk e lejojmë veten të flasim negativisht për mënyrën se si po jetojnë fëmijët tanë të rritur.

Tani, krejt papritur, ju i keni lënë të shkojnë aq plotësisht, sa që fëmijët tuaj tashmë janë më shumë si miq - miq të ngushtë, të afërt e të çmuar. A do t'i jepnit miqve tuaj këshilla, nëse ata nuk ju pyesin rreth harxhimit të parave dhe administrimit të kohës? A do të prisnit që miqtë tuaj t'i rregullonin pushimet ose festat e tyre duke iu përshtatur preferencave tuaja? Sigurisht që jo!

Bekojini të rinjtë tuaj duke i dëgjuar në vend që t'i gjykoni

DIANE:

Ju kujtohet kur thashë që asnjëra nga vajzat e mia nuk më konsideronte shoqe të ngushtë kur ishin pesëmbëdhjetë vjeçe? Tani ne jemi mikeshë, mike të vërteta – mike të ngushta! Vajzat e mia më tregojnë çfarë kanë në zemër pa u merakosur se mund t'i kundërshtoj ose t'u tregoj se sa gabim e kanë. Djemtë e mi e kanë të qartë se unë jam ajo që di gjithçka rreth tyre – dhe prapë mendoj se janë të përsosur.

Jam shumë më mirë kështu, sesa kur isha disiplinuesja. Edhe mua personalisht më pëlqen më shumë vetja në këtë rol.

Teksa po punonim në këtë pjesë, ra zilja e telefonit. Ishte njëra prej vajzave tona e cila telefonoi që t'i kërkonte Diane një këshillë. Pak minuta pasi ajo e mbylli telefonin, njëri prej djemve tanë telefonoi dhe tha: “Më duhet të flas pak me mamin një minut”. Dy nga fëmijët tanë të rritur telefonuan pasi ata donin urtësinë dhe këndvështrimin e Diane se si të përballonin më së miri situatat që po kalonin.

Prindër, kjo është një e drejtë që duhet fituar!

Ju e fitoni këtë marrëdhënie të ngushtë me djalin ose vajzën tuaj duke i pranuar ata në vend që t'i kundërshtoni, duke i dëgjuar në vend që t'i gjykoni. Jepni mendimin tuaj kur ua kërkojnë, dhe jepni maksimumin që të formuloni fjalët tuaja në mënyrën më mbështetëse

që mund të gjeni. Lërimi të mësojnë përmes vështirësive ndonjëherë, tamam ashtu siç keni bërë edhe ju. Nëse nuk janë duke bërë diçka vërtetë të tmerrshme ose të jashtëligjshme, mos thoni: “Mund të të kisha thënë të mos e bëje këtë!” Përkundrazi, thoni: “Edhe ne kemi marrë disa vendime të pamatura, por Perëndia ishte me ne, dhe Ai na ndihmoi që t’ia dilnim mbanë!”

Bekojini të rinjtë tuaj duke u lutur për ta

Në këtë fazë të jetës së fëmijës tuaj, *autoriteti dhe përgjegjësia* juaj zëvendësohet me *influencë dhe ndërmjetësim*. Nëse do të afirmoni, pranoni dhe vlerësoni *atë që ata po bëhen*, do të keni një ndikim të pamasë. Dhe nëse do të bëheni një lutës/ndërmjetësues i përkushtuar dhe i besueshëm për ta, do të keni kënaqësinë që të shikoni Perëndinë duke atëruar fëmijët tuaj në dekadat që do të vijin.

Kjo është arsyeja pse ne dalim për ecje çdo mëngjes. Teksa ecim, lutemi me zë për secilin prej fëmijëve tanë, bashkëshortët e tyre, nipërit tanë, emër për emër. Duke e ditur këtë, fëmijët tanë telefonojnë ose na dërgojnë mesazh, duke na kërkuar të lutemi specifikisht për gjërat që i shqetësojnë.

Këtë javë ne u lutëm për një telefonatë të vështirë që kishte dhëndri ynë, duke i kërkuar Perëndisë që të derdhte urtësi, dallim, dhe dashuri mbi personin me të cilin ai do të fliste. Për shkak se ai e dinte që ne do të luteshim, i kërkoi Phil këshillë, të cilën Phil ia dha me kënaqësi. Kur telefonata nuk shkoi aq mirë sa ç’shpresonte dhëndri ynë, e bekuam atë duke e parë përmes lenteve të një vjehrrë dhe vjehrri që e respektojnë thellësisht.

Nëse biri ose bija juaj nuk është duke ecur me Jezusin teksa hyni në këtë fazë, gjëja më efektive që mund të bëni është të luteni. Lutja i ndryshon gjërat! Lutja e vazhdueshme lëviz dorën e Perëndisë në mënyra që ne nuk mund t’i imagjinojmë. Profeti Samuel tha:

“Sa për mua, mos ndodhtë kurrë që unë të mëkatoj kundër Zotit duke hequr dorë nga lutjet për ju” (1 Sam. 12:23).

Ndërsa lutemi për fëmijët tanë tani, ne marrim perspektivën e veçantë që Fryma u jep atyre që janë të qëllimshëm për ndërmjetësim. Ai na tregon gjëra, na pëshpërit urtësi, na thërret që të jemi partnerë me Të dhe planet e Tij për fëmijët tanë. Është e çuditshme! Në njëfarë mënyre Ai shkrin zemrat tona me të Tijën, dhe ne i shohim të rinjtë tanë përmes syve të Tij. Respekti ynë për ta rritet teksa lutemi për ta përgjatë kohëve të vështira. Dhembshuria jonë për ta shtohet teksa mbartim barrën e realiteteve të jetës bashkë me ta.

Kohët e fundit, vajza jonë dhe bashkëshorti i saj po kalonin një kohë tepër të frikshme. Vajza e tyre shtatëmuajshe filloi të kishte konvulsione, gjë që bëri që të diagnostikohej me spazma infantile. Kjo është një formë e tmerrshme dhe debuluese epilepsie. Trajtimi ishte brutal, duke përfshirë injeksione ditore intermuskulare që shkaktonin tension gjaku tepër të lartë. Përpos kësaj, ata kalonin netë të tëra pa gjumë në ambjentet spitalore. Frika për të ardhmen e vogëlushes së tyre nuk u hiqej nga mendja për asnjë moment.

Duke u lutur për Brook dhe Elizabeth dhe duke ecur bashkë me ta, respekti ynë për ata të dy u rrit jashtë mase. Në pamundësinë e tij për ta rregulluar këtë, Brook është bërë një burrë i vërtetë besimi, një kampion. Besimi i tij është themeluar në të vërtetën, në realitetin se ndonjëherë jeta është e vështirë dhe nuk ka kuptim, por Perëndia është i mirë – gjithmonë. Ai po e udhëheq familjen e tij në këtë teologji tepër solide. Vajza jonë Elizabeth po shfaq një fuqi të brendshme të jashtëzakonshme teksa po përjeton një histori që asnjë nënë nuk do ta donte për fëmijën e vet. Rrugës për në spital, ajo ndjeu dorën e Perëndisë në supin e saj dhe e dëgjoi të pëshpëriste: “Unë jam me ty në këtë situatë, Elizabeth. Unë jam me ty”. Gjatë gjithë kësaj përvoje të hidhur, ajo u mbajt në sigurinë e Perëndisë – jo se Ai do të bëjë atë që ajo do, as sepse Ai garanton një përfundim të mirë, por për shkak se Ai është i pranishëm, i vërtetë dhe është gjithçka që ajo ka nevojë.

Ky është lloji më i sinqertë i besimit. Nuk e vendosëm ne këtë lloj besnikërie tek fëmijët tanë – Ati i tyre qiellor e vendosi. Dhe ne kemi privilegjin dhe kënaqësinë që të jemi partnerë me Të duke u lutur për ta.

Bekoni që të bekoheni

Nuk jeni vetëm ju që i jepni bekimin fëmijëve tuaj, por edhe ata do të kthehen dhe do t'ju bekojnë ju! Ne përjetuam diçka që është ëndrra e çdo prindi.

DIANE:

Një mëngjes djali ynë i vogël, Matthew, po largohej për në vitin e tij të fundit në universitet. Ne po mbushnim makinën me gjithë gjërat që do t'i duheshin atij për të jetuar vetëm. Kishim kaluar një verë shumë të këndshme së bashku; çdo moment kishte peshë ndërsa kuptonim që këto do të ishin kujtimet e fundit të prindërimit aktiv me fëmijën tonë të fundit. Teksa Matt mbylli bagazhin, u kthye nga ne dhe tha: “Kam nevojë të flas me ju”.

Unë, sigurisht, fillova të shqetësohesha menjëherë; mendja më shkante tek problemet e mundshme!

Matt na çoi drejt kuzhinës, më vuri duart në supe dhe filloi të flasë, duke derdhur fjalë bekimi dhe aprovimi drejt meje. Lotët filluan të më rridhnin në fytyrë teksa im bir kujtonte vitet që i kisha dedikuar rritjes, edukimit dhe kujdesit për të. Gjithë turpi e faji i dështimeve të mia, gjithë ato herë që e kisha katranosur si mami, gjithë keqardhjet e mia të sinqerta u fshinë në monologun e rrjedhshëm të bekimit për mua.

Më pas Matt u kthye nga Phil, ndërkohë unë mora celularin që të regjistroja fjalët e tij për babin. Kjo është ajo që tha:

“Babi, thjesht dua të të them sa shumë të dua, dhe sa shumë të vlerësoj si baba. Vitin e kaluar, kam kuptuar sa shumë ke bërë për mua dhe si nuk e kisha kuptuar këtë gjë gjatë gjimnazit. Të dua shumë, por ti e di që është e vështirë t'i vësh re disa gjëra. E di sa shumë kujdesesh për mua. Të jam mirënjohës për çdo gjë që ke bërë për mua – si më ke rritur, si më ke disiplinuar, dhe si ke dashur që të jem një burrë i mirë. Disa herë ke qenë i ashpër me mua, por e di që ka qenë për mirë. Dua të dish sa të dua dhe sa shumë të respektoj. Nëse nuk do të ishte burri që je, nuk e di nësa do të isha duke ecur me Jezusin. Gjithçka që ti predikon, ti

e bën, dhe unë e respektoj këtë. Ti je ndër miqtë e mi më të mirë. Më pëlqen të shoh filma me ty dhe të kalojmë kohë bashkë, dhe do më mungosh shumë”.

Nuk ka fjalë që e përshkruajnë shenjtërinë e atij momenti ose mënyrën se si zemrat tona u përulën nga këndvështrimi i hirshëm i djalit tonë ndaj përpjekjeve tona të mundimshme gjatë prindërimit të qëllimshëm. Por Phil arriti t'i përmblidhte mendimet e tij në fjalë dhe iu kthye të birit, duke thënë:

“Ti do të më mungosh më shumë. Ti je një djalë i mirë dhe do të bëhesh një burrë i shkëlqyeshëm. Jam shumë krenar për ty. Të doja kur ishe vogëlush, dhe të dua edhe tani që je një djalosh. Do të të dua edhe kur të jesh burrë i madh, nëse Zoti më lë të jetoj. Do të më mungosh, por jam i lumtur për ty. Të bekoj plotësisht ndërsa shkon”.

Gjithë ato vite që shpenzoni duke derdhur veten tuaj tek fëmijët – ia vlejnë! Mbahuni fort në shpresën se do të vijë dita kur edhe fëmijët tuaj gjithashtu do t'ju bekojnë, dita kur do t'ju shohin përmes syve të hirit.

Asgjë dhe askush nuk mund të kthehet e t'ju bekojë si ata fëmijë që ju i quani tuajt. Gjithë ai disiplinim dhe ndreqje, urgjencat e ndryshme, pirqjet e pafundme të rrobave për t'u larë, vaktet e ngrënies dhe oraret e gjumit, muret e zhgarravitura dhe rrëmujat – *çdo moment ia vlen*.

Nuk ka asnjë thirrje më të lartë në këtë jetë. Asnjë privilegj më të madh. Ky është përdorimi më i mirë i mundshëm i kohës tuaj!

PO KUTIA?

Kutia tani nuk është më!

Që në momentin që ju filloni të rritni fëmijët, jeni duke i përgatitur ata të lënë shtëpinë. Tashmë është koha që t'ua lini atyre plotësisht përgjegjësinë për jetën e tyre. Ju nuk jeni më autoriteti mbi djalin apo vajzën tuaj. Tashmë ju ecni përkrah tyre.

Nuk është më puna juaj që t'i disiplinoni ata ose të impononi rregull në jetët e tyre. Tashmë puna juaj është të bëni tifo për ta dhe t'i inkurajoni. Ju jeni të hapur për këshillim, për të dhënë informacione,

të ndani nga urtësia juaj, t'u përgjigjeni pyetjeve – t'i ndihmoni kur ata duan që ju ta bëni këtë.

Kutia ka ikur, por themeli qëndron.

Jezusi do të jetë gjithmonë themeli i marrëdhënies tuaj me fëmijët. Ai është shkëmbi i fortë mbi të cilin qëndroni edhe ju edhe fëmijët tuaj. Nëse ata tashmë po ndjekin Jezusin, ju nuk jeni vetëm prind dhe fëmijë, por jeni motra dhe vëllezër në Krishtin. Ai do t'ju japë mundësi të rriteni së bashku duke soditur kush është Perëndia dhe si punon Ai në jetën tuaj.

Ndërsa i përcillni të rinjtë tuaj në botë, duke u zbrapsur nga roli juaj autoritar, ju merrni kënaqësi kur i shikoni ata të përdorin aftësitë që kanë mësuar në shtëpinë tuaj teksa jetojnë në mision në një botë që ka nevojë për Jezusin.

ÇELËSI

Ditën që merrni në zotërim shtëpinë tuaj, sipërmarrësi ju dorëzon një çelës të ri e të shndritshëm. Puna e tij ka mbaruar. Për njëzet vite ju keni bashkëpunuar me Perëndinë teksa Ai ndërtonte një shtëpi frymërore në jetën e djalit apo vajzës tuaj. Tashmë puna juaj ka përfunduar dhe është koha që ju t'u dorëzoni çelësin e shtëpisë së tyre.

Çfarë do të thotë t'i dorëzoni Çelësin djalit apo vajzës tuaj?

Kur fëmijët tanë lanë shtëpinë, secilit prej tyre i dhamë një çelës të shtëpisë tonë si një akt gjysmë-ceremonial sigurie, duke u thënë atyre: “Jeni të mirëpritur të vini në çdo kohë; edhe nëse ne nuk jemi aty. Shtëpia jonë është shtëpia juaj!”

Por ne nuk kërkuam, dhe as nuk do ta prananim, një çelës të shtëpisë së tyre. Kjo ishte diçka e qëllimshme dhe simbolike. Gjëja e fundit që fëmijët duan ose kanë nevojë është të mendojnë që mami ose babi mund të shfaqen në shtëpi në çdo lloj kohe! Shtëpia e tyre nuk është shtëpia juaj!

Donim që fëmijët tanë të rritur dhe bashkëshortët/et e tyre ta dinin që ne e kuptojmë këtë gjë, dhe e respektojmë nevojën e tyre për të ndërtuar shtëpitë e tyre, të kenë familjet e tyre veçmas prindërve.

Në ditën e dasmës, i kemi marrë veç secilin prej fëmijëve tanë dhe u kemi thënë: “Viti i parë i martesës është themelor për gjithë pjesën

tjetër të jetës tuaj. Ne nuk duam të vendosim asnjë lloj presioni mbi ju, ose t'ju bëjmë të ndiheni në faj që të vini në shtëpinë tonë vetëm sepse ne duam t'ju shohim më shpesh. Ne duam t'ju shohim aq sa ju dëshironi, por nuk do të ankojemi: 'Nuk po ju shohim më fare!'

E vërteta është që, disa prej fëmijëve tuaj mund të fillojnë me aq varfëri saqë do t'ju *kërkojnë* të vijnë tek ju për darkë. Ne kemi bërë kështu, çdo javë! Të dyja mamatë tona siguroheshin që të na jepnin me vete ushqimet që tepronin kur iknim, në mënyrë që të kishim mjaftueshëm deri javës që vinte.

Por ne donim që fëmijët tanë të shikonin nevojën e tyre për t'i qëndruar besnikë familjes së tyre që ishte në zhvillim e sipër, që t'i jepnin bashkëshortëve/eve vëmendjen dhe kohën e tyre më të mirë. Ky është plani i Perëndisë, siç shprehet tek Zanafilla 2:24: "Për këtë arsye njeriu do të lërë babanë dhe nënën e tij dhe do të bashkohet me gruan e tij dhe do të jenë një mish i vetëm".

Që kjo të ndodhë pa shumë dramë dhe stres, mamatë dhe baballarët duhet që në mënyrë të qëllimshme t'i lënë të shkojnë. Fëmijët tuaj kanë nevojë për lejen dhe aprovimin tuaj në procesin e largimit. Nuk është e shëndetshme për ne të kemi nevojë për fëmijët ndërsa ata janë në moshë madhore. Ne duhet të qëndrojmë bashkë, të fortë dhe të kënaqur në Jezusin, duke u dhënë fëmijëve lirinë që të dalin të fortë në jetën e tyre të re.

Një ditë do të jeni vetëm ju të dy sërish, dhe do ta shijoni! Jepuni atyre Bekimin, çmontojeni Kutinë, dhe dorëzojuni Çelësin e shtëpisë tuaj. U thoni kështu:

"Ju do të ndërtoni shtëpinë tuaj tani, duke rritur brezin e ardhshëm të ndjekësve të pasionuar për Jezusin. Do të hartoni vetë planet tuaja, do të hidhni themelin tuaj, do ngrini strukturën tuaj, do të instaloni sistemet tuaja funksionale, do ta përmbyllni punën, dhe një ditë, do t'u dorëzoni fëmijëve tuaj çelësin e tyre".

Pengje

Kini parasysh këtë: kur ndërtoni një shtëpi, sa herë që të kaloni përmes asaj dere, do të donit që disa gjëra t'i kishit bërë ndryshe. Këndi

i kuzhinës është shumë i vogël; duhet të kishit vendosur një lavaman tek dhoma e larjes së rrobave; pse, oh pse nuk vumë një dritare atje?

Kur vjen puna tek rritja e fëmijëve, do të keni pengje – çdo prind ka. Asnjë nënë ose baba nuk shikon pas dhe thotë: “E bëra në mënyrë të përsosur!” Do të kujtoni kohët kur keni reaguar me frikë, në vend që të reagonit me urtësi. Do të uronit që t’i kishit ditur ato që nuk i dinit – gjërat që duken qartazi në pasqyrën që sheh pas (si pasqyrat e makinës). Nëse do kishit mundësinë ta bënit komplet nga e para, normalisht që do të kishit bërë ndryshime! Disa prej atyre gabimeve mund të bëhen material gajasjeje në historikun e familjes tuaj, ndërsa disa të tjera mund t’ju bëjnë që të kërkonit falje për atë gjë edhe pas shumë vitesh. Shkoni tek hiri i përlësisë, dhe do të jeni thellësisht mirënjohës për mëshirën që fëmijët tuaj kanë treguar ndaj atyre gjykimeve dhe hapave të gabuar.

Kur vjen puna tek ndërtimi i burrave dhe grave të perëndishme, mbani mend: qëllimi juaj nuk është të rritni djem dhe vajza të përsosur! Qëllimi juaj është të rritni ndjekës të pasionuar pas Jezusit që cilët po ashtu do të rritin brezin e *ardhshëm* të ndjekësve të pasionuar pas Jezusit.

Ashtu siç Psalmisti përshkruan tek Psalmi 78:

O populli im, kushtoji kujdes ligjit tim; dëgjo fjalët e gojës sime.

Do të hap gojën time për të thënë shëmbëlltyra, dhe kam për të paraqitur misteret e kohërave të lashta.

Atë që ne kemi dëgjuar dhe kemi njohur, dhe që etërit tanë na kanë treguar,

nuk do t’ua fshehim bijve të tyre, por do t’i tregojmë brezit të ardhshëm lavdet e Zotit, fuqinë e tij dhe mrekullinë që ai ka bërë.

Ai ka vendosur një dëshmi te Jakobi dhe ka vënë një ligj në Izrael, dhe ka urdhëruar etërit tanë që t’ua bëjnë të njohura bijve të tyre,

me qëllim që brezi i ardhshëm t’i njohë së bashku me bijtë që do të lindin; dhe këta nga ana e tyre t’ua tregojnë bijve të tyre,

dhe të vendosin te Perëndia besimin e tyre dhe të mos harrojnë veprat e Perëndisë, por të respektojnë urdhërimet e tij (Psalmi 78:1-7).

Paçi privilegjin që të rritni bij dhe bija që do të duan Perëndinë me pasion dhe do të duan njerëzit me qëllim, që do të vendosin shpresën e tyre tek Jezu Krishti, shkëmbi i pamposhtur.

Dhe mbretëria e Perëndisë ardhte mbi shtëpinë dhe familjen tuaj, duke sjellë bukurinë dhe lavdinë e Tij në çdo cep të tokës.

Amen.

Rritja e Ndjekësve Pasionantë për Jezusin

Hapja e derës së përparme



=



+



+



BEKIMI

Bekojni fëmijët tuaj duke besuar tek ata, duke zgjedhur të mos i kritikoni, duke i dëgjuar në vend që t'i gjykoni, si dhe duke u lutur për ta.

KUTIA

Kutia ka ikur tashmë, por themeli i Jezusit qëndron. Ju nuk jeni më mbi ta. Tashmë ju jeni përkrah tyre.

ÇELËSI

Jepuni atyre një çelës të shtëpisë tuaj, në mënyrë që ju do të jeni gjithmonë aty për ta. Respektojeni nevojën që ata kanë për të ndërtuar shtëpinë e tyre – ndryshe prej tuajës.

Shtojca A

Riparimi

“Njerëzit e tu do të rindërtojnë rrënojat e lashta, dhe do të ngrenë përsëri themelet e shumë brezave të shkuara; kështu ti do të quhesh riparuesi i të çarave, restauruesi i shtigjeve për të banuar në vend”.

Isaia 58:12

Pikërisht rreth kohës kur fëmija ynë i fundit po përfundonte universitetin, shihnim shtëpinë tonë të madhe bosh në një kodër me pamje nga qyteti i Portland dhe vendosëm të shpërngulehim. Nuk na nevojiteshin më gjithë ato dhoma, tualete dhe hapësira të tepërta – apo këstet e kredisë që lidheshnin me të.

Miku ynë Bob përmendi rastësisht një shtëpi që do të nxirrej në shitje në lagjen ku ai po rimodelonte një shtëpi për ta rishitur. Shtëpia ishte në një territor të pyllëzuar, të qetë dhe po ashtu afër një zone të këndshme me shtëpiza dhe dyqane – si qytezat evropiane që ndërtohen jashtë qytetit. Ne nxituam që të shkonim e t'i hidhnim një sy.

U zhgënjeva jashtë mase kur e pashë shtëpinë për herë të parë. Ishte e shëmtuar! E ndërtur në vitin 1969, ishte një shtëpi e vogël e rëndomtë njëkatëshe që nuk kishte qenë ndonjëherë e lezetshme. Unë kisha imagjinuar një shtëpizë të këndshme e cila priste që unë të shkoja e t'i riktheja rehatinë e dikurshme. Përkundrazi, garazhi mbante erë urinë maceje, dhe shtëpia ishte e paretatshme, e pistë, dhe kishte lagështirë – patetike.

E blemë.

Kështu filloi një projekt restaurimi dhe rindërtimi me të cilin po punojmë ende. Kthimi i një shtëpie të rrënuar në një shtëpizë të bukur ku ne jetojmë, dashurojmë dhe qeshim e dhe ku të gjithë Comers -at (gjashhtëmbëdhjetë për momentin dhe vazhdon numërimi!) mbledhen së bashku për të festuar. Me ndihmën e ndërtuesve të shkëlqyer, mjeshtrave, dizenjatorëve dhe atyre që u vjen dora për punime artistike, dalëngadalë po e shohim Shtëpizën Firwood të kthehet në një vend që e dashurojmë. Disa prej jush e dinë për çfarë po flasim. Ju keni ardhur vonë në këtë përpjekje për të rritur bij dhe bija që do të jenë ndjekës plotësisht të pasionuar të Jezusit. Kur ju lindën fëmijët, ju ose nuk po e ndiqnit Jezusin as vetë, ose thjesht nuk dinit çfarë të bënit, kështu që si mund t'i trajtonit ata fëmijë?

Në Psalmin 11, Davidi pyet: “Nëse themelet janë shkatërruar, çfarë mund të bëjë i drejti?”¹

Përgjigja është kjo: Rindërtoni themelet.

Ju po pyesni njëloj si Davidi: *çfarë mund të bëj tani? A ka shpresë për fëmijët e mi të rritur? Po për adoleshentin tim? Për atë djalë apo vajzë që nuk do t'ia dijë për Jezusin?*

Po! Në fakt, Perëndia është i specializuar të kthejë rrënojat në ekspozitë të lavdisë së Tij. Po! Dhe Ai do veçanërisht plangprishësit dhe rebelët – thjesht shikoni dishepujt që Jezusi zgjodhi!

Megjithëse kjo nuk është historia që ju uroni për birin ose bijën tuaj, do t'ju këshillojmë që të hiqni tutje prangat e turpit që ju shtrëngojnë. Faji është një nga shigjetat e preferuara që Satani hedh në rrugën tonë dhe duket sikur ai e sheh më të përdorshme tek prindërit këtë gjë. Ndonjëherë sa më i mirë të jetë prindi, aq më i rëndë është faji!

Shkruesi i Hebrenjve hodhi pak dritë mbi këtë kur shkroi:

“Pastaj etërit tanë sipas mishit i patëm për të na ndrequr dhe i nderonim ata . . . Sepse ata na ndreqën për pak ditë, ashtu siç u dukej më mirë, kurse ai na ndreq (*disiplinon*) për të *mirën* tonë që të bëhemi pjestarë të shenjtërisë së tij” (Hebrenjtë 12:9-10).

Vetëm se nuk keni bërë gjithçka që do të uronit të kishit bërë,

ose fëmijët nuk janë përgjigjur ashtu siç ju shpresonit, nuk do të thotë që Ai nuk ka punuar fare përgjatë kësaj kohe. Në fakt, Perëndia shpesh thërret burra dhe gra të tjerë përkrah nesh që të na ndihmojnë të bëjnë prindërimin shpirtëror që ne nuk jemi në gjendje ta bëjmë. Apostulli Pal përmend shkurtimisht një grua që ndikoi në jetën e tij kur tha tek Romakëve: “Të fala Rufit, të zgjedhurit në Zotin, dhe nënës së tij që është edhe imja” (Rom. 16:13). Dikush tjetër përpos mamasë së tij kontribuoi në përkujdesje ndaj Palit.

Pali po ashtu e shikonte veten si një lloj ati përkujdesës për Timoteun, duke e thirrur atë, “biri im i dashur” (2 Tim. 2:1), teksa i ofronte këshilla për jetën.

Pra, mos hiqni dorë ende. Ka punë për të bërë, dhe nuk është kurrë – *kurrë* – shumë vonë.

Ne do të përdorim vargun tek Isaia si një model referues për rindërtimin e shtëpisë tuaj shpirtërore. Vini re foljet – si-të e këtij procesi: *Rindërtoni. Ngrini lart. Riparoni. Restauroni.*

Rindërtoni

Libri i Ezdrës dhe Nehemias janë regjistrime historike dhe shpirtërore të rindërtimit të tempullit në Jerusalem. Qyteti që kishte qenë qendra e adhurimit kishte rënë dhe ishte pothuajse tërësisht i shkatërruar në vitin 587 para Krishtit, nga pushtimi babilonas. Perëndia ngriti Ezdrën dhe Nehemian që të ndërmerrnin dhe të përfundonin punën e restaurimit të tempullit dhe të qytetit si një vend ku njerëzit e Perëndisë të mund të jetonin sërish të lirë në praninë e Tij. Ezdra i sfidoi njerëzit duke thënë: “Kush nga ju i përket popullit të tij? Zoti, Perëndia i tij, qoftë me të; të rindërtojë shtëpinë e Zotit” (Ezdra 1:3). A nuk është kjo një sfidë me vend për prindërit që po përballen me sfidën e “rindërtimit” të një zemre për Perëndinë në fëmijët e tyre?

Thirrja e Ezdrës rezultoi në drejtues kyç të cilët e ndërmorën këtë sfidë: “Atëherë Zorobabeli, bir i Shealtielit, dhe Jeshua, bir i Jotsadakut, u ngritën dhe nisën të rindërtojnë shtëpinë e Perëndisë në Jeruzalem; dhe me ta ishin profetët e Perëndisë, që i ndihmonin” (Ezdra 5:2).

E shikoni çfarë bënë ata fillimisht? U ngritën. Ata vendosën të

bënin atë që ishte e nevojshme për t'u bërë pavarësisht se sa e frikshme dukej puna. Ky është lloji i këmbënguljes që do t'ju nevojitet edhe juve po ashtu. Rindërtimi është shumë më i vështirë se sa të fillosh nga e para.

Pas daljes në pension, prindërit e Dianës ndërtuan shtëpinë e tyre të ëndrrave lart në malet Sierra të Kalifornisë. Një vilë e bukur prej druri si ekspozitë sendesh antike e pozicionuar mbi një kreshtë me pamje nga malet që atyre u pëlqenin aq shumë. Ata e shijuan shtëpinë e tyre për dhjetë vjet, duke hapur dyert për të mirëpritur miq dhe familjarë, po ashtu edhe misionarë që udhëtonin dhe këdo që do të kishte nevojë për pak pushim.

Një natë teksa po flinin, shpërtheu një zjarr. Ata u zgjuan të rrethuar nga flakët në çdo drejtim, aq sa me zor shpëtuan. Më pas panë se si shtëpia e tyre e bukur u shkrumbua plotësisht. Humbën pothuajse gjithçka që zotëronin, por më e keqja ishte se humbën qenin e tyre që e donin shumë.

Brenda javës, pas humbjes katastrofike që pësuan, Jack dhe Sue po përgatiteshin që të rindërtonin. Kur dikush u dha idenë që të shpërnguleshin nga mali dhe të shkonin më poshtë, në një komunitet të përshtatur për pensionistë, ata i hodhën një shikim njëri-tjetrit dhe thanë: “Nuk bëhet fjalë! Ne e dashurojmë jetën këtu”.

Për fatin e tyre, themeli, edhe pse goxha i dëmtuar, ishte ende në gjendje të mirë. Kishte nevojë për t'u forcuar dhe për t'i bërë disa riparime, por gjithsesi ishte i përdorshëm.

Rindërtimi i shtëpisë frymërore të familjes suaj fillon me ju. Fillon pasi ju me përlësi kuptoni që Jezusi nuk ka qenë themeli i fortë i shtëpisë tuaj. Perëndia “u jep hir² të përlururve” (1 Pje. 5:5).

Çfarë nënkupton kjo? Ndoshta do t'ju duhet t'u kërkonti falje fëmijëve tuaj. Ndoshta mund të thoni: “Pendohem që nuk e kam ndjekur Perëndinë nga afër, që nuk e kam bërë Atë qendrën e familjes. Tani, me ndihmën e Tij, gjërat do të ndryshojnë. Unë dua që kjo të jetë një shtëpi ku dashuria e Perëndisë përshkon gjithçka që ne bëjmë dhe themi, dhe e di që kam shumë punë për të bërë”. Mund të duket e çuditshme në fillim, por nuk ka problem.

Më pas duhet t'i futeni punës, ashtu si bënë njerëzit në librin e Ezdrës. Ashtu si prindërit e Dianës me shumë kujdes rindërtuan

shtëpinë e tyre të ëndërrave, duke kaluar orë e orë të tëra për ta bërë siç duhet, kështu edhe ju, mund të dedikoni veten tuaj për të rindërtuar shtëpinë frymërore të familjes tuaj.

Ngrini lart

Tendenca e parë e shumë prindërve, pasi ndërgjegjësohen për përgjegjësinë shpirtërore ndaj fëmijëve të tyre, është që të krijojnë një listë të gjatë rregullash. Sjelljet duhen ndryshuar. Qëndrimet kanë nevojë të përshtaten me kujdes. Duhet bërë një pastrim shtëpie i thellë! Ju e dini *çfarë* duhet të bëni, por nuk jeni të sigurt se *si* ta bëni.

Së pari: E mbani mend çfarë kemi thënë më parë në kapitullin 11? Jezusi është themeli. Jo kisha, jo mënyra e krishterë e të jetuarit, jo organizatat e ndryshme ungjillizuese, ose ndonjë lloj program tjetër – vetëm Jezusi. Ne theksuam se Pali u lut që efesianët ta “njihnin dashurinë e Krishtit” (Efe. 3:19).

Kështu që lartësoni Jezusin! Thjesht filloni me Të. Ai Vetë është “guri i qoshes” (Efe. 2:20). Kërkojini urtësi Atij. Lutuni për guxim të shoqëruar me një bindje të sinqertë teksa i hapni zemrën fëmijëve tuaj. Ai është i gatshëm t’u përgjigjet lutjeve tuaja!

Jezusi është themeli. *Dashuria* e Tij është ajo që na nevojitet – ajo çka u nevojitet vërtet fëmijëve tanë. Ndryshimet në mënyrën e jetesës vijnë si rrjedhojë e ndryshimeve që Jezusi bën në zemrën tonë. Kjo është mënyra se si funksionon ungjilli – shumë kontradiktore me kulturën tonë “Kryeje / Bëje!” Ndërsa ne biem më thellë në dashuri me Jezusin, Ai kryen veprën e Tij në ne.

Gjatë rrugës për në kryq ku Ai do të jepte jetën e Tij prej dashurisë që kishte ndaj nesh, Jezusi tha: “. . . tani do të hidhet jashtë princi i kësaj bote! Dhe unë, kur të jem ngritur lart nga toka, do t’i tërheq të gjithë tek unë!” (Gjo. 12:31-32).

Ju po hidhni jashtë shtëpisë tuaj “princin e kësaj bote” dhe po lartësoni Jezusin duke folur për hirin dhe për mëshirën e Tij, duke dëshmuar se çfarë Ai po bën në zemrën tuaj. Tregojuni fëmijëve tuaj dashurinë që po përjetoni prej Tij. Jini bujarë dhe të këndshëm, duke i anashkaluar irritimet që ju provokojnë zakonisht. Kërkoni falje kur e

katranosni. Shfaqeni gëzimin që ndjeni. Fëmijët tuaj do ta shohin këtë paqe dhe do të mrekullohen!

Po, disa gjëra do duhet të shkojnë, por do të jetë dashuria juaj e re për Jezusin që do t'ju informojë se cilat aktivitete, filma, revista – gjëra që më parë mendonit se ishin në rregull – tashmë ju sikletosin dhe ju duken shumë pavend me Jezusin në jetën dhe shtëpinë tuaj.

Riparoni

Pa dashurinë e Jezusit në qendër të shtëpisë tuaj padyshim që ju keni lejuar të thuhet e të bëhen gjëra që janë antiteza të dashurisë së Jezusit. Disa qëndrime kanë lëshuar rrënjë, disa sjellje si nga ana juaj, ashtu edhe nga ana e fëmijëve tuaj mund të mos pajtohen me mënyrën e mbretërisë të të bërit të gjërave. Marrëdhëniet mund të kenë nevojë për riparime madhore.

DIANE:

Kur isha shtatëmbëdhjetë vjeçe, mamaja më kërkoi falje. Të gjithë ishim besimtarë të rinj dhe shkonim në një kishë që e solli Jezusin tek ne në një mënyrë që nuk e kishim dëgjuar kurrë më parë. Megjithëse po filloja të ndiqja Jezusin, marrëdhënia me mamën time ishte e tensionuar.

Ajo ishte rritur me një baba të dhunshëm e zemërak, dhe nuk ishte trajnuar si të përballej me inatin që ndonjëherë dukej sikur i ziente përbrenda në mënyrë të pavullnetshme. Unë acarohesha me të pasi ajo zemërohej me mua për arsye që nuk arrija t'i kuptoja. Kur më tha të ulesha dhe përulësisht më kërkoi falje, duke më treguar se si në një takim grash kishte kuptuar se zemërimi i saj kundrejt meje ishte i gabuar, mbeta pa fjalë.

Gjithë arroganca ime prej adoleshenteje thjesht mbeti pezull aty mes nesh. Nuk mund t'u besoja veshëve. Mamaja ime po më thoshte se i vjen keq?

Ajo ditë shënoi një ndryshim në marrëdhënien tonë, gjë që mundësoi që ne të dyja të bëheshim mikështa. Qëndrimi im kundërshtues dalëngadalë po zbutej teksa shikoja Jezusin, Shpenguesin, të punonte në jetën e mamasë sime. Ajo nuk u bë

përsosmërisht e durueshme brenda natës, por filloi të riparonte në mënyrë të qëllimshme atë që ishte thyer midis nesh. Gjatë këtij procesi, unë rashë më thellë në dashuri me një Shpëtimtar që mund të ndryshonte edhe mamanë time. Pa patur nevojë që të rrëfeja dhe të kërkoja falje, mamaja ime më tregoi rrugën për tek hiri duke më ftuar ta ndiqja.

Vite më vonë mësova kuptimin e fjalës mëshirë. Mëshira është kur nuk u japim të tjerëve atë që meritojnë, por përkundrazi, zgjedhim t'i falim ashtu siç edhe ne jemi falur.

Kur një prind kërkon falje, mëshira demonstron me një ekstravagancë që madje as adoleshenti nuk e injoron dot!

Restauroni

Bariu i Mirë është ai që restauron shpirtërat tanë, dhe Ai e bën këtë me një butësi të pafundme³. Fjala *restaurim* do të thotë të kthesh, ose të kthehesh pas.

Pasi ju rindërtoni themelin, lartësoni Jezusin, dhe riparoni marrëdhëniet e thyera, tashmë vjen procesi i gjatë i restaurimit.

Dy vargjet e fundit të Dhiatës së Vjetër thonë:

“Ja, unë do t’ju dërgoj Elian, profetin, para se të vijë dita e madhe dhe e llahtarshme e Zotit. Ai do të bëjë që zemra e etërve t’u kthehet bijve dhe zemra e bijve etërve, me qëllim që vendi të mos goditet nga një shfarosje e plotë” (Malakia 4:5-6).

Zemra e Perëndisë është që të rikthejë zemrat e etërve dhe nënave drejt fëmijëve të tyre. Ky është qëllimi i restaurimit.

Kur një baba kthehet pas nga çfarëdo lloj gjëje që e pengonte atë për të dashur dhe udhëhequr fëmijët e tij në mënyrë radikale, duke e kthyer fokusin *kundrejt* birit ose bijës së tij, atëherë ndodh restaurimi. Kur mami kthehet pas nga telefoni ose karriera e saj apo nga aktivitetet e kishës ose nga zemërimi i saj, dhe e përqëndron dashurinë dhe vëmendjen e saj tek fëmija i saj, atëherë ndodh restaurimi.

Kjo është mënyra se si Perëndia dëshiron t’ju përdorë që ta sjellë

shtëpinë tuaj nën bashkërendimin e Tij. Ai do t'ju përdorë për të shfaqur hirin e Tij shpëtues teksa punon në ju e ju ndryshon në sy të fëmijëve tuaj. Ç'mund të jetë tjetër një provë më e madhe e fuqisë së Tij se sa kjo?

Por nuk do të jetë një lundrim i qetë. Është një pikë që nuk duhet të tregohemi të shkujdesur e ta neglizhojmë.

Prisni rezistencë

DIANE:

Kur babai im vendosi që të përpiquej të na drejtonte në devocione familjare, të tre ne ishim adoleshentë të papjekur. Po, ne po gjenim rrugën tonë drejt Jezusit, por ende nuk kishim mësuar konceptin e nderimit të prindërve tanë – ishim shumë larg!

Babi na thirri të gjithëve në dhomën e ndenjes që rrallë përdorej dhe u ulëm në ato karriget e ngurta me kurrizin drejt, duke menduar se çfarë nuk shkonte. Mendova që me siguri ishim në ndonjë lloj telashi, prandaj kur ai na shpjegoi se do të lexonim Biblën dhe do të flisnim rreth saj si familje, më shpërtheu një gaz që nuk e përmbaja dot. I palëkundur, babi pastroi fytin dhe me zë autoritar filloi të lexonte nga Ungjilli i Mateut. Pas disa vargjes, ai ia kaloi Biblën mamit. Ajo lexoi për pak, dhe ia kaloi Biblën vëllait tim, i cili filloi të qeshte nën zë ndërsa lexonte vargjet e tij. Më pas ishte radha ime. Mora Biblën në duar, duke u përpjekur shumë që ta përmbaja veten, por nuk munda. Fillova të qeshja aq shumë, sa që nuk lexoja dot asnjë fjalë.

I gjori baba. Kur shikoj pas tani kuptoj se ajo që ai bëri ishte vërtet kurajoze, edhe pse sjelljet tona qesharake ishin të rënda për të (megjithëse ne po përqafojmë me entuziazëm rrugën e Jezusit). Jo shumë vite më pas, ishim në gjendje të qeshnim si familje për ato përpjekjet e para qesharake, për ta bërë Jezusin qendrën e shtëpisë tonë.

A mund t'ju inkruajoj pak? Megjithëse ajo ditë nuk shkoi sipas parashikimit, duke folur për gjëra shpirtërore – apo duke u lutur së bashku – në fakt u bë një moment i natyrshëm dhe gazmor i kohëve tona së bashku si familje.

Vini re një ngjarje në historinë e rindërtimit të Jerusalemit. Gjërat po shkonin mirë kur, për shkak të një kundërshtimi të vazhdueshëm, Nehemia shkroi:

“Ne, pra, i rindërtuam muret që u bashkuan deri në gjysmën e lartësisë së tyre; sepse populli e kishte marrë me zemër punën. Por kur Sanballati, Tobiahu, arabët, amonitët dhe asdodejtë mësuan që riparimi i mureve të Jerusalemit po përparonte dhe të çarat kishin filluar të mbylleshin, ata u zemëruan shumë, dhe të gjithë së bashku komplotuan për të ardhur në Jerusalem dhe për të krijuar trazira në të” (Neh. 4:6-8).

Më pas vijon një listë e gjatë telashesh që kërcënonin të mposhtnin ndërtuesit e mureve. Por Nehemia doli me një plan:

“Por ata që ndërtonin muret dhe ata që mbartnin o ngarkonin peshat, me një dorë merreshin me punimet dhe me dorën tjetër mbanin armën e tyre” (Neh. 4:17).

Rezistenca nuk është një shenjë që tregon se është koha të tërhiqeni dhe të dorëzoheni! Përkundrazi, shpeshherë është një pasojë direkte e të ecurit në vullnetin e Perëndisë. Ashtu si ndërtuesit e mureve, prindërit që bëjnë një punë të vështirë në rindërtimin e shtëpive të tyre që në mënyrë më të bukur të reflektojnë rrugën e Jezusit do të hasin pengesa në rrugën e tyre. Kështu që me një dorë bëjmë punën dhe me dorën tjetër mbajmë ngjeshur armët tona!

Cilat janë armët tona? Gjeni një listë tek Efesianëve 6:10, 18:

“Për çfarë mbetet, vëllezërit e mi, forcohuni në Zotin dhe në forcën e fuqisë së Tij. duke u lutur në çdo kohë dhe me çdo lloj lutjeje dhe përgjërimi në Frymën, duke ndenjtur zgjuar për këtë qëllim me çdo ngulmim dhe lutje për të gjithë shenjtorët”.

Teksa rindërtoni, ngrini lart, riparoni, dhe restauroni, do të shikoni familjen tuaj të transformohet dalëngadalë përpara syve tuaj. Perëndia ju dhëntë hirin, urtësinë, të kuptuarit, dhe vendosmërinë e nevojshme për të rindërtuar shtëpinë tuaj e për ta bërë atë një ekspozitë të hirit të Tij të mrekullueshëm!

Shtojca B

Drejtimi i Fëmijës tek Jezusi

Pasi kishte marrë pjesë në një nga konferencat tona të prindërimit në Glasgow, Skoci, një nënë e motivuar shkoi në shtëpi dhe e pyeti vajzën e saj tetëvjeçare nëse e kishte ftuar ndonjëherë Jezusin që të ishte Shpëtimtari i saj. Ajo i tha: “Jo, mami, nuk e kam bërë”. Kur Lynne e pyeti nëse kishte dëshirë ta bënte këtë, ajo tha: “Po, dua”.

Pasi folën, medituan dhe u lutën për këtë, Lynne e drejtoi vajzën e saj drejt besimit në Jezusin. Ne nuk do ta harrojmë kurrë gëzimin në fytyrën e asaj mamaje kur e takuam mëngjesin e ditës tjetër!

Kemi vënë re së fundmi se disa prindër të rinj që e duan Jezusin duket sikur kanë turp ose ngurrojnë të ulen me djalin apo vajzën e tyre për t’u prezantuar qartësisht lajmin e mirë të shpëtimit.

Nga frika se fëmija mund të “bëjë një lutje” e cila mund të mos jetë e vërtetë, prindërit ndonjëherë hezitojnë të flasin haptas e të pyesin fëmijët e tyre nëse duan t’ia përkushtojnë jetën e tyre Jezusit.

1 Gjoni 4:18 thotë: “Në dashuri nuk ka frikë, madje dashuria e përsosur e nxjerr jashtë frikën”.

Për shkak se ne i duam fëmijët tanë, duhet të heqim tutje frikërat tona, dhe të ngrihemi e t’u flasim atyre për Jezusin!

Shumë nga ata persona që shërbejnë me fëmijët sot janë duke folur për “Dritaren 4-14”. Fëmijët janë më të hapur ndaj ungjillit dhe pranimit të Jezusit ndërmjet moshës katër dhe katërmëdhjetëvjeçare.

Jezusi tha: “I lini fëmijët e vegjël të vijnë tek unë, dhe mos i pengoni, sepse atyre u përket mbretëria e qiejve” (Mateu 19:14). Si prindër, ne nuk duhet t’ia lejojmë vetes neglizhimin e ndarjes së lajmit të mirë me fëmijët tanë teksa janë të vegjël.

Ndoshta po mendoni: *Sigurisht, e kuptoj. Thjesht nuk di se si.*

Në këtë shtojcë, ne ofrojmë tetë udhëzime të cilat lutemi të jenë ndihmuese për ju teksa përpiqeni të drejtoni fëmijën tuaj drejt një

besimi shpëtues në Jezusin, dhe më pas të dishepullizoni vetë fëmijët tuaj. Ato janë:

Gëzohuni

Gëzohuni që keni privilegjin të ndani Jezusin me fëmijët tuaj. Nuk është thjesht një detyrë e ngarkuar që duhet kryer; është një thirrje argëtuese për t'u realizuar.

Tek Luka 15:10 Jezusi tha: “do të ketë gëzim në mes të engjëjve të Perëndisë për një mëkatar të vetëm që pendohet”.

Engjëjt në qiej gëzohen kur një person shpëtohet. Dhe Jezusi Vetë gëzohet kur emrat “shkruhen në qiej” (Luka 10:20).

A nuk duhet që mamatë dhe baballarët të gëzohen në privilegjin që kanë për t'u treguar fëmijëve të tyre për Jezusin si dhe të përjetojnë së bashku momentin kur djali ose vajza e tyre të pranojë Jezusin si Zot dhe Shpëtimtar? Absolutisht po!

Lexoni

Lexojuni rregullisht Shkrimet! Lexojuni atyre Gjonin 3:16 dhe flisni sesa shumë Perëndia i do ata. Tregojuni se Perëndia i do aq shumë, sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm me mision që ata të mund të shpëtohen. Tregojuni se Jezusi literalisht dha jetën e Tij në kryq për ta.

Recitoni

Recitoni atyre vargje kyçe.

Ligji i Përtërirë 6:7 u thotë prindërve t'u flasin fëmijëve të tyre për Zotin “kur rri ulur në shtëpinë tënde, kur ecën rrugës, kur ke rënë në shtrat dhe kur çohesh”.

Disa vargje që mund t'i ndani e të flisni rreth tyre me djalin ose vajzën tuaj mund të jenë: Gjoni 8:12; 10:10; 14:6, Romakëve 3:23; 6:23; 5:8; 10:9-10.

Kërkonte

Kërkojini urtësi Perëndisë lidhur me *kur* dhe *si* t'u flisni fëmijëve tuaj për marrjen e vendimit për të pranuar Jezusin si Shpëtimtar.

Lajmi i mirë është se kur ne i kërkojmë urtësi Perëndisë, Ai me zor pret që të na e japë! Jakobi 1:5 thotë: “Por në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtia, le të kërkojë nga Perëndia, që u jep të gjithëve pa kursim, pa qortuar, dhe atij do t'i jepet”.

Jezusi tha: “Lypni dhe do t’ju jepet; kërkoni dhe do të gjeni; trokitni dhe do t’ju çelet. Sepse kush lyp merr, kush kërkon gjen dhe do t’i çelet atij që troket” (Mat. 7:7-8).

Jezusi po ashtu tha: “Askush nuk mund të vijë tek unë, po qe se Ati që më ka dërguar nuk e tërheq dhe unë do ta ringjall atë në ditën e fundit” (Gjo. 6:44).

Duke qenë se kjo është e vërtetë, sigurisht që ne dëshirojmë të lutemi dhe t’i kërkojmë Atit të hapë zemrën e djalit apo vajzës tonë për të pranuar lajmin e mirë të shpëtimit! Perëndia është Ai që hap zemrat dhe Ai që zbut zemrat e ngurtësuar!

Jeremia 32:40 thotë: “Do t’u shtie në zemër dëshirë për të më adhuruar, dhe nuk do të më braktisin kurrë”. Diane është lutur herë pas here nëpërmjet këtij vargu mbi katër fëmijët tanë, dhe të mahnitur e kemi parë teksa bëhej realitet!

Pranoni

Pranoni Jezusin si Zot dhe Shpëtimtar.

Të “besoni” se Zoti ekziston është njëra anë. Bibla thotë që edhe demonët, që e urrejnë Perëndinë, e dinë se Ai ekziston (Jak. 2:19). Por është diçka krejt tjetër të “pranoni” Jezusin në jetën tuaj si Zot dhe Shpëtimtar, duke e përkushtuar veten tuaj për ta ndjekur Atë dhe për të ecur në rrugët e Tij.

Një varg i mirë që ju ndihmon t’ia shpjegoni këtë fëmijëve tuaj është Gjoni 1:12: “por të gjithë atyre që e pranuan, Ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e Tij”.

Pasi t’u jepni një model fëmijëve tuaj se si është të ndjekësh Jezusin; pasi të luteni dhe t’u flisni atyre për marrjen e vendimit për të ndjekur rrugën e Jezusit; kur ta ndjeni që është koha e duhur, bëhuni të guximshëm dhe pyetini nëse duan të pranojnë Jezusin si Zotin dhe Shpëtimtarin e tyre!

Kujtojini

Kujtojini ata vazhdimisht (pasi ta kenë pranuar Zotin) për vendimin që kanë marrë për t’ia dhënë jetën e tyre Jezu Krishtit.

Nëse ata janë shumë të rinj, është e rëndësishme që vazhdimisht t’i kujtoni në mënyrë të përsëritur se ku ishin kur janë lutur dhe i kanë dorëzuar jetën e tyre Jezusit.

Një të dielë pas kishe, po shkonim rrugës me makinë për tek shtëpia e disa miqve tanë për drekë. Djali ynë i madh, John Mark, i cili ishte vetëm katër vjeç e gjysmë në atë kohë, ishte në makinë me ne. Ai sapo kishte dëgjuar një prezantim të qartë të lajmit të mirë në grupin e fëmijëve në kishë dhe, teksa ishim në makinë, ai befas tha: “Unë dua t’ia jap jetën time Jezusit në këtë moment!”

Ndaluam makinën pranë një qendre tregtare në një bulevard të ngarkuar dhe e drejtuam atë në një lutje për të pranuar Jezusin si Zotin dhe Shpëtimtarin e tij. Pikërisht aty, në atë moment, ai u shpëtua!

Por duke qenë se ai ishte katër vjeç e gjysmë, në vitet që vijuan, sa herë që kalonim tek ai vend, ne e ndalonim makinën dhe e pyesnim: “John Mark, çfarë ka ndodhur aty?” Ai e dinte, dhe na përgjigjej: “Unë pranova Jezusin si Shpëtimtarin tim!”

Apostulli Pjetër tha: “Por unë mendoj se është e drejtë . . . t’ju mbaj zgjuar duke ua sjellë këto gjëra ndër mend” (2 Pje. 1:13).

Është e rëndësishme që së bashku t’u kujtojmë fëmijëve tanë vendimin që ata kanë marrë për të ndjekur Jezusin, dhe të përforcojmë realitetin e atij vendimi teksa ata rriten dhe maturohen.

Një mik i mirë na tha dikur se qëkur ishte djalë i vogël, derisa mbaroi gjimnazin, prindërit e tij vazhdimisht ia kujtonin atë që ai u kishte thënë: “Kur të rritem, dua t’i shërbej Jezusit si ungjilltar”. Sot, Jose Zayas është në të dyzetat e tij dhe udhëton rreth e rrotull botës duke ndarë lajmin e mirë si ungjilltar ndërkombëtar!

Mbani mend

Ju dëshironi që fëmija juaj të mbaj mend vendimin jetëndryshues që kanë bërë, kështu që flisni për vendin, kohën, natën, dhe kush ishte aty kur ata ia dhënë jetën Perëndisë. Gjithçka që i ndihmon për të mbajtur mend vendimin që ata kanë marrë teksa rriten.

Po përsa i përket pagëzimit?

Megjithëse Bibla nuk përcakton një moshë kur dikush duhet të pagëzohet, kemi zbuluar se në rastin e një fëmije të vogël është më mirë që të ndodhë më vonë, jo përpara moshës shtatë ose dhjetëvjeçare.

Megjithatë, ky është thjesht një udhëzim. Çelësi është që të jeni të ndjeshëm për çfarë po ndodh në zemrën e fëmijës tuaj.

Duke pritur derisa të jenë pak më të rritur për të hedhur hapin e pagëzimit, ata do të kenë më shumë mundësi për ta mbajtur mend këtë ngjarje, e cila biblikisht, është një ngjarje që ndodh vetëm një herë në jetë.

Me vajzën tonë Elizabeth, pritëm derisa ajo mbushi dhjetë vjeçe përpara se të konsideronim që ta lejonim të pagëzohej. Përpara kësaj moshe, ajo na e përmendte herë pas here, por më pas hutohej duke folur për diçka tjetër. Por kur mbushi dhjetë vjeçe, ajo këmbënguli me vendosmëri: “Dua të pagëzohem”. Ne patëm mundësi të bënim një bisedë të gjatë e serioze me të, duke kuptuar kështu që ajo ishte gati dhe ishte koha e duhur për të që të ndiqte Jezusin në pagëzim.

Kërkojini dikujt të bëjë fotografi gjatë pagëzimit të fëmijës tuaj. Ftoni miq që të jenë dëshmitarë të kësaj ngjarjeje të bukur. Bëni një album fotografish të cilin fëmija juaj mund ta shohë në vitet në vazhdim dhe ta ndihmojë ta kujtojë atë.

Gëzohuni Sërish

Në fund, gëzohuni sërish! Fillimisht, ju gëzoheni sepse keni privilegjin për t’u folur fëmijëve tuaj për Jezusin. Por në momentin që ata e pranojnë Atë si Shpëtimtar, ju vërtet duhet të gëzoheni, sepse emrat e tyre janë shkruar në librin e jetës (Zbu. 3:5, 20:15).

Jezusi u tha dishepujve të Tij: “gëzohuni më shumë se emrat tuaj janë shkruar në qiej” (Luka 10:20). Kështu që, mama dhe baballarë, drejtojeni fëmijën tuaj tek Jezusi! Lërin fëmijët të shkojnë tek Ai!

Gëzohuni, lexojuni, recitojuni, kërkoni, pranoni, kujtoni, mbani mend, dhe gëzohuni sërish, sepse nuk ka asgjë më të rëndësishme se kjo. Çdo gjë tjetër zbehet në krahasim me gëzimin që do të ndjeni duke ditur që ju dhe fëmija juaj do të përjetoni qiellin e ri dhe tokën e re, përjetësinë me Jezusin, përgjithmonë së bashku!

Shtojca C

Lexime të Rekomanduara

Love & Respect in the Family (Dashuri & Respekt në Familje) nga Dr. Emerson Eggerichs

Parenting: 14 Gospel Principles That Can Radically Change Your Family (Prindërimi: 14 Parime Biblike Që Mund Të Ndryshojnë Rrënjësisht Familjen Tuaj) nga Paul David Tripp

Age of Opportunity: A Biblical Guide to Parenting Teens (Moshë e Mundësisë: Një Udhëzues Biblik për Prindërimin e Adoleshentëve) nga Paul David Tripp

Parenting: From Surviving to Thriving (Prindërimi: Nga Mbijetimi tek Lulëzimi) nga Charles R. Swindoll

Loveology: God. Love. Marriage. Sex. And the Never-Ending Story of Male and Female (Dashurologjia: Perëndia. Dashuria. Martesa. Seksi. Dhe Historia-Pa-Mbarim e Mashkullit dhe Femrës) nga John Mark Comer
Garden City: Work, Rest, and the Art of Being Human (Qyteti Kopësht: Puna, Pushimi, dhe Arti i të Qenit Njeri) nga John Mark Comer

Never Say No: Raising Big-Picture Kids (Kurrë Mos Thuaj Jo: Rritja e Fëmijëve Vizionarë) nga Mark dhe Jan Foreman

Peacemaking for Families: A Biblical Guide to Managing Conflict in Your Home (Paqebërësit për Familjet: Një Udhëzues Biblik për të Administruar Konfliktin në Shtëpinë Tuaj) nga Kenn Sande

The Young Peacemaker (Paqebërësi i Ri) nga Corlette Sande

When Sorry Isn't Enough: Making Things Right With Those You Love (Kur Keqardhja Nuk Mjafton: Rregullimi i Marrëdhënieve me Ata që Do) nga Gary Chapman dhe Jennifer Thomas

Anger: Taming a Powerful Emotion (Zemërimi: Zbutja e një Ndjenje të Fuqishme) nga Gary Chapman

The Heart of Anger: Practical Help for the Prevention and Cure of Anger in Children (Zemra e Zemërimit: Ndihmë Praktike për Parandalimin dhe Kurimin e Zemërimit tek Fëmijët) nga Lou Priolo

Effective Parenting in a Defective World: How to Raise Kids Who Stand Out from the Crowd (Prindërim Efektiv në një Botë Difektoze: Si të Rritësh

Fëmijë Që Dallojnë nga Turma) nga Chip Ingram

Hands Free Mama: A Guide to Putting Down the Phone, Burning the To-Do List, and Letting Go of Perfection to Grasp What Really Matters! (Mamaja që fokusohet tek familja e saj duke lënë mënjanë çdo angazhim dytësor për t'i dhënë të dashurve të saj vëmendje e dashuri të plotë: Një Udhëzues për të Hequr Celularin nga Dora, Për të Djegur Listën e Gjërave që Duhet Bërë, dhe Për të Mos u Kapur pas Perfeksionit, por Pas Atyre Që Vërtet Kanë Vlerë!) nga Rachel Macy Stafford

Why Wait? What You Need to Know About the Teen Sexuality Crisis (Përse të Presësh? Çfarë Duhet Të Dini Rreth Krizave Seksuale të Adoleshentëve) nga Josh McDowell dhe Dick Day

Burime që do t'ju ndihmojnë të kuptoni personalitetin unik dhe dhuntitë e fëmijës tuaj:

Children Are Wet Cement (Fëmijët Janë Çimento e Lagësht) nga Anne Ortlund
The Road Back to You (Rruga për t'u Kthyer tek Ti) nga Ian Morgan Cron dhe Suzanne Stabile

Dad, Here's What I Really Need from You: A Guide for Connecting with Your Daughter's Heart

(Babi, Ja çfarë më Nevojitet Vërtetë Nga Ti: Një Udhëzues për t'u Lidhur me Zemrën e Vajzës Tuaj) nga Michelle Watson

Understanding How Others Misunderstand You: A Unique and Proven Plan for Strengthening Personal Relationships

(Të kuptosh Se Si të Tjerët të Keqkuptojnë Ty: Një Plan Unik dhe i Vërtetuar Për Fuqizimin e Marrëdhënieve Personale) nga Ken Voges dhe Ron Braund

Are My Kids on Track? The 12 Emotional, Social, and Spiritual Milestones Your Child Needs to Reach (A Janë Fëmijët e Mi në Binarë? 12 Piketa Emocionale, Sociale, dhe Shpirtërore që Fëmija Juaj Duhet t'i Arrijë) nga Sissy Goff, David Thomas, dhe Melissa Trevathan

Shënime

Shënime nga autori

1. Marku 2:15-17

Kapitulli 1: Historia Jonë

1. Elisabeth D. Dodds, Martesa me një burrë të vështirë (Marriage to a difficult man) (Filadelfia: Botimet West-minsters, 1971)

Kapitulli 2: Çmimi

1. 2 Korintasve 5:17

2. J. Warner Wallace, “A Po E Braktisin Vërtet Të Rinjtë Krishterimin?” Are Young People Really Leaving Christianity?) Cold-case Christianity, 20 Tetor 2017, <http://coldcasechristianity.com/2017-are-young-people-really-leaving-christianity/>.

3. Ibid

4. A. W. Tozer, Ndjekja e Perëndisë (Çikago, Botimet Moody, 2015), 1

5. “Kampionë shpirtërorë” është term i Barnas për atë që ne e quajmë ndjekës plot pasion për Jezusin, ose siç Bill Hybels i cilëson, “ndjekës plotësisht të përkushtuar të Jezusit”.

6. George Barna, Prindërimi Revolucionar (Wheaton, IL: Shtëpia botuese Tyndale 2007), 30

7. Ibid.

8. Mateu 6:33 (NLT)

Kapitulli 3: Historia Juaj

1. Don Devine, “Sa i gjatë është një brez?” (How long is a generation?) Ancestry.com Learning Centre, 13 Dhjetor 2017

2. Ruth Bell Graham, Plangprishësit dhe ata i duan (Prodigals and those who love them) Colorado Springs; Botimet Fokusi në familje, 1991), xiii

Kapitulli 4: Urdhërimi i Madh

1. 1 Korintasve 6:19

2. Wayne Rice, Brez pas brezi, Ide praktike dhe krijuese për të rritur fëmijë që e njohin dhe e duan Perëndinë (Generation to Generation, Practical And Creative Ideas for Raising Kids to Know and Love God) Cincinnati: Botimet Standart, 2004), 11
3. Barna, 29
4. Mark dhe Jan Foreman janë prindërit e John dhe Tim Foreman nga grupi Switchfoot.
5. Mark dhe Jan Foreman, Kurrë mos thuaj jo: Të rritësh fëmijë vizionarë (Never say no: Raising big picture kids), Colorado Springs; David C. Cook, 2015, 125
6. General William Booth; “Të trajnosh fëmijët e tu për Krishtin” (Training your children for Christ) Revista: Ditët e fundit, vëll.8, Nr.5, 44-45.
7. Dallas Willard, Konspiracioni hyjnor (The divine conspiracy), San Francisco: HarperCollins,1998.
8. Charles Spurgeon, Pasuria e Davidit (The treasury of David), vëll.2, McLean, VA: Botimet McDonald Co, 1982, 331.

Kapitulli 5: Llamba dhe Drita

1. Dr. Gerry Breshears, profesor teologjie në seminarin Western në Portland, Oregon tregon me mençuri se ky është një paralelizëm hebre, që do të thotë se urdhrat e babait dhe mësimet e mamasë i referohen së njëjtës gjë. Ndaj, pika që po nxjerr në pah shkruesi i Fjalëve të Urta është që fëmijët bëjnë mirë t'i dëgjojnë si mësimet e mamasë, ashtu edhe të babait. Thelbi që po evidentojmë është që edhe mësimet e nënës, edhe të babait janë të një rëndësie jetësore.
2. Ezdra 7:6
3. Një serial televiziv amerikan që transmetohej nga 1957 deri në 1963 duke përshkruar familjen “perfekte” në një epokë të artë.
4. Gjoni 10:10

Kapitulli 6: Qëllimet kundrejt Vlerave

1. John dhe Charles Wesley ishin themeluesit e Lëvizjes Metodiste.
2. Emerson dhe Sarah Eggerichs kanë mbajtur konferencën më të mirë për martesën nga të gjitha ato ku kemi marrë pjesë. Shihni gjithashtu librat e

tyre: Dashuri dhe respekt (Love and Respect) si dhe Dashuri dhe respekt në familje (Love and respect in the family). Mësimet biblike të mrekullueshme mbi familjen.

Kapitulli 7: Zemra e Bindur

1. Andrew Murray, Si t'i rritni fëmijët tuaj për Krishtin (How to raise your children for Christ), Minneapolis: Bashkësia Bethany, 1975, 167

Kapitulli 8: Mjete për Disiplinim

1. Kjo është një histori fantastike! Lexojeni dhe flisni për të me fëmijët tuaj për të theksuar një strategji të perëndishme për marrjen e vendimeve.

2. Robert E. Larzelere, Robert B. Cox, Jr., dhe Jelani Mandara, Reagimi ndaj sjelljeve të gabuara tek fëmijët e vegjël: Si e rrisin prindërit autoritarë arsyetimin me kontroll të palëkundur. (Responding to misbehaviour in young children; How authoritative parents enhance reasoning with firm control), Washington, D.C: Librat APA, 2013, 211.

3. St. Theophan (Shën Theofani): T'i rritësh ata në mënyrën e duhur; Këshillat e një shenjtori për rritjen e fëmijëve (Raising them right; A saint's advice on raising children), Ben Loman, CA; Botimet Conciliar, 1989, 44.

4. Adam Grant, Origjinalët: Si e lëvizin botën jo-konformistët (Originals: How non-conformists move the world), New York: Penguin, 2016, 163

5. Emerson Eggrichs ka shkruar në loveandrespect.com: Kjo ngre pyetjen: Çfarë do të thotë të fshikullosh një fëmijë me thupër? Në njërën anë lexojmë se fëmija “nuk do të vdesë”, por a do të thotë kjo që prindi mund të bëjë ç'të dojë përveçse ta vrasë fëmijën? Sigurisht që thupra mund të vrasë sipas Eksodit 21:30. Por nëse merrni përkthimin më konservativ të ‘shebet’ (thupra) për disiplinimin, nënkupton një shkop ose një degë të vogël që fshikullon, por nuk lë plagë trupore ose lëndime vdekjeprurëse. Me fjalë të tjera, fshikullimi i fëmijës me një degë të tillë nuk do ta vrasë atë. Nuk mundet. ‘Nuk do të vdesë’. Ky interpretim i fjalës ‘shebet’ është një interpretim i sigurt, konservativ dhe i vlefshëm dhe sugjerimi ynë reflekton këtë qasje të përgjithshme dhe konservative.

6. Ky citim është marrë nga Fjalët e Urta 3:11-12
7. W. E. Vine, Fjalori i zgjeruar shpjegues i fjalëve të Dhiatës së Re i Vine (The expanded vine's expository dictionary of new testament words), Minneapolis: Shtëpia botuese Bethany,1984, 1000.
8. New American standart exhaustive concordance of the bible, (Nashville, TN: Holman Bible Publishers,1981),1665
9. “Ndëshkimi i Perëndisë ndaj nesh përfshin jo vetëm ‘fshikullimin’ e Tij për shkelje specifike (me qëllim korrigjues, jo dënues), por edhe një sërë sprovash dhe shtrëngimesh që Ai cakton, të cilat shërbejnë për të mposhtur mëkatin dhe për të rritur besimin”. The complete word study dictionary new testament, (Chattanooga, TN: Botimet AMG,1993),948
10. Larzelere, Cox, Jr., dhe Mandara. “Një shuplakë e lehtë jo-abuzive çon në më shumë pajtueshmëri ose më pak agresivitet tek fëmijët 2-6 vjeçarë sesa metodat e tjera alternative të përdorura tek 10-13 vjeçarët kur përdoren ndaj përgjigjeve kundërshtuese të taktikave të zbutura disiplinuese, si, psh., një kohë reflektimi apo arsytimi”.
11. Larzelere, Cox, Jr., dhe Mandara. “Rezultatet e fëmijëve ishin më të pafavorshme nga përdorimi i ndëshkimeve fizike sesa i taktikave të tjera alternative, vetëm kur ato ishin tepër të rënda ose kur ishin metoda disiplinuese parësore.”
12. James C. Dobson, Guxo të disiplinosh (i riu), The new dare to discipline (Wheaton, IL; Tyndale Momentum, 1992, 118
13. Karyn B. Purvis, Ph. D, David R. Cross, Ph. D. Wendy Lyons Sunshine, Fëmija i lidhur (The connected child), New York: McGraw Hill, 2007, 102.
14. Spiros Zodhiates, Th.d. The complete word study dictionary new testament, (Chattanooga, TN: Botimet AMG, 1992,1088. Zodhiates thotë se disiplina është përdorur si një aktivitet i drejtuar ndaj përkujdesjes morale dhe shpirtërore, si dhe trajnimit të fëmijës për të influencuar vullnetin dhe veprimet e ndërgjegjshme. Është disiplinë edukative; të ndëshkosh me qëllim për të edukuar dikë që të përshtatet me të vërtetën hyjnore”.
15. Ibid.
16. Kjo është e njëjta fjalë hebraisht e përdorur në frazën thupra e disiplinës.

17. Disa shembuj të diçkaje tjetër që mund të jetë duke ndodhur në zemrën e fëmijës tuaj që ngjan si mosbindje kundërshtuese, por mund të mos jetë, përfshirë: frikën, përshtjellimin, dhimbjen, probleme në shkollë që po e shtojnë fëmijën tuaj poshtë, në një gjendje të keqe emocionale, në mungesë vetëbesimi apo probleme me përqëndrimin. Kjo është arsyeja pse i studiojmë fëmijët tanë dhe i kërkojmë Perëndisë të na ndihmojë që të shohim në zemrën e tyre, ndërkohë që i mësojmë ata të ecin në rrugët e Tij.

Kapitulli 9: Zemra me vetëkontroll

1. Dr. James Dobson, Zbutni shpërthimet emocionale të fëmijës tuaj *Temper Your Child's Tantrums* (Wheaton, IL: Shtëpia botuese Tyndale, 1986), 19.
2. Për më shumë detaje lidhur me menaxhimin e krizave emocionale, shihni Pjesën 3.
3. Dobson, 19.
4. Shihni Jakobi 4:8, Gjoni 15:5
5. J. Oswald Sanders, Udhëheqësia Shpirtërore, Botimi i Rishikuar (*Spiritual Leadership, Revised Edition* (Chicago: Botimet Moody, 1980), 141–145.

Kapitulli 10: Ndërtojini Ata

1. Barna, 42.
2. Foreman dhe Foreman, 109
3. Rachel Macy Stafford, Mamaja që fokusohet tek familja e saj duke lënë mënjanë çdo angazhim dytësor për t'i dhënë të dashurve të saj vëmendje e dashuri të plotë: *Një Udhëzues për të Hequr Celularin nga Dora, Për të Djegur Listën e Gjërave që Duhet Bërë, dhe Për të Mos u Kapur pas Perfeksionit, por Pas Atyre Që Vërtet Kanë Vlerë!* (*Hands Free Mama: A Guide to Putting Doën the Phone, Burning the To-Do List, and Letting Go of Perfection, to Grasp What Truly Matters* (Grand Rapids: Zondervan, 2013), 212.
4. The New American Standard Bible e përkthen trajnimin si disiplinë.
5. Shihni Efesianëve 2:10
6. Steven M. Southwick, M.D. and Dennis S. Charney, M.D., Elasticiteti: Shkenca e zotërimit të sfidave më të mëdha të jetës (*Resilience: The Science of*

Mastering Life's Greatest Challenges), (Cambridge, UK: Cambridge University Press, 2012), 13

Kapitulli 11: Kutia

1. Shihni Efesianëve 3:19 NLT “dhe ta njihni dashurinë e Krishtit që tejkalon çdo njohuri,”
2. Shihni intentionalparenting.org për tri arsytet për të cilat ne kemi përdorur thuprën e disiplinës.
3. Dave Stone, Ndërtimi i lidhjeve të ngushta familjare me besim, dashuri dhe të qeshura (Building Family Ties ëith Faith, Love and Laughter), (Nashville, TN: Thomas Nelson, 2012), 61.

Kapitulli 12: Zhvillimi i Karakterit

1. Fokusi i eksperiencës sonë, trajnimi dhe mësimi ka të bëjë me studime biblike dhe kujdes pastoral, jo me zhvillimin fëmënor. Ne i nxitim prindërit që të jenë vigjilentë ndaj simptomave biologjike dhe / ose neurologjike që mund ta bëjnë të pamundur që fëmijët e tyre t'i përgjigjen disiplinës dhe mësimit njëjloj si fëmijët e tjerë.

Ka çrregullime të të mësuarit dhe vështirësi fizike si ADHD, sindroma e alkoolit fetal, probleme shqisore dhe intolerancë ndaj ushqimit që ndonjëherë maskohen si probleme sjellje ose karakteri. Kini kujdes dhe kërkoni ndihmë profesionale sipas nevojës kur lindin probleme të pakuptimta.

2. Faleminderit Emerson dhe Sarah Eggerichs, për këtë propozim të thjeshtë e të thellë njëkohësisht.
3. Shihni Mateu 21:12-13
4. David Poëlison, Fëmijë të zemëruar: Të kuptuarit dhe të ndihmuarit e fëmijës suaj të rimarrë kontrollin (Angry Children: Understanding and Helping Your Child Regain Control (Greensboro, NC: New Growth Press, 2008), 5.
5. Fjalët e Urta 22:15 thekson problemin e marrëzisë me të cilin të gjithë kemi lindur. Në vend që të vepron i tmerruar kur fëmija juaj vepron marrëzisht, jini proaktivë duke e udhëhequr djalin ose vajzën tuaj drejt konfidencës shoqërore dhe emocionale.

6. Një nga gjërat më të mira që Phil bëri me të dy djemtë tanë ishte shpërndarja e gazetave bashkë me ta. Ai ua bëri atë aq argëtuese saqë ata u rritën me kujtime të këndshme të atyre orëve të para të mëngjesit të shpërndarjes së gazetave. Pasi paguanin për karburantin (nuk kishte variant të shpërndarjes me biçikleta në dispozicion), fëmijët mbanin paratë e tyre dhe mësonin se si të jepnin të dhjetën, të kursenin, të ishin bujarë dhe të shijonin pjesën tjetër.

7. Dr. Gerry Breshears vëren: “Kjo është një nga ato fjalë vërtet të mëdha në Dhiatën e Vjetër. Zakonisht përkthehet ‘i patëmetë’, i shëndetshëm, i plotë, i përsosur. Është e ngjashme me ‘i patëmetë’ për pleqtë në 1 Timoteut 3. Shihni Zakarian tek Luka 1 dhe të tjerët.”

8. Shihni gjithashtu Predikuesi 9:10

Kapitulli 13: Ndërtimi i Marrëdhënieve

1. Shihni Efesianëve 1:7-8

2. Jon Courson është pastori i Bashkësisë së Krishterë Applegate në Jacksonville, OR. Kështu e shpjegon ai Gjonin 15: 5.

3. Faqja e Facebook-ut Biseda rreth Familjes e Dr. Dobson, 21 janar 2017 <https://www.facebook.com/DrJamesDobsonsFamilyTalk/posts/10153943269166735>.

4. Lexoni historinë e bijve të Adamit dhe Evës, Kainit dhe Abelit, tek Zanafilla 4.

5. Lexoni Filipianëve 2: 1–11 për gjithë kontekstin e bukur.

6. Për një shpjegim të shkëlqyeshëm dhe të plotë të një mënyre efektive për t'i bërë gjërat siç duhet, ne rekomandojmë shumë Kur Keqardhja Nuk Mjafton (When Sorry Isn't Enough) nga Gary Chapman (autor i Pesë Gjuhët e Dashurisë - The Five Love Languages) dhe Jennifer Thomas.

Kapitulli 14: Trajnimi Shpirtëror

1. Shihni intenalparents.org për burime.

2. Shihni intenalparents.org për Biblat që rekomandojmë për fëmijët në këtë fazë.

3. Barna, 31.

4. Faleminderit, Glenn Miller, për mësimin e mençur dhe të ekuilibruar që derdhët në ne në ato vite të hershme.
5. Mark Buchanan, Zoti Juaj Është Shumë I Sigurt, *Your God Is Too Safe* (Colorado Springs: Multnomah, 2001), 131.
6. M'u deshën shumë vite të tjera të mësoja të dëgjoja për të kuptuar se nuk kisha nevojë të vija në kishë e veshur me rrobat e mia më të mira. Mund ta lexoni atë histori në librin tim, *Ai flet në heshtje* (Grand Rapids: Zondervan, 2015).
7. Shihni <https://en.wiktionary.org/wiki/kindergarchy>.
8. Shihni Gjoni 15:1–5.
9. John Lawrence, Shtatë Ligjet e të Korrave, *Seven Laws of the Harvest* (Grand Rapids, MI: Botimet Kregel, 1975), 92

Kapitulli 15: Katër Gjëra Që Do T'ju Nevojiten

1. Mark Twain, Zgjuarsia dhe Mençuria e Mark Twain: Një libër me citime, *The Wit and Wisdom of Mark Twain: A Book of Quotations* (Mineola, NY: Botimet Dover, 1998), 120.
2. Barna, 43 vjeç.
3. Joshua McDowell dhe Dick Day, Pse të presim? Çfarë duhet të dini rreth krizës së seksualitetit në adoleshencë, *Why Wait? What You Need to Know About the Teen Sexuality Crisis* (San Bernardino, CA: Here's Life Publishers, Inc., 1987), 178.
4. Jim Burns, "Fuqia e Të Sjellurit atje", "The Power of Bring There," *HomeWord*, 5 janar 2015, <https://homeword.com/articles/the-power-of-being-there/#.WjFueVWnGM8>.
5. Shauna Niequist, Bukë dhe verë, *Bread and Wine* (Grand Rapids, MI: Zondervan, 2015), 258.
6. Lexoni të gjithë historinë në 2 Kronikave 20.
7. Gary W. Smith, Mendime Jetë-ndryshuese, *Life-Changing Thoughts* (Bloomington, IN: AuthorHouse, 2009), 482.

Kapitulli 16: Tre sekrete që funksionojnë

1. Në librin e shkëlqyeshëm të Emerson Eggerich, Dashuri dhe Respekt në Familje, Love & Respect in the Family ai shpjegon pse - veçanërisht për burrat - kjo lloj bisede krah për krah është më e mirë sesa përballja “më shiko në sy!”.
2. Shihni 2 Kronikave 16: 9.
3. Për një shpjegim të plotë të kuptimit të mjetit të korrigjimit, shihni kapitullin 10
4. Shikoni kapitullin 6.

Kapitulli 17: Tri Gjëra Që Do T’i Nevojiten Adoleshentit Tuaj

1. Shihni Psalmin 139: 14.
2. Faleminderit pastor Jon Courson të Fellowship Christian Applegate për këtë reflektim.
3. Për më shumë rreth dhuntive shpirtërore, shihni Romakëve 12: 4–8, 1 Korintasve 12: 4–11, 28.
4. John Mark është pastori i një kishe të madhe në qytetin Portland. Shikoni faqen e internetit në <http://bridgetown.church>.
5. Shihni Kantiku i Kantikëve.
6. Materialet e rekomanduara mund të gjenden në intenalparents.org.
7. Shihni Fjalët e Urta 30:19.
8. Jim Burns, Pesë Çelësat Për T”u Mësuar Fëmijëve Seksualitetin E Shëndetshëm, Five Keys for Teaching Kids Healthy Sexuality (Bloomington, MN: Bethany House, 2008).
9. Shih Fjalët e Urta 4:23 NASB, “Ruaje zemrën tuaj me shumë kujdes, sepse nga ajo dalin burimet e jetës”.
10. “Pornografia në internet sipas numrave; një kërcënim i rëndësishëm për shoqërinë,” Webroot, vizitoi 13 dhjetor 2017, <https://www.webroot.com/us/en/home/resources/tips/digital-family-life/internet-pornography-by-the-numrat>
11. Ibid.

12. David Briggs, “Arsyeja Nr.1 që Adoleshentët e Mbajnë Besimin edhe Kur Rriten”, Huffington Post, 29 Dhjetor 2014, http://www.huffingtonpost.com/david-briggs/the-no-1-reason-teens-kee_b_6067838.html #.
13. Susanna Schrobsdorff, “Fëmijët nuk janë në rregull”, The Kids Are Not All Right TIME Vol.188, Nr. 19, 47.
14. Shekar Raman, MD, cituar nga Diana Spechler në “Fuqia e prekjes: Si kontakti fizik mund të përmirësojë shëndetin tuaj”, Huffington Post, 14 maj 2013, https://www.huffingtonpost.com/2013/05/14/the-fuqia-e-kontaktit-shendetit-kontakt-fizik-shendetesor_n_3253987.html.
15. Charles R. Swindoll, Prindërimi: Nga Mbijetesa në Lulëzim, Parenting: From Surviving to Thriving (Nashville: Thomas Nelson, 2008), 20.

Kapitulli 18: Kutia Tani

1. Sharon Jayson, “Kush po ndihet i stresuar? Të rinjtë, tregon sondazhi i ri.” USA Today, 7 Shkurt 2013. <http://www.usatoday.com/story/news/nation/2013/02/06/stress-psychology-millennials-depression/1878295/>.
2. Franklin Graham dhe Donna Lee Toney, Citime të Billy Graham (Nashville: Thomas Nelson, 2011), 118.
3. Bob Goff, Twitter, 30 maj 2017.
4. Kemi ndërthurur së bashku këtu përkthimet NASB dhe NLT të Filipianëve 1: 6.

Kapitulli 19: Lista

1. Zodiates, 1198.
2. Këto “Letra për Tim Bir” mund të gjenden në arkivat e blogut të Dianës, hespeaksinthesilence.com.
3. John Mark Comer, Dashurologjia: Perëndia. Dashuria Martesa. Seksi Dhe Historia Pambarim e Meshkujve dhe Femrave (Grand Rapids, MI: Zondervan, 2014).
4. Megjithëse disa e hedhin poshtë të dhjetën si një koncept të Dhiatës së Vjetër, Jezusi pohoi praktikimin e saj te Mateu 23:23. Ne besojmë se e dhjeta është një vend i shkëlqyeshëm për të filluar një jetë dhënieje. Shihni gjithashtu Malakia 3: 8–11 dhe 2 Korintasve 9: 6–11.

5. Shihni Luka 16: 10–12, Mateu 25:21.
6. Bukhanan, 131.
7. Vizitoni <https://www.inentionalparents.org> për një kopje falas të planit të leximit të Shkrimit të Phil-it.
8. Kjo është deklarata e misionit të Westside: Kisha e Jezusit në Portland, Oregon.
9. Jan Johnson, “Formacioni Shpirtëror i Qëndrueshëm”, Jan Johnson, 2015, <http://janjohnson.org/pdf/Contagious.pdf>.
10. Anania dhe Pali tek Veprat 9, Korneli dhe Pjetri tek Veprat 10.
11. Shihni Veprat 21: 8–14.
12. Shihni Jeremia 17: 8, Jakobi 3: 6, Psalmi 42: 1.
13. Dallas Willard, Dëgjimi i Zotit, Botimi i Përditësuar dhe i Zgjeruar, Hearing God, Updated and Expanded Edition (Downers Grove, IL: libra IVP, 2012), 143.
14. Diane Comer, Ai flet në heshtje: Gjetja e intimitetit me Perëndinë duke mësuar të dëgjosh (Grand Rapids, MI: Zondervan, 2015).

Kapitulli 20: Vendosja e çatisë

1. Shihni gjithashtu Shtojcën B: Drejtimi i Fëmijës tek Jezusi.
2. Edward M. Bounds, Fuqi përmes lutjes (Grand Rapids, MI: Baker Book House, 1972), f. 31.

Kapitulli 21: Bekimi, Kutia dhe çelësi

1. “Dhe unë jam i bindur dhe i sigurt për këtë gjë, se Ai që e nisi një punë të mirë në ju do ta vazhdojë deri në ditën e Jezu Krishtit [deri në kohën e kthimit të Tij], duke e zhvilluar [atë punë të mirë] dhe duke e përsosur dhe sjellë atë deri në përfundimin e plotë në ju” (Filipianëve 2: 6 AMP).

Shtojca A: Rindërtimi

1. Psalmi 11: 3 NASB
2. Përkthyer gjithashtu hir.
3. Shihni Psalmin 23: 3.

Mirënjohje

Ky libër ka qenë në proces për gati dyzet vjet – ndaj një listë e plotë e personave që kanë kontribuar dhe i kanë dhënë këtij materiali me shumë mundësi është e pamundur. Megjithatë, do të veçojmë disa prej tyre:

Së pari dhe më e rëndësishmja, duam të falenderojmë Perëndinë i cili na shpëtoi, na pastroi nga ndyrësitë e akumuluar gjatë viteve që jetonim të ndarë prej Tij, dhe më pas derdhi pasuri të pamerituara fillimisht në shpirtat tanë, dhe më pas në shtëpinë tonë.

Fëmijëve tanë: John Mark, Bekah, Elizabeth, dhe Matt. Ju keni parë anët tona më të këqija dhe keni vendosur të rishkruani historinë nëpërmjet syve të hirit. Do ta kalojmë pjesën e mbetur të jetës tonë duke u përpjekur të jetojmë në përputhje me dashurinë tuaj besnike dhe të mëshirshme.

Tammy-t, Simonës, Steve-t, dhe Brook, për gjithë hirin që na jepni. Ju jeni martuar në një familje me mentalitete shumë të forta, dhe në vend që të rrotullonit sytë ndaj nesh, u përshtatët e u bëtë pjesë e jona duke ua shtuar urtësinë tuaj bisedave. Secilin prej jush e duam si fëmijët tanë!

Simo, përkujdesja jote ndaj mamasë së Dianës në ditët e saj të fundit na dha lirinë ta përfundonim punën e nisur.

Prindërve tanë, të cilët mësuan të ndjekin Jezusin nga fundi i jetës së tyre, faleminderit. Ju modeluat përlulësinë, ndërsa demonstruat fuqinë e Frymës që ndryshon jetë. Na mungoni tmerrësisht shumë.

Bill dhe Laurie Keyes, të cilët kanë shpenzuar orë të pafundme duke këshilluar, mësuar, nxitur, shpjeguar, dhe përshkruar se si duhet të jetë një familje që ndjek Jezusin. Pjesa më e madhe e asaj që kemi aplikuar dhe tashmë u mësojmë të tjerëve është plagjiaturë e pastër. Ne ju kopjuam atëherë, dhe shpresojmë të vazhdojmë t'ju kopjojmë përmes fazave të ardhshme të jetës sonë.

Pleqve të kishës sonë, të cilët patën vizionin të na linin mënjane për gjashtë muaj që t'i vendosnim të gjitha në formën e mësimdhënies: Steve Marshman, Todd Newell, Peter Quint, Matt Norman, dhe Tony Viducich. Dhe djali ynë, John Mark Comer, i cili drejtoi kauzën.

Falenderime shkojnë për persona të ndryshëm të cilët në mënyrë të palodhur na kanë ndihmuar me hulumtimet: Daniel Golder (drejtshkrimin grek dhe hebre), Richard Tamburro (shqyrtimin teologjik), Sunny Grover (ato

tabelat e grafikët!), Tyler Haans (për diagramët e shtëpive), Melody dhe Alex Graeber (statistikat, artikujt, thëniat, burimet, librat), dhe Kathie Taggart (je mbretëresha e citimeve!)

Faleminderit Dr. Gerry Breshears, profesor i Teologjisë në Western Seminary, që u sigurove se i kemi interpretuar saktësisht Shkrimet që kemi përdorur në mësimet dhe shkrimin tonë. Jeni një burrë i perëndishëm, i hirshëm, dhe me një durim të pafund. Respekti ynë për atë që jeni, dhe po ashtu për ato që dini, vazhdon të rritet.

Për pastorin dhe autorin Chuck Bomar, që na tregoi se ndërtimi i një martese të mirë është si vendosja e armaturës në themelin e shtëpive tona. Brillante. Për Cyndi dhe Alex Guidry, të cilët besojnë tek ne dhe na e bëjnë të ditur këtë gjë vazhdimisht. Së bashku, ju jeni familja më e mirë e përzier që ne njohim. Cyndi, ti meriton një titull (Ph.D) në Gjuhën e Inkurajimit. Dhe për Jay dhe Michelle Fordice të cilët na kanë këshilluar, kanë besuar tek ne, dhe na kanë ndihmuar që ta vazhdojmë këtë shërbesë – t’ju shihnim ju duke rritur me qëllim tre burra-të ardhshëm na jep shpresë për brezin e ri.

Për morinë e miqve të cilët na dhanë kontribut të perëndishëm që ka ndikuar mënyrën se si kemi prindëruar fëmijët tanë, por edhe çfarë u mësojmë prindërve tani: Glen dhe Patty Miller, Stan dhe Cindy Campbell, Todd dhe Danita Newell, Jan Bisenius, dhe Mary Courson. Dhe për Jodi Hughes, urtësia dhe perceptimet e së cilës na kanë mundësuar të kuptojmë shqetësimet specifike të prindërve beqarë.

Për bordin ndërkombëtar të Intentional Parents (Prindërve të Qëllimshëm): Tim dhe Brittany McDonald, si dhe Tony dhe Beth Vidulich. Ju jeni disa prej prindërve më të qëllimshëm që ne njohim, e po ashtu edhe partnerët tanë më të ngushtë në shërbesë. Faleminderit për orët e pafundme në lutje, mbështetjen, këshillat, strukturën, urtësinë, dhe miqësinë e dhënë.

Diane ka dëshirë të falenderojë mikeshat e saj: Julie Kohl, Melody Dobson, Mary Kay Taylor, Jodi Stilp, dhe Ann Menke. Ju më keni mbajtur në lutje, më keni ftuar (okej, detyruar) që të dal dhe të luaj, dhe më keni inkruajuar që të vazhdoj të shkruaj kur mendoja që nuk mundesha. Ju jeni mikeshat – komuniteti im më i afërt – që jepni më shumë sesa merrni, më shumë sesa unë do të meritoj ndonjëherë. Ju dua.

Phil dëshiron të falenderojë pastorin Dominic Done dhe pleqtë e tanishëm të Westside, A Jesus Church të cilët na kanë dhënë lirinë të vazhdojmë të përmbushim thirrjen tonë për të sjellë shpresë dhe për të ndihmuar prindërit teksa ende i shërbejmë Jezusit si pjesë e ekipit të pastorit / pleqve.

Për Michael dhe Rhonda Cotton, të cilët na ftuan të shijojmë shtëpinë e tyre të bukur të plazhit, duke na dhënë dhuratën e një vendi të qetë për të shkruar, ku shpërqëndrimi i vetëm ishte pamja befasuese. Faleminderit për zemrat tuaja bujare.

Për Bill Jensen, agjenti letrar i jashtëzakonshëm. Dikush harroi të të thoshte se sapo të firmosnim kontratën, puna jote mbaronte. Por përkundrazi, ti na këshillove, trajnove, inkurajove dhe ke shtuar përmbajtje, duke e mbartur me vete kompjuterin gjatë drekës tek Jefe's aq shpesh sa nuk numërohen.

Carolyn McCready, nga t'ia nisim për të të falenderuar ty? Ti ke hapur dyer për ne duke qenë një mike e vërtetë dhe një inkruajuese e palodhur. Si ka mundësi që nuk të mbarojnë kurrë energjitë, nuk ankohesh kurrë, dhe ke gjithmonë kohë?

Mick Silva, ti ke redaktuar ato pjesë më-pak-të-hirshme, duke na sfiduar të rimendojmë e të rishkruajmë deri sa të thonim atë që vërtetë nënkuptonim. Je një redaktor tepër i talentuar dhe një kritik i ndjeshëm, si dhe një njeri i shkëlqyer. Urojmë që vajzat e tua të rriten duke kuptuar çfarë babai të rrallë që kanë.

Harmony Harkema, je më e mira! Puna jote e mundimshme për të zbutur fjalitë e çuditshme, dhe për t'u siguruar që çdo citim të ishte burim i saktë, bashkë me mbështetjen tënde entuziaste dhe fjalët e këndshme, na kanë dhënë energjinë që na nevojitej për të përfunduar misionin.

Për pjesën tjetër të ekipit Zondervan: Kait Lamphere dhe Curt Diepenhorst për krijimin e një libri të bukur; Bridgette Brooks, Jennifer Verhage dhe Tom Dean, që na kanë udhëzuar me durim përmes këtij projekti.

Së fundmi, duam të falenderojmë qindra prindër që kanë ardhur në konferencat tona të Prindërimit të Qëllimshëm në SHBA dhe në mbarë botën me dëshirën për të dëgjuar dhe mësuar, për të mbajtur shënime dhe për të bërë pyetje, për të na treguar historitë dhe për të hapur zemrën – jeni pasuri e çmuar për ne.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Comer, Phil

*Rritja e ndjekësve pasionantë për Jezusin : fuqia
e prindërimit të qëllimshëm / Phil Comer, Diane*

*Comer; përkth. Mirela Zefi, Elisa Zefi;
red. Zefjan Nikolla.*

- Tiranë : Erik, 2021

304 f. ; A5.

*Tit. origj.: Raising passionate Jesus followers :
the power of intentional parenting*

ISBN 978-9928-275-67-7

I.Comer, Diane

1.Familja 2.Prindi dhe fëmija 3.Aspekte fetare

27 - 45